



UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”

FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE

DEPARTAMENTI I GJUHËSISË

DISERTACION

PËR FITIMIN E GRADËS SHKENCORE:

“DOKTOR I SHKENCAVE ALBANOLOGJIKE”

TEMA

**MBI KATEGORINË E KOHËS DHE MËNYRËS NË FOLJET E GJUHËS SHQIPE
DHE GJERMANE**

KANDIDATI

UDHËHEQËSI SHKENCOR

Edesa PAHESHTI

Prof. dr. Emine SADIKU

Elbasan, 2021

Doktoratë

Përgatitur nga: Edesa Paheshti

Për marrjen e gradës shkencore „DOKTOR“

Specialiteti: Morfologji (Gjuhësi)

*MBI KATEGORINË E KOHËS DHE MËNYRËS NË FOLJET E GJUHËS SHQIPE DHE
GJERMANE*

Udhëheqësi shkencor: **Prof. dr. Emine Sadiku**

Mbrohet më datë, para jurisë:

1. _____ (Kryetar)
2. _____ (Anëtar)
3. _____ (Anëtar)
4. _____ (Anëtar)
5. _____ (Anëtar)

Deklaratë

Deklaroj në përgjegjësinë time të plotë e ky punim është hartuar nga unë dhe për çdo formulim apo informacion i cili nuk është i imi, kam respektuar të gjitha rregullat e citimit dhe referimit.

Deklaroj se në këtë punim nuk ka vend plagjiatura në asnjë pjesë të tij.

Edesa Paheshti

Abstrakt

Studimi “Mbi kategorinë e kohës dhe mënyrës në foljet e gjuhës shqipe dhe gjermane” përbën një përpjekje serioze për të evidentuar përqasjet dhe ndryshimet e mënyrave dhe kohëve të këtyre dy gjuhëve, të trajtuara kryesisht në rrafshin morfologjik e semantik, duke i lënë një vend të veçantë edhe gramatikës së tekstit.

Shqipja edhe gjermanishtja, të cilat rezultojnë të pasura me një sistem zgjedhimi tejet të zhvilluar, i janë nënshtruar një procesi të gjatë evoluimi e riorganizimi. Studimi trajton fillimisht kategoritë e mënyrës dhe kohës në të dyja gjuhët, duke vijuar me një tablo përmbledhëse teoriko-krahasuese mbi ndërtimet morfologjike të kohëve në shqipe e gjermanishte. Në mënyrë intensive janë trajtuar kuptimet dhe përdorimet e formave gramatikore të secilës kohë e mënyrë në aspektin krahasues. Studimi i kushton vëmendje edhe gramatikës së tekstit, duke qenë se e konsiderojmë si platformë solide në kuadrin e krahasimit të dy gramatikave.

Studimi ofron vërejtje me vlerë teorike dhe nxjerr në pah vlerat gramatikore me të cilat tri mënyrat e pranura për gjermanishten mbulojnë gjashtë mënyrat e pranura për shqipen. Në këtë studim kemi dhënë përqasjet midis dëftores në shqipe dhe asaj në gjermanishte duke evidentuar edhe përdorime të tjera të dëftores në gjermanishte, të cilat i tejkalojnë përdorimet e dëftores në shqipe. Studimi tregon se mënyra urdhërore në të dyja gjuhët ka përqasje në nivelin formal, modal, semantik dhe funksional - si shqipja edhe gjermanishtja përdorin forma të tjera gramatikore, të cilat trajtohen si konkurruese të urdhërores. Në mungesë të mënyrave dëshirore dhe habitore gjermanishtja ngërthen një kompleks elementesh morfologjike, sintaksore dhe semantike për të shprehur një urim, mallkim apo habi. Më tej thesojmë se funksionet dhe përdorimet e lidhore në shqipe janë të ndryshme nga ato të lidhore në gjermanishte, si dhe ndërtimet me folje në mënyrën kushtore në shqipe jepen me folje në mënyrën lidhore në gjermanishte.

Për realizimin e këtij studimi është përdorur metoda krahasuese-sinkronike duke evidentuar jo vetëm ndryshimet, por dhe përqasjet në gramatikën e foljes në shqipe e në gjermanishte. Metoda krahasuese shtrihet në hulumtimet empirike duke vënë përballë kuptimet, përdorimet e kohëve të foljeve dhe mënyrave.

Fjalë kyçe: kategori gramatikore, ekuivalencë morfologjike, rendi semantik, vlerë kuptimore, kuptim kohor, paskohshmëri, ngjyrim modal, folje modale, habi, intonacion

Abstract

The study "Mood and tense in Albanian and German" is a serious effort of the author to identify the similarities and differences in mood and tense occurring in these two languages, treated mainly at morphological and semantic level, paying special attention to the text grammar.

The verbal system is in both languages quite rich in tense forms. Both verbal systems have undergone a long process of evolution and reorganization. This study deals firstly with the categories of mood and tense in both languages, followed by a theoretical comparative overview on the morphological structure of tenses in Albanian and German. The meanings and uses of the grammatical forms of tenses and moods are compared intensively. The study also pays attention to the grammar of the text, considering it a solid platform in the context of comparing these two languages.

The study offers several theoretical considerations as well highlights the grammatical values by which the three accepted moods for German cover the six accepted moods for Albanian. In comparing the two languages, we have shown the approaches between the Indicative in Albanian and in German by identifying further uses of this mood in German, which exceed the use of the Indicative in Albanian.

The study shows approaches of the Imperative in both languages in the formal, modal, semantic and functional levels - both Albanian and German also use other grammatical forms, which are treated as competitors of the Imperative. The German language manages to use various morphological, syntactic and semantic elements to express a wish, curse, or surprise due to the loss of the Optative and Admirative. We further note that the functions and uses of the Conjunctive in Albanian are different from those of the Conjunctive in German, as well as the structures with the verb in the Conditional mood in Albanian are rendered with Conjunctive in German.

This study uses a comparative-synchronous method, which enables not only to identify the differences, but also to compare the grammar of the verb in Albanian and German. The comparative method extends to empirical research by confronting meanings of the tenses, their uses and the moods.

Keywords: grammatical category, morphological equivalence, semantic order, semantic value, temporal meaning, temporality, modal value, modal verb, wonder, intonation

Mirënjohje

Është e vërtetë që ky punim mban një emër, por realizimi i tij nuk do të kishte qenë i mundur pa mbështetjen, ndihmesën dhe frymëzimin e shumë personave. E pra, sot dëshiroj të shpreh publikisht mirënjohjen time e të falënderoj të gjithë ata që më kanë mbështetur në ecurinë dhe përmbylljen e doktoraturës.

Fillimisht falënderimi im shkon për udhëheqësen time të nderuar Prof. dr. Emine Sadiku (Teichmann), së cilës i shpreh mirënjohjen time të thellë që më ka mbështetur, udhëzuar, inkurajuar e frymëzuar gjatë tërë punimit shkencor duke i dhënë atij formë e frymë.

Në veçanti doja të falënderoja Prof. asoc. Albert Riska, pa mbështetjen dhe këshillat e të cilit unë nuk do të kisha mundur të realizoja këtë ëndërr profesionale.

Mirënjohja ime shkon edhe për profesorin e nderuar Prof. dr. Roland Gjini, i cili më ka mbështetur dhe inkurajuar gjithmonë në kërkimet e mia shkencore.

Kolegen, shoqen time aq të mirë, Prof. asoc. Teuta Toska e falënderoj me gjithë zemër për mbështetjen e saj të vyer.

Shumë falënderime nga thellësia e zemrës shkojnë për familjen time, për bashkëshortin tim, Sokolin, i cili ka qenë një shpatull e fortë mbështetjeje për mua dhe nxitës i vazhdueshëm, që nga fillimi e deri në përmbylljen me sukses të këtij rrugëtimi të gjatë. Mirënjohje pa fund për dy fëmijët e mi aq të shtrenjtë, Esterin dhe Alesandron, të cilët janë gëzuar për mua dhe me mua për çdo sukses timin.

PËRMBAJTJA

HYRJE	I
0.1. Objekti i punimit	ii
0.2. Struktura e punimit	iv
0.3. Metodatat e punimit	vi
0.4. Rëndësia e punimit	vi
KREU I	1
KATEGORIA GRAMATIKORE E MËNYRËS DHE KOHËS NË SHQIPE DHE GJERMANISHTE	1
1.1. Kategoria gramatikore e mënyrës dhe kohës në shqipe dhe gjermanishte	1
1.2. Kategoria gramatikore e mënyrës	2
1.3. Kategoria gramatikore e kohës	5
KREU II	8
MËNYRAT E FOLJES – NDËRTIMI MORFOLOGJIK I KOHËVE	8
2.1 Mjetet e ndërtimit të formave foljore	8
2.2. Format gramatikore të mënyrës dëftore	11
2.2.1. Koha e tashme	11
2.2.2. Koha e pakryer, e kryer e thjeshtë e shqipes dhe preteritumi i gjermanishtes ...	14
2.2.3. Koha e kryer	16
2.2.4. Koha më se e kryer, koha e kryer e tejshkuar në shqipe dhe më se e kryer në gjermanishte	18
2.2.5. Koha e ardhme	19
2.2.6. Koha e ardhme e përparme	21
2.2.7. Koha e ardhme e përparme e së shkuarës	22
2.3. Mënyra habitore	22
2.3.1. Koha e tashme	23

2.3.2. Koha e pakryer	24
2.3.3. Koha e kryer	24
2.3.4. Koha më se e kryer	25
2.4. Mënyra lidhore	26
2.4.1. Koha e tashme	26
2.4.2. Koha e pakryer	27
2.4.3. Koha e kryer	29
2.4.4. Koha më se e kryer	30
2.4.5. Koha e ardhme dhe e ardhme e përparme lidhore në gjermanishte	31
2.5. Mënyra kushtore	33
2.5.1. Koha e tashme	33
2.5.2. Koha e kryer	33
2.6. Mënyra dëshirore	34
2.6.1. Koha e tashme	35
2.6.2. Koha e kryer	36
2.7. Mënyra urdhërore	36
 KREU III	 41
MËNYRA DËFTORE	41
3.1. Mënyra dëftore në shqipe dhe gjermanishte	41
3.1.1. Koha e tashme	45
3.1.2. Koha e pakryer, e kryer e thjeshtë e shqipes dhe preteritumi i gjermanishtes	54
3.1.3. Koha e pakryer e shqipes përballë preteritumit të gjermanishtes	60
3.1.4. Koha e kryer e thjeshtë e shqipes përballë preteritumit të gjermanishtes	66
3.1.5. Kohët e thjeshta të shkuara si kohë drejtuese në rrëfim	74
3.1.6. Koha e kryer	77
3.1.7. Koha më se e kryer, e kryer e tejshkuar në shqipe dhe më se e kryer	

në gjermanishte	83
3.1.8. Koha e ardhme	88
3.1.9. Koha e ardhme e përparme	95
3.1.10. Koha e ardhme e së shkuarës dhe e ardhme e përparme e së shkuarës në shqipe	99
3.1.11. Koha e ardhme e së shkuarës në shqipe dhe format gjegjëse në gjermanishte	100
3.1.12. Koha e ardhme e përparme e së shkuarës në shqipe dhe format gjegjëse në gjermanishte	102
KREU IV	105
MËNYRA HABITORE	105
4.1. Mbi mënyrën habitore në shqipe dhe gjermanishte	105
4.1.1. Mënyra habitore në shqipe	107
4.1.2. Koha e tashme	110
4.1.3. Koha e pakryer	114
4.1.4. Koha e kryer	115
4.1.5. Koha më se e kryer	116
4.1.6. Shprehja e habisë në gjermanishte.....	116
4.1.7. Shprehja gramatikore e mënyrës habitore në shqipe dhe format gjegjëse në gjermanishte – ilustrime me shembujsh	122
KREU V	125
MËNYRA LIDHORE	125
5.1. Mënyra lidhore në shqipe dhe gjermanishte	125
5.2 Marrëdhënia " <i>ligjëratë e zhdrejtë:Konjunktiv</i> " në gjermanishte përballë kthimit në ligjëratë të zhdrejtë në shqipe	159
5.3. Konjunktiv II në gjermanishte – shprehje e mirësjelljes	162
KREU VI	165

MËNYRA KUSHTORE	165
6.1. Mbi mënyrën kushtore në shqipe dhe gjermanishte	165
6.2. Përdorime të mënyrës kushtore në shqipe dhe format gjegjëse në gjermanishte	167
KREU VII	172
MËNYRA DËSHIRORE	172
7.1. Mbi mënyrën dëshirore në shqipe dhe gjermanishte	172
7.1.1. Mënyra dëshirore në shqipe	174
7.1.2. Koha e tashme	175
7.1.3. Koha e kryer	176
7.1.4. Vështrimi semantiko-pragmatik i mënyrës dëshirore në gjuhën shqipe	178
7.1.5. Shprehja e dëshirës në gjermanishte	180
KREU VIII	185
MËNYRA URDHËRORE	185
8.1. Mënyra urdhërore në shqipe dhe gjermanishte	185
8.2. Format konkurruese të urdhërores	193
Përfundime	197
Pasqyrë mbi mënyrat dhe kohët përkatëse në diatezën vepore dhe pësore në shqipe dhe gjermanishte	222
Bibliografia	225
Literatura artistike e shfrytëzuar	230

HYRJE

Shumë gjuhëtarë dhe gramatika¹ e shohin dhe e trajtojnë gramatikën e foljes si bërthamën e çdo gramatike. Pozicioni sintaksor i foljes përcakton në mënyrë vendimtare strukturën e fjalisë. Në teorinë e valencave folja trajtohet si e vetmja gjymtyrë kryesore e fjalisë, ajo është “regens”, drejtuesi superior. Që nga Tesnieri (Tesnier) kryefjala nuk e ka më rolin e gjymtyrës kryesore duke u parë njësoj si të gjitha argumentet e tjera, si gjymtyrë e varur nga folja.

Është detyrë e foljes që të shprehë e të përçojë te dëgjuesi udhëzime mbi atë çka është menduar duke e instruktuar bashkëbiseduesin për një qëndrim adekuat. Me larminë e formave gramatikore, sasinë dhe peshën e kuptimeve leksiko-gramatikore, me funksionet sintaksore dhe me shumë veçori dhe aftësi të tjera (shumë madje ende të pazbuluara) folja ka qenë dhe do të mbetet objekt i përhershëm studimi në të gjitha rrafshet gjuhësore e më gjerë, në disiplina të afërta e të largëta me gjuhësinë. Vlera, bota kuptimore-afektive dhe rëndësia e veçantë e foljes ka qenë shtysa kryesore që më nxori në rrugën e një studimi sa interesant aq dhe të vështirë mbi këtë kategori. Jemi përpjekur të themi fjalën tonë modeste mbi këtë “dukuri” të sistemit abstrakt, që shfaq në ligjërim veçori formale dhe një potencë semantike-kuptimore të parrokshme (komplet) nga mendimi gjuhësor.

Gjuha shqipe dhe ajo gjermane i përkasin familjes së madhe të gjuhëve indoevropiane – shqipja bën pjesë në gjuhët satem² e gjermanishtja në ato kentum³. Në këtë punim janë trajtuar çështje që lidhen me sistemin foljor të shqipes dhe gjermanishtes. Është një përpjekje disavjeçare e autorit për të hedhur dritë e nxitur kureshtje shkencore mbi përqsjet e shtyrjet e

¹ Për shqipen: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe* 1, Tiranë, 2002, f. 259. Bucholz & Fiedler, cit. Nga Vjosa Hamiti „Modaliteti dhe mundësitë e tij sipas Albanische Grammatik të Oda Bucholz-it dhe Wilfried Fiedler-it“, Prishtinë, 2017, f. 204.; për gjermanishten: Ulrich Engel, *Deutsche Grammatik*, IUDICIUM Verlag GmbH München, 2004; Gerhard Helbig & Wolfgang Schenkel, *Wörterbuch zur Valenz und Distribution deutscher Verben*, Max Niemeyer Verlag Tübingen, 1983; Rudolf Hoberg & Ursula Hoberg, *Deutsche Grammatik: Eine Sprachlehre für Beruf, Studium, Fortbildung und Alltag: Eine Sprachlehre für Beruf, Studium, Fortbildung und Alltag (Der kleine Duden)*, 1. Auflage, Kindle Ausgabe, Dudenredaktion, 2017; Andrea Surneur, *Die Valenz der Verben*, GRIN Verlag, 2008; Anne Buscha & Szilvia Szita, *Begegnungen, Deutsch als Fremdsprache*, Schubert-Verlag, 2013.

² Benjamin W. Fortson, IV, *Indo-European Language and Culture: An Introduction*, 2nd Edition, Wiley-Blackwell, July 2009, f. 449.

³ Günther Schweikle, *Germanisch-deutsche Sprachgeschichte im Überblick*, Metzler Verlag, 1996, f. 27.

mënyrave dhe kohëve të këtyre dy gjuhëve, të trajtuara kryesisht në rrafshin morfologjik, semantik e stilistik, duke i lënë një vend të veçantë edhe gramatikës së tekstit, si një fushë studimi në lëmin e linguistikës botërore. Gjuha shqipe dhe ajo gjermane janë që të dyja gjuhë të pasura me një sistem zgjedhimi tejet të zhvilluar. Që të dyja gjuhët i janë nënshtruar një procesi të gjatë evoluimi e riorganizimi, tipike kjo për shumicën e gjuhëve indoevropiane. Për shqipen standarde pranohen gjashtë mënyra, ndërsa për gjuhën e sotme gjermane tri. Mbi mënyrat dhe kohët e shqipes dhe gjermanishtes janë bërë studime dhe kërkime shkencore, por deri tani nuk kemi gjetur ndonjë punim krahasues midis mënyrave dhe kohëve të të dyja gjuhëve në përmasa të këtilla.

Duke thënë këto, mbështesim mendimin se një studim krahasues midis dy gjuhëve në nivelin e sistemit foljor - konkretisht midis mënyrave dhe kohëve - do të ishte me interes të veçantë studimi për gjuhëtarë dhe kërkues shkencorë të rinj në këtë fushë kërkimi. Njëkohësisht, urojmë që ky punim të vlejë si një hap më tej në sqarimin e disa çështjeve morfologjike duke i shërbyer studiuesve të shqipes dhe gjermanishtes.

0.1. Objekti i punimit

Objekti i këtij punimi është hulumtimi shkencor i strukturës gramatikore foljore të gjuhës standarde shqipe dhe asaj së sotme gjermane në rrafsh krahasues. Duke argumentuar dhe nëpërmjet një studimi empirik të dy teksteve, në origjinal dhe në variantin e përkthyer, do të paraqesim një tablo mbi formimin e paradigmave foljore të kohëve në të gjashta mënyrat e pranuar për shqipen standarde duke i ballafaquar me tri mënyrat e pranuar për gjuhën e sotme gjermane. Vëzhgimi ynë krahasues mbi mënyrat dhe kohët në shqipe dhe gjermanishte i kalon kufijtë e studimit përqasës, duke dhënë vërejtje me vlerë teorike që mund të merren në konsideratë në secilën gjuhë, në veçanti. Duke u përqëndruar në aspektin semantik kemi cekur ndjeshëm dhe atë stilistik. Folja është analizuar edhe në marrëdhëniet që krijon me elementet e tjerë të fjalisë, duke u hedhur kështu në një domen tjetër, në gramatikën e tekstit.

Në fokusin tonë të studimit ka qenë gjuha standarde letrare shqipe dhe ajo e sotme gjermane. Nisur nga ky fakt, shprehem se karakteri i hulumtimit tonë është sinkronik e megjithatë kemi

ngërthyer dhe elemente të karakterit diakronik, kur kemi qenë të ndërgjegjshëm për forcën argumentuese të tyre në disa kuptime e përdorime të foljeve në të dyja gjuhët.

Për të hulumtuar mbi përqasjet apo të ndryshmet e mënyrave në sistemin foljor të shqipes dhe gjermanishtes, janë ngritur hipotezat e mëposhtme:

Hipoteza 1: Krahasuar me shqipen, për të kompensuar mospasjen e tri mënyrave në gjermanishte, në një plan ballafaques, përdorimet e dëftores në gjermanishte i tejkalojnë përdorimet e dëftores në shqipe.

Hipoteza 2: Habia në gjermanishte shprehet me mënyrën dëftore.

Hipoteza 3: Funksionet dhe përdorimet e lidhore në shqipe janë të ndryshme nga ato të lidhore në gjermanishte.

Hipoteza 4: Ndërtimet me folje në mënyrën kushtore në shqipe jepen me folje në mënyrën lidhore në gjermanishte.

Hipoteza 5: Shprehja e një urimi apo mallkimi në gjermanishte jepet me anë të të tri mënyrave të pranuara e kësaj gjuhe.

Hipoteza 6: Tri mënyrat e pranuara për gjermanishten i mbulojnë vlerat e gjashtë mënyrave të pranuara për shqipen.

Realizimi i punimit ka hasur edhe në momente krahasimi të vështira për shkak të diferencave, disa herë të mëdha, në kategoritë dhe veçoritë gramatikore-pragmatike të foljeve në gjuhët në shqyrtim. Për çdo mënyrë të "munguar" në gjermanishte ne kemi dhënë përmes shpjegimeve teorike dhe shembujve të qartë e argumentues gjegjëset konkrete të hetuara në kontekstin e përkthimit. Një moment tjetër delikat i punimit ka qenë edhe trajtimi i mënyrës lidhore, të cilën për arsye të forcës që bartin ngjyrimet e saj modale dhe shumëllojshmërisë së nuancave kuptimore, e kemi trajtuar ndryshe nga mënyrat e tjera. Studimin tonë e kemi orientuar duke u përqëndruar në kuptimet dhe funksionet e saj ngjyruese duke e shmangur disi përshkrimin e kohëve analitike apo sintetike, siç kemi vepruar me mënyrat e tjera. Mënyra lidhore e shqipes ka pak të përbashkëta me lidhoren e gjermanishtes - këtu përmendim kuptimin e përgjithshëm të mundësisë, dëshirës, pasigurisë etj.; folja në mënyrën lidhore nuk shpreh vërtetësi ose pavërtetësi të një veprimi a gjendjeje, por qëndrimin e folësit ndaj përmbajtjes së foljes. Kuptimet modale, kohore, përdorimet e foljeve në lidhore në shqipe janë shpesh të ndryshme krahasuar me lidhoren e gjermanishtes.

Një element tjetër plotësues është edhe tabela ilustruese mbi të gjitha kohët dhe mënyrat, në të dyja diatezat në shqipe dhe gjermanishte.

0.2. Struktura e punimit

Ky punim është një studim krahasues në plan sinkronik për të vëzhguar përjasjet dhe ndryshimet e mënyrave dhe kohëve në gjuhën standarde shqipe dhe atë të sotme gjermane, në nivelin morfologjik, semantik, deri diku edhe stilistik. Përzgjedhja e këtyre metodave është e lidhur ngushtë me analizën dhe interpretimin e shembujve, si dhe me vënien përballë të tipareve të sistemit foljor në shqipe me ato në gjermanishte. Hapi i parë konsistoi në grumbullimin dhe lëvrimin e literaturës së bollshme teorike në fushën tonë të interesit, i cili u ndoq me konceptimin, përshkrimin dhe përvijimin e përqsajeve apo të veçantave, të argumentuara përmes shembujve të përzgjedhur në korpuset letrare. Në momente të caktuara, ku literatura e botuar gjuhësore nuk mundësonte përligjje, duke na vënë kufizime, jemi munduar – bazuar në shembujt ilustrues - të shprehim mendimet apo konsideratat tona mbi çështjen në fjalë gjithnjë në pikëpamje krahasuese, duke e vënë respektivisht përballë gjuhës tjetër.

Për kryerjen e këtij studimi jemi mbështetur në një literaturë të pasur teorike⁴ klasike për të dyja gjuhët. Për shqipen përmendim veprën “*Albanische Grammatik*” (“Gramatika shqiptare”) të albanologëve Oda Buholc dhe Wilfrid Fidler (Oda Buchholz & Wilfried Fiedler) - në të gjejmë një paraqitje e trajtim dinjitoz e të hollësishëm të sistemit foljor të shqipes. Në përshkrime e argumente jemi mbështetur në “Gramatikën e gjuhës shqipe I”, sikurse edhe veprat e gjuhëtarit Shaban Demiraj. Ndërsa për gjuhën gjermane jemi orientuar kryesisht nga gjuhëtarët Fridrih Engel (Friedrich Engel), Gerhard Helbig (Gerhardt Helbig) dhe filologu Joakim Busha (Joachim Buscha), Gizela Cifonun, Ludger Hofman dhe Bruno Shtreker (Gisela Zifonun, Ludger Hoffmann, Bruno Strecker), të cilët ka bërë një paraqitje të detajuar të sistemit foljor gjerman në veprën e tyre “*Grammatik der deutschen Sprache*”, (“Gramatika e gjuhës gjermane”), si dhe gramatika e gjermanishtes së sotme Duden (DUDEN) si etalon matës i gramatikës standarde të gjuhës gjermane. Një ndihmë e mbështetje ka qenë dhe vepra e linguitit gjerman Harald Vajnrh (Harald Weinrich) “*Textgrammatik der deutschen Sprache*”⁵ (“Gramatika e tekstit e gjuhës gjermane”). Tërë mundimet dhe përpjekjet tona për t’u shprehur kuptueshëm e për të realizuar këtë punim nuk do të mund të kurorëzoheshin më mirë se sa përmes shembujve të vjelë për shqipen nga vepra “*Kronikë në gur*” e Ismail Kadaresë, botim i vitit 1971, e përkthyer në gjermanishte nga përkthyesi Joakim Römi

⁴ Literatura teorike është e listuar me detajet përkatëse te bibliografia e shfrytëzuar.

(Joachim Röhm), botim i vitit 1988; e për gjermanishten nga "*Nichts Neues aus dem Westen*" ("Asgjë e re nga fronti i perëndimit") e shkrimtarit Erik Maria Remark, botim i vitit 1999, e përkthyer në shqipe nga Robert Shvarc dhe "*Ansichten eines Clowns*" ("Me syrin e një kllouni") e shkrimtarit Hajnrih Bël (Heinrich Böll), botim i vitit 1980, e përkthyer në shqipe nga Adrian Klosi. Puna me korpuset letrare na ka mundësuar të zhvillojmë analiza introspektive. Synimi ynë ka qenë që përmes shembujve të vjelë të vëzhgonim se deri në ç'pikë teoria zbatohet në ligjërim/gjuhë, nëse empiria linguistike i përgjigjet teorisë. Jo rrallë rezultatet e arritura nga hulumtimet në korpuset tona letrare nuk u korrespondojnë vëzhgimeve e konstatimeve të nxjerra nga krahasimet e zhvilluara në korpuset teorike.

Punimi përbëhet nga tetë kapituj. **Kapitulli i parë** trajton kategoritë e mënyrës dhe kohës në të dyja gjuhët.

Kapitulli i **dytë** paraqet një tabllë përmbledhëse teoriko-krahasuese mbi ndërtimet morfologjike të kohëve në shqipe e gjermanishte. Këta kapituj pregatisin e shtojnë rrugën që të çon në zemër të punimit.

Kapitujt vijues nga i treti e deri në të tetin trajtojnë kuptimin dhe përdorimin e formave gramatikore të secilës kohë e mënyrë në aspektin krahasues. Këta kapituj synojnë të ofrojnë një paraqitje teoriko-praktike mbi përjasjet dhe ndryshimet e kuptimeve dhe përdorimeve të mënyrave dhe kohëve në gjuhën shqipe dhe atë gjermane. Në mënyrë të veçantë i është kushtuar vëmendje gramatikës së tekstit, duke qenë se e konsiderojmë si platformë solide në kuadrin e krahasimit të dy gramatikave. Gjithçka u tha më sipër është parë e trajtuar në plan krahasues, në kontekstin e përkthimit, duke ilustruar me shembuj.

Te **përfundimet** kemi përmbledhur përjasjet dhe ndryshimet e mënyrave dhe kohëve në gjuhën standarde shqipe dhe atë të sotme gjermane.

Më pas vijojmë me një **tabelë përmbledhëse** mbi kohët dhe mënyrat në gjuhën shqipe dhe gjermane me shembuj konkretë ilustrues në të dyja dialektet.

Punimi përmbyllet me **bibliografinë** dhe **literaturën** e përdorur nga ne për të kryer këtë punim shkencor. Pjesë e strukturës së këtij punimi janë edhe **mirënjohja, hyrja, objekti, metodologjia dhe ndërtimi i punimit** si dhe **çështja mbi interesin që bart punimi**.

⁵ Qëllimi i kësaj vepre është që përmes metodave të linguistikës së tekstit të krijojë një teori gramatike të qartë dhe të thjeshtë të përshtatshme për gjuhën gjermane dhe të përshkruajë gramatikën e gjuhës gjermane në mënyrë të tillë, që ajo të jetë e kuptueshme dhe lehtësisht e mësuueshme. Përshkrimi i fenomeneve gjuhësore në vepër bëhet duke iu referuar gjithmonë tekstit. (Maria Thurmair mbi: Weinrich, Harald - *Textgrammatik der deutschen Sprache*, Unter Mitarbeit von Eva Breindl, Maria Thurmair, Eva-Maria Willkop., München, f. 1.).

0.3. Metodatat e punimit

Punimi ynë është, para së gjithash, një trajtim krahasues-sinkronik. Sipas konceptit tonë krahasues janë evidentuar jo vetëm ndryshimet, por dhe ngjashmëritë në gramatikën e foljes në shqipe e në gjermanishte. Një mënyrë e tillë analize është me interes për gjuhësinë teorike dhe atë të aplikuar.

Metoda krahasuese shtrihet dhe në hulumtimet empirike që përbëjnë një pjesë të rëndësishme të punimit tonë. Gjashtë korpuse paralele krahasohen përta i përket kuptimit, përdorimit dhe kategorive gramatikore të foljeve.

Metoda historike-krahasuese e menduar në fillim si mënyrë e mundshme analize, e përdorur në disa argumentime të rralla nuk u arrit të aplikohet në mënyrë të gjerë.

0.4. Rëndësia e punimit

Punimi ka rëndësi teorike, pragmatike dhe didaktike. Vlera teorike e tij lidhet, para së gjithash, me informacionin e gjerë që ofron, por jo vetëm. Duke qenë se krahasimi i mënyrave dhe kohëve midis shqipes dhe gjermanishtes në këtë punim është trajtuar në mënyrë intensive, si rezultat kemi sjellë konsiderata teorike të reja mbi këto kategori gramatikore. Punimi mund t'i vlejë kërkuesve shkencorë që aspirojnë të lëvrojnë në tema krahasuese midis shqipes e gjuhëve të tjera, duke e marrë si punë referuese që sjell bashkë aspekte të ndryshme linguistike dhe çel rrugën për kërkime të mëtejshme në fushën e gjuhësisë. Nga ana tjetër, grumbullimi nën një titull, përfshirja në një koncept të përgjithshëm e çështjeve që janë trajtuar pjesërisht deri më tani (çështje të përgjithshme ose të veçanta, fragmentare, të shpërndara nëpër literaturë) ose që nuk janë trajtuar fare, është, pa dyshim, me interes teorik. Studime të tilla bëjnë akoma më të qartë përmbajtjen e konceptit “gramatikë e foljes”. Referimi në teorinë e reja lidhur me foljen dhe kategoritë specifike të saj, citimi, formulimi i koncepteve pak ose aspak të njohura janë gjithashtu një prurje në kuadrin teorik të kësaj dukurie.

Punimi ka interes didaktik. Gjithnjë e më tepër shtohen sot kritikant në adresë të studentëve, që paraqesin dobësi të theksuara në rrokjen e koherencës, organizimit të tekstit. Ata nuk janë në

gjendje të interpretojnë një tekst, ca më pak të konceptojnë dhe të hartojnë një tekst koherent. Gramatika e foljes zë një vend qendror në koherencën e tekstit. Kuptimi dhe realizimi i drejtë i saj ndihmon së tepërmi në kuptimin e mbarë tekstit dhe në hartimet tekstore. Punimi tregon, ndër të tjera, se problemi i paraqitjes dhe përvetësimit të paradigmave foljore është më i komplikuar se përshkrimet e dhëna në gramatikat shkollore. Metoda kontrastive e punimit vë në dukje dallimet dhe ngjashmëritë e dy gjuhëve. Analiza të tilla mund të integrohen në çdo formë e nivel të mësimdhënies së gjermanishtes.

Përvetësimi i formave dhe i kuptimeve foljore të gjuhës gjermane nuk rrjedh pa probleme. Me anë të një krahasimi konsekuent midis gramatikës së foljes në gjuhën shqipe dhe përgjegjëses në gjuhën gjermane, lehtësohet shumë ky përvetësim. Edhe analiza krahasuese e korpuseve, hetimi i foljeve, i përdorimit të tyre në korpus, ndihmon në përmirësimin e kompetencës praktike në gjuhën e huaj, forcon vetëdijen gjuhësore dhe qëndrimin kritik ndaj literaturës. Trajtime të tilla janë interesante e ndihmojnë edhe në fushën e teorisë së përkthimit.

Përsa i përket vlerës dhe rëndësisë pragmatike të leximit, perceptimit dhe interpretimit të foljeve në tërë format dhe shfaqjet e tyre këtu vlen thënia lapidare: "Një folje flet sa për 1000 fjalë". Një kapacitet të tillë logjiko-semantiko-gramatikor kanë foljet si shënues ekspresive të veprimit, pësimit, gjendjes, rezultatit, kohës, mënyrës, aspektit, valencës dhe një sërë përbërësish të tjerë.

*"Das Verb, das ist so, wie man im dunklen Raum das Licht anknipst. Mit einem Schlag ist das Grundgerüst des Satzes da."*⁶

"Folja është si të ndezësh dritën në një dhomë të errët. Menjëherë ia bef struktura themelore e fjalisë".

Gjatë leximit, receptimit të një vepre letrare, bëhet dhe përcaktimi, plotësimi i vendeve bosh. Ky plotësim bëhet nga lexuesi në mënyrë të pandërgjegjshme nën veprimin sugjerues të tekstit. Lexuesi lexon kështu midis rreshtave dhe plotëson intuitivisht semantikën implicite të tekstit. Pjesë përbërëse e semantikës implicite është dhe ngarkesa e veçantë kuptimore afektive e foljes. Punime të tilla mbi përdorimin e mjeteve që shprehin eksplisit dhe përmbajnë implicit informacion mbi botën ndihmojnë në analizën tekstore, në receptimin e përmbajtjeve, në interpretimin e thellë të veprave letrare ku letërsia dhe gjuhësia janë në

⁶Hans Jürgen Heringer, *Neues von der Verbszene*, Pädagogischer Verlag Schwann-Bagel GmbH Düsseldorf, 1984, f. 49.

unison. Kuptimet foljore të dhëna implicit janë po aq të gjithgjendshëm sa ata eksplicitë, madje më shumë.

KREU I

KATEGORIA GRAMATIKORE E MËNYRËS DHE KOHËS NË SHQIPE DHE GJERMANISHTE

1.1. Kategoria gramatikore e mënyrës dhe kohës

Kategoritë gramatikore të mënyrës dhe kohës i gjejmë në sistemin foljor të shqipes dhe në atë të gjermanishtes. Lidhja që ekziston midis këtyre dy koncepteve gramatikore takohet si në paradigmat foljore, ashtu edhe në funksionet e përdorimit të tyre. Sistemi foljor i shqipes është më i larmishëm se ai i gjermanishtes, ndërsa përse i përket kuptimeve gramatikore, që të dyja gjuhët paraqiten tepër të pasura. Përjasja e të dyja gjuhëve karakterizon edhe atë çka shprehet përmes kategorisë gramatikore të mënyrës, pikërisht lidhjen midis veprimit të emërtuar nga folja dhe realitetit objektiv, duke i mundësuar folësit të shprehë qëndrimin e tij ndaj veprimit të shprehur nga folja, duke e paraqitur atë si të vërtetë, të mundshëm, të dëshirueshëm etj.⁷ Pa dyshim që për të dyja gjuhët kategoria gramatikore e mënyrës është mjeti kryesor, por jo i vetëm për të shprehur modalitetin⁸.

⁷ Për shqipen: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Tiranë, 2002, f. 271.; Për gjermanishten: DUDEN, *Grammatik der deutschen Gegenwartssprache*, Duden Band 4, Mannheim, Leipzig, Wien, Zürich, 2003, f. 156.

⁸ Në linguistikë si rregull modaliteti përkufizohet si një kategori semantike, ndërkohë që mënyra si kategori morfo-sintaksore (Lyons, 1977:848; Bausch, 1979:56; Palmer, 1998:4), cit. Elke Hentschel & Petra M. Vogel, *Deutsche Morphologie*, De Gruyter Lexikon, Berlin, New York, 2009, f. 233.

1.2. Kategoria gramatikore e mënyrës

Në shqipen standarde sipas kuptimeve modale që shprehin dhe paradigmave foljore përkatëse, dallohen gjashtë mënyra: *dëftorja*, *habitorja*, *lidhorja*, *kushtorja*, *dëshirorja* dhe *urdhërorja*⁹. Ndërsa në gjuhën e sotme gjermane gjenden tri mënyra: *dëftorja*, *lidhorja* dhe *urdhërorja*¹⁰. Evolucioni gjuhësor i ka prekur të dyja gjuhët duke lënë gjurmë domethënëse në sistemin foljor përkatës, por vlen të përmendet se drejtimet e zhvillimeve gjuhësore kanë qenë në kahe të ndryshme. Kështu, ndërkohë që gjermanishtja është treguar "kursimtare" me numrin e mënyrave duke u "rrudhur" nga katër mënyra në tri¹¹, shqipja ka patur prirjen të përvijojë e qartësojë mënyrat ekzistuese.

Sipas „Gramatikës së gjuhës shqipe I“¹², bazuar në kuptimet modale themelore që shprehin, mënyrat në shqipe klasifikohen në tri grupe:

- I. *Në grupin e parë* hyjnë mënyra dëftore dhe habitorja, që shprehin kryesisht modalitetin e vërtetësisë;

⁹Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Tiranë, 2002, f. 272; Lidhur me numrin e mënyrave në shqipe hasim në qëndrime të ndryshme, shpeshherë të kundërta jo vetëm të gramatikanëve shqiptarë, por edhe të huaj. Në traditën e mëparshme gramatikore pranohen si mënyra të foljes edhe paskajorja, pjesorja dhe përcjellorja. Sami Frashëri nuk e pranon habitorën dhe kushtoren si mënyra më vete. Edhe Kostandin Kristoforidhi i përshkruan gjerësisht format foljore të habitores te dëftorja (Demiraj, 1977:102). Demiraj në librin e tij “Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe”, botim i vitit 1970 pranon e trajton pranon edhe mënyrën lidhore-habitore (Demiraj, 1970:231), por në artikullin e tij në veprën “Studime filologjike”, botim të vitit 1977 e hedh poshtë këtë tezë (Demiraj, 1977:105). Buholc dhe Fidler pranojnë tetë mënyra për shqipen dhe kushtorja nuk është midis tyre, por klasifikohet si kohë (cit. nga Vjosa Hamiti, 2017:208) (Bucholz & Fiedler, 1987:133-163). Camaj përveç gjashtë mënyrave që gjenden në „Gramatikën e gjuhës shqipe I“ pranon edhe pjesoren, paskajoren dhe gerundin (Camaj, 1984:126-232). Broj (Breu) shkon edhe më tutje me njëmbëdhjetë mënyra për shqipen, duke pranuar edhe jusivin (lejoren), posibilitativin (mundësinë), obligativin (detyrimin), volitivin dhe hipotetiken (Breu, 2010:453-470). Karapinjalli pranon pesë mënyra për shqipen dhe kushtorja nuk bën pjesë në to (Çeliku, Karapinjalli, Stringa, 2004:127-128).

¹⁰ DUDEN, *Grammatik der deutschen Gegenwartssprache*, Duden Band 4, Mannheim, Leipzig, Wien, Zürich, 2003, f. 156.

¹¹ Studiues të gjuhës gjermane kanë mbajtur qëndrime të ndryshme përsa i përket pranimit të numrit të mënyrave në gjermanishte. Kështu në gramatikën Duden (DUDEN, 2003:156) pranohen tri mënyra: dëftorja, lidhorja dhe urdhërorja. Të njëjtin qëndrim mbajnë Helbig, Busha (Helbig-Buscha, 2001:168), Cifonun etj. (Zifonun u.a., 1997:1723/1724). Flemig (Flämig, 1991:401) mbron modelin e skemës me katër mënyra, duke pranuar dy ndarjet e lidhore në Konjunktiv I dhe Konjunktiv II si mënyra më vete. Ndërsa Ajzenberg (Eisenberg, 1994:108) cit. nga Radke (Radkte, 1998:196), dhe Ferrarezi (Ferraresi, 2015:16) paraqesin një teori krejt ndryshe me tri mënyra, sikurse Duden, Helbig, Busha (Helbig-Buscha), Cifonun etj. (Zifonun uns.), porse me një ndryshim drastik në skemën e mënyrave duke e vendosur urdhëroren në kllapa – Eisenberg nuk e trajton urdhëroren si mënyrë më vete.

¹² Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Tiranë, 2002, f. 273.

- II. *Në grupin e dytë* hyjnë mënyra lidhore dhe kushtorja, që shprehin kryesisht modalitetin e mundësisë;
- III. *Në grupin e tretë* hyjnë dëshirorja dhe urdhërorja, si mënyra që shërbejnë për të shprehur kryesisht modalitetin e dëshirës, e para në formë urimi e mallkimi, ndërsa e dyta në formë urdhri a kërkesë.

Edhe pse numri i mënyrave në të dyja gjuhët është i ndryshëm, gjermanishtja afrohet me shqipen për sa i përket numrit të grupeve të mënyrave dhe modalitetit që ato shprehin. Më poshtë vijojmë me grupimet e mënyrave në gjuhën e sotme gjermane:

- I. *Në grupin e parë* hyn mënyra dëftore, e cila shpreh modalitetin e së vërtetës;
- I. *Në grupin e dytë* hyn mënyra lidhore, e cila shpreh modalitetin e mundësisë;
- II. *Në grupin e tretë* hyn mënyra urdhërore, e cila shpreh modalitetin e dëshirës në formë urdhri a kërkesë.

Sistemi modal në shqipe është shumë i komplikuar dhe i pasur me forma foljore sintetike, analitike dhe të bashkëngjitura. Për sistemin modal të gjermanishtes nuk mund të themi të njëjtën gjë – ai na paraqitet më i rrudhur si në mënyra edhe në kohë. Në të dyja gjuhët¹³ dëftorja përshkruan apo paraqet një ngjarje, e cila i përket "një bote reale" duke u dalluar së bashku me habitoren e shqipes për nga kuptimi modal i vërtetësisë. Lidhorja mund të shihet si mënyrë me karakter përshkrues dhe shpreh së bashku me kushtoren e shqipes kuptimin modal të mundshmërisë, ndërsa urdhërorja shihet si mënyrë me karakter adresues duke shprehur së bashku me dëshiroren e shqipes modalitetin e dëshirueshmërisë. Midis mënyrave nuk ekzistojnë kufij të mirëpërcaktuar e për rrjedhojë shfaqen edhe vështirësi në studimin e tyre. Ndodh të kemi kombinime të mënyrave, sidomos të habitores në shqipe¹⁴. Këtë mendim të Brojit (Breu) e mbështet edhe Demiraj, duke u shprehur se edhe pse mënyrat në gjuhën shqipe dallohen qartë midis tyre për nga përdorimet modale, në disa raste vihen re edhe përdorime sinonimike. Raste sinonimie mund të përmendim përdorimin e dëftores me kuptim modal të mënyrës lidhore apo përdorimin e lidhore me kuptim modal të mënyrës dëshirore,

¹³ Për shqipen: Shaban Demiraj, Studime filologjike: *Rreth kategorive gramatikore të mënyrës dhe të kohës në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1977, f. 102/103; për gjermanishten: Gisella Ferraressi, *Grammatikalisierung*, Universitätsverlag WINTER Heidelberg, 2015, f. 16. & Simone Heinold, *Tempus, Modus und Aspekt im Deutschen: Ein Studienbuch*, Narr Francke Attempto Verlag, 2015, f. 16.

¹⁴ Björn Rothstein & Rolf Thieroff, *Mood in the Languages of Europe*, John Benjamin Publishing Company, Amsterdam, Philadelphia, 2010, f. 453.

përkatësisht të mënyrës urdhërore¹⁵. Kur folësi zgjedh të përdorë një mënyrë të caktuar, ai njëkohësisht vendos të klasifikojë gjykimin e tij mbi veprimin në fjalë¹⁶. Të krahasohen:

(1)

Thuhet që artikulli është/qënka interesant.

Man sagt, der Artikel ist/wäre interessant.

Në përdorimet (1) me folje në mënyrën dëftore në të dyja gjuhët thënia na paraqitet si e vërtetë. Me përzgjedhjen e mënyrës habitore në shqipe dhe të Konjunktiv II në gjermanishte, ligjëruesi transmeton respektivisht habinë apo mosbesimin e tij.

Spektri i përdorimit të lidhore si në shqipe edhe në gjermanishte është tepër i gjerë dhe me shumë nuanca. E megjithatë për lidhoren vlen të përmendim që ajo ka pak funksione të sajat, një pjesë të mirë e ka falë kombinimeve me mënyrat e tjera. Urdhërorja që në nisje paraqitet me një deficiet në forma gramatikore - e krahasuar me dëftoren dhe lidhoren përdorimet e saj në të dyja gjuhët janë më të pakta. Ndikim në shpeshtësinë e përdorimit të urdhërores kanë edhe format konkurruese të saj, të cilat e detyrojnë të humbasë terren përdorimi. Kategoritë e mënyrës dhe kohës nuk ndërveprojnë vetëm në nivelin morfologjik, por edhe në atë semantik¹⁷

(2).

(2) (Bie zilja e derës.)

Nëna: Do të jetë Aleks.

Mutter: "Das wird Alex sein".

Në të dyja gjuhët foljet janë në kohën e ardhme dëftore në diatezën veprorë dhe sjellin me vete nuanca modale: përdorimi shpreh një probabilitet, realiteti i të cilit nuk është vërtetuar.

Duke qenë se dy konceptet mënyrë dhe modalitet janë të lidhura ngushtë njëra me tjetrën, që herët ka qenë e vështirë të ndahen kufijtë midis tyre¹⁸. Marrëdhënia *modalitet:mënyrë* luan të njëjtin rol morfologjiko-sintaksor në të dyja gjuhët - edhe pse përse i përket numrit të mënyrave që gjenden në të dyja gjuhët nuk shohim përjasje midis shqipes dhe gjermanishtes,

¹⁵ Shaban Demiraj, Studime filologjike: Rreth kategorive gramatikore të mënyrës dhe të kohës në gjuhën shqipe, Tiranë, 1977, f. 110/111.

¹⁶ Walter Flämig, *Grammatik des Deutschen, Einführung in Struktur- und Wirkungszusammenhänge*, Akademie Verlag, 1991, f. 403.

¹⁷ Gisella Ferraressi, *Grammatikalisierung*, Universitätsverlag WINTER Heidelberg, 2015, f. 13.

¹⁸ Po aty, f. 127.

mund të dallojmë fare qartë afrimin e larmisë së kuptimeve modale që ato shprehin dhe tipologjitë e grupimit të mënyrave.

1.3. Kategoria gramatikore e kohës

Më lart përmendëm që kategorinë gramatikore të kohës e gjejmë në të të dyja gjuhët. Gjuha shqipe gjatë evolucionit të saj historik ka krijuar një sistem kohor koherent dhe mjaft të larmishëm formash gramatikore, të mbështetura jo vetëm në kundërvënien me karakter kohor, por edhe në atë me nuancë aspekte¹⁹. Të njëjtën prirje semantike të foljes e hasim edhe në gjermanishte. E megjithatë nevojitet të themi që, kategoria gramatikore e aspektit nuk është dhe aq e zhvilluar në të dyja gjuhët – atë e hasim në kundërvënien *veprim i kryer:veprim i pakryer (perfektiv:imperfektiv)* në shqipe, të mbështetur kryesisht në kundërvënien e kohës së tashme ndaj së shkuarës dhe së ardhmes²⁰, ndërsa në gjermanishte shihet pjesorja e shkuar si bartëse gramatikore e aspektit duke e klasifikuar të kryerën dëftore si formë të aspektit. Në gjermanishte çështja e aspektit trajtohet si fenomen gjuhësor, i cili nuk ka një pozicion të qartë e të mirëfiksuar. Kjo gjen shpjegim në faktin, që gjuha gjermane nuk i përket grupit të foljeve aspekte dhe e ashtuquajtura *Verlaufsform*²¹ nuk pranohet si fenomen standard gjuhësor²². Si në shqipe edhe në gjermanishte nëpërmjet kategorisë së kohës shprehet lidhja midis kohës kur kryhet veprimi i emërtuar nga folja dhe një çasti të caktuar, që merret si bazë për marrëdhëniet kohore. Si bazë kohore për marrëdhëniet kohore në gjuhën e folur merret çasti i ligjëritimit, kurse në gjuhën e shkruar merret ose çasti kur shkruajmë ose një çast tjetër i përfytyruar²³. Shqipja dhe gjermanishtja takohen edhe kur flasim për kohët themelore të foljes – ato janë tri: *e tashmja, e shkuara dhe e ardhmja*. Në një vërtetim krahasues më të thellë midis dy gjuhëve, konstatojmë fillimisht se duke qenë se dy gjuhët dallojnë njëra më tjetrën për sa i përket numrit të mënyrave, ndryshimet vijnë e reflektohen më tej edhe në një shërndarje jo të njëjtë

¹⁹ Shaban Demiraj, *Morfologjia historike e gjuhës shqipe*, Pjesa II, Tiranë, 1976, f. 21.

²⁰ Po aty, f. 17.

²¹ Strukturë foljore e cila shpreh zhvillimin apo zgjatjen e një veprimi. (E-Duden)

²² Herweg (1990:68) cituar nga Gisella Ferraressi, *Grammatikalisierung*, Universitätsverlag WINTER Heidelberg, 2015, f. 62.

²³ Për shqipen: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 273.

të kohëve. Në shqipe kategorinë gramatikore të kohës e kanë kryesisht mënyra dëftore, habitore, lidhore, kushtore dhe dëshirore, që nga pikëpamja gramatikore i kundërvihen njëra-tjetrës. Ndërsa në gjermanishte kategorinë gramatikore të kohës e kanë mënyra dëftore dhe lidhore. Ndërkohë, te të dyja gjuhët nuk mund të flasim për kategori gramatikore të kohës për mënyrën urdhërore²⁴ – këtu kemi mungesë të kundërvënieve kohore, gjë e cila e gjen shpjegimin tek vetë modaliteti i kësaj mënyre²⁵.

Me rëndësi studimi është edhe trajtimi i lidhjes së ngushtë midis kategorisë së kohës dhe asaj të modalitetit - është pikërisht tipi i modalitetit të kësaj apo asaj mënyre ai që kushtëzon numrin e formave kohore. Kështu, mënyra dëftore ka forma gramatikore të ndryshme për tri kohët themelore të foljes²⁶ duke u paraqitur me dhjetë kohë: të *tashmen*, të *pakryerën*, të *kryerën e thjeshtë*, të *kryerën*, më se të *kryerën*, të *kryerën e tejshkuar*, të *ardhmen*, të *ardhmen e së shkuarës*, të *ardhmen e përparme*, të *ardhmen e përparme të së shkuarës*. Edhe dëftorja e gjermanishtes është mënyra më pak e shenjzuar, dhe ashtu si dëftorja e shqipes, shtrihet në të tri hapësirat kohore. Vetëm se krahasuar me shqipen, dëftorja e gjermanishtes, ka gjashtë kohë: *e tashme*, *preteritum*, *e kryer*, *më se e kryer*, *e ardhme*, *e ardhme e së shkuarës*, pra katër më pak. Duke qëndruar në grupin e mënyrave që shprehin modalitetin e së vërtetës, në shqipe gjendet edhe habitorja – mënyrë të cilën nuk e hasim në gjermanishte - e paraqitur me katër kohë: të *tashmen*, të *pakryerën*, të *kryerën dhe më se të kryerën*. Ndryshe qëndron çështja me mënyrën lidhore: në shqipe lidhorja ka katër forma kohore: të *tashmen*, të *pakryerën (imperfektin)*, të *kryerën*, më se të *kryerën*, ndërsa në gjermanishte, ajo ka gjashtë forma kohore: të *tashmen*, *preteritumin*, të *kryerën*, më se të *kryerën*, të *ardhmen*, të *ardhmen e së shkuarës*. Mënyra e dytë në shqipe që shpreh modalitetin e mundësisë, të cilën nuk e gjejmë në gjermanishte, ajo kushtore, ka dy forma kohore: të *tashmen dhe të kryerën*. Më tej vijojmë me mënyrën dëshirore, të cilën e hasim vetëm në shqipe me dy forma kohore: të *tashmen dhe të kryerën*. Konsideratat shkencore për urdhëroren si mënyrë e cila nuk përmban forma kohore, por vetëm forma gramatikore të së tashmes, i kemi shprehur pak më lart. Nisur

²⁴ Edhe pse gramatikat standarde të të dyja gjuhëve shprehen se urdhërorja nuk e ka kategorinë e kohës, gjuhëtarë si Shaban Demiraj, Gerard Gelbig dhe Joakim Buscha (Joachim Buscha) shprehen konkretisht që urdhërorja ka vetëm forma gramatikore të kohës së tashme në shqipe, (Shaban Demiraj, Morfologji e gjuhës së sotme shqipe, II, Tiranë, 1970, f. 168) e të vetës II në kohën e tashme diateza veprorë në gjermanishte (Gerhardt Helbig & Joachim Buscha, *Deutsche Grammatik, ein Handbuch für Ausländerunterricht*, Langenscheidt, Berlin und München, 2001, f. 173).

²⁵ Për shqipen: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 275.

²⁶ Po aty, f. 274.

nga logjika e lartpërmendur nuk mund të shënojmë forma kohore për urdhëroren në tabelën e mëposhtme (tab. 1)²⁷.

<i>Gjuha shqipe</i>		<i>Gjuha gjermane</i>	
<i>Mënyra ...</i>	<i>Koha ...</i>	<i>Mënyra ...</i>	<i>Koha ...</i>
dëftore	1. e tashme 2. e pakryer 3. e kryer e thjeshtë 4. e kryer 5. më se e kryer 6. e kryer e tejshkuar 7. e ardhme 8. e ardhme e së shkuarës 9. e ardhme e përparme 10. e ardhme e përparme e së shkuarës	dëftore	1. e tashme 2. preteritum 3. e kryer 4. më se e kryer 5. e ardhme 6. e ardhme e së shkuarës
habitore	1. e tashme 2. e pakryer 3. e kryer 4. më se e kryer	-	-
lidhore	1. e tashme 2. e pakryer 3. e kryer 4. më se e kryer	lidhore	1. e tashme 2. preteritum 3. e kryer 4. më se e kryer 5. e ardhme 6. e ardhme e së shkuarës
kushtore	1. e tashme 2. e kryer	-	-
dëshirore	1. e tashme 2. e kryer	-	-
urdhërore	-	urdhërore	-

Tabela 1

²⁷ Kjo është trajtuar më gjerë në këtë punim në çështjen mbi urdhëroren.

KREU II

MËNYRAT E FOLJES – NDËRTIMI MORFOLOGJIK I KOHËVE FOLJORE

2.1. Mjetet e ndërtimit të formave foljore

Përkufizimi gramatikor i foljes, si në shqipe edhe në gjermanishte është i njëjtë: folje quhet ajo pjesë e ligjëratës që emërton një veprim si proces dhe që ka kategoritë gramatikore të vetës, numrit, mënyrës, kohës dhe diatezës. Në të dyja gjuhët folja përbën bërthamën kryesore të fjalisë²⁸. Zgjedhim quhet tërësia e formave të shtjelluara, që merr folja sipas vetës, numrit, mënyrës e kohës, si dhe e formave të pashtjelluara²⁹. Si në gjuhën shqipe edhe në atë gjermane zgjedhimi i foljeve është dy llojesh: *vepror* dhe *jovepror*, i njohur ndryshe edhe me emërtimin *zgjedhim pësor*. Midis dy zgjedhimeve, ai *vepror* vlen si formë e pashenjësuar morfologjikisht dhe semantikisht. Të gjitha foljet në shqipen standarde formojnë paradigma foljore në formën *veprore*. Por veçse një pjesë e foljeve paraqesin paradigma foljore në formën *joveprore*. Të njëjtat konsiderata gjuhësore shpreh edhe Shubert (Schubert) për gjermanishten standarde³⁰. Sipas Zomerfeldit dhe Shtarkes³¹ (Sommerfeld-Starke) vetëm 50% e foljeve formojnë paradigma foljore në formën *joveprore*. Ndërsa për shqipen nuk kemi

²⁸ Për shqipen: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Tiranë, 2002, f. 259.; për gjermanishten: Ulrich Engel, *Deutsche Grammatik*, IUDICIUM Verlag GmbH München, 2004; Gerhard Helbig & Wolfgang Schenkel, *Wörterbuch zur Valenz und Distribution deutscher Verben*, Max Niemeyer Verlag Tübingen, 1983; Rudolf Hoberg & Ursula Hoberg, *Deutsche Grammatik: Eine Sprachlehre für Beruf, Studium, Fortbildung und Alltag: Eine Sprachlehre für Beruf, Studium, Fortbildung und Alltag (Der kleine Duden)*, 1. Auflage, Kindle Ausgabe, Dudenredaktion, 2017; Andrea Surneur, *Die Valenz der Verben*, GRIN Verlag, 2008; Anne Buscha & Szilvia Szita, *Begegnungen, Deutsch als Fremdsprache*, Schubert-Verlag, 2013.

²⁹ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Tiranë, 2002, f. 276.

gjetur ndonjë gjuhëtar që të jetë shprehur statistikisht për këtë çështje. Ajqel dhe Bynting (Eichel-Bünting) e shohin kufizimin e foljeve në gjermanishte për të formuar trajta foljore në formën joveprorë të lidhur ngushtë me tiparet semantike dhe sintaksore të foljeve, edhe pse nuk mund të bëhet një ndarje e qartë në këtë kontekst³². Ndërsa Helbig dhe Buscha (Helbig & Buscha) shprehen se folja mund të formojë paradigma në formën joveprorë (Vorgangspassiv) nëse në fjalinë veprorë kryefjala sintaksore shpreh një agjent, pra folja është folje vepruese³³. Në shqipe foljet jokalimtare, përkatësisht foljet mesore të tipit *kollem*, kanë vetëm një lloj zgjedhimi – zgjedhimin vepror, përkatësisht jovepror. Sipas Brikerit³⁴ (Briker) foljet që nuk mund të formojnë paradigma foljore në formën pësore në gjermanishte janë foljet që tregojnë një gjendje, ato që e formojnë kohën e kryer³⁵ me foljen ndihmëse *jam*. Sipas Duden (DUDEN) në grupin e foljeve të paafta për të formuar formën joveprorë hyjnë edhe foljet vetvetore.

Si në shqipe edhe në gjermanishte format e ndryshme foljore që merr folja gjatë zgjedhimit të saj janë *sintetike*, ku përfshihen format e thjeshta foljore, dhe *analitike*, ku përfshihen strukturat e përbëra foljore. Format sintetike³⁶ të foljes në shqipe ndërtohen përmes mjeteve të ndryshme gramatikore:

1. me anë të mbaresave vetore, duke përfshirë këtu edhe mbaresën zero (*la-j, hap*);
2. me anë të ndërrimeve fonetike që pëson tema e foljes, qofshin këto ndryshime në zanore apo bashkëtingëllore (*dal→del, flas→flet*);
3. njëherazi me anë mbaresash vetore dhe ndërrimesh fonetike (*heq→hiqni*);

³⁰ Cit. nga Petra Radtke, *Die Kategorien des deutschen Verbs, zur Semantik grammatischer Kategorien*, Gunter Narr Verlag Tübingen, 1998, f. 255.

³¹ Lena Brünjes, *Das Paradigma deutscher Modalpartikeln. Dialoggrammatische Funktion und paradigminterne Oppositionen*, E-Book, 2014, f. 52.

³² Cit. nga Petra Radtke, *Die Kategorien des deutschen Verbs, zur Semantik grammatischer Kategorien*, Gunter Narr Verlag Tübingen, 1998, f. 255-256.

³³ Gerhardt Helbig & Joachim Buscha, *Deutsche Grammatik, ein Handbuch für Ausländerunterricht*, Langenscheidt, Berlin und München, 2001, f. 152.

³⁴ Cit. nga Petra Radtke, *Die Kategorien des deutschen Verbs, zur Semantik grammatischer Kategorien*, Gunter Narr Verlag Tübingen, 1998, f. 256.

³⁵ Këtu bëjnë përjashtim disa folje të cilat është e mundur fjalia pësore me kryefjalë pavetore: *Jetzt wird aber gelaufen! Tani jepuni kembëve.* (Petra Radtke, *Die Kategorien des deutschen Verbs, zur Semantik grammatischer Kategorien*, Gunter Narr Verlag Tübingen, 1998, f. 256).

³⁶ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 276-277.

4. me anë prapashtesash trajtëformuese, të plotësuar ndonjëherë dhe me mbaresa vetore (*la-fsh-a*);
5. me anë të supletivizimit, të plotësuar edhe me mbaresa vetore ose me prapashtesa trajtëformuese (*jam*→*qeshë*).

Ndërsa format analitike³⁷ të foljes në shqipe ndërtohen me anë të:

1. foljeve ndihmëse *kam* dhe *jam* (*kam larë, jam larë*);
2. pjesëzave formante: *të, duke, pa, u* (*të laj, duke larë, pa larë, u lava*).

Në gjermanishte vërejmë përjasje me shqipen përse i përket mjeteve me anë të të cilave folja ndërton format e saj sintetike dhe analitike, pikërisht në pikat e mëposhtme 1, 2, 4 dhe 5. Kështu, nëse fillimisht ndalemi te format sintetike, shkruajmë se ato ndërtohen:

1. me anë të mbaresave vetore (*mach-e*);
2. me anë të ndërrimeve fonetike që pëson tema e foljes, qofshin këto ndryshime në zanore apo bashkëtingëllore apo fleksion i brendshëm³⁸ siç emërtohet në gjermanishte (*les*→*liest, nehm*→*nimmst*);
3. me anë të fleksionit të jashtëm, ku tema e foljes mbetet e pandryshuar (*ge-les-en, ge-mach-t*);
4. njëkohësisht fleksion të jashtëm edhe të brendshëm (*ge-schrieb-en*);
5. me anë të supletivizimit, të plotësuar edhe me mbaresa vetore ose me prapashtesa trajtëformuese (*sein*→*war*).

Ndërsa format analitike të foljes në gjermanishte ndërtohen me anë të:

1. foljeve ndihmëse *haben* (*kam*), *sein* (*jam*) dhe *werden*³⁹ (*do të/ do të bëhem*) (*habe gemacht, bin gelaufen, werde kommen, würde kommen*).

Strukturat foljore analitike në gjuhën shqipe karakterizohen nga tipari morfologjik i domosdoshmërisë për të qëndruar bashkë në fjali, qoftë në ligjërimin e folur, qoftë në atë të shkruar (3). Ndryshe qëndron çështja në gjermanishte, ku kohët analitike apo të përbëra siç emërtohen edhe në gramatikën gjermane, formojnë të ashtuquajturën në gjermanishte kllapë duke u shpërndarë nëpër fjali. Kështu, p.sh., kur bëhet fjalë për kohët e përbëra me dy

³⁷ Po aty, f. 277.

³⁸ Anna Volodina, *Einführung in die Sprachwissenschaft, Morphologie II: Nominale und verbale Flexion, Wortarten*, Universität Frankfurt, 2010, f. 12.

³⁹ Folja *werden* në gjermanishte përkthehet *do të bëhem*. Ajo shërben për të ndërtuar kohët e ardhme dëftore, lidhoren (Konjunktiv II) dhe kohët në diatezën pësore.

elemente vlen rregulli i pozicionit në vendin e dytë të foljes ndihmëse, pranë kryefjalës apo fjalës pyetëse (në fjalitë pyetëse me fjalë pyetëse⁴⁰), ndërsa folja kryesore pozicionohet në fund të fjalisë apo periudhës (3).

(3)

*Për ne të gjitha proceset e **kanë rifituar** pafajësinë e tyre, sepse kryhen detyrimisht hapur. (Asgjë e re nga fronti i Perëndimit, Erik Maria Remark, f. 15)*

*Für uns **haben** diese ganzen Vorgänge den Charakter der Unschuld durch ihre zwangsmäßige Öffentlichkeit **wiedererhalten**. (Nichts Neues aus dem Westen, Erik Maria Remark, Seite 13)*

2.2. Format gramatikore të mënyrës dëftore

Kohështrirja e mënyrës dëftore në të dyja gjuhët është e shkuar, e tashme dhe e ardhme. Siç e kemi përmendur edhe më parë në këtë punim, kjo mënyrë në shqipe prezantohet me dhjetë kohë (të tashmen, të pakryerën, të kryerën e thjeshtë, të kryerën, më se të kryerën, të kryerën e tejshkuar, të ardhmen, të ardhmen e së shkuarës, të ardhmen e përparme, të ardhmen e përparme të së shkuarës), e në gjermanishte me gjashtë kohë (të tashmen, preteritumin, të kryerën, më se të kryerën, të ardhmen, të ardhmen e së shkuarës).

2.2.1. Koha e tashme

Në formimin e kohës së tashme në diatezën vepore në shqipe ndiqet rregulli i pasvendosjes në temën e foljes të mbaresave vetore, të cilat variojnë nga klasat e foljeve. Foljet e zgjedhimit I në të tri vetat, në njëjës edhe në shumës dalin me temë të pandryshuar dhe marrin këto mbaresave vetore: -j, -n, -n, -jmë, -ni, -jnë⁴¹ (mëso-j, mëso-n, mëso-n, mëso-jmë, mëso-ni, mëso-jnë). Foljet e klasës I të zgjedhimit II dalin me temë të pandryshuar. Foljet e klasës II të zgjedhimit II pësojnë ndryshime në temat e tyre⁴². Karakteristike për foljet e zgjedhimit II

⁴⁰ Në fjalitë pyetëse pa fjalë pyetëse, folja ndihmëse si rregull pozicionohet në vendin e parë.

⁴¹ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Gramatika e gjuhës shqipe 1, Tiranë, 2002, f. 285. Shënim: Përjashtim këtu bën folja *blej*: *ble-j*, *ble -n*, *ble -n*, *ble-jmë*, *bli -ni*, *ble -jnë*.

⁴² Po aty.

është bashkëtingëllojja në fund të foljes. Mbaresat vetore në njëjës dhe në shumës këtu janë: *-0, -0, -0; -im, -ni, -in (hap, hap, hap; hap -im, hap-ni, hap-in)*. Në disa folje ndryshon zanorja e rrënjës së foljes nga: $a \rightarrow e, e \rightarrow i$; me ndryshim zanoreje të rrënjës dhe të bashkëtingëllores së foljes: $e \rightarrow e \rightarrow i / s \rightarrow t, a \rightarrow e \rightarrow i / s \rightarrow t$; më ndryshim të bashkëtingëllores së foljes: $t \rightarrow s$. Foljet e zgjedhimit III në numrin njëjës dalin me mbaresa zero. Mbaresat vetore janë: *-0, -0, -0, -më (-m), -ni, -në (-n) (pi, pi, pi, pi-më, pi-ni, pi-në)*. Të gjitha foljet e zgjedhimit III që mbarojnë me *-e, -ë* ose *-ie*, e ndryshojnë zanoren e rrënjës në vetën e dytë shumës në *-i*: *ngre- ngrini, zë - zini, bie - bini*.⁴³ Edhe foljet e parregullta pësojnë ndryshime të temës së tyre, kur zgjedhohen në të tashmen e dëftores në diatezën pësore. Me përjashtim të foljeve *jam, kam* dhe *them*, foljet e tjera të parregullta, në përgjithësi marrin po ato mbaresa vetore që marrin edhe foljet e tri zgjedhimeve të foljeve të rregullta⁴⁴.

Në formimin e kohës së tashme dëftore në diatezën veprorë në gjuhën gjermane dallohen foljet e buta apo të quajtura ndryshe folje të rregullta, foljet e forta apo të çrregullta dhe ato të përziera⁴⁵. Koha e tashme dëftore në diatezën veprorë në gjermanishte ndërtohet duke u bazuar në temën e foljes: foljet e buta e ruajnë temën e foljes në të gjitha vetat⁴⁶; disa folje të çrregullta pësojnë ndryshime të zanores në vetën e dytë dhe të tretë njëjës⁴⁷: $a \rightarrow \ddot{a}$ (*schlafen: schlaf-e, schläf-st, schläf-t*; në shqipe: *fle*), $e \rightarrow ie$ (*lesen: les-e, lies-t, li es-t*; në shqipe: *lexoj*), $e \rightarrow i$ (*geben: geb-e, gib-st, gib-t*; në shqipe: *jap*), të zanores dhe bashkëtingëllores në vetën e dytë dhe të tretë njëjës $e \rightarrow i-h \rightarrow m$ (*nehmen: neh-m-e, nimm-st, nimm-t*; në shqipe: *marr*). Mbaresat vetore për të gjitha foljet në të tashmen e dëftores për njëjës dhe shumës janë: *-e, -st, -t, -en, -t, -en*. (*lernen: lern-e, lern-st, lern-t, lern-en, lern-t, lern-en*; në shqipe: *mësoj*). Foljet ndihmëse dhe ato modale i marrin pjesërisht këto mbaresa në njëjës, ndërsa në shumës plotësisht. Si në shqipe edhe në gjermanishte, ka përjashtime në formimin e së tashmes dëftore. Këtu vlen të përmendet folja *wissen (di)* apo folje, tema e të cilave mbaron me: *s, ß, x, z (reisen, në shqipe: udhëtoj; heißen, në shqipe: quhem etj)*, të cilat nuk marrin *-t* në vetën e dytë njëjës. Foljet, tema e të cilave mbaron me *-n, -t, -m [öffnen (hap), arbeiten (punoj)]* do të

⁴³ Për një paraqitje më të detajuar mbi formimin e foljeve në kohën e tashme dëftore në shqipe shih: Emine Teichmann, *Handbuch Grammatik der albanischen Sprache Teil I*, GRIN Verlag, 2015, f. 19-25.

⁴⁴ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Tiranë, 2002, f. 286.

⁴⁵ DUDEN, *Die Grammatik, Unentbehrlich für richtiges Deutsch*, Dudenverlag, Mannheim-Wien-Zürich, 2009, f. 433.

⁴⁶ Gisella Ferraressi, *Grammatikalisierung*, Universitätsverlag WINTER Heidelberg, 2015, f. 82.

⁴⁷ Po aty.

marrin për efekt shqiptimi në vetën e dytë, të tretë njëjës dhe të dytë shumës –e midis temës së foljes dhe mbaresës vetore (*arbeiten: arbeit-e, arbeit-e-st, arbeit-e-t, arbeit-en, arbeit-e-t, arbeit-en*). Duke parë në detaje rregullat e formimit të së tashmes dëftore në diatezën veprorë si në gjermanishte edhe në shqipe, vërejmë se ky proces gjuhësor është parimisht i njëjtë: në të dyja gjuhët format vetore të së tashmes dëftore ndërtohen duke i shtuar temës së foljes mbaresat përkatëse. Në gjermanishte mbaresat vetore vlejné pothuajse për të gjitha foljet, ndërsa në shqipe gati çdo klasë zgjedhimi kërkon mbaresa vetore të veçanta. Gjithashtu kemi përjasje edhe në momentet kur disa folje të forta në gjermanishte ndryshojnë zanoren e rrënjës së foljes, tipar që e gjejmë edhe në shqipe. Ndryshimi këtu midis dy gjuhëve qëndron në faktin, që në gjermanishte ndiqet një rregull: zanorja e rrënjës pëson ndryshim vetëm në vetën e dytë dhe të tretë njëjës. Ndërsa në shqipe ky ndryshim është i variueshëm: në disa folje gjen zbatim vetëm në vetën e dytë shumës (folja *marr: merrni*), në disa të tjera në vetën e dytë dhe të tretë njëjës edhe në vetën e dytë në shumës (folja *flas: flet, flet, flitni*).

Në gjuhën shqipe foljet e kohës së tashme të mënyrës dëftore paraqiten në diatezën pësore (4) dhe vetvetore (5) shumë të qarta me format e tyre gramatikore dhe përdorimet përkatëse. Ndërtimi i formave foljore në kohën e tashme dëftore në diatezën pësore në shqipe realizohet duke i prapavendosur temës së foljes mbaresat vetore: *-em/-hem, -esh/-hesh, -et/-het, -emi/-hemi, -en/-hen* (*lah-em, lah-esh, lah-et, lah-emi, lah-eni, lah-en*). Alomorfet me *-h-* (*-hem, -hesh* etj.) i marrin foljet me temë në zanore⁴⁸. Koha e tashme dëftore në diatezën pësore në gjermanishte ndërtohet sipas rregullit “*folja ndihmëse werden (do të) + pjesoren e shkuar të foljes kryesore*” (*ich werde operiert*). Ndërsa foljet vetvetore ndërtohen me anë të përemrit vetvetor *sich: mich/mir, dich/dir, sich, uns, euch, sich* (*ich kümmere mich, du kümmerst dich, er kümmert sich, wir kümmern uns, ihr kümmert euch, sie/Sie kümmern sich*) (shqip: merakosem). Siç shihet, formimi i kohës së tashme dëftore në diatezën pësore në të dyja gjuhët është i ndryshëm nga ana morfologjike dhe nuk gjejmë asnjë pikë takimi: në shqipe formimi realizohet përmes mbaresave të caktuara foljore, ndërsa në gjermanishte ka pamjen e një kllape morfologjike me dy elemente përbërës: foljen ndihmëse dhe pjesoren e shkuar të foljes kryesore. Më poshtë shqyrtojmë disa shembuj me përdorimet përkatëse.

⁴⁸ Po aty, f. 302.

(4)

*Po ndërtohet një pallat i madh në afërsi të liqenit.**Es wird ein großes Hochhaus in der Nähe des Sees gebaut.*

(5)

*Çfarë po bën? – Po mendohem, si t'ja bëj me shtëpinë.**Was machst du gerade? – Ich überlege mir, was ich mit dem Haus machen soll.*

2.2.2. Koha e pakryer, e kryer e thjeshtë e shqipes dhe preteritumi i gjermanishtes

Në shqipe formimi e kohëve të shkuara të thjeshta dëftore në diatezën veprorë ka një të përbashkët midis tyre: shumica e foljeve kanë temë të njëjtë me atë të kohës së tashme⁴⁹. Në gjermanishte format gramatikore të preteritumit dëftore ndërtohen duke u nisur nga koha e tashme dëftore, veta e tretë njëjës. Referuar formimit të kohës së pakryer dëftore në shqipe⁵⁰ shprehemi: ato folje në shqipe që në vetën e dytë shumës të kohës së tashme pësojnë ndërrime tingujsh zanorë ose bashkëtingëllorë në temat e tyre, i pësojnë këto ndërrime edhe në të pakryerën: *heq*→*hiq-ni*, →*hiq-ja*; *bie*→*bi-ni*, →*bi-ja*. Të gjitha foljet, duke përfshirë edhe foljet e parregullta, me përjashtim të foljeve *jam* e *kam*, në të pakryerën marrin këto mbaresa: *-ja*, *-je*, *-te* ose *-nte* (për njëjësin) dhe *-nim*, *-nit*, *-nin* (për shumësin). Mbaresën e vetës së tretë njëjës *-nte* e marrin foljet me temë me zanore. Foljet *kam* dhe *jam* në të pakryerën nuk formohen bazuar në të tashmen, por dalin me format *isha* dhe *kisha*⁵¹.

Më lart përmendëm që shumica e foljeve në të kryerën e thjeshtë⁵² dalin me po atë temë që kanë edhe në kohën e tashme. Por një pjesë e tyre pësojnë ndryshime si në vijim: disa folje dalin me temë të zgjeruar, disa me temë të pazgjeruar apo pësojnë ndërrime tingujsh. Pjesa më e madhe e foljeve, përfshirë këtu edhe ato të parregullta, në numrin njëjës të së kryerës së

⁴⁹ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Gramatika e gjuhës shqipe 1, Tiranë, 2002, f. 287-288.

⁵⁰ Po aty, f. 287; Për një paraqitje më të detajuar mbi formimin e foljeve në kohën e pakryer dëftore në shqipe shih: Emine Teichmann, *Handbuch Grammatik der albanischen Sprache Teil I*, GRIN Verlag, 2015, f. 37-38.

⁵¹ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Gramatika e gjuhës shqipe 1, Tiranë, 2002, f. 287.

⁵² Për një paraqitje më të detajuar mbi formimin e foljeve në kohën e kryer të thjeshtë dëftore në shqipe shih: Emine Teichmann, *Handbuch Grammatik der albanischen Sprache Teil I*, GRIN Verlag, 2015, f. 31-35.

thjeshtë marrin mbaresat vetore *-a, -e, -i* ose *-u*, dhe në numrin shumës mbaresat vetore *-ëm, -ët, -ën*. Foljet me temë zanore në vetën e parë dhe të dytë njëjës marrin mbaresat vetore *-va, -ve*, dhe në numrin shumës mbaresat vetore *-më* ose *-m, -të* ose *-t, -në* ose *-n*. Foljet e parregullta në vetën e parë njëjës të së kryerës së thjeshtë marrin mbaresën *-shë*, e në vetën e dytë dhe të tretë njëjës ato nuk marrin mbaresë vetore, ndërsa në numrin shumës dalin me mbaresat vetore *-më, -të, -në*, ashtu si dalin foljet me temë me zanore (*ra-shë, re, ra, ra-më, ra-të, ra-në*)⁵³.

Siç e përmendëm pak më lart, formimi i paradigmave foljore në preteritumin e dëftores në gjermanishte fillon duke u bazuar në rrënjën e vetës së tretë në kohën e tashme dëftore – kësaj të fundit i shtohet mbaresa *-t*, për foljet e buta, ndërsa foljet e forta ndërrojnë zanoren e rrënjës. Mbasesat vetore për njëjës dhe shumës për foljet e buta janë: *-e, -est, -e, -en, -et, -en*, ndërsa për foljet e forta: *-, -(e)st, -, -en, -(e)t, -en*⁵⁴. Nga foljet ndihmëse ajo *haben (kam)* sillet si folje e butë, ndërsa *sein (jam)* si e fortë. Mbasesat vetore të foljes *werden (do të/ do të bëhem)* përkojnë me ato të foljeve të buta. Në të dyja gjuhët gjenden folje, formimi i të cilave bën përjashtim nga rregullat e lartpërmendura.

Lidhur me formimin e kohës së pakryer dëftore në diatezën pësore në shqipe mbasesat vetore janë: *-esha/-hesha, -eshe/-heshe, -ej(-esh)/-hej(-hesh), -eshin/-heshin, -eshit/-heshit, -eshin/-heshin* (*pyetsha, pyetse, pyetej, pyeteshim, pyeteshit, pyeteshin*). Alomorfet me *-h-* (*-hesha, -heshe* etj.) i marrin foljet me temë me zanore. Temat foljore, të cilave u shtohen këto mbasesa, janë po ato të kohës së tashme të zgjedhimit jovepror⁵⁵. Për të formuar format vetore foljore të së kryerës së thjeshtë dëftore në diatezën joveprore kryesisht u paravendoset formave vetore të foljes pjesëza *u* (*u pyeta, u pyete, u pyet, u pyetëm, u pyetët, u pyetën*). Vetëm veta e tretë njëjës shmanget nga ky rregull – aty përdoret tema e foljes në numrin shumës. Format foljore të foljeve vetvetore përputhen në shqipe me ato të diatezës pësore⁵⁶. Ndërsa format foljore të preteritumit dëftore në diatezën pësore në gjermanishte ndërtohen sipas rregullit: “*folja werden* në preteritum (*wurde*) + *pjesoren e shkuar te foljes kryesore*” (*ich wurde gefragt, du wurdest gefragt, er/sie/es wurde gefragt, wir wurden gefragt, ihr wurdet gefragt, sie/Sie wurden gefragt*).

⁵³ Për këtë shih: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 288-289.

⁵⁴ Ulrich Engel, *Deutsche Grammatik*, IUDICIUM Verlag GmbH München, 2004, f. 215.

⁵⁵ Po aty, f. 303.

⁵⁶ Emine Teichmann, *Handbuch Grammatik der albanischen Sprache Teil I*, GRIN Verlag, 2015, f. 36.

Nisur nga rregullat e formimit të kohëve të shkuara të thjeshta dëftore në diatezën veprorë si në shqipe edhe në gjermanishte, vërejmë se ky proces gjuhësor në vija të përgjithshme gjen pika të përbashkëta: për të formuar kohët e thjeshta të shkuara dëftore ato i referohen së tashmes dëftore duke i shtuar mbaresat vetore përkatëse; në të dyja gjuhët foljet e forta apo të parregullta siç quhen ndryshe, ndryshojnë zanoren e rrënjës. Ndërsa përsa i përket formimit të këtyre kohëve në diatezën pësore, ai është i ndryshëm.

2.2.3. Koha e kryer

Në shqipe format foljore të kohës së kryer në diatezën veprorë ndërtohen sipas rregullit: *“folja ndihmëse kam në kohën e tashme + pjesoren e shkuar të foljes kryesore”*⁵⁷ (6) (*unë kam pyetur etj.*). Edhe në gjermanishte format foljore të kësaj kohe në diatezën veprorë ndërtohen me ndihmën e foljes ndihmëse *kam*: *“folja ndihmëse kam në kohën e tashme + pjesoren e shkuar të foljes kryesore”* (*ich habe gefragt etj.*), por kjo vlen për foljet kalimtare dhe vetvetore⁵⁸, ndërsa foljet jokalistare (7) e formojnë këtë kohë me anë të foljes ndihmëse *jam*: *“folja ndihmëse jam në kohën e tashme + pjesoren e shkuar të foljes kryesore”* (*ich bin gefahren etj.*). Bazuar në strukturën gramatikore, formimi i këtyre kohëve në diatezën veprorë në të dyja gjuhët është deri diku i njëjtë – ndryshimi qëndron në faktin, që në shqipe folja ndihmëse *kam* përdoret për të formuar format foljore të diatezës veprorë (7), ndërsa në gjermanishte ajo përdoret për të formuar kohën e kryer dhe më se të kryer për foljet kalimtare dhe folja ndihmëse *jam* për të formuar kohën më se të kryer për foljet jokalistare (7). Foljet e së kryerës dëftore në diatezën pësore dhe vetvetore paraqiten qartë në të dyja gjuhët me format e tyre gramatikore dhe përdorimet përkatëse.

⁵⁷ Për këtë shih: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 289.

⁵⁸ Gisella Ferraressi, *Grammatikalisierung*, Universitätsverlag WINTER Heidelberg, 2015, f. 87.

(6)

*Dy herë **kanë thirrur** hoxhën, por akoma s'u bë gjë. (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 29)*

*Sie **haben** schon zweimal nach dem Hodscha **gerufen**, aber es hat noch nichts getan. (Chronik im Stein, Ismail Kadare, Seite 35)*

(7)

*Atij që **ka qenë** aq shpesh në vijën e parë si puna jonë, i argaset lëkura. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark)*

*Wer so oft nach vorn **gefahren ist** wie wir, der wird dickfellig. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque)*

Ndërtimi i formave foljore në kohën e kryer dëftore në diatezën pësore në shqipe realizohet sipas rregullit: “folja ndihmëse jam në kohën e tashme + pjesoren e shkuar të foljes kryesore” (unë jam larë etj.). Edhe në gjermanishte format foljore të diatezës pësore formohen me anë të foljes ndihmëse jam: folja ndihmëse jam në kohën e tashme + pjesoren e shkuar të foljes kryesore + pjesoren e shkuar të foljes ndihmëse werden”, pa pjesëzën ge (ich bin gefragt worden etj.) (8). E përbashkëta midis shqipes dhe gjermanishtes në formimin e formave foljore të kohës së kryer dëftore në diatezën pësore qëndron në këto pika: në rolin dhe kohën e foljes ndihmëse jam, si dhe në formën gramatikore të foljes kryesore – në të dyja gjuhët ajo është pjesore e shkuar; ndryshimi qëndron në rolin e foljes ndihmëse werden në gjermanishte, si element shtesë dhe tipik për të formuar format foljore në diatezën pësore. Më poshtë shohim disa shembuj me përdorime në diatezën pësore (8) për gjermanishten, (9) dhe (10) për shqipen, dhe me folje vetvetore (10) për gjermanishten, si dhe përkthimet përkatëse:

(8)

*Gjyshe, ç'i kanë bërë djalit të Naços që **e kanë lidhur** me magji? (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 29)*

*Großmutter, wie **ist** denn Nazos Sohn **verzaubert worden**? (Chronik im Stein, Ismail Kadare, Seite 35)*

(9)

*Mbërrijmë në zonën ku fillon fronti – dhe **jemi kthyer** në njerëz-bisha. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 55)*

*- wir kommen in die Zone, wo die Front beginnt, und **sind** Menschentiere **geworden**. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 53)*

(10)

Jemi shtrirë rrëzë barakave, nga ajo anë ku na kap dielli. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 43)

Wir **haben uns** auf der Sonnenseite der Baracken **hingehauen**. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 40)

2.2.4. Koha më se e kryer, e kryer e tejshkuar në shqipe dhe më se e kryer në gjermanishte

Në shqipe format foljore të kohës më se të kryer në diatezën veprorë ndërtohen sipas rregullit: “folja ndihmëse kam në të pakryer + pjesoren e shkuar të foljes kryesore”⁵⁹ (unë kisha pyetur etj.) (11). Në gjermanishte kjo kohë në diatezën veprorë ndërtohet sipas rregullit: “folja ndihmëse kam/jam në preteritum + pjesoren e shkuar të foljes kryesore” (ich hatte gefragt/ich war gewesen etj.) (11). Bazuar në strukturën gramatikore, formimi i këtyre kohëve në diatezën veprorë në të dyja gjuhët është deri diku i njëjtë: në të dyja gjuhët pjesorja e shkuar është pjesë e të ashtuquajturës në gjermanishte kllapë foljore të kohës më se të kryer; ndryshimi qëndron në faktin, që në shqipe përdoret folja ndihmëse *kam* për të formuar format foljore të diatezës veprorë, ndërsa në gjermanishte kjo folje përdoret për të formuar kohën më se të kryer për foljet kalimtare dhe folja ndihmëse *jam* për të formuar kohën më se të kryer për foljet jokalistare.

(11)

Plaka Haxhe kishte njëzetedy vjet që nuk **kish dalë** nga shtëpia. Plaka Neslihan s’**kishhte dalë** qysh prej tetëmbëdhjetë vjetësh, kur varrosi nipin e fundit. (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 31)

Die alte Haxhe **hatte** seit zweiundzwanzig Jahren das Haus nicht **verlassen**. Die greise Neslihan **war** vor achtzehn Jahren zum letzten Mal **ausgegangen**, als sie den letzten Enkel begrub. (Chronik im Stein, Ismail Kadare, Seite 38)

Në shqipe format foljore të më se të kryerës në diatezën pësore ndërtohen sipas rregullit: “folja ndihmëse jam në të pakryerën dëftore + pjesoren e shkuar të foljes kryesore” (unë isha

⁵⁹ Për këtë shih: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Tiranë, 2002, f. 289.

larë etj.) (12). Në gjermanishte diateza pësore e më se të kryerës ndërtohet ndryshe nga ajo në shqipe: “*folja ndihmëse jam në preteritum + pjesoren e shkuar të foljes kryesore + foljen ndihmëse werden në pjesoren e shkuar pa pjesën ge*” (*ich war gefragt worden etj.*).

(12)

Kapaku i librit ishte mykur dhe fletët qenë ngjitur me njëra-tjetrën, ngaqë ishin lagur. (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 59)

Das Buchdeckel war angeschimmelt, und die Seiten waren durch die Feuchtigkeit zusammengeklebt. (Chronik im Stein, Ismail Kadare, Seite 70)

Në shqipe format foljore të kohës së kryer të tejshkuar në diatezën veprorë ndërtohen sipas rregullit: “*folja ndihmëse kam në të kryerën e thjeshtë + pjesoren e shkuar të foljes kryesore*” (*unë pata pyetur etj.*), ndërsa format foljore të diatezës pësore ndërtohen sipas rregullit: “*folja ndihmëse jam në të pakryer + pjesoren e shkuar të foljes kryesore*”⁶⁰ (*unë isha larë etj.*).

Duke qenë se në gjermanishte nuk gjenden format foljore të kryerës së tejshkuar nuk mund të bëhet krahasim në nivelin morfologjik midis dy gjuhëve.

2.2.5. Koha e ardhme

Sipas “Gramatikës së gjuhës shqipe I”⁶¹ për të shprehur kohën e ardhme dëftore në shqipe përdoren dy tipe: ajo e tipit “*do të mësoj*” dhe “*kam për të mësuar*” - midis këtyre e ardhmja e tipit *do të mësoj* është mbizotëruese. Tipi më i përdorur *do të mësoj* ndërtohet sipas rregullit: “*pjesëza do + format e foljes të kohës së tashme të mënyrës lidhore*” (*do të pyes etj.*) (13). Tipi i dytë i së ardhmes dëftore në shqipe *kam për të larë* ndërtohet duke i para vendosur formës së parashtjelluar të tipit *për të larë*, format vetore të kohës së tashme të foljes ndihmëse *kam*: “*folja ndihmëse kam në kohën e tashme + forma e pashtjelluar e foljes kryesore*” (*kam për të pyetur etj.*). Në gjermanishte koha e ardhme dëftore *das Futur I* formohet sipas rregullit: “*folja ndihmëse werden (do të) + foljen kryesore në infinitiv*”⁶² (*ich werde fragen etj.*) (13).

⁶⁰ Po aty, f. 290.

⁶¹ Po aty, f. 316.

⁶² Gerhard Helbig & Joachim Buscha: *Deutsche Grammatik, ein Handbuch für den Ausländerunterricht*, Langenscheidt, Berlin und München, 2001, f. 113.

(13)

*Për aq kohë sa nuk ia di emrin, ndoshta edhe do të mund ta harroj; koha **do ta shuajë** këtë pamje. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 196)*

*Solange ich seinen Namen nicht weiß, kann ich ihn vielleicht noch vergessen, die Zeit **wird es tilgen**, dieses Bild. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 199)*

Ndërtimi i kohës së ardhme dëftore në diatezën veprorë në shqipe dhe në gjermanishte është i ndryshëm: në gjermanishte, me zgjedhim të foljes në kohën e ardhme dëftore kuptojmë zgjedhim të foljes ndihmëse *werden*, ndërsa folja kryesore rri në infinitiv e pandryshuar; në shqipe zgjedhim i foljes në kohën e ardhme dëftore do të thotë zgjedhim i formave të foljes në të tashmen e lidhore dhe pjesa *do* rri e ngurtësuar. Gjithashtu edhe tipi i dytë i së ardhmes dëftore në shqipe nuk ka asnjë pikë të përbashkët me ndërtimin e së ardhmes dëftore në gjermanishte.

Kjo kohë shprehet qartë edhe në diatezën pësore: ndërtimi i formave foljore në kohën e ardhme dëftore në diatezën pësore në shqipe realizohet duke i prapavendosur pjesëzës së ngurtësuar *do* foljen kryesore në të tashmen e lidhore (pra, siç ndërtohet diateza veprorë) dhe folja kryesore del me mbaresat: *-em/-hem, -esh/-hesh, -et/-het, -emi/-hemi, -en/-hen (unë do të operohem etj.)* (14). Alomorfet me *-h-* (*-hem, -hesh etj.*) i marrin foljet me temë në zanore.⁶³ Në gjermanishte format foljore të diatezës pësore të kësaj kohe formohen sipas rregullit: “*folja ndihmëse werden në kohën e tashme dëftore + pjesoren e shkuar të foljes kryesore + pjesoren e tashme të foljes ndihmëse werden*”⁶⁴ (*ich werde operiert werden etj.*) (14). Gjithashtu në diatezën pësore nuk gjejmë pika të përbashkëta midis dy gjuhëve përsa i përket ndërtimit morfologjik të kohës së ardhme.

(14)

*Posta elektronike **do të dërgohet** nesër.*

*Die E-Mail **wird** morgen **gesendet werden**.*

⁶³ Për këtë shih: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 302.

⁶⁴ Gerhard Helbig & Joachim Buscha: *Deutsche Grammatik, ein Handbuch für den Ausländerunterricht*, Langenscheidt, Berlin und München, 2001, f. 144.

2.2.6. Koha e ardhme e përparme

Koha e ardhme e përparme dëftore në diatezën vepore në shqipe ndërtohet duke i paravendosur pjesores së foljes format vetore të së ardhmes të ndihmëses sipas rregullit *kam*⁶⁵ (*do të kem mësuar* etj.) (15). Në gjermanishte kjo kohë e quajtur *Futurperfekt*⁶⁶ ndërtohet sipas rregullit: “*folje ndihmëse werden + kohën e kryer në infinitiv*”⁶⁷ (*ich werde gesehen haben* etj.) (15). Siç vërehet nga rregullat e formimit morfologjik të kësaj kohe në të dyja gjuhët, ai është i ndryshëm – element i përbashkët mund të konsiderohet roli i kohës së kryer, megjithëse edhe ky është i pjesshëm: te shqipja bëhet fjalë për të kryerën e lidhore, ndërsa në gjermanishte për të kryerën në infinitiv.

(15)

Ju do ta keni lexuar Remarkun.

Sie werden doch Remark gelesen haben.

Rregulli gramatikor i ndërtimit të kësaj kohe në diatezën pësore në shqipe është: “*kohë e ardhme e foljes jam + pjesoren e shkuar të foljes kryesore*”⁶⁸ (*do të jem pyetur* etj.) (16); në gjermanishte: “*kohë e tashme e foljes werden + pjesoren e shkuar të foljes kryesore + worden + sein*” (*ich werde gefragt worden sein* etj.) (16). Ndërtimi i formave foljore të kësaj kohe në diatezën pësore në të dyja gjuhët, edhe pse në përgjithësi është i ndryshëm, gjejmë një pikë të përbashkët, atë të pjesores së shkuar të foljes kryesore.

(16)

Pacienti do të jetë operuar dje.

Der Patient wird gestern operiert worden sein.

⁶⁵ Për këtë shih: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 290.

⁶⁶ E emërtur edhe ndryshe si Futur II, Vorfutur (e paraardhme) ose vollendete Zukunft (e ardhme e përfunduar).

⁶⁷ Karl-Ernst Sommerfeldt & Günter Starke, *Einführung in die Grammatik der deutschen Gegenwartssprache*, Max Niemeyer Verlag, Tübingen, 1998, f. 75.

⁶⁸ Për këtë shih: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 305.

2.2.7. Koha e ardhme e përparme e së shkuarës

Format gramatikore të së ardhmes së përparme të së shkuarës ndërtohen duke i paravendosur pjesore së foljes format vetore të së ardhmes të së shkuarës të ndihmëses *kam*⁶⁹ për diatezën veprorë (17) (*do të kisha pyetur* etj.) dhe me ndihmësen *jam* për atë pësorë⁷⁰ (*do të isha pyetur* etj.). Buholci dhe Fidler (Buchholz & Fiedler) e quajnë këtë kohë Perfekt Volitiv, e ardhme e së kryerës⁷¹. Në gramatikën gjermane nuk gjenden paradigma foljore të kohës së ardhme të së shkuarës e për rrjedhojë nuk mund të flasim për krahasim në nivelin morfologjik.

(17)

Peter më tha se gjer të hënën do ta kishte mbaruar raportin.

Peter sagte mir, dass er bis Montag den Bericht fertig haben würde.

2.3. Mënyra habitore

Kohët e mënyrës habitore në shqipe janë dy: *e tashme dhe e shkuar*, ku e shkuara paraqitet me tri kohë: *të pakryerën, të kryerën dhe më se të kryerën*. Nisur nga numri i kohëve e shkuara vërehet se e shkuara del me një larmi formash gramatikore. Në gjuhën gjermane nuk gjenden paradigma foljore të mënyrës habitore.

⁶⁹ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 291.

⁷⁰ Po aty, f. 305.

⁷¹ Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987. f. 146.

2.3.1. Koha e tashme

Nga ana formale habitorja shihet si kohë e kryer e përmbysur e dëftores⁷²: “*Kam punuar – Punua-kam*”⁷³. Megjithatë format e habitores nuk janë përdorime të veçanta të formave të kohës së kryer, por forma të diferencuara morfologjikisht, që do të thotë, ato përfaqësojnë paradigma foljore të tjera⁷⁴. Foljet kalimtare të diatezës veprorë dhe jokalistare e formojnë kohën e tashme të habitores duke i prapangjitur pjesores së shkurtër të foljes ndajshesat – *kam, -ke, -ka, -kemi, -keni, -kan*⁷⁵ (*pyetkam, pyetke, pyetka, pyetkemi, pyetkeni, pyetkan*) (18). Elementi i parë mbetet në formë të pandryshuar, ndërsa ai i dytë ndryshon sipas numrit dhe vetës.

(18)

*S’po u besoj syve. Edhe Bëtheri na **qenka** këtu, portieri i shkollës sonë! Dhe na **qenka** edhe shembullor, pale! (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 156)*

Ich traue meinen Augen kaum – Boettcher ist ja auch da, Boettcher, unser Schulportier. Und der ist vorbildlich! (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 157)

E tashmja e habitores shfaqet qartë edhe në diatezën pësore e vetvetore, ku pjesëza *u* vendoset para formave vetore përgjegjëse të zgjedhimit vepror: *u lakam, u lake, u laka, u lakemi, i lkeni, u lakan*⁷⁶ (19).

(18)

*Shikoni, si **u mësoka** rosa nënë të vegjëleve të kapin peshq!*

Schauen Sie, wie die Mutter den Kleinen das Fischenfangen beibringt!

⁷² Kjo tezë është vërtetuar nga Demiraj (1971), i cili hodhi poshtë mendimin e Joklit (Jokl) të mbështetur më vonë nga Zanzfeld (Sanfeld), që habitorja rrjedh nga një formë e vjetër e së ardhmes (Balkanistika, Friedmann, *Balkan Admirativity*, Volume IV, 1980, f. 17.).

⁷³ Emine Teichmann, *Handbuch der Albanischen Sprache*, Teil 1, GRIN Verlag, 2013, f. 48.

⁷⁴ Blertë Ismajli, *Verbmodi im Deutschen und Albanischen im Vergleich, Alles Mögliche: Sprechen, Denken und Schreiben des (Un)Möglichen*, Verlag Königshausen & Neumann GmbH, Würzburg, 2014, f. 168.

⁷⁵ Ndajshesat përkojnë me format vetore të së tashmes të foljes ndihmëse *kam*. (Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 291). Elementi “ë” në vetën e tretë në numrin shumës, do të bjerë.

⁷⁶ Po aty, f. 304.

2.3.2. Koha e pakryer

E pakryera e habitores për foljet kalimtare të diatezës veprorë dhe jokolimtare del me forma sintetike të përfutuara duke i prapangjitur pjesores së shkurtër të foljes ndajshitesat –*kës*ha, –*kës*he, –*kësh*, –*kej*, –*këshim*, –*këshit*, –*këshin*⁷⁷ (*pyetkës*ha, *pyetkës*he, *pyetkësh*, *pyetkej*, *pyetkëshim*, *pyetkëshit*, *pyetkëshin*) (19).

(19)

Po sa i vështirë qenkësh emigrimi!

Doch wie schwierig war (für ihn) die Auswanderung!

E pakryera e habitores shfaqet qartë edhe në diatezën pësore e vetvetore, ku pjesëza *u* vendoset para formave vetore përgjegjëse të zgjedhimit vepror: *u lakës*ha, *u lakës*he, *u lakës*ha, *u lakëshim*, *u lakëshit*, *u lakëshin*⁷⁸.

2.3.3. Koha e kryer

E kryera habitore e foljeve kalimtare dhe jokolimtare në diatezën veprorë ndërtohet duke i paravendosur pjesores së foljes format vetore të së pakryerës të ndihmëses *kam*⁷⁹: *paskam*, *pyetur*, *paske* *pyetur*, *paska* *pyetur*, *paskemi* *pyetur*, *paskeni* *pyetur*, *paskan* *pyetur* (20), (21).

(20)

Paskeni patur fat! (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 38)

Da habt ihr aber Glück gehabt. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 36)

(21)

Nuk e paskeni gjetur? (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 85)

Habt ihr ihn nicht gefunden? (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 157)

Në diatezën pësore dhe vetvetore foljet e formojnë të kryerën e habitores me ndihmën e foljes *jam* në të tashmen e mënyrës habitore: *qenkam* çuar etj... (22)

⁷⁷ Këto kanë dalë nga format vetore të së pakryerës së ndihmëses *kam* (Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 292).

⁷⁸ Po aty, f. 304.

⁷⁹ Po aty, f. 292.

(22)

Qënke çuar që me natë, moj Sofikë!*Sofike, du bist wohl sehr früh aufgestanden!*

Në rastet kur ligjëruesi dëshiron të shprehë habinë e tij referuar mossuksesit të një veprimi të ndodhur në të shkuarën apo në momentin e ligjërimit, atëherë forma e habitores paraprihet nga pjesëzat mohuese *nuk* (23) apo *s*.

(23)

Nuk e paskeni gjetur? (*Asgje e rë nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 85*)*Habt ihr ihn nicht gefunden? (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 82)*

2.3.4. Koha më se e kryer

Formimi i më se të kryerës habitore të foljeve kalimtare dhe jokalistare në diatezën veprorë ngjan me atë të kohës së kryer duke i paravendosur pjesores së foljes format vetore të së pakryerës habitore të ndihmës *kam*⁸⁰: *paskësja pyetur, paskëshe pyetur, paskësh pyetur, paskëshim pyetur, paskëshit pyetur, paskëshin pyetur* (24).

(24)

Ai paskësh qenë xham i mallkuar. (*Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 14*)*Dieses Glass war verflucht. (Chronik in Stein, Ismail Kadare, Seite 16)*

Në diatezën pësore dhe vetvetore foljet e formojnë kohën më se të kryer të mënyrës habitore me ndihmën e foljes *jam*⁸¹: *qenkësh bërë, qenkëshe bërë, qenkësh bërë, qenkëshin bërë, qenkëshit bërë, qenkëshin bërë* etj.

Duke qenë se në gjermanishte nuk gjenden forma foljore të mënyrës habitore, është e pamundur të flitet për krahasim në nivelin e formimit morfologjik midis dy gjuhëve. Krahasimi ynë do të vijojë në rrafshin semantik dhe funksional, duke përvijuar mjetet gramatikore që ngërthen gjermanishtja për të shprehur habinë apo ironinë në ligjërimin verbal dhe atë të shkruar.

⁸⁰ Po aty, f. 294.

⁸¹ Po aty, f. 305.

2.4. Mënyra lidhore

Kohët e mënyrës lidhore në shqipe janë dy: *e tashme dhe e shkuar*, ku e shkuara paraqitet me tri nënndarje: *të pakryerën, të kryerën dhe më se të kryerën*. Shtrirja kohore e lidhore në gjermanishte përfshin: *të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen*. Kohët e lidhore në gjermanishte janë gjashtë: *e tashmja, preteritumi, e kryera, më se e kryera, e ardhmja dhe e ardhmja e së shkuarës*. Krahësuar me shqipen, lidhorja e gjermanishtes përmban edhe format gramatikore të kohës së ardhme, ndërsa përse i përket kohëve të shkuara, secila gjuhë ka tri. Mënyra lidhore në gjermanishte është më e pasur në kohë se lidhorja e shqipes, duke shënuar një diferencë prej 2 kohësh. Megjithatë përse i përket paradigmave foljore nevojitet të paraqesim këtu se si është e organizuar lidhorja në gjermanishte. Për nga forma në gjuhën gjermane dallohen Konjunktiv I, i cili formohet nga rrënja e kohës së tashme dëftore, dhe Konjunktiv II, i cili formohet nga rrënja e preteritumit. Kohët analitike e sintetike që formohen me anë të Konjunktiv I janë: *e tashmja, e kryera, e ardhmja (Futur I) dhe e ardhmja e përparme (Futur II)*. Kohët që formohen me anë të Konjunktiv II janë: *preteritumi dhe më se e kryera*⁸².

2.4.1. Koha e tashme

Të gjitha foljet, me përjashtim të foljeve *jam* e *kam*, në të tashmen lidhore në diatezën veprorë në shqipe, dalin me tema në përgjithësi të njëjta me ato të kohës së tashme të dëftores (25). Por ato folje, që në vetën e dytë e të tretë njëjës të së tashmes së dëftores pësojnë ndonjë ndërrim zanoreje ose edhe ndërrimin -s, -t, në të tashmen e lidhore nuk i pësojnë këto ndërrime⁸³: *të shkoj, të shkosh, të shkojë, të shkojmë, të shkoni, të shkojnë: të marrë, të marrësh, të marrë, të marrim, të merrni, të marr-in*.

Foljet *kam* dhe *jam* në të gjitha vetat (njëjës dhe shumës) e së tashmes lidhore dalin me temë *je-*, përkatësisht *ke-*: *të je-m, të ke-m*⁸⁴.

⁸² Karl-Ernst Sommerfeld & Günter Starke, *Einführung in die Grammatik der deutschen Gegenwartssprache*, Max Niemeyer Verlag, Tübingen 1998, f. 74-75.

⁸³ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 293.

⁸⁴ Po aty.

Në gjermanishte e tashmja lidhore në diatezën veprorë, Konjunktiv I ndërtohet nga rrënja e foljes duke i shtuar mbaresat *-e, -est, -e, -en, -et, en* (25) (këtu bëjnë përjashtim foljet ndihmëse *kam* dhe *jam*): *ich frag-e, du frag-est, er/sie/es frag-et, wir frag-en, ihr frag-et, sie/Sie frag-en*. Foljet të cilat kanë në rrënjën e tyre *-el*, do të paraqiten në lidhoren e tashme me *-l*: *ich schmeichl-e*⁸⁵.

(25)

Le të bëjë, si të dojë!

Möge sie tun, was sie wolle!

Në gjuhën shqipe foljet e së tashmes lidhore në diatezën pësore dalin me të njëjtat mbaresat vetore sikur foljet e kohës së tashme dëftore: *-em/-hem, esh/-hesh, -et/-het, -emi/-hemi, -eni/-heni, -en/-hen*⁸⁶ (të pyetem, të pyetesh, të pyetet, të pyetemi, të pyeteni, të pyeten).

Në gjuhën gjermane diateza pësore e foljeve në kohën e tashme lidhore ndërtohet: "*folja werden në kohën e tashme dëftore + pjesoren e shkuar të foljes kryesore*" (*ich werde gefragt, du wirst gefragt, er/sie/es wird gefragt, wir werden gefragt, ihr werdet gefragt, sie/sie werden gefragt*).

Procesi i ndërtimit të së tashmes lidhore në të dyja gjuhët është kryesisht i ndryshëm – përjasje kemi në momentin kur këto dy kohë bazohen në të tashmen dëftore: ndërtimi i paradigmave foljore të së tashmes lidhore në diatezën veprorë dhe i tyre në diatezën pësore në gjermanishte.

2.4.2. Koha e pakryer

Të gjitha foljet në këtë kohë të mënyrës lidhore dalin me të njëjtat mbaresat vetore si në të pakryerën e dëftores⁸⁷ duke i shtuar pjesëzën *të* (26): *të pyesja, të pyesje, të pyeste, të pyesnim, të pyesnit, të pyesnin*.

Në gjermanishte ndërtimi i paradigmave foljore të preteritumit në lidhore nuk na paraqitet kaq i thjeshtë. Për të formuar këtë kohë gjermanishtja orientohet nga preteritumi i dëftores duke i

⁸⁵ Ulrich Engel, *Deutsche Grammatik*, Neubearbeitung, Iudicium Verlag, München, 2004, f. 217.

⁸⁶ Për këtë shih: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 302.

⁸⁷ Po aty, f. 294.

shtuar mbaresat: *-e, -est, -e, -en, -et, en* (*ich vermied-e, du vermied-est, er/sie/es vermied-e, wir vermied-en, ihr vermied-et, sie/Sie vermiede-en*). Foljet e forta të karakterizuara nga aftësia për të marrë në zanoren e rrënjës Umlaut, dalin në preteritumin e lidhore me këtë metafoini karakteristike⁸⁸: *ich kām-e, du kām-est, er/sie/es kām-e, wir kām-en, ihr kām-et, sie/Sie kām-en*. Preteritumi i lidhore i foljeve të buta është i njëjtë me format foljore të preteritumit në mënyrën dëftore⁸⁹: *ich fragt-e, du fragt-est, er/sie/es fragt-e, wir fragt-en, ihr fragt-et, sie/Sie fragt-en*. Preteritumi i lidhore i foljeve të përziera ndryshon nga preteritumi i dëftores përmes metafonisë, Umlaut të rrënjës së foljes, i cili shfaqet herë me *ä*, e herë me *e*.

(26)

Edhe sikur të tjerët të ishin të këqinj, aeroplani im nuk ishte i tillë. (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 110)

Auch wenn die anderen schlecht wären, mein Flugzeug nicht. (Chronik im Stein, Ismail Kadare, S. 127)

Lidhur me formimin e së pakryerës lidhore në diatezën pësore në shqipe mbaresat vetore janë: *-esha/-hesha, -eshe/-heshe, -ej(-esh)/-hej(-hesh), -eshin/-heshin, -eshit/-heshit, -eshin/-heshin*. Alomorfet me *-h-* (*-hesha, -heshe* etj.) i marrin foljet me temë me zanore. Temat foljore, të cilave u shtohen këto mbaresa, janë po ato të kohës së tashme të zgjedhimit jovepror:⁹⁰ *të pyetësja, të pyetëshe, të pyetëj, të pyetësim, të pyetëshit, të pyetëshin*.

Ndërsa format foljore të preteritumit lidhore në diatezën pësore në gjermanishte ndërtohen me ndihmën e foljes *werden* në lidhore (Konjunktiv II): “*würde + pjesoren e shkuar te foljes kryesore + infinitivin e foljes werden*” (*ich würde gefragt werden, du würdest gefragt werden, er/sie/es würde gefragt werden, wir würden gefragt werden, ihr würdet gefragt werden, sie/Sie würden gefragt werden*).

Ndërtimi i kësaj kohe në lidhore në të dyja gjuhët orientohet drejt mënyrës dëftore – dallim kemi në ndërtimin e paradigmave foljore të preteritumit në diatezën pësore: në shqipe bazohemi në kohën e pakryer diateza pësore dëftore, ndërsa në gjermanishte në mënyrën lidhore.

⁸⁸ Безугла Л. Р., Бублик І. Ф., Відюкова Н. І., Криворучко С. І., Мірошніченко М. Ю., Потапова Ж. Є., Скачкова В. В., Сотникова С., *Login 2, Deutsch für Germanistikstudenten*, NK Verlag, 2016 f. 246.

⁸⁹ По аты.

⁹⁰ Për këtë shih: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 303.

Në rastet kur format e Konjunktiv I përputhen me ato të së tashmes dëftore, atëherë lidhorja ndërtohet: *"folja werden në lidhore (Konjunktiv II) + foljen kryesore në infinitiv"* (*ich würde lernen, du würdest lernen, er/sie/es würde lernen, wir würden lernen, ihr würdet lernen, sie/Sie würden lernen*).

2.4.3. Koha kryer

E kryera lidhore ndërtohet duke i paravendosur pjesores së foljes format vetore të kohës së tashme lidhore të ndihmëses *kam*⁹¹: *të kem pyetur; të kesh pyetur; të ketë pyetur; të kemi pyetur; të keni pyetur; të kenë pyetur* (27).

(27)

*Kur të ketë hyrë në thellësi, ti do të hapësh zjarr*⁹².

Sobald er tief eingedrungen sein wird, wirst du das Feuer eröffnen.

E kryera lidhore në gjermanishte ndërtohet: *"folja kam/jam në të tashmen lidhore + pjesoren e shkuar të foljes kryesore"* (*ich habe gefragt, du habest gefragt, er/sie/es habe gefragt, wir haben gefragt, ihr habet gefragt, sie/Sie haben gefragt; ich sei gefahren, du seiest gefahren, er/sie/es sei gefahren, wir seien gefahren, ihr seiet gefahren, sie/Sie seien gefahren*).

Koha e kryer lidhore në diatezën pësore në shqipe ndërtohet: *"folja jam në të tashmen e lidhore + pjesoren e shkuar të foljes kryesore"*⁹³ (*të jem pyetur; të jesh pyetur; të jetë pyetur; të jemi pyetur; të jeni pyetur; të jenë pyetur*).

Koha e kryer lidhore në diatezën pësore në gjermanishte ndërtohet: *"folja jam në të tashmen e lidhore + pjesoren e shkuar të foljes kryesore + pjesoren e shkuar të foljes werden"*⁹⁴ (*ich sei gefragt worden, du seiest gefragt worden, er/sie/es sei gefragt worden, wir seien gefragt worden, ihr seiet gefragt worden, sie/Sie seien gefragt worden*).

⁹¹ Po aty, f. 294.

⁹² Shembull i marrë nga: Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 141.

⁹³ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Gramatika e gjuhës shqipe 1, Tiranë, 2002, f. 303.

⁹⁴ Për këtë shih: Karl-Ernst Sommerfeld & Günter Starke, *Einführung in die Grammatik der deutschen Gegenwartssprache*, Max Niemeyer Verlag, Tübingen 1998, f. 75.

Midis dy gjuhëve kemi përjasje në ndërtimin e së kryerës lidhore në diatezën veprorë: si shqipja edhe gjermanishtja e formojnë këtë kohë në të njëjtën mënyrë: *"folja kam në lidhore + pjesoren e shkuar të foljes kryesore"*. Ndryshimi qëndron që në gjermanishte foljet që tregojnë lëvizje apo ndryshim gjendjeje e formojnë këtë kohëme ndihmën e foljes *jam*. Ndërtimet e këtyre kohëve në diatezën pësore janë të ngjashme në dy pika: të dyja gjuhët i paravendosin pjesores së shkuar të foljes kryesore ndihmësen *jam* në të tashmen lidhore; përveç kësaj në strukturën e saj gjermanishtja ka edhe pjesoren e shkuar të ndihmëses *werden*.

2.4.4. Koha më se e kryer

Kjo kohë ndërtohet duke i paravendosur pjesores së foljes format vetore të kohës së pakryer lidhore të ndihmëses *kam*⁹⁵ (28): *të kisha pyetur, të kishe pyetur, të kishte pyetur, të kishim pyetur, të kishit pyetur, të kishin pyetur*.

Në gjermanishte kjo kohë ndërtohet: *"folja kam/jam në preteritum lidhore + pjesoren e shkuar të foljes kryesore"*⁹⁶ (*ich hätte gefragt, du hättest gefragt, er, sie, es hätte gefragt, wir hätten gefragt, ihr hättet gefragt, sie/Sie hätten gefragt; ich wäre gefahren, du wärest gefahren, er/sie/es wäre gefahren, wir wären gefahren, ihr wärt gefahren, sie/Sie wären gefahren*) (28).

(28)

Sikur të kishim udhëtuar të gjithë së bashku!

Wären wir doch alle zusammengefahren!

Më se e kryera lidhore në diatezën pësore në shqipe ndërtohet: *"folja jam në të pakryerën e lidhore + pjesoren e shkuar të foljes kryesore"*⁹⁷ (*të isha pyetur, të ishe pyetur, të ishte pyetur, të ishim pyetur, të ishit pyetur, të ishin pyetur*).

Koha më se e kryer lidhore në diatezën pësore në gjermanishte ndërtohet me ndihmën e foljes *"jam në preteritum e lidhore + pjesoren e shkuar të foljes kryesore + pjesoren e shkuar të*

⁹⁵ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 293-294.

⁹⁶ Безугла Л. Р., Бублик И. Ф., Відюкова Н. І., Криворучко С. І., Мірошніченко М. Ю., Потапова Ж. Є., Скачкова В. В., Сотникова С., *Login 2, Deutsch für Germanistikstudenten*, NK Verlag, 2016 f. 246.

⁹⁷ Për këtë shih: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 303.

foljes werden”: *ich wäre gefragt worden, du wärest gefragt worden, er/sie/es wäre gefragt worden, wir wären gefragt worden, ihr wärt gefragt worden, sie/Sie wären gefragt worden.*

Ndërtimi i më se të kryerës lidhore në diatezën vepore në të dyja gjuhët paraqitet i njëjtë: të dyja gjuhët orientohen nga koha e thjeshtë e shkuar lidhore dhe i prapavendosin kësaj të fundit pjesoren e shkuar të foljes kryesore. Ndryshe qëndron çështja në formimin e paradigmave foljore të kësaj kohe në diatezën pësore: shqipja i paravendos pjesores së shkuar të foljes kryesore foljen jam në të pakryerën e lidhore, ndërsa gjermanishtja i paravendos pjesoreve të shkuara të foljes kryesore dhe asaj ndihmëse *werden* foljen ndihmëse *jam* në preteritumin e lidhore.

2.4.5. Koha e ardhme dhe e ardhme e përparme në lidhore në gjermanishte

E ardhmja lidhore në diatezën vepore në gjermanishte ndërtohet: "*folja werden në të tashmen lidhore + foljen kryesore në infinitiv*"⁹⁸ (*ich werde fragen, du werdest fragen, er/sie/es werde fragen, wir werden fragen, ihr werdet fragen, sie/Sie werden fragen*) (29).

(29)

*Sie hat gesagt, sie **werde** das Buch **veröffentlichen**.*

Ajo tha, që do ta botonte librin.

Ndërsa në diatezën pësore për këtë kohë dallojmë dy degëzime, ndërtim me Konjunktiv I dhe Konjunktiv II:

1. E ardhmja lidhore në diatezën pësore me Konjunktiv I ndërtohet: "*folja werden në të tashmen dëftore + pjesoren e shkuar të foljes kryesore + foljen werden në infinitiv*"⁹⁹ (*ich werde gefragt werden, du wirst gefragt werden, er/sie/es wird gefragt werden, wir werden gefragt werden, ihr werdet gefragt werden, sie/Sie werden gefragt werden*).
2. E ardhme lidhore në diatezën pësore me Konjunktiv II ndërtohet: "*folja werden në preteritum + pjesoren e shkuar të foljes kryesore + foljen werden në infinitiv*" (*ich würde gefragt werden, du würdest gefragt werden, er/sie/es würde gefragt werden, wir würden gefragt werden, ihr würdet gefragt werden, sie/Sie würden gefragt werden*).

⁹⁸ Për këtë shih: Karl-Ernst Sommerfeld & Günter Starke, *Einführung in die Grammatik der deutschen Gegenwartssprache*, Max Niemeyer Verlag, Tübingen, 1998, f. 75.

⁹⁹ Po aty.

E ardhmja e përparme lidhore në diatezën veprore ose Futur II në gjermanishte ndërtohet: "*folja werden në të tashmen lidhore + foljen kryesore në pjesoren e shkuar + ndihmësen kam/jam në infinitiv*"¹⁰⁰ (*ich werde gefragt haben, du werdest gefragt haben, er/sie/es werde gefragt haben, wir werden gefragt haben, ihr werdet gefragt haben, sie/Sie werden gefragt haben*) (30).

(30)

*Er wird die Stadt besichtigt haben.*¹⁰¹

Do ta ketë vizituar qytetin.

Edhe te kjo kohë dallojmë dy degëzime në diatezën pësore, ndërtim me Konjunktiv I dhe Konjunktiv II:

1. E ardhmja e përparme lidhore në diatezën pësore me Konjunktiv I ndërtohet: "*folja werden në të tashmen dëftore + pjesoren e shkuar të foljes kryesore + pjesoren e shkuar të foljes werden + foljen sein në infinitiv*"¹⁰² (*ich werde gefragt worden sein, du wirst gefragt worden sein, er/sie/es wird gefragt worden sein, wir werden gefragt worden sein, ihr werdet gefragt worden sein, sie/Sie werden gefragt worden sein*).

2. E ardhmja e përparme lidhore në diatezën pësore me Konjunktiv II ndërtohet: "*folja werden në preteritum + pjesoren e shkuar të foljes kryesore + pjesoren e shkuar të foljes werden + foljen sein në infinitiv*" (*ich würde gefragt worden sein, du würdest gefragt worden sein, er/sie/es würde gefragt worden sein, wir würden gefragt worden sein, ihr würdet gefragt worden sein, sie/Sie würden gefragt worden sein*).

Duke qenë se koha e ardhme dhe ajo e ardhme e përparme lidhore gjenden vetëm në gjermanishte, nuk është e mundur të flasim për krahasim në nivelin morfologjik midis dy gjuhëve.

¹⁰⁰ Po aty.

¹⁰¹ Shembull i marrë nga: Gerhardt Helbig & Joachim Buscha: *Deutsche Grammatik, ein Handbuch für den Ausländerunterricht*, Langenscheidt, Berlin und München, 2001, f. 139.

¹⁰² Karl-Ernst Sommerfeld & Günter Starke, *Einführung in die Grammatik der deutschen Gegenwartssprache*, Max Niemeyer Verlag, Tübingen, 1998, f. 75.

2.5. Mënyra kushtore

Në shqipe kushtorja ka dy kohë: *të tashmen* dhe *të kryerën*. Siç është përmendur edhe në kapitullin e dëftores, format morfologjike të kushtores përputhen me ato të dëftores, konkretisht format gramatikore të së tashmes kushtore janë homonime me ato të së ardhmes të së shkuarës të dëftores¹⁰³, ndërsa format gramatikore të së kryerës kushtore janë homonime me ato të së ardhmes së përparme të së shkuarës.

2.5.1. Koha e tashme

Paradigmat foljore të së tashme kushtore në diatezën veprorë ndërtohen duke i paravendosur pjesëzën *do* formave të së pakryerës së lidhores: *do të pyesja, do të pyesje, do të pyeste, do të pyesnim, do të pyesnit, do të pyesnin* (31).

(31)

*Edhe unë, po të isha në vendin tënd, kështu do të çuditesha*¹⁰⁴.

An deiner Stelle würde ich genauso überrascht wie du sein.

Format foljore të së tashmes kushtore në diatezën pësorë dalin: *do të pyetesh, do të pyetesh, do të pyetesh, do të pyeteshim, do të pyeteshit, do të pyeteshin*¹⁰⁵.

2.5.2. Koha e kryer

Format gramatikore të së kryerës kushtore janë homonime me ato të së ardhmes së përparme të së shkuarës¹⁰⁶: *do të kisha pyetur, do të kishe pyetur, do të kishte pyetur, do të kishim pyetur, do të kishit pyetur, do të kishin pyetur* (32).

¹⁰³ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 294.

¹⁰⁴ Shembull i marrë po aty, f. 328.

¹⁰⁵ Po aty, f. 303.

¹⁰⁶ Po aty, f. 295.

(32)

Do të ta kisha falur atë gabim, sikur t'u kishe dhënë fund prapësive të tua¹⁰⁷.*Ich hätte dir den Fehler verziehen, hättest du mit deinen Gemeinheiten aufgehört.*

Format foljore të së kryerës kushtore në diatezën pësore dalin: *do të isha pyetur, do të ishe pyetur, do të ishte pyetur, do të ishim pyetur, do të ishit pyetur, do të ishin pyetur*¹⁰⁸.

Duke qenë se në gjermanishte nuk gjenden paradigma foljore të mënyrës kushtore, është e pamundur të flasim për krahasim mbi nivelin morfologjik midis dy gjuhëve. Krahasimi ynë do të vijojë në rrafshin semantik dhe funksional, duke përvijuar mjetet gramatikore që ka në dispozicion gjermanishtja për të mbuluar a shprehur fjalitë e mënyrës kushtore të shqipe.

2.6. Mënyra dëshirore

Dëshirorja e shqipes në formatin e saj të posaçëm paraqitet shumë e vështirë për t'u sqaruar historikisht. Në shumë gjuhë indoevropiane ka ndodhur përzjerja e lidhore me dëshiroren, ndërkohë në sistemin foljor të shqipes është vërtetuar një prirje e kundërt, ajo për t'i dalluar sa më qartë formalisht kuptimet modale¹⁰⁹. Në shqipe dëshirorja dallohet shkoqur si për nga format foljore, edhe për nga kuptimet modale përkatëse, pra themi që ajo është një mënyrë e përvijuar. Mënyra dëshirore në gjuhën shqipe ka dy kohë: *të tashmen dhe të kryerën*¹¹⁰. Ndryshe qëndron çështja në gjuhën e sotme gjermane, ku nuk gjenden paradigma gramatikore të mënyrës dëshirore¹¹¹.

¹⁰⁷ Shembull i marrë nga Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 147.

¹⁰⁸ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Tiranë, 2002, f. 305.

¹⁰⁹ Shaban Demiraj, *Morfologjia historike e gjuhës shqipe (pjesa II)*, Tiranë, 1976, f. 22.

¹¹⁰ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Tiranë, 2002, f. 296-296.

¹¹¹ Fillimisht në gjuhën gjermane gjendeshin katër mënyra, midis tri mënyrave të pranura tashmë (dëftore, lidhore dhe urdhërore) gjendej edhe një mënyrë e katërt, "forma e dëshirës", dëshirorja *Optativi*. Me kalimin e kohës kjo mënyrë iu bashkëngjiti lidhore, andaj lidhoreja ka aq shumë nuanca kuptimore dhe nuk është gjithmonë lehtësisht e dallueshme. Studiuesit nuk e pranojnë apo njohin dëshiroren si mënyrë më vete në gjermanishten e sotme letrare. Por ky qëndrim nuk ka qenë gjithmonë kështu ose të paktën jo kaq i prerë. Historia e gramatikës së gjuhës gjermane na tregon se hasim përdorime të termit *der Optativ* (dëshirore). Ajo çka gjuhëtarët ngrenë si çështje dhe diskutojnë është pikërisht shfaqja e pastër ose jo e kësaj mënyre, por nuk e vënë në diskutim që ajo

2.6.1. Koha e tashme

Format e kohës së tashme dëshirore në diatezën veprorë ndërtohen duke i shtuar temës së posaçme të dëshirores mbaresat vetore: *-a*, *-*, *-të* (në numrin njëjës) dhe *-im*, *-i*, *-in* (në numrin shumës). Tema e posaçme e dëshirores ndërtohet me anë të prapashitesës trajtëformuese *-fsh/-sh*, e cila i prapangjitet temës së foljes. Kjo e fundit përkon në shumicën e rasteve me atë të së kryerës së thjeshtë e në disa të tjera me temën e pjesores ¹¹²: *la-fsh-a*, *qo-fsh-a*, *gjet-sh-a* (33).
(33)

Veçanërisht më mundonin shprehje të tilla si "hëngsh"¹¹³ kokën". (Kronikë në gur; Ismail Kadare, faqe 72-73)

Aussprüche wie "Ich fress' meinen Kopf, wenn nicht ..." machten mir übel zu schaffen. (Chronik im Stein, Ismail Kadare Seite 84)

Përsa i përket ndërtimit morfologjik të së tashmes në diatezën pësore, pjesëza *u* i paravendoset formave vetore përgjegjëse të zgjedhimit vepror¹¹⁴: *u lafsha*, *u lafsh*, *u laftë*, *u lafshim*, *u lafshi*, *u lafshin*.

ekziston. Midis tri mënyrave tashmë të konfirmuara në gjuhën e sotme gjermane disa autorë kanë pranuar dëshiroren dhe eksklamativin (habitoren), edhe pse me rezerva e duke i vendosur shpeshherë në pikëpyetje. Openraider (Oppenrieder) klasifikon dëftoren, lidhoren dhe urdhëroren në klasa të mëdha ose qëndrore, ndërkohë që dëshiroren dhe eksklamativin i klasifikon në klasa të vogla ose periferike. Dëshiroren që nuk përmban asnjë përbërës të lidhores, Karnap (Carnap) e quan "dëshirore të pastër". Disa gjuhëtarë njohin dhe përmendin fjalinë dëshirore nën termin *Desiderativsatz* në vend të *Optativsatz* (Duden-Grammatik, 2009, cit. Jörg Meibauer, Markus Steinbach, Hans Altmann - *Satztypen des Deutschen*, 2013); Henschel përdor termin *Optativsatz* (Elke Henschel, 2010:214).

¹¹² Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Tiranë, 2002, f. 295.

¹¹³ Në vepër shkrimtari Kadare ka përdorur formën *hëngërsh*.

¹¹⁴ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Tiranë, 2002, f. 304.

2.6.2. Koha e kryer

Format e së kryerës dëshirore në diatezën vepore ndërtohen duke i paravendosur pjesores së foljes format vetore të së tashmes së dëshirores të foljes ndihmëse *kam*¹¹⁵: *paça pyetur, paç pyetur, pastë pyetur, paçim pyetur, paçi pyetur, paçin pyetur* (34).

(34)

Të pastë marrë të ligat!

Er sollte dein Böses wegnehmen!

Format gramatikore të së kryerës dëshirore në diatezën pësore ndërtohen me anë të foljes ndihmëse *jam*¹¹⁶: *qofsha larë, qofsh larë, qoftë larë, qofshin larë, qofshit larë, qofshin larë*.

Duke qenë se në gjermanishte nuk gjenden format foljore të mënyrës dëshirore është e pamundur të flitet për krahasim në nivelin e formimit morfologjik midis dy gjuhëve. Krahasimi ynë do të vijojë në rrafshin semantik dhe funksional, duke paraqitur mjete gramatikore që ngërthen gjermanishtja për të shprehur një dëshirë në formën e urimit apo mallkimit.

2.7. Mënyra urdhërore

Urdhërorja është e vetmja mënyrë në shqipe dhe gjermanishte, e cila nuk ka ndarje kohore sikur mënyrat e tjera. Paraqitja e kësaj mënyre në të dyja gjuhët përmbledhet me dhënien e paradigmave foljore në vetën e dytë njëjës e shumës, duke shtuar për gjermanishten edhe vetën e përdorimit zyrtar, e cila gramatikusht shprehet ndryshe te njëra gjuhë e ndryshe te tjera, por përdorimi, kuptimi e funksioni janë të ngjashëm. Në shqipe përdoret veta e dytë shumës për të shprehur formën e politesës, ndërsa në gjermanishte forma me *Sie*, e cila zgjedhohet njëjloj si veta e tretë shumës. Në të dyja gjuhët forma e politesës mund t'i drejtohet një, dy apo disa personave.

¹¹⁵ Po aty, f. 296.

¹¹⁶ Po aty, f. 305.

Si në shqipe edhe në gjermanishte urdhërorja sillet në të njëjtën mënyrë kur bëhet fjalë për formimin e formave foljore të saj: baza për formimin e tyre është koha e tashme e mënyrës dëftore. Ndryshimi qëndron në faktin që secila gjuhë ka rregullat e saj për të ndërtuar paradigmën foljore të urdhërores. Nisur nga karakteri i studimit tonë, ne do të fokusohemi më shumë mbi procesin e formimit të formave foljore të urdhërores se sa në rastet e detajuara të secilës klasë. Për të krijuar bazën morfologjike të krahasimit përmendim disa raste argumentuese: foljet kalimtare dhe ato jokolimtare në vetëm e dytë njëjës dhe shumës në diatezën veprorë të mënyrës urdhërore dalin me forma gramatikore sintetike, që shpeshherë janë të njëjta me format gramatikore përkatëse në kohën e tashme të mënyrës dëftore¹¹⁷. Këtu mund të përmendim disa folje të cilat mbarojnë me: *-as* (*qeras, pikas, qas*), *-is* (*braktis, habit/habis, rradhit/rradhis*), *-os* (*vendos, tymos, palos*), *-us* (*kërrus, këpus, zbus*), *-ys* (*ngrys*). Foljet e klasës së dytë të zgjedhimit të parë¹¹⁸ në vetën e dytë njëjës të kohës së tashme të mënyrës urdhërore në pjesën më të madhe dalin me temë në zanore, d.m.th. nuk marrin ndonjë mbaresë vetore dhe as nuk e ruajnë bashkëtingëlloren hundore *-n*, që kanë në vetën e dytë njëjës të kohës së tashme të mënyrës dëftore¹¹⁹: *Ti punon→Puno!*; *Ti shkon→Mos shko!*. Si rregulla vijuese në ndërtimin e urdhërores në shqipe përmendim: mbaresa *-j* në vetën e dytë njëjës, apo ndryshim i zanores së temës së foljes *-e* ose togun e zanoreve *-ie* të temës në *-i*, folje pa ndryshim apo me forma gramatikore të ndryshme nga ato të vetës së dytë njëjës të kohës së tashme të mënyrës dëftore (*ti nget→mos e nga; ti flet→mos fol*). Folja supletive *vij* në vetën e dytë njëjës dhe shumës të kohës së tashme të mënyrës urdhërore bën: *Eja! Ejani!*¹²⁰. Në gjermanishte këtë fenomen e gjejmë në një formë të ngjashme me ndihmësen *sein* (jam). Duke qenë se baza për formimin e urdhërores është koha e tashme e dëftores, atëherë kemi: *Du bist* (Ti je.) Urdhërore: *Sei vernünftig!* (Ji i arsyetueshëm!). Procesi i formimit të paradigmave foljore të urdhërores është tepër i thjeshtë: veta e dytë njëjës urdhërore është e njëjtë me rrënjën e foljes. Kjo e shprehur më konkretisht: kur folja vendoset në mënyrën urdhërore, bie përëmri vetor dhe mbaresa e vetës e së tashmes dëftore: *Du gehst→Geh!/Ti shkon→Shko!*; *Du arbeitest→Arbeite!/Ti punon→Puno!*. Foljet të cilat në kohën e tashme dëftore, veta e 2-të dhe e 3-të numri njëjës ndryshojnë zanoren e rrënjës, nën veprimin e

¹¹⁷ Shaban Demiraj, *Morfologji e gjuhës së sotme shqipe*, II. Tiranë. 1970, f. 221.

¹¹⁸ Siç e kemi përmendur në fillim të këtij punimi, ky grup foljesh përbën pjesën më të madhe të foljeve në gjuhën shqipe.

¹¹⁹ Shaban Demiraj, *Morfologji e gjuhës së sotme shqipe*, II, Tiranë. 1970, f. 221.

¹²⁰ Po aty, f. 224.

Umlautit (metafonisë), kur formojnë mënyrën urdhërore do ta humbasin atë: *fahren* (udhëtoj në infinitiv)→*du fährst* (mënyra dëftore, koha e tashme, veta II njëjës)→*Fahr!* (*Udhëto!* mënyra urdhërore, veta II, njëjës); foljet me ndryshim të zanores së rrënjës në mënyrën dëftore, koha e tashme veta e 2-të dhe e 3-të njëjës, në formën urdhërore do ta ruajnë këtë ndryshim zanoreje: *nehmen* (marr në infinitiv)→*du nimmst* (mënyra dëftore, koha e tashme, veta e 2-të njëjës)→*Nimm!* (*Merr!* mënyra urdhërore, veta e 2-të njëjës). Në të dyja gjuhët në procesin e formimit të paradigmave foljore të një mënyre ka dhe raste të veçanta apo përjashtime. Kështu për gjermanishten mund të përmendim mbaresën -e si të detyrueshme tek foljet që mbarojnë me -el (shpesh me shkurtim të mbaresës): *lächeln*→*lächle* (buzëqesh)¹²¹. Formimi i urdhërores në vetën e dytë të numrit shumës si në shqipe edhe në gjermanishte është i njëjtë: urdhërorja e shumësit është homografe dhe homofone me paradigmën foljore të vetës së dytë shumës të kohës së tashme të mënyrës dëftore në diatezën veprorë¹²² dhe kthehen në mënyrën urdhërore pa pësuar ndryshime, ndërsa përemri vetor bie: *Ihr geht*→*Geht!* (*Ju shkon!*→*Shkon!*). Në disa ndërtime me urdhërore në të dyja gjuhët, kur duam të theksojmë personin të cilit i / personave të cilëve u drejtohem, vendoset edhe përemri vetor¹²³: *Shko ti, jo Ana!* / *Shkon ju, jo fëmijët!* / *Geh du, nicht Anna!* *Geht ihr, nicht die Kinder!*

Në gjermanishte forma e politesës në mënyrën urdhërore përputhet plotësisht me formën e politesës në mënyrën dëftore, koha e tashme. Ndryshimi i vetëm është që në formën urdhërore, folja dhe përemri *Sie* këmbëjnë pozicionet e tyre në fjali: *Sie sprechen* (mënyra dëftore, koha e tashme)→*Sprechen Sie!* (mënyra urdhërore) (*Ju flisni*→*Flisni!*). Ndërsa në shqipe forma e politesës e mënyrës urdhërore ndjek formimin e mënyrës urdhërore të vetës së dytë të numrit shumës, koha e tashme, mënyra dëftore. Përjashtje tjetër këtu vërehet në momentin, që në të dyja gjuhët morfologjikisht nuk arrihet të kuptohet nëse po i drejtohem një apo shumë personave. Këtë informacion ne mund ta nxjerrim nga konteksti gjuhësor: *Nehmen Sie Platz, Herr Meier!* / *Zini vend ju lutem, zoti Majer!*; *Trinken Sie auf das Wohl des Geburtstagskindes, meine Damen!* / *Pini për shëndetin e të festuarit, zonjat e mia!*¹²⁴.

¹²¹ Për më shumë shih: Ulrich Engel, *Deutsche Grammatik*, IUDICIUM Verlag GmbH, München, 2004, f. 222.

¹²² Gisela Zifonun, Ludger Hoffmann, Bruno Strecker, *Grammatik der deutschen Sprache*, Band 1, 2, 3, De Gruyter, 1997, f. 1725.

¹²³ Pë gjermanishten: Peter Eisenberg, *Grundriss der deutschen Grammatik, Band 2: Der Satz, 2. Überarbeitete und aktualisierte Auflage*, Verlag J. B. Metzler, Stuttgart – Weimar, 2004, f. 102.

¹²⁴ Harald Weinrich, *Textgrammatik der deutschen Sprache*, Dudenverlag, 1993, f. 268.

Lidhur me shprehjen e mënyrës urdhërore në diatezën pësore në gjermanishte nuk gjejmë të njëjtin qëndrim midis gjuhëtarëve - disa e pranojnë e disa të tjerë jo. Engel e përjashton ekzistencën e formave foljore të urdhërores në diatezën pësore duke njohur vetëm një rast si përjashtim: *Sei gegrüßt!*¹²⁵ (Ji i përshëndetur!¹²⁶). Ndryshe e sheh këtë Vajnrh (Weinrich), i cili shprehet se urdhërorja dhe pësorja nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën. Duke qenë se përdorimi i urdhërores kërkon plotësimin e kushtit që personit të cilit i drejtohet urdhri të ketë ndikim në ndryshimin e situatës, paraqiten format e urdhërores në diatezën pësore tepër rrallë. Përdorime të këtilla kufizohen në pësoren e gjendjes¹²⁷:

(35)

Sei vielmals gegrüßt von Deinem ...

Shumë të fala nga i yti ...

Më shpesh ai e gjen përdorimin e urdhërores në diatezën pësore me ndihmën e foljes vetvetore *lassen* (36):

(36)

Lass dich hier nicht mehr sehen!

*Mos u duk më kënde!*¹²⁸

Në kthimin në shqipe gjejmë përputhje të të gjitha niveleve, në atë morfologjik, sintaksor dhe semantik. Ndryshe qëndron çështja në përdorimin: *Lass dich hier nicht mehr sehen!*/*Mos u duk më ketej!* – këtu kemi afrim në nivelin semantik e sintaksor, por jo në atë morfologjik. Kthimi në shqipe realizohet në kornizën e përshtatjes gjuhësore. Cifonun (Zifonun) dhe bashkëautorët i shohin përdorimet e foljes *lassen* në shembuj të tipit "*Lass dich ja nicht erwischen!*", si të pamundura për t'u klasifikuar si pësore apo struktura me pësore, me argumentimin që kryefjala është individ i përfshirë me vullnetin e tij në situatën në fjalë¹²⁹.

¹²⁵ Ulrich Engel, *Deutsche Grammatik*, IUDICIUM Verlag GmbH München, 2004, f. 222. Qëndrimin të Engelit (Engel) i bashkohen shumë gjuhëtarë të tjerë, si: Cifonun etj. (Zifonun etj.), Hofman (Hoffmann), Shtreker (Strecker), Helbig dhe Buscha (Helbig-Buscha), të cilët i konsiderojnë strukturat e urdhërores në formën pësore si të mundura gramatikisht, por jo semantikisht.

¹²⁶ Format në kllapa nuk ekzistojnë në shqipe, por i kemi përkthyer për të krijuar idenë e përdorimit në gjermanishte. Përkthimi i përshtatur është: *Të përshëndes!* Por në këtë mënyrë, nuk do të mund të paraqitej nga ana gramatikore pësorja e përdorur në gjermanishte.

¹²⁷ Harald Weinrich, *Textgrammatik der deutschen Sprache*, Dudenverlag, 1993, f. 270.

¹²⁸ Po aty.

¹²⁹ Gisela Zifonun, Ludger Hoffmann, Bruno Strecker, *Grammatik der deutschen Sprache*, Band 3, De Gruyter, 1997, f. 1729.

Krahasuar me gjermanishten, çështja mbi format urdhërore në pësore në shqipe qëndron ndryshe, ku përveçse këto forma foljore gjenden fare të pastra, ato kanë edhe spektër të gjerë përdorimi, sidomos në komunikimin e situatave të përditshme: *Mësohu!* (*veta II njëjës*); *Mësohuni!* (*veta II shumës*). Format e diatezave pësore e vetvetore të kësaj urdhërores në shqipe ndërtohen me pjesëzën *-u*, në vetën e dytë shumës vendoset midis rrënjës dhe mbaresës vetore *-ni*, e cila vihet zakonisht pas foljes: *Vish-u!* *Vish-uni!* *Zbath-u!* *Zbath-uni!* *Mendoh-u!* *Mendoh-uni!*¹³⁰: *Lëreni dritën ndezur,-briti gruaja përnjëherësh e me rrëmbim*. Por në rast se folja është e shoqëruar me pjesëzën e mohimit ‘*mos*’, atëherë pjesëza *u* vihet para foljes: *Mos u bëj nazelie!*; *Mos u bëni indiferentë ndaj varfërisë!*.

Fjalja urdhërore mohuese në shqipe ndërtohet me pjesëzën mohuese *mos*, e cila i paravendoset foljes në urdhërore (37). Dy pjesëzat mohuese të shqipes *nuk* dhe *mos* qëndrojnë përballë pjesëzës mohuese *nicht*. Në gjermanishte pjesëza mohuese i paravendoset foljes në strukturën e lidhore, kur kjo strukturë përfaqësohet nga paskajorja (37). Në shembullin (37) në gjermanishte, urdhërorja shprehet me strukturën gramatikore: “*pjesëz mohuese nicht + folje në infinitiv*”, ndërsa në shqipe kemi strukturën gramatikore: “*pjesëz mohuese mos + folje në urdhërore*”. Përjasja në këtë strukturë gramatikore është e pjesshme: në përdorimin e pjesëzës mohuese *mos/nicht*, gjithashtu edhe pozicioni i kësaj pjesëze në fjali është i njëjtë: ajo i paravendoset foljes. Në strukturën klasike foljore në urdhërore, pjesëza mohuese në gjermanishte i pasvendoset foljes në urdhërore: *Geh nicht!*/*Mos shko!*

(37)

Mos ikni! (*Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 69*)

Nicht weggehen! (*Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 67*)

¹³⁰ Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie. Leipzig, 1987, f. 109.

KREU III

MËNYRA DËFTORE

3.1. Mënyra dëftore në shqipe dhe gjermanishte

Nëpërmjet kategorisë gramatikore të mënyrës shprehet lidhja midis veprimit të emërtuar nga folja dhe realitetit objektiv¹³¹. Sipas “Gramatikës së gjuhës shqipe I”¹³² dhe Demirajt¹³³ për gjuhën shqipe pranohen gjashtë mënyra të foljes: *dëftore, habitore, lidhorje, kushtore, dëshirore dhe urdhërore*. Sipas Duden¹³⁴ (DUDEN), Zomerfeld dhe Shtarkes¹³⁵ (Sommerfeld-Starke) Helbigut dhe Bushës¹³⁶ (Helbig-Buscha) në gjermanishte gjenden tri mënyra të foljes: *dëftore, lidhore dhe urdhërore*. Pra, krahasuar me shqipen, në gjermanishte nuk gjenden: *mënyra dëshirore, habitore dhe ajo kushtore*. Termat *mënyra dëftore* në shqipe dhe *der Indikativ* apo “die Wirklichkeitsform” (forma e së vërtetës) në gjermanishte u përgjigjen termës latine *modus indicativus*¹³⁷ – me anë të kësaj mënyre shprehet kryesisht modaliteti i

¹³¹ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 272.

¹³² Po aty.

¹³³ Shaban Demiraj, *Studime filologjike: Rreth kategorive gramatikore të mënyrës dhe të kohës në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1977, f. 101.

¹³⁴ DUDEN, *Grammatik der deutschen Gegenwartssprache*, DUDENVERLAG, Mannheim–Leipzig–Wien–Zürich, 2005, f. 156.

¹³⁵ Karl-Ernst Sommerfeldt / Günter Starke, *Einführung in die Grammatik der deutschen Gegenwartssprache*, Max Niemeyer Verlag, Tübingen, 1998, f. 74.

¹³⁶ Gerhardt Helbig & Joachim Buscha, *Deutsche Grammatik, ein Handbuch für Ausländerunterricht*, Langenscheidt, Berlin und München, 2001, f. 168.

¹³⁷ Për shqipen: Shaban Demiraj, *Morfologji e gjuhës së sotme shqipe*, II, Tiranë, 1970, f. 185.

vërtetësisë. Por mënyra dëftore nuk duhet të kuptohet si "mënyra e së vërtetës", me anë të së cilës mund të shprehen vetëm thënie të vërteta - e rëndësishme është që këto thënie të jepen si reale ose të paktën, të paraqiten si mundësisht reale¹³⁸. Nëse folësi dëshiron të shprehë mohim, dyshim apo pasiguri lidhur me vërtetësinë e asaj që ka shprehur, atëherë folja në mënyrën dëftore paraprihet nga pjesëzat mohuese *nuk* apo *s'* në shqipe dhe *nicht* në gjermanishte, si dhe mund të shoqërohet me pjesëzat: *ndoshta*, *kushedi*, *mbase*, *mundësisht*, përkatësisht në gjermanishte: *vielleicht*, *eventuell*, *womöglich*. Parë nga këndvështrimi sintaksor mohimi i fjalisë në gjermanishte është relativisht i shenjzuar vonë. Kjo pasi në fjalitë mohuese vendosja e pjesëzës mohuese *nicht* në fjali ose është në fund të saj ose i paravendoset foljes, kur kjo e fundit pozicionohet në fund të fjalisë¹³⁹. Krahësuar me shqipen themi se në këtë pikë gjejmë përputhje të pjesshme në disa struktura mohuese të fjalive - në më të shumtën e rasteve pjesëzat mohuese në shqipe vendosen në fillim të fjalive dhe një gjë e tillë vjen krejt natyrshëm sipas logjikës së mohimit. Kjo lidhet edhe me faktin gramatikor, që në shqipe pjesëzat mohuese *nuk* dhe *s'* i paravendosen foljes, qoftë e thjeshtë, e përbërë apo edhe strukturë me folje modale. Ndërsa në gjermanishte pjesëza mohuese e veprimit *nicht*, i paravendoset foljes, kur ajo është e thjeshtë, dhe vendoset midis foljeve, kur kemi struktura me kohë të përbëra apo me folje modale. Gjithashtu pjesëza të ndryshme përforcuese shitesë apo ndjafolje kohore zakonisht vendosen para pjesëzës mohuese, qoftë strukturë me fjali të thjeshtë apo strukturë me fjali të përbërë, ndërsa në shqipe midis pjesëzës mohuese dhe foljes nuk hyjnë elemente të tjerë gramatikorë. Për ta ilustruar, lë të shohim shembujt e mëposhtëm:

(1)

Ne s'kishim hedhur akoma rrënjë. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 26)

*Wir waren noch **nicht** eingewurzelt. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 24)*

(2)

***Nuk** m'u durua dhe zbrita shkallët të shikoja se ç'bëhej poshtë. (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 6)*

¹³⁸ DUDEN, *Grammatik der deutschen Gegenwartssprache*, DUDENVERLAG, Mannheim–Leipzig–Wien–Zürich, 2005, f. 157.

¹³⁹ Për këtë shih: Shin Tanaka, *Deixis und Anaphorik – Referenzenstrategien in Text, Satz und Wort, Linguistik – Impulse -Tendenzen*, De Gruyter, 2011, f. 110-111.

*Ich hielt es **nicht** mehr aus und lief die Stufen hinunter; (Chronik im Stein, Ismail Kadare, Seite 8)*

(3)

Po të aviten aq sa të na arrijë flaka, jemi të humbur, sepse tani për tani s'mund të tërhiqemi dot. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 243)

*Wenn sie so nahe kommen, dass sie uns erreichen, sind wir erledigt, denn zurück können wir gerade jetzt **nicht**. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 249)*

Në shembullin (1) fjalia në shqipe përmban 6 fjalë dhe pjesëza mohuese mban pozicionin numër 2; fjalia në gjermanishten origjinale është e thjeshtë, përbëhet nga 5 fjalë dhe pjesëza mohuese mban pozicionin numër 4. Në këtë shembull pjesëza *noch* në gjermanishte pozicionohet para pjesëzës mohuese, ndërsa në shqipe pas foljes. Në shembullin (2) fjalia në shqipen origjinale është e thjeshtë, përbëhet nga 13 fjalë dhe pjesëza mohuese gjendet në pozicionin numër 1. Fjalia e kthyer në gjermanishte përmban 11 fjalë dhe pjesëza mohuese gjendet në pozicionin numër 4. Në shembullin (3) fjalia në gjermanishten origjinale përbëhet nga 19 fjalë dhe pjesëza mohuese zë pozicionin numër 19, pra, pozicionin e fundit. Fjalia e kthyer në shqipe përmban 21 fjalë dhe pjesëza mohuese zë pozicionin numër 17.

Normalisht dëftorja e gjermanishtes nuk trajtohet si operatore e modalitetit, duke qenë se ajo i referohet realitetit, pra operon në një zonë, e cila në sensin epistemik vlen si e verifikueshme¹⁴⁰. Disa gjuhëtarë të huaj kanë ngritur çështjen nëse dëftorja në shqipe e ka kategorinë e modalitetit apo jo. Shaban Demiraj e merr të mirëqenë kategorinë e modalitetit për dëftoren dhe shprehet se kjo mënyrë karakterizohet negativisht në vështirimin që nëpërmjet formave kohore të saj folësi e shpreh qëndrimin e tij vetëm në formën e një pohimi lidhur me kryerjen e një veprimi objektiv, pra shpreh njëherazi edhe një vlerësim plotësues në formën e një dyshimi, dëshire a emocioni. Edhe nga ana formale, përse i takon modalitetit, kjo mënyrë karakterizohet negativisht¹⁴¹. Në lëmin gjuhësor në të dyja gjuhët gjenden mjete të ndryshme gramatikore me anë të të cilave mund të ngjyrosen nga ana modale fjalitë në dëftore. Këtu mund të përmendim p.sh.: *ndajfoljet modale* [*sigurisht, ndoshta, pa dyshim* (në gjermanishte: *sicherlich, sicher, vielleicht, zweifellos*)], *disa grupe fjalësh modale* [*sipas mendimit tim...* (në gjermanishte: *meiner Meinung nach...*)], *foljet modale* [*mund, duhet etj.*

¹⁴⁰ Elke Hentschel & Petra M. Vogel, *Deutsche Morphologie*, De Gruyter Lexikon, Berlin, New York, 2009, f. 233.

¹⁴¹ Shaban Demiraj, *Studime filologjike "Rreth kategorive gramatikore të mënyrës dhe të kohës në gjuhën shqipe"*, Tiranë, 1977, f. 102.

(në gjermanishte: können, müssen, sollen)], *forma kohore modalisht të ngjyrosura* [Ajo do të ketë qenë (me siguri)., (në gjermanishte: Sie wird es (sicher) gewesen sein.)], *theksim të veçantë* [Ti do të vish!, (në gjermanishte: Du kommst mit!)], *folje të caktuara në fjalinë kryesore* [Ajo *beson*, që do ta marrë provimin., (në gjermanishte: Sie *glaubt*, dass sie die Prüfung besteht.)]. Duke përdorur të tilla mjete gramatikore folësi apo shkrimtari merr një qëndrim të caktuar ndaj veprimit në fjalë¹⁴². Në të dyja gjuhët dëftorja është e pashenjzuar¹⁴³ dhe konsiderohet si mënyra normale apo standarde më e përdorur në ligjërimin e shkruar dhe të folur. Kjo mënyrë përdoret gjerësisht në të gjitha llojet e teksteve, qofshin këto letrare, shkollore, me karakter shkencor, teknik apo industrial etj.

Kuptimi kohor i mënyrës dëftore në të dyja gjuhët është i tanishëm, i shkuar ose i ardhshëm. Në shqipe dëftorja është e vetmja mënyrë me një shtrirje kaq të madhe në kohë (tab. 1, f. 7). Në tabelën 1 vërejmë se numri i kohëve të mënyrës dëftore në shqipe është më i madh se sa ai në mënyrën dëftore në gjermanishte. Konkretisht ndryshime vërehen në kohën e shkuar me diferencën dy kohë ose më saktë në gjermanishte kemi preteritumin, i cili qëndron përballë së pakryerës dhe së kryerës së thjeshtë në shqipe; gjithashtu në gjermanishte nuk gjejmë të kryerën e tejshkuar. Përsa i përket së ardhmes, edhe këtu vërehet një diferencë kohësh: shqipja ka katër kohë, ndërsa gjermanishtja dy, në gjermanishte nuk gjenden: e ardhmja e përparme dhe e ardhmja e përparme e së shkuarës. Nëse përdorimi dhe kuptimi i mënyrës dëftore në të dyja gjuhët është i njëjtë, atëherë përse paraqitet kjo diferencë kohësh? Si do të shprehen apo mbulohen gramatikisht në gjermanishte këto “mungesa” në kohë? Për t’i dhënë përgjigje këtyre pyetjeve trajtojmë më poshtë kohët e mënyrës dëftore në të dyja gjuhët.

¹⁴² DUDEN, *Grammatik der deutschen Gegenwartssprache*, DUDENVERLAG, Mannheim-Leipzig-Wien-Zürich, 2005, f. 157.

¹⁴³ Për gjermanishten: Hentschel, Elke & Vogel, Petra M., *Deutsche Grammatik*, De Gruyter Lexikon, Berlin, New York, ISBN-10:3110185601, 2010, f. 171 & Gisela Zifonun, Ludger Hoffmann, Bruno Strecker, *Grammatik der deutschen Sprache*, Band 1,2, 3, De Gruyter, 1997, f. 1743; për shqipen: Shaban Demiraj, *Studime filologjike “Rreth kategorive gramatikore të mënyrës dhe të kohës në gjuhën shqipe”*, Tiranë, 1977, f. 102.

3.1.1. Koha e tashme

Kuptimi themelor i foljes në kohën e tashme dëftore në të dyja gjuhët është i njëjtë, pikërisht të tregojë kryerjen e një veprimi në një kohë që përfshin edhe çastin e ligjërimit¹⁴⁴. Në një vështrim më të thellë vërejmë se përdorimet e së tashmes dëftore paraqesin disa variante përdorimi: atë me kuptimin mbarëkohor e në disa rrethana edhe me kuptimet e së ardhmes dhe të së shkuarës¹⁴⁵. Veprimet e shprehura me kohën e tashme bartin modalitetin e vërtetësisë, qofshin këto pohime apo dyshime. Fjalitë pyetëse dëftore mund të përmbajnë edhe elemente gramatikorë mohues: *Nuk po vjen me ne?*, në gjermanishte: *Kommst du nicht mit?*. Gjithsesi edhe këto pyetje paraqesin elemente pasigurie referuar realitetit. Përgjigja mund të jetë: *Jo, nuk ndjehem mirë.*, në gjermanishte: *Nein, ich fühle mich nicht so wohl.* ose: *Po, natyrisht.*, në gjermanishte: *Ja, natürlich.*

Vajnrih (Weinrich) e përcakton të tashmen e dëftores në gjermanishte si kohën drejtuese në botën e ligjërimit dhe si kohën më të përdorshme gjithandej, me anë të së cilës nuk shprehet perspektivë e kaluar apo e ardhme. Njëkohësisht kjo do të thotë që përdorimi i së tashmes nuk është as i lidhur me një periudhë kohore qoftë e shkuar, e tashme apo e ardhme. Pra, në vetvete e tashmja nuk është as kohë e tanishme. Ajo shpreh një perspektivë neutrale apo të quajtur ndryshe zero¹⁴⁶. Të njëjtin mendim lidhur me kohëpërdorimin zero të së tashmes dëftore ndajnë edhe për shqipen albanologët Buholc dhe Fidler (Buchholz-Fiedler). Ata shprehen se e tashmja është koha e vetme e papërvijuar stilistikisht për sinjalizimin e kohëpërdorimit zero (e tashme e përgjithshme). Përsa i përket shtrirjes kohore të së tashmes, ajo është e papërcaktuar dhe varet nga ajo çka dëshiron të shprehë folësi – kohëpërdorimi mund të nënkuptojë momentin kur flasim, të jetë i përcaktuar në kontekst apo edhe të zgjasë deri në pafundësi, pra të ketë vlerë mbarëkohore e vështruar si e tashme e pakufizuar¹⁴⁷.

Si në shqipe edhe në gjermanishte, kur duam të bëjmë përshkrime të ndryshme të personazheve, emocioneve etj. - qofshin këto të shkurtra apo të gjata - përdorim të tashmen e

¹⁴⁴ Për shqipen: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Tiranë, 2002, f. 306; për gjermanishten: Gisela Ferraresi, *Grammatikalisierung, kurze Einführung in die germanistische Linguistik*, Universitätsverlag WINTER Heidelberg, 2015, f. 84.

¹⁴⁵ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Tiranë, 2002, f. 306.

¹⁴⁶ Harald Weinrich, *Textgrammatik der deutschen Sprache*, Dudenverlag, 1993, f. 213.

¹⁴⁷ Për këtë shih: Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 123.

dëftores. Jo vetëm kaq, por e tashmja e dëftores gjen përdorim mjaft të mirë edhe në tekstet e specialiteteve për qëllime të shumta përshkruese dhe analitike. Ajo është një kohë absolutisht dominuese, veçanërisht në tekstet me karakter shkencor, në të cilat paraqiten veprime jo aktuale apo që ndodhin veç një herë, por ngjarje apo veprime që ndodhin rregullisht¹⁴⁸.

Në shqipe dhe në gjermanishte e tashmja e dëftores shfaqet në katër variante përdorimi:

1. Kur përdoret në kuptimin themelor të kohës së tashme dhe shpreh veprime të cilat po ndodhin në momentin e tanishëm¹⁴⁹. Në përdorimet e shqipes folja shoqërohet me pjesëzën *po*, fenomen gjuhësor të cili nuk e hasim në gjermanishte. Kjo pjesëz i paravendoset foljes në të tashmen¹⁵⁰ dhe shërben për të dalluar një veprim të caktuar, të fiksuar në momentin e ligjërimin (7) ose paralel me një veprim tjetër. I njëjti kuptim në gjermanishte mund të shprehet pa ndihmë morfologjike shtesë (7), (8), (9) me anë të ndajfoljeve kohore: *gerade (tani, në këtë moment)* (10), *jetzt, nun (tani)* ose përmes togfjalëshit: *im Moment (në këtë moment)*. Mbështesim mendimin e gjuhëtarit Dodi, sipas të cilit pjesëza *po* përdoret atëherë kur folësi do të tregojë jo thjesht procesin e veprimit, por karakterin konkret e demonstrativ të tij, sikur ky veprim ndodh para syve të folësit. Kështu nëse vërejmë shembullin (1) në shqipe *personazhi ynë po rri pranë shtratit* të Kemerikut - këtu kemi përputhje të kohës së veprimit, ligjërimin dhe vëzhgimit. Buholc dhe Fidler (Buchholz-Fiedler) dallojnë përdorime relativisht të shpeshta – kryesisht në vetën e parë njëjës dhe shumës, atëherë kur kemi praninë e elementit volitiv, dëshiror (2) – personazhet në shembullin e marrë dëshirojnë të shkojnë nga lëndina. Më i kufizuar është përdorimi jo kohor, por kundërshtues i pjesëzës *po + e tashme*¹⁵¹ – në këtë përdorim është e qartë kundërshtia “*drejtues (kapiten):humb kontrollin*”, pasi një drejtues duhet të jetë gjakftohtë dhe të mos e humbë kurrë toruan.

(1)

*Ich sitze*¹⁵² *am Bette Kemmerichs. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 30)*

¹⁴⁸ Harald Weinrich, *Textgrammatik der deutschen Sprache*, Dudenverlag, 1993, f. 215.

¹⁴⁹ Për shqipen: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Gramatika e gjuhës shqipe 1, Tiranë, 2002, f. 306; për gjermanishten: Gerhardt Helbig & Joachim Buscha, *Deutsche Grammatik, ein Handbuch für Ausländerunterricht*, Langenscheidt, Berlin und München, 2001, f. 130. Shënim: Helbig dhe Buscha e emërtojnë *e tashme aktuale*.

¹⁵⁰ Në shqipe kjo pjesëz gjen shtrirje përdorimi edhe në kohë/mënyrë tjetër, – këto përdorime do të trajtohen në kapitujt përkatës.

¹⁵¹ Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 168.

¹⁵² Folja *sitzen* në gjermanishte mbart në vetvete kuptimin e veprimit që ndodh pikërisht në këtë moment, andaj nuk janë të domosdoshëm elemente morfologjikë mbështetës, megjithatë prania e tyre (*gerade, jetzt, im Moment*) nuk e ndryshon kuptimin e fjalisë.

Po rri pranë shtratit të Kemerihut. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 32)

(2)

Nun schlendern wir zu der Wiese hinter den Baracken hinüber. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 12)

Tani po ia mbathim njëherë andej nga lëndina që shtrihet pas barakave tona. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 14)

(3)

Es ist mir egal, ob du Angst hast. Außerdem bist du Hauptmann, und da verlierst du die Kontrolle.

*Aq më bën mua në ke frikë ti . . . Je edhe kapiten dhe po humbet kontrollin.*¹⁵³

(4)

Was machst du gerade?

Çfarë po bën?

Në të njëjtin kuptim me atë të pjesës *po* në shqipe mund të përdoret edhe forma perifrastike e përfutur si rezultat i lidhjes së formave të kohës së tashme të foljes ndihmëse *jam* dhe përcjellores së foljes themelore¹⁵⁴. Në gjuhën gjermane kjo strukturë gramatikore ndërtohet ndryshe morfologjikisht – është e vërtetë që përdoret folja ndihmëse *jam*, por kësaj folje do t'i shtohet si element i dytë një folje e emëruar. Ky përdorim në gjermanishte emërtohet Verlaufsform: *Ich bin am Nachdenken. Jam duke u menduar*. Kjo mund të vrojtohet lehtësisht në shembullin (5):

(5)

Jam duke mësuar. (folja jam + pjesore e foljes kryesore)

Ich bin am Lernen/beim Lernen. (folja jam + folje e emëruar)

Po sipas “Gramatikës së gjuhës shqipe I” një numër i kufizuar foljesh në gjuhën shqipe, të cilat emërtojnë veprime ose gjendje (kryesisht gjendje fizike apo emocionale) që e karakterizojnë kryefjalën për një kohë të pacaktuar, si p.sh: *gjendem, jam, kam, dua, dashuroj, urrej, admiroj, ëndërroj, di* etj., nuk shoqërohen me pjesëzën *po* (6), (7). Mendojmë se ky

¹⁵³ Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 168.

¹⁵⁴ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 307.

kufizim buron nga shtrirja e pacaktuar kohore. Në kontekste me shtrirje kohore të caktuar (e tashme apo e shkuar) foljet e lartpërmendura përdoren fare mirë në struktura me pjesëzën *po*. I njëjti kuptim në gjermanishte mund të shprehet pa ndihmë morfologjike shtesë, përmes ndajfoljeve: *gerade, jetzt (tani)* ose nëpërmjet togfjalëshit: *im Moment (në këtë moment)*. Pyetjes: *Çfarë po bën?*, i përgjigjemi: **Po** ëndërroj. ose **Po** admiroj pikturën tënde. Në kthimin në gjermanishte prania e ndajfoljes kohore *gerade* nuk është e domosdoshme sikurse në shembullin në shqipe: “*Was machst du (gerade)?*” – *Ich träume. oder Ich bewundere (gerade) dein Bild.*

(6)

- *Këtë nuk e di, - i them unë. – Di vetëm që bëhet luftë dhe që gjithnjë e më shumë vende po marrin pjesë në të. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 179)*

“*Das weiß ich nicht*”, sage ich, “*auf jeden Fall ist Krieg, und jeden Monat kommen mehr Länder dazu.*” (*Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 181*)

(7)

- *Je vërtet kaq hajvan, apo bën sikur je? – hungëron Alberti. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 179)*

“*Bist du wirklich so dämlich oder tust du nur so?*“ knurrt Albert,.. (*Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 181*)

2. Kur përdoret me kuptim mbarëkohor, folja në të tashmen në shqipe nuk shoqërohet me pjesëzën *po*¹⁵⁵. Në këtë variant përdorimi në të dyja gjuhët folja mund të tregojë:

a) veprime të zakonshme, që përsëriten herë pas here¹⁵⁶ (8), pra veprimtari rutinë pa patur nevojën e elementeve gramatikore shtesë. Në shembullin (8) del qartë nga konteksti, që veprimi i të lexuarit të gazetës është diçka që ndodh çdo ditë. Treguesit kohorë në kllapa *gjithmonë* (në gjermanishte: *immer*) nuk janë të nevojshëm për të qartësuar shpeshësinë e veprimit. Pjesa e dytë e fjalisë *kur ha mëngjes* (në gjermanishte: *während er frühstückt*) ndihmon lexuesin/dëgjuesin të hyjë në brendësi të kontekstit dhe të krijojë një pikturë imagjinare lidhur me këtë veprim-rutinë.

¹⁵⁵ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 307.

¹⁵⁶ Për shqipen: *po* aty; për gjermanishten: Gisella Ferraresi, *Grammatikalisierung, kurze Einführung in die germanistische Linguistik*, Universitätsverlag WINTER Heidelberg, 2015, f. 84.

(8)

*Ai **lexon** (gjithmonë) gazetën, kur ha mëngjes.**Er **liest** die Zeitung (immer) während er frühstückt.*

b) veprime, që nuk lidhen me një kohë të caktuar, sepse kanë vlerë mbarëkohore¹⁵⁷. Koha e ligjërimimit dhe e vëzhgimit janë në të tashmen, ndërsa koha e veprimit shtrihet gjatë ose njëkohësisht para dhe pas kohës së ligjërimimit dhe asaj të vëzhgimit¹⁵⁸. Këtë përdorim e hasim në fjalë të urta popullore (9), në mendime me vlerë mbarëkohore (10) apo në thënie të ndryshme të vërtetuara apo të konstatuara nga fusha shkencore (11). Duke qenë se shembuj të këtillë nuk shprehin supozime, por të vërteta të vlefshme, atëherë ky variant përdorimi nuk e përmban faktorin modal.

(9)

*Koha **është** gjykatësi më i mirë.**Der beste Prediger **ist** die Zeit.*

(10)

*Kush **kërkon**, **gjen**.**Wer **sucht**, der **findet**.*

(11)

*Çdo atom **përbëhet** nga bërthama e atomit dhe elektronet.**Jedes Atom **besteht** aus einem Atomkern und einer Elektronenhülle.*

3. Në të dyja gjuhët e tashmja e dëftores mund të përdoret edhe me kuptimin e së ardhmes, kur në fjali ka tregues kohorë, që shënojnë të ardhmen, si *nesër*; *pasnesër* etj¹⁵⁹. Nuk ka asnjë kohë tjetër në sistemin foljor shqip apo gjerman, që ta gjejë veten në përdorime në fjali me kuptime kohore aq të larmishme sikur e tashmja e dëftores; veçanërisht prezantimi i së tashmes në fjali me vlerë mbarëkohore mbështet faktin gjuhësor, që kjo kohë të shihet si

¹⁵⁷ Për shqipen: po aty; për gjermanishten: Karl-Ernst Sommerfeldt & Günter Starke, *Einführung in die Grammatik der deutschen Gegenwartssprache*, Max Niemeyer Verlag, Tübingen, 1998, f. 69.

¹⁵⁸ Gerhardt Helbig & Joachim Buscha, *Deutsche Grammatik, ein Handbuch für Ausländerunterricht*, Langenscheidt, Berlin und München, 2001, f. 132.

¹⁵⁹ Për shqipen: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 307; për gjermanishten: Karl-Ernst Sommerfeldt & Günter Starke, *Einführung in die Grammatik der deutschen Gegenwartssprache*, Max Niemeyer Verlag, Tübingen, 1998, f. 68.

kategori gramatikore e pashenjësuar. Në këto përdorime e tashmja nuk ka kuptim të vetin kohor – referimi kohor nevojitet të nxirret nga konteksti¹⁶⁰.

Përdorimi i kohës së tashme dëftore në gjuhën gjermane për të shprehur veprime në të ardhmen si në ligjërimin e shkuar edhe të folur është shumë i gjerë – krahasuar me shqipen, kjo shtrirje është dukshëm më e madhe. Nëse e krahasojmë me përdorimet standarde të së ardhmes në gjermanishte, përdorimet e së tashmes me vlerën e së ardhmes nuk janë të shenjësuar. Për të shprehur të ardhmen, e tashmja përdoret pa karakterizim stilistik të përcaktuar, sidomos në kontekste me përcaktime kohore si *pasnesër* (në gjermanishte: *übermorgen*), *pas një viti* (në gjermanishte: *nach einem Jahr*), si dhe në format e së ardhmes (volitivi, domosdoshmëria)¹⁶¹. Përdorime të së tashmes të thjeshtë me vlerën e së ardhmes hasen pikërisht në ato raste, kur në kontekst dallohet qartë që veprimi për të cilin ligjërohet pritet të ndodhë, të vijojë apo të kurorëzohet (mbyllet) në të ardhmen, pra, në momentin e ligjërimin shfaqet një synim, dëshirë apo siguri për realizimin e tij. Ndryshe ndodh në rastet, kur realizimi i veprimit has apo mund të hasë në vështirësi të cilat në momentin e ligjërimin janë të pakonstatueshme, por ndjehet një përqindje e shfaqjes së rrezikut të mosrealizimit. Shembuj të tillë gjenden në të ardhmen modale, kur veprimi shoqërohet me dyshime apo supozime. Atëherë edhe në gjermanishte folësi i qëndron formulës standarde të ndërtimit të së ardhmes dëftore dhe nuk ngërthen forma foljore të së tashmes dëftore. Kjo vlen deri diku për shqipen: shqipja sillet më e kursyer në përdorimin e së tashmes dëftore në vend të së ardhmes dëftore. Në tekstet rrëfimtare në gjermanishte në rastet e paskohshmërisë nuk zëvendësohet e ardhmja përmes së tashmes. Zëvendësimi do të çonte në humbjen e efektit të veçantë të parashikimit, i cili synohet të arrihet me anë të përdorimit të së ardhmes. Në përgjithësi zgjedhja midis së tashmes dhe së ardhmes varet kryesisht nga konteksti. Përzgjedhja konsiderohet edhe si çështje e stilit të shkrimtarit apo ligjëruesit. Kur kemi tekste të gjata nuk shihet si e udhës të përdoret e ardhmja e thjeshtë. Në raste të tilla qëndron e tashmja e dëftores në dispozicion¹⁶². Shembujt e mëposhtëm e ilustrojnë qartë spektrin e përdorimit të së tashmes me vlerën e së ardhmes në të dyja gjuhët.

(12)

¹⁶⁰ Peter Eisenberg, *Grundriss der deutschen Grammatik, Band 2: Der Satz, 2. Überarbeitete und aktualisierte Auflage*, Verlag J. B. Metzler, Stuttgart – Weimar, 2004, f. 114.

¹⁶¹ Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 123.

¹⁶² Për këtë shih: DUDEN, *Die Grammatik – unentbehrlich für richtiges Deutsch*, Band 4, Dudenverlag, Mannheim, Leipzig, Wien, Zürich, 2005, f. 517.

*Morgen **kommen** die neuen Studenten. (koha e tashme në kuptimin e së ardhmes)*

*Nesër **vijnë** studentët e rinj. (koha e tashme në kuptimin e së ardhmes)*

(13)

*Nächste Woche **beginnt** die Schule.¹⁶³*

*Javës tjetër **fillon** shkolla.¹⁶⁴*

(14)

*Was **machst** du am Wochenende? (koha e tashme në kuptimin e së ardhmes)*

*Çfarë **do të bësh** në fundjavë? (koha e ardhme)*

(15)

*Vorgestern waren wir noch im Feuer, heute machen wir Albernheiten und fechten uns die Gegend, morgen **gehen** wir wieder in den Graben. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 125)*

*Sot merremi me budallallëqe e vrasim kohën dhe nesër **do të shkojmë** përsëri në llogore. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 126)*

Siç shihet në shembujt (12), (13) në të dyja gjuhët kemi përputhje në përdorim të kohës së tashme për veprime në të ardhmen. Në shembuj të këtyllë të së tashmes, e ardhmja nuk shprehet me mjete gramatikore, por gjen mbështetje në mjete leksikore, në ndajfoljet kohore: *morgen/nesër* (12), *nächste Woche/javës tjetër* (13). Këto elemente gramatikorë e transportojnë dëgjuesin me mendime menjëherë në të ardhmen. Gjithashtu vlen të përmendet fakti, që ligjëruesi është i sigurt se studentët e rinj do të vijnë ditën e nesërme apo që shkolla do të fillojë javën që vjen. Përsa u takon shembujve (14) dhe (15) vërehet qartë distancimi i përdorimit të kohës së tashme në kuptimin e kohës së ardhme në gjermanishte me atë në shqipe. Forca e treguesve kohorë në këto shembuj nuk ka të njëjtin ndikim gramatikor në shqipe – këta elemente nuk e mbështesin dot paraqitjen e së ardhmes në shqipe përmes së tashmes. Në të katër shembujt (12), (13), (14) dhe (15) koha e ligjëritimit shtrihet para asaj të veprimit. Për sa thamë më sipër shprehemi se, shpeshtësia i përdorimit të kohës së tashme në shqipe në kuptimin e së ardhmes së thjeshtë është shumë më i kufizuar se sa ai në gjermanishte.

¹⁶³ Në gjermanishte nuk e gjejmë përdorimin: *Nächste Woche wird die Schule beginnen.*

¹⁶⁴ Në shqipe mund të përdorim edhe kohën e ardhme: *Javës tjetër **do të fillojë** shkolla.*

4. Kur duam të shprehim një veprim a ngjarje, që ka marrë fund në të shkuarën, ta paraqesim sa më të gjallë, sikur të ndodhte para syve tanë¹⁶⁵. Vajnih (Weinrich) shprehet se që nga koha antike ekziston një traditë e gjatë e përdorimeve të së tashmes dëftore si kohë rrëfimesh në letërsinë tregimtare e kjo kohë quhet *e tashme historike* (gjithashtu edhe e tashme dramatike apo skenike)¹⁶⁶. Për realizimin e këtij kuptimi shpesh nevojiten mjete kohore shtesë¹⁶⁷. Në shqipe e tashmja historike mund të përfaqësojë të gjitha kohët e shkuara. Përdorimi është i shenjëzuar stilistikisht – ai vlen për theksimin e ngjyrave të veprimit, e shkuara do të hidhet në të tashmen¹⁶⁸: veprimi ka ndodhur në të shkuarën dhe paraqitet aktual, sikur po ndodh në të tashmen, pikërisht tani në këto momente. Të njëjtin përdorim të kohës së tashme historike e gjejmë edhe në gjermanishte. Kjo ngjashmëri mund të vërehet lehtësisht nëse vrojtojmë shembujt e mëposhtëm, në gjuhën origjinë e në kthimin e tyre në gjermanishte dhe anasjelltas. Në shembullin e parë *Krujë, o qytet i bekuar* (16) koha e tashme formohet si kohë rrëfimesh, e tashme epike. Përdorime më të shumta të së tashmes historike i hasim në artikujt e leksikëve, biografi dhe lloje të ngjashme kronologjike, jopersonale¹⁶⁹.

Shembulli i parë, vargje në gjuhën shqipe të përkthyer në atë gjermane:

(16)

Krujë o qytet i bekuar,

Prite, prite Skënderbenë,

Po vjen si pëllumb i shkruar,

Të shpëtojë mëmëdhenë.

Kruja, du gesegnete Stadt,

Empfange, empfang Skanderbeg,

*Er **kommt** wie ein Adler,*

¹⁶⁵ Për shqipen: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 308; për gjermanishten: Karl-Ernst Sommerfeldt & Günter Starke, *Einführung in die Grammatik der deutschen Gegenwartssprache*, Max Niemeyer Verlag, Tübingen, 1998, f. 68.

¹⁶⁶ Harald Weinrich, *Textgrammatik der deutschen Sprache*, Dudenverlag, 1993, f. 217.; Karl-Ernst Sommerfeldt & Günter Starke, *Einführung in die Grammatik der deutschen Gegenwartssprache*, Max Niemeyer Verlag, Tübingen 1998, f. 68.

¹⁶⁷ Karl-Ernst Sommerfeldt & Günter Starke, *Einführung in die Grammatik der deutschen Gegenwartssprache*, Max Niemeyer Verlag, Tübingen, 1998, f. 68.

¹⁶⁸ Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 123.

¹⁶⁹ DUDEN, *Die Grammatik*, Dudenverlag, Mannheim, Leipzig, Wien, Zürich, 2005, f. 513.

Das Heimatland zu retten.

Shembulli i dytë, fjali në gjuhën gjermane, të përkthyer në atë shqipe:

(17)

*Also, gestern, **gehe** ich im Nord Park **spazieren**. Plötzlich **kommt** die Polizei und **sucht** nach einer Leiche im See.*

*Atëherë, dje, **dal**¹⁷⁰ **shëtitje** në Nord Park. Papritur **vjen** policia dhe **kërkon** një kufomë në liqen.*

Në poezinë (16) në shqipe *po vjen* dhe në kthimin në gjermanishte *er kommt* vërehet lehtësisht roli i së tashmes historike për t'i dhënë jetë dhe emocionet e dhura ngjarjes historike të kthimit të Skënderbeut në Shqipëri. Para se autori të shpallë kthimin e heroit kombëtar, ai i drejtohet qytetit të lindjes së heroit, duke i bërë thirrje, dhe parapërgatit kështu skenën e kthimit të madhërishtë të shpëtimtarit të kombit. Format e së tashmes e bëjnë më të besueshme ngjarjen dhe zgjojnë dukshëm te lexuesi interesin e kureshtjen njerëzore. Vazhdimi i poezisë në shqipe me folje në lidhore referuar një veprimi në të ardhmen dhe në gjermanishte me strukturën gramatikore “zu + folje kryesore në infinitiv” (për të shpëtuar) e vesh ngjarjen me petkun e realitetit dhe kujdeset për shpërthime emocionale të forta. Edhe tek shembulli i dytë (17) në gjermanishten origjinale *gehe ich spazieren, kommt, sucht*, dhe në shqipen e kthyer *dal shëtitje, vjen, kërkon*, si lexues e ndjejmë qartë që besueshmëria ndaj ngjarjes që po tregohet rritet dukshëm nga përdorimi i së tashmes historike dhe e gjithë historia vishet me një nuancë kureshtjeje e kërkësie rritet. Në të dy shembujt e sipërshënuar lexuesi ka përshtypjen e teletransportimit nga e shkuara në të tashmen. Gjatë kthimit të vargjeve nga gjuha shqipe në atë gjermane kemi ekuivalencë të plotë kohore. Gjithashtu në kthimin anasjelltas të fjalive gjejmë përputhje: prania e kohës së tashme historike në të dyja gjuhët është më se e qartë, prani e cila reflektohet edhe në përkthimet e bëra nga njëra gjuhë në tjetrën.

¹⁷⁰ Mendojmë se përdorimi i foljes *dal* në të tashmen e dëftores është disi i rrallë – këtu mund të nisim fjalinë edhe me folje në të pakryerën dëftore *po dilja*.

3.1.2. Koha e pakryer, e kryer e thjeshtë e shqipes dhe preteritumi i gjermanishtes

(1)

*Më tepër se aq nuk **posedonim**: ca ëndërrime, ca dashuriçka dhe shkollën – më tej jeta jonë **nuk arrinte** akoma. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 25)*

*Außer diesem **gab** es ja bei uns nicht viel anderes mehr; etwas Schwärmertum, einige Liebhabereien und die Schule; weiter **reichte** unser Leben noch nicht. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 23)*

(2)

*Për habinë time **pashë** se bota përnjëherësh **u trondit**. Befas konturet e saj **u tendosën, u mblodhën, u qartësuan** në mënyrë të pamëshirshme. Për një kohë të gjatë, duke mbajtur xhamin në dorë te njëri sy dhe duke mbyllur tjetrin, unë **vështrova** pamjen e gjerë që hapej nga shtëpia jonë. (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 15)*

*Mit Verblüffung **stellte** ich **fest**, dass die Welt schlagartig **veränderte**. Ihre Konturen **rückten** **jäh zusammen, schlossen sich, wurden** auf erbarmungslose Weise. Lange **stand** ich da mit dem Glas vor dem einen Auge, während das andere geschlossen blieb, und **blickte** die Weite, die sich von unserem Haus öffnete. (Chronik im Stein, Ismail Kadare, Seite 18)*

Në gramatikën e shqipes standarde dëftorja ka dy kohë të shkuara të thjeshta: të pakryerën (1)¹⁷¹ e njohur ndryshe edhe me emërtimin imperfekt, dhe të kryerën e thjeshtë (2) e njohur edhe si aorist I. Në gramatikën e gjermanishtes së sotme gjendet vetëm një kohë e thjeshtë e shkuar në mënyrën dëftore: preteritumi¹⁷² apo das Präteritum siç emërtohet në gjermanishte. Pra, përballë preteritumit të gjermanishtes qëndron skematisht në shqipe binomi: e pakryer dhe e kryer e thjeshtë.

Vijojmë më tej me përcaktimet kuptimore të secilës kohë për të kuptuar nëse vënia përballë qëndron fillimisht nga ana teorike si dhe për të vërejtur më pas shqyrtimin nga ana praktike, e parë në lëmin e përkthimeve. Në gramatikën e shqipes standarde format foljore të së pakryerës gjenden në mënyrën dëftore dhe atë lidhore. Sipas “Gramatikës së gjuhës shqipe I” kuptimi themelor i së pakryerës dëftore në shqipe është të tregojë një veprim në zhvillim e

¹⁷¹ Koha e pakryer e shqipes është e krahasueshme me kohën e shkuar 1 dhe kohën e shkuar 2 në gjermanishte - Emine Teichmann, *Handbuch Grammatik der albanischen Sprache Teil I*, GRIN Verlag, 2015, f. 30.

¹⁷² Disa gjuhëtarë shqiptarë përdorin shpesh termën *preteritum*.

sipër në një çast të caktuar të së shkuarës¹⁷³. Po sipas kësaj gramatike kuptimi themelor i së kryerës të thjeshtë është të tregojë një veprim të përfunduar në një çast të caktuar të së shkuarës¹⁷⁴. Sipas Helbig dhe Bushës (Helbig-Buscha) preteritumi tregon veprime në të shkuarën, ku kemi përputhshmëri të momentit të veprimit me atë të ligjërit.¹⁷⁵ Përkufizimi mbi preteritumin i dhënë në Duden (DUDEN) na duket më i plotësuar se ai i Helbig dhe Bushës (Helbig-Buscha): me formën bazë të grupit kohor të II, preteritumin, jepet një ngjarje e vetme apo ngjarje që përsëriten, të cilat i referohen një momenti të caktuar në të shkuarën përmes treguesve kohorë apo bashkëlidhjes së përgjithshme¹⁷⁶. Përsa i përket perspektivës kohore Vajnrh (Weinrich) shprehet se preteritumi ka të njëjtën sjellje indiferente si e tashmja e dëftores duke patur perspektivën zero apo neutrale. Kuptimin e preteritumit ai e karakterizon shumë mirë me tiparin semantik të vazhdimësisë, të përfundimit¹⁷⁷. Dhe funksione të tilla rezultojnë të volitshme për gjermanishten – me një kohë të vetme ajo arrin të shprehë zhvillimin e një veprimi, por edhe përfundimin e tij. Në kuadrin e këtij këndvështrimi hyn menjëherë në lojë tipari aspektor i preteritumit apo perspektiva e jashtme dhe ajo e brendshme, siç e gjejmë në Duden (DUDEN). Atributi kryesor në fjalinë në preteritum i takon foljes – është pikërisht ajo në bashkëlidhje me kontekstin që i lejon preteritumit një perspektivë të jashtme apo të brendshme. Kjo na çon pikërisht në përcaktimin e funksionit të preteritumit si kohë e thjeshtë e shkuar me anë të së cilës mund të shprehet një ngjarje në proces, një gjendje, një gjendje emocionale apo mendore, ashtu edhe një ngjarje e përmbyllur (skica1). Çështja nuk qëndron shumë ndryshe me dy kohët e thjeshta të shkuara dëftore në shqipe: si e pakryera edhe e kryera e thjeshtë shprehin veprime në të shkuarën – dallimi midis tyre ka më fort karakter aspektor¹⁷⁸ se sa kohor. Ngjyrimet aspektore midis këtyre kohëve janë

¹⁷³ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 308.

¹⁷⁴ Po aty, f. 310.

¹⁷⁵ Gerhardt Helbig & Joachim Buscha, *Deutsche Grammatik, ein Handbuch für Ausländerunterricht*, Langenscheidt, Berlin und München, 2001, f. 133.

¹⁷⁶ DUDEN, *Die Grammatik, Unentbehrlich für richtiges Deutsch 7., völlig neu erarbeitete und erweiterte Auflage*, Duden Band 4, Dudenverlag, Mannheim, 2005, f. 517.

¹⁷⁷ Harald Weinrich, *Textgrammatik der deutschen Sprache*, Dudenverlag, 1993, f. 219.

¹⁷⁸ Kategoria gramatikore e aspektit nuk është e zhvilluar në sistemin foljor të shqipe, i cili karakterizohet nga kategoria gramatikore e kohës. Por disa forma kohore - këtu mund të përmendim të pakryerën, të kryerën e thjeshtë dhe të kryerën e tejshkuar - dallohen midis tyre për ngjyrimet aspektore (Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 274).

të ndryshme – tipari i së pakryerës është të paraqesë një ngjarje, një gjendje, një gjendje emocionale apo mendore në zhvillim e sipër, duke përshkruar procesin - ajo nuk i kushton rëndësi fillimit apo përfundimit të veprimit, por i jep jetë ngjarjes parë nga përbrenda, duke u karakterizuar kështu nga karakteri imperfektiv apo i papërfunduar. Ndërsa e kryera e thjeshtë e vështrohet veprimin nga jashtë dhe paraqit përfundimin, përmbylljen e tij, duke u karakterizuar kështu nga karakteri i saj perfektiv apo i përfunduar (skica 1).

E pakryera	E kryera e thjeshtë	Preteritumi
→		→
<i>Zhvillimin e veprimit</i>	<i>Përfundimin e veprimit</i>	<i>Zhvillimin dhe përfundimin e veprimit</i>
		(skica 1)

Nga sa më sipër, themi që: përjasja e kuptimit të këtyre kohëve të thjeshta të dëftores është relativisht e një spektri të gjerë duke u ndalur në tri pika:

- a- me anë të këtyre kohëve shprehet një veprim në të shkuarën
- b- e kryera e thjeshtë e shqipes dhe preteritumi i gjermanishtes shprehin një veprim të përfunduar tashmë
- c- e pakryera e shqipes dhe preteritumi i gjermanishtes shprehin një veprim në zhvillim e sipër.

Pra, themi që teorikisht e pakryera dhe e kryera e thjeshtë e shqipes rrinë përballë preteritumit të gjermanishtes. Për një argumentim konkret le të krahasojmë shembujt e mëposhtëm (3) dhe (4)¹⁷⁹:

(3)

*Kur unë erdha, ajo po **ziente** çaj.*

*Als ich ankam, **kochte** sie gerade Tee. (Imperfektiv)*

(4)

*Kur unë erdha, ajo **zjeu** menjëherë/shpejt çajin.*

*Als ich ankam, **kochte** sie gleich/sofort/schnell Tee. (Perfektiv)*

¹⁷⁹ Shembujt e gjermanishtes janë cituar nga Vjosa Morina, Magisterarbeit “*Modus und Tempus im Deutschen und Albanischen*”, Wien, 2009, f. 46. (Thieroff, 1992:70).

Në shembullin (3) veprimi në gjermanishte është shprehur me folje në preteritum *kochte*, ndërsa në shqipe me të pakryerën *ziente*. Veprimi në shembullin (3) nuk ka përfunduar ende *ajo po ziente çaj*, andaj mund të themi themi që, në këtë rast shqipja është korrekte në zgjedhjen e kohës së pakryer. Këtu gjermanishtja ngërthen elemente gjuhësore shtesë *gerade* për të orientuar lexuesin/dëgjuesin, që veprimi për të cilin bëhet fjalë *kochte sie gerade Tee*, nuk është i përmbyllur, por në proces e sipër. Shqipja këtë gjë e realizon me një ndihmë të vogël, duke i paravendosur foljes në të pakryerën pjesëzën *po*. Ndryshe qëndron çështja në shembullin (4) – veprimi këtu është i përmbyllur tashmë dhe shqipja zgjedh përdorimin e formave gramatikore të së kryerës së thjeshtë *zjeu*. Gjermanishtja duke qenë se ka vetëm një kohë të thjeshtë gramatikore për të shprehur veprime në të shkuarën, përdor përsëri preteritumin *kochte* duke u kërkuar ndihmë treguesve kohorë: *gleich/sofort/schnell* (*menjëherë, shpejt*). Roli i këtyre treguesve kohorë në gjermanishte është i madh, pasi dhe fuqia e tyre semantike është e atillë: janë pikërisht këta tregues kohorë, që e paraqesin veprimin e zjerjes së çajit *kochte sie Tee* si të përmbyllur. Në shembullin (5) në shqipe kemi kombinime të dy kohëve të thjeshta, së pakryerës *ishin, mundoheshin, ndodhte, mbante, vështronte* dhe të kryerës së thjeshtë *durua, zbrita, vunë re* – në kthimin në gjermanishte këto dy kohë qëndrojnë përballë preteritumit *hielt ... aus, lief ... hinunter, vor sich ging, bemerkten, versuchten, aussah* (tab. 3).

(5)

Nuk m'u durua dhe zbrita shkallët të shikoja se ç'bëhej poshtë. Ata të tre ishin të shqetësuar dhe nuk më vunë re. Kishin hequr kapakun e grykës së sterës dhe po mundoheshin të vështronin ç'ndodhte atje brenda. Nëna mbante llambën dhe babai vështronte. (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 6)

Ich hielt es nicht mehr aus und lief die Stufen hinunter, um nachzusehen, was unten vor sich ging. In ihrer Sorge bemerkten mich die drei nicht. Sie hatten den Deckel von der Zisternenöffnung genommen und versuchten festzustellen, wie es drinnen aussah. Mutter hielt die Lampe, und Vater blickte angestrengt hinein. (Chronik im Stein, Ismail Kadare, Seite 8)

<i>Shqipe</i>		<i>Gjermanishte</i>
<i>Koha e pakryer</i>	<i>Koha e kryer e thjeshtë</i>	<i>Preteritum</i>
	durua	hielt ... aus
	zbrita	lief ... hinunter
	vunë re	bemerkten
mundoheshin		versuchten
ndodhte (atje brenda)		(wie es drinnen) aussah
mbante		hielt
vështronte		blickte

Tabela 2

Kur autori flet për veprime të përfunduara në shqipe ai ngërthen forma foljore të së kryerës së thjeshtë: *durua*, *zbrita*, *vunë re*; ndërsa kur rrëfen për veprime në zhvillim e sipër orientohet nga e pakryera: *mundoheshin*, *ndodhte*, *mbante*, *vështronte*. Pra, siç vërehet nga shembujt (3), (4), (5) edhe nga tabela e mësipërme dy kohët e thjeshta të shkuara në shqipe i korrespondojnë një kohe të thjeshtë të shkuar në gjermanishte.

Marrëdhëniet morfologjike të vendosura midis kohëve qoftë në shqipe apo në gjermanishte janë të qarta - janë pikërisht marrëdhëniet semantike ato që shkaktojnë pikëpyetje e paqartësi në vendosjen e kufijve të kësaj apo asaj kohe. Jo rrallëherë në shqipe hasen përdorime të kohëve të thjeshta dëftore - të kryerës së thjeshtë më së shumti dhe të pakryerës më pak - në vend të kohëve të tjera të shkuara apo të ardhme dëftore. Nisur nga kjo themi që kjo karakteristikë e kohëve të shkuara të thjeshta mund t'i atribuohet zhërvjellësisë semantike e stilistike që i karakterizon ato duke u dhënë mundësinë e ndërthurjes me njëra-tjetrën deri në zëvendësimin e tyre, fenomen gjuhësor të cilin e hasim në të dyja gjuhët. Nëse ndjekim linjën e argumentimit të Tirofit (Thieroff), preteritumi në gjermanishte nuk përdoret vetëm për të shprehur situata në të kaluarën, por edhe për të treguar ngjarje në të tashmen e në të ardhmen, ashtu sikurse edhe përcaktime të përgjithshme, duke e afruar kështu atë me të tashmen. Ndryshimi i preteritumit me të tashmen dëftore qëndron në përkufizimin e kohës: preteritumi shpreh çështje kohore nga një pikë referimi në të shkuarën, ndërsa e tashmja i referohet këtyre

momenteve nga një pikë referimi në të tashmen¹⁸⁰. Të njëjtin mendim ndan edhe Vajnrh (Weinrich), i cili e cilëson preteritumin e dëftores në gjermanishte si kohë të së shkuarës, por jo gjithmonë. Shpesh flitet për ngjarje në të shkuarën para së gjithash në jetën tonë të përditshme apo kur informohemi në lajme dhe në media mbi ngjarje në të shkuarën, më tepër mbi të kaluarën e hershme. Megjithatë përcaktimin e preteritumit si “kohë e së shkuarës” ai e gjen si të pavend duke u nisur nga dy arsye: e para, për të shkuarën mund të flitet edhe me anë të kohëve të tjera, p.sh. me të kryerën, madje edhe me të tashmen, dhe e dyta, me anë të preteritumit mund të shprehen edhe veprime që nuk i referohen së shkuarës, p.sh. në historitë e trilluara e shembuj të tillë gjejmë plot në literaturën artistike botërore¹⁸¹. Ajo çka Vajnrh (Weinrich) ka dashur të shprehë me këtë është pikërisht tipari i universalitetit të preteritumit – ai nuk mund të kufizohet vetëm në tiparin e tij për të shprehur një veprim në zhvillim e sipër në të kaluarën. Nuancat e tij janë shumëngjyrëshe – preteritumi duhet të konsiderohet e studiohet si koha-mjeshtre, që sundon botën e rrëfimit dhe të përshkrimit, kohë që herë vesh petkun e së tashmes e herë atë të së ardhmes. Të njëjtat nuanca si preteritumi në gjermanishte përmban edhe e pakryera e shqipes. Më tej themi që këto kohë të shkuara të thjeshta shtyhen nga njëra-tjetra në pikën e faktorit modal – e pakryera e shqipes shërben për të shprehur nuanca të ndryshme të ngjyimeve modale në përdorime në lëmin e kushtores, kryesisht në të folmet popullore, por edhe në botën letrare¹⁸². Të njëjtat përdorime, me të njëjtat vlera i gjejmë edhe në të kryerën e thjeshtë - edhe pse vlen të theksojmë se në të dyja kohët spektri i përdorimeve kohore dhe aspektuale është shumë më i gjerë nga ai i atyre modale. Ndryshe qëndron çështja me preteritumin, i cili nuk e përmban faktorin modal, por karakterizohet vetëm nga tipari kohor. Për të qartësuar e argumentuar më konkretisht paralelizmat apo veçimet e kuptimeve dhe përdorimeve midis binomit *e pakryer:e kryer e thjeshtë* në shqipe dhe *preteritumit* në gjermanishte nevojitet t’i vëzhgojmë sjelljet e këtyre kohëve në kuadrin e përkthimeve, duke i parë një herë në gjuhën origjinale e një herë të kthyer.

¹⁸⁰ Kristiane Dürich, *The Acquisition of the English Tense and Aspect System by German Adult Learners*, Chemnitz, 2005, S. 49.

¹⁸¹ Harald Weinrich, *Textgrammatik der deutschen Sprache*, Dudenverlag, 1993, f. 220.

¹⁸² Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 126.

3.1.3. Koha e pakryer e shqipes përballë preteritumit të gjermanishtes

Mbi kuptimet themelore dhe shfaqjen apo jo të karakterit modal të së pakryerës dhe preteritumit kemi folur në çështjen paraardhëse. Në përdorimet me karakter jo modal të saj në shqipe tiparet semantike të detyrueshme janë kohore dhe imperfektive apo aspektuale – këto tipare bien në përdorimet e së pakryerës me ngjyime modale¹⁸³.

Variantet kryesore të përdorimit të së pakryerës janë:

1. Për të treguar një veprim të pacaktuar, që është përsëritur herë pas here në të shkuarën (6). Këtu Buholci, Fidleri (Buchholz-Fiedler) dhe Demiraj bien dakord, duke e cilësuar si përdorim për veprime, kuptimi i të cilave përgjithësisht del nga konteksti – të njëjtin përcaktim e gjejmë edhe në “Gramatikën e gjuhës shqipe I”¹⁸⁴. Të njëjtin përdorim me të njëjtën vlerë e hasim edhe në preteritumin e gjermanishtes (6).

(6)

Kur shirat vazhdonin tri-katër ditë rresht, babai e shkëpuste qyngjin, që stera mos të mbushej më tepër nga ç’duhej. (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 6)

Wenn der Regen drei oder vier Tage anhielt, löste mein Vater ein Stück der Dachrinne, damit die Zisterne nicht zu voll wurde. (Chronik im Stein, Ismail Kadare, Seite 8)

Në shembullin (6) shkrimtari për të shprehur përsëritjen e veprimit në shqipe *babai e shkëpuste qyngjin*, në gjermanishte: *löste mein Vater ein Stück der Dachrinne*, e shoqëron fjalinë në të pakryerën dhe në preteritum dëftore me një fjali të varur kohore në shqipe *Kur shirat vazhdonin tri-katër ditë rresht*, në gjermanishte: *Wenn der Regen drei oder vier Tage anhielt*. Është pikërisht kjo fjali e varur kohore e cila na mundëson të përcaktojmë bazuar në kontekst, një veprim të përsëritur.

2. Në të dyja gjuhët gjejmë përdorim të së pakryerës në shqipe dhe të preteritumit në gjermanishte kur i referohemi dy veprimeve të njëkohshme të së shkuarës¹⁸⁵. Forma foljore shpreh njëkohshmëri të veprimeve, d.m.th. zhvillim të njëkohshëm të dy veprimeve (7).

¹⁸³ Po aty, f. 125.

¹⁸⁴ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 309.; Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 125.; Shaban Demiraj, *Morfologji e gjuhës së sotme shqipe, II*, Tiranë, 1970, f. 201.

(7)

... – dhe pranë meje **vraponte** nënoficeri i shërbimit, kapteri Himelshtos, dhe më **shkelte** gishtërinjtë e këmbëve; (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 29)

Neben mir **lief** der Unteroffizier vom Dienst, Himmelstoß, und **trat** mir auf die Zehen; (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 27)

Në shembullin (7) foljet në shqipe janë në kohën e pakryer *vraponte*, *shkelte* dhe në gjermanishten origjinale në preteritum *lief*, *trat*; foljet tregojnë zhvillimin e dy veprimeve, ndërsa përmes kontekstit arrijmë të kuptojmë, që këto dy veprime ndodhin paralelisht, pra të të njëjtën kohë.

3. Për të treguar një veprim të pacaktuar që ka zgjatur për një kohë pak a shumë të gjatë në të shkuarën¹⁸⁶ (8). Të njëjtin përdorim e hasim edhe te preteritumi (8).

(8)

Njerëzit **dashuroheshin** në heshtje, vjedhurazi.

Die Menschen liebten sich schweigend, verstohlen.¹⁸⁷

4. Për të shprehur një veprim të ndodhur në kohë të shkuar para një veprimi fillestar bazë (9)¹⁸⁸ - këtu gjermanishtja distancohet nga shqipja, duke ngërthyer forma foljore të më se të kryerës.

(9)

Ndenji në krevatin bosh, ku gjer të djeshmen **dergjej** i biri.

Sie blieb an dem leeren Bett stehen, wo bis zum gestrigen Tag ihr Sohn **gelegen hatte**.¹⁸⁹

¹⁸⁵ Për shqipen: Shaban Demiraj, *Morfologji e gjuhës së sotme shqipe, II*, Tiranë, 1970, f. 201; për gjermanishten: Karl-Ernst Sommerfeldt / Günter Starke, *Einführung in die Grammatik der deutschen Gegenwartssprache*, Max Niemeyer Verlag, Tübingen, 1998, f. 69.

¹⁸⁶ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Tiranë, 2002, f. 309.

¹⁸⁷ Shembull i marrë nga libri "Albanische Grammatik" me autorë Buholcin dhe Fidlerin (Buchholz & Fiedler, 1987:125).

¹⁸⁸ Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 125.

¹⁸⁹ Shembull i marrë nga vepra "Albanische Grammatik" me autorë Buholcin dhe Fidlerin (Buchholz-Fiedler, 1987:125).

Në shembullin (9) në shqipe kemi përdorim të binomit: e kryer e thjeshtë dhe e pakryer dëftore *ndenji + dergjej*. Veprimet e shprehura në fjali kanë ndodhur në momente të ndryshme: *dergjej i biri/ihr Sohn gelegen hatte* është veprimi i ndodhur më herët, dhe *Ndenji në krevatin bosh/Sie blieb an dem leeren Bett stehen* është veprimi i mëvonshëm. Në kthimin në gjermanishte kemi kombinim të preteritumit me më se të kryerën *blieb + gelegen hatte*.

5. Ashtu si në kohën e tashme dëftore edhe në të pakryerën dëftore, folja shoqërohet me pjesëzën *po* kur përdoret me kuptimin e saj themelor (10). Përdorimet me pjesëzën *po* në të pakryerën janë më të kufizuara se ato në të tashmen – kjo lidhet drejtpërsëdrejti me faktin gramatikor, që e pakryera si kohë e shkuar është më e qartë në fokusimin kohor se sa e tashmja e dëftores¹⁹⁰. Po me këtë kuptim mund të përdoret edhe forma perifrastike e ndërtuar me anë të së pakryerës së foljes ndihmëse *jam* dhe *përcjellores së foljes*¹⁹¹. Siç e kemi përmendur edhe në trajtime të kohës së tashme dëftore, ky fenomen gjuhësor është tipik për gjuhën shqipe - në gjermanishte kjo strukturë gjuhësore është e panjohur dhe jepet me folje të emëruar. Kthimi në gjermanishte realizohet me anë të preteritumit, duke mos e patur nevojën e elementeve gramatikore mbështetës shtesë ose bazuar në shembuj të tjerë përdorimi me ndihmën e treguesve kohorë *gerade/në atë moment, gleich/tani, sofort/menjëherë*.

(10)

Po atë çast unë vë re Katin tek po rraste kapën në kokë dhe e pyes: ... (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 41)

*Ich sehe jedoch, wie Kat seine Mütze **aufsetzt**, und frage: ... (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 38)*

Në shembullin (10) shkrimtari duke përdorur të pakryerën dëftore në shqipe *rraste* të paraprirë nga pjesëza *po*, na rrëfen për një veprim që po kryhej pikërisht në atë moment të caktuar të së shkuarës - fjalia nis menjëherë me togfjalëshin *Po atë çast* duke e ngrirë vëmendjen e lexuesit në atë moment të caktuar. Shembulli në gjermanishte është me të vërtetë interesant: që në nisje të fjalisë autori përdor *Ich sehe jedoch*, pjesë e cila e orienton lexuesin menjëherë drejt një veprimi i cili po ndodhte në atë moment. Por autori ka përzgjedhur të

¹⁹⁰ Për më shumë shih në disertacion çështjen *Koha e tashme në kapitullin e dëftores.

¹⁹¹ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, citimi 1, Tiranë, 2002, f. 308-309.

përdorë të tashmen për të rrëfyer mbi diçka në të shkuarën¹⁹²: *Ich sehe, aufsetzt*. Këto “akrobacira” të gjuhës janë si në shqipe edhe në gjermanishte tejet tërheqëse dhe funksionojnë mjaft mirë në përfshirjen emocionale të lexuesit/dëgjuesit.

6. E pakryera e dëftores mund të përdoret pa pjesëzën *po* edhe për të treguar veprime të cilat ndodhin në të tashmen (11). Në përdorime të këtilla fjalia në të pakryerën e dëftores mund të shoqërohet me tregues kohorë. Përdorim me të njëjtën vlerë e hasim edhe në preteritumin e gjermanishtes (11).

(11)

*Tani ato **vraponin** tërë gaz e bujë nëpër pllakat e gurta të çatisë dhe, duke dëgjuar zhurmën e tyre, unë u qaja hallin. (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 6)*

*Jetzt **hüpften** sie fröhlich und ausgelassen über die steinernen Platten des Daches, und mir, der ich ihnen lauschte, taten sie sehr leid. (Chronik im Stein, Ismail Kadare, Seite 8)*

7. Më lart përmendëm karakteristikën e së pakryerës në shqipe për të shfaqur tipare me ngjyrimë modale. Para së gjithash në ligjërimin popullor, por shpesh edhe në atë letrar e pakryera dëftore në shqipe shërben për të shprehur nuanca të ngjyimeve modale në struktura hipotetike, në fjali me elemente të kushtores (12). Në përdorime të tilla vërehet një tendencë apo aftësi e së pakryerës dëftore për t’u përdorur në fjali, të cilat fare mirë mund të shprehen me mënyrën lidhore apo fjali lidhore me përdorime të kushtores. E megjithatë shprehemi se struktura të tilla nuk hasen vetëm në të folmet popullore, por ato janë pjesë edhe të ligjëtimeve të përditshme: *Po të kisha kohë, vija edhe unë.*; *Po të më kishe thënë më parë, e gjeja kohën*. Duke qenë se në lëmin e përdorimeve të preteritumit nuk hasim përdorime me ngjyrimë modale, është e logjikshme që përjashtohen kthimet e këtyre përdorimeve nga shqipja në gjermanishte me anë të preteritumit – gjë e cila vërehet fare qartë edhe në shembullin (12).

¹⁹² Për më tepër shih në disertacion çështjen **Koha e tashme* në kapitullin e dëftores.

(12)

*Të mos kisha ata kalamaj, **shkoja** edhe unë atje.**Hätte ich nicht die Kinder, **würde** ich auch dorthin **gehen**.*¹⁹³

Në shembullin (12) shihet qartë që në fillim prania e elementit të kushtit *Të mos kisha ata kalamaj*. Nisur nga fakti që kjo fjali bart elementin joreal – e vërteta është ndryshe: ligjëruesi ka fëmijë, ai thjesht shpreh një mendim hipotetik – shqipja ngërthen forma foljore të së pakryerës *shkoja* për të shprehur një veprim të paretizueshëm, jo më në të shkuarën, por në momentin e ligjërimit të orientuar drejt së ardhmes. Kjo fjali në shqipe ndryshe mund të jepet: *Sikur të mos kisha ata kalamaj, do të shkoja edhe unë atje.* ose *Po të mos kisha ata kalamaj, do të shkoja edhe unë atje.* Format gjegjëse në gjermanishte në të dyja pjesët e fjalisë orientohen drejt Konjunktiv II *Hätte* dhe *würde gehen* - kjo sjellje e gjermanishtes është më se e kuptueshme, duke qenë se ligjërimiti qëlon në situata joreale, hipotetike.

8. Sipas “Gramatikës së gjuhës shqipe I”, Buholcit dhe Fidlerit (Buchholz-Fiedler) në disa raste e pakryera përdoret në vend të së kryerës së thjeshtë – këtu bëhet fjalë për foljet *kam* dhe *jam* (13), format e pakryera të të cilave nga ana funksionale nuk janë të ndara qartazi nga ato të së kryerës së thjeshtë. Shpjegimi kjo dukuri e gjen të mbështetur në faktin që këto dy folje tregojnë një gjendje, e cila e karakterizon kryefjalën për një kohë të gjatë. E meqë e kryera e thjeshtë, si rregull, vë në dukje vetëm përfundimin e një veprimi, por jo zgjatjen e tij, te këto dy folje ajo priret të zëvendësohet nga e pakryera¹⁹⁴.

(13)

*Çuditërisht Jozef Bemi **ishte** nga të parët që ranë në luftë. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 18)**Sonderbarerweise **war** Behm einer der ersten, die fielen. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 16)*

Në shembullin (13) të shqipe folja *ishte* është në të pakryerën dëftore. Në të vërtetë kjo folje është e përdorur në kuptimin e një gjendjeje dhe jo të një veprimi në zhvillim e sipër – tipar ky i foljeve të përdorura në të pakryerën dëftore. Folja *ishte* shpreh një gjendje të përmbyllur

¹⁹³ Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 126.

¹⁹⁴ Po aty, f. 312. & Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 126.

tashmë e cila i referohet kryefjalës jo për një kohë të gjatë, por në mënyrë përfundimtare. Në gjermanishte folja *war* tregon të njëjtin tipar si ajo në shqipe, një gjendje përfundimtare.

9. Demiraj mbron tezën që e pakryera nuk ndërkëmbehet me asnjë nga kohët e tjera të së shkuarës – këtë ai e vështron nga pikëpamja e nuancave aspektore që i karakterizon tri kohët “absolute” – të pakryerën, të kryerën e thjeshtë dhe të kryerën¹⁹⁵. Po në këndvështrimin e aspektit Buholci dhe Fidler (Buchholz-Fiedler) nuk mbajnë të njëjtin qëndrim sikur Demiraj, duke u shprehur, që në shqipe ka raste në të cilat e pakryera përdoret me vlerën e së kryerës së thjeshtë: tipari aspektual i së pakryerës është paraqitja e një momenti orientimi, një prapavije veprimi. Me sa duket e pakryera e përfaqëson të kryerën e thjeshtë si në shembullin (14), ku bëhet fjalë për ligjërim të shkruar, të pregatitur kohë më parë (14)¹⁹⁶.

(14)

Po letra që mori tashti i epte afatin e fundit.

Doch der Brief, den er jetzt erhalten hatte, gab ihm die letzte Frist an.

Në shembullin (14) në shqipe folja *epte* në të pakryerën dëftore mund të zëvendësohet fare mirë me foljen *dha* në të kryerën e thjeshtë dhe kuptimi i fjalisë nuk ndryshon aspak – këtu jemi të mendimit se përzgjedhja e së pakryerës i jep ngjyrimë stilistikore fjalisë duke transmetuar nuanca më të forta emocionale se sa shembulli me folje në të kryerën e thjeshtë. Vështrimi i veprimit është nga një perspektivë e jashtme, edhe pse kemi përdorim të së pakryerës, aspekti është perfektiv. Madje edhe kthimi në gjermanishte e përforcon mendimin tonë përse i përket trajtimit të veprimit si të përmbyllur. Vrojtuar në kuadrin e kontekstit, kjo duket fare qartë: folja *gab ... an* shpreh një qark të mbyllur. Nisur nga fakti teorik që në gjermanishte gjenden forma foljore të vetëm një kohe të thjeshtë të shkuar në dëftore, themi që nuk mund të vijojmë më tej me krahasime në këtë nivel, andaj dhe përqasjen e pamë në nivelin semantik dhe stilistik.

3.1.4. Koha e kryer e thjeshtë e shqipes përballë preteritumit të gjermanishtes

¹⁹⁵ Shaban Demiraj, *Studime filologjike “Rreth kategorive gramatikore të mënyrës dhe të kohës në gjuhën shqipe”*, Tiranë, 1977, f. 129.

¹⁹⁶ Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 126.

Sipas Buholcit dhe Fidlerit (Buchholz-Fiedler) e kryera e thjeshtë ka tiparet e detyrueshme të së shkuarës dhe aspektit. Përdorime të së kryerës të thjeshtë të cilat nuk tregojnë tiparin e së shkuarës, kanë ngjyrosje stilistike (të varura nga konteksti) apo modale¹⁹⁷. Ndërkohë që përfundimi i një veprimi në fjalitë me folje në të kryerën e thjeshtë në shqipe shprehet nga vetë karakteristikat semantike të foljes, nuk mund të themi të njëjtën gjë për preteritumin e gjermanishtes. Kjo për arsye se preteritumi përdoret në të dyja rastet: edhe kur një veprim është në proces, edhe kur ai ka përfunduar - kjo e fundit arrihet të kuptohet apo nxirret më rrallë nga tiparet semantike të foljes e më shpesh nga konteksti. Gjithashtu përmendim faktin gjuhësor, që e kryera e thjeshtë përdoret më shumë se e pakryera në vend të kohëve të tjera të shkuara, të së kryerës apo më se të kryerës. Më poshtë vijojmë me përdorimet e së kryerës së thjeshtë në shqipe dhe kthimet përkatëse në gjermanishte apo shembuj në gjermanishten origjinale.

1. Përdorimi kryesor i së kryerës së thjeshtë është të tregojë një veprim të përfunduar në një çast të caktuar të së shkuarës¹⁹⁸. Përmbajtja aspektuale e kësaj kohe qëndron në shprehjen e një veprimi si ngjarje e mbyllur - ajo nuk shënjon një moment orientimi në veprim, ashtu siç bën e pakryera, por karakterizon vetë veprimin¹⁹⁹ duke e paraqitur si të përfunduar, të përmbyllur – këtu kemi përjasje të kësaj kohe me një nga përdorimet e preteritumit të gjermanishtes (1). Shpeshherë fjalitë me forma foljore në të kryerën e thjeshtë apo në preteritum shoqërohen dhe me tregues kohorë²⁰⁰ të caktuar apo të pacaktuar: *dje (gestern)*, *pardje (vorgestern)*, *vjet (voriges Jahr)*, *atëherë (damals)*, – këtu kemi përjasje midis dy gjuhëve.

(1)

¹⁹⁷ Po aty, f. 129. Krahësuar me të pakryerën e dëftores, shumëllojshmëria e tipologjive të përdorimeve të së kryerës së thjeshtë me tipar kohor dhe aspektual është më e lartë. Ndërsa përse i përket përdorimeve me ngjyrosje stilistike apo modale, themi që te të dyja kohët gjejmë përputhje jo vetëm në shpeshësinë e përdorimeve, madje edhe në karakterin e tyre, gjë e cila vihet re lehtësisht në shembujt argumentues të vjelë nga dy korpuset artistikë të përzgjedhur për këtë punim.

¹⁹⁸ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 310.

¹⁹⁹ Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 127.

²⁰⁰ Për shqipen: po aty & Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 310; për gjermanishten: Gerhardt Helbig & Joachim Buscha, *Deutsche Grammatik, ein Handbuch für Ausländerunterricht*, Langenscheidt, Berlin und München, 2001, f. 133.

*Xhexhua **iku** ashtu siç erdhi me atë frymëmarrjen e saj karakteristike, mbështjellë me shifon të zi, duke lënë prapa si përherë pasiguri dhe alarm. (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 31)*

*Xhexho **ging**, wie sie gekommen war, auf ihre eigentümliche Art atmen, in ihr schwarzes Kopftuch gehüllt, und hinterließ wie immer Unruhe und Bestürzung. (Chronik im Stein, Ismail Kadare, Seite 35)*

(2)

*U **afrova** tek gryka e sterës, **hoqa** kapakun dhe **përkula** kokën. (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 10)*

*Ich **ging** zur Öffnung der Zisterne, **hob** den Deckel und **beugte mich hinein**. (Chronik im Stein, Ismail Kadare, Seite 13)*

Në shembullin (1) veprimi është i përfunduar e shprehet me folje në të kryerën e thjeshtë në shqipe *iku* dhe me preteritum në gjermanishte *ging* – përdorimet janë të njëjta në të dyja gjuhët. Po me të njëjtat karakteristika përdoret e kryera e thjeshtë edhe në shembullin (2), me ndryshimin që këtu foljet shprehin veprime të përfunduara të cilat ndodhin njëra pas tjetrës: në shqipe *U afrova, hoqa, përkula*, e në gjermanishte *ging, hob, beugte mich hinein*. Edhe në këtë përdorim gjejmë përjasje midis shqipes dhe gjermanishtes.

2. E kryera e thjeshtë e dëftores kombinohet me të pakryerën në rastet kur shfaqet një veprim i ri dhe veprimi, që në proces kalon në vëmendje dytësore duke u shprehur me të pakryerën, ndërsa veprimi i ri shprehet me të kryerën e thjeshtë²⁰¹ (3). Këtë përdorim e gjejmë edhe në gjermanishte, porse këtu kemi përdorim të dyfishtë të preteritumit.

(3)

*Për 10 javë rresht na **futën** në stërvitje ushtarake, dhe gjatë kësaj periudhe **pësuam** një transformim shumë më vendimtar sesa në dhjetë vjet shkollë. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 27)*

*Wir **wurden zehn Wochen** militärisch **ausgebildet** und in dieser Zeit entscheidender **umgestaltet** als in zehn Jahren Schulzeit. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 25)*

Në shembullin (3) foljet *na futën, pësuam*, janë në të kryerën e thjeshtë dëftore, dhe *wurden ausgebildet, wurden umgestaltet*, preteritum dëftore në diatezën pësore. Shembulli (3) përmban edhe treguesin kohor *Për 10 javë rresht/Für zehn Wochen*, por foljet këtu nuk

²⁰¹ Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 127.

përshkruajnë ecurinë e ngjarjeve gjatë kësaj periudhe kohore – ato së bashku me kontekstin i paraqesin veprimet si ngjarje të përmbledhura dhe të përfunduara.

Të njëjtat vlera morfologjike, semantike dhe stilistike si në shqipen e kthyer, i gjejmë edhe në gjermanishten origjinale, si në shembullin (2) ashtu edhe në shembullin (3): në përdorime të tilla vërehet një përjasje e shqipes me gjermanishten, me të vetmin ndryshim, që përmbyllja e veprimit në shqipe shpaloset, transmetohet nga karakteristikat semantike të foljeve, ndërsa në gjermanishte nga konteksti.

3. Kur shprehen dy veprime të njëpasnjëshme të varura me njëra-tjetrën (4) apo që kanë lidhje shkakore (5) midis tyre në shqipe kemi përdorim të dy formave gramatikore të së kryerës së thjeshtë²⁰². Edhe në këtë variant përdorimi kemi përjasje midis shqipes dhe gjermanishtes.

(4)

*Edhe nëna **hodhi** një rrobë të tjetër dhe i **shkoi** pas. (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 7)*

*Mutter **zog sish** ein altes Kleid über den Kopf und **folgte** ihm. (Chronik im Stein, Ismail Kadare, Seite 9)*

(5)

*Por më e rëndësishmja ishte se na **lindi** një ndjenjë bashkësie, e fuqishme dhe praktike, e cila **erdh** e u **forcua** pastaj në front si gjëja më fisnike që **nxorri** lufta – dashuria për shoku-shokun. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 31)*

*Das Wichtigste aber war, dass in uns ein festes, praktisches Zusammengehörigkeitsgefühl **erwachte**, dass **sich** im Felde dann zum Besten **steigerte**, was der Krieg **hervorbrachte**: zur Kameradschaft! (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 29)*

Në shembullin (4) fjalia shpreh dy veprime të cilat pasojnë njëra-tjetrën, në shqipe *hodhi* dhe *shkoi*, përkatësisht në gjermanishte *zog sich* dhe *folgte* - foljet në shqipe janë që të dyja në të kryerën e thjeshtë, ndërsa në gjermanishte janë në preteritum. Përfundimin e veprimit në shqipe e kuptojmë nga karakteristikat semantike dhe morfologjike të foljeve, ndërsa në gjermanishte hyn në lojë konteksti, i cili na e mundëson të kuptojmë përmbylljen e dy veprimeve të njëpasnjëshme. Në shembullin (5) e shohim të kryerën e thjeshtë të shpalosë

²⁰² Për shqipen, po aty: f. 127/128 – Buholci dhe Fidler (Bucholz & Fiedler) shprehen vetëm për dy veprime të njëpasnjëshme – jemi të mendimit që kjo nuk është tërësisht e saktë, pasi ky variant mund të përdoret edhe për më shumë veprime të njëpasnjëshme; për gjermanishten: Karl-Ernst Sommerfeldt & Günter Starke, *Einführung in die Grammatik der deutschen Gegenwartssprache*, Max Niemeyer Verlag, Tübingen, ISBN 3-484-73001-3, 1998, f. 69.

veprime apo më saktë ndjenja në një marrëdhënie shkakore midis tyre *lindi, erdh, u forcua, nxori* e njëkohësisht na shpalos një tablo emocionesh të personazheve të cilat finalizohen me dashurinë për shoku-shokun. Shembulli në gjermanishte ngërthen forma foljore të preteritumit *erwachte, sish steigerte, hervorbrachte*.

4. Një tipar i veçantë i së kryerës së thjeshtë në shqipe është pikërisht ai i përdorimit të saj në situata të lidhura me të ardhmen²⁰³. Këtë përdorim e hasim në fjali të cilat shprehin një veprim të sigurt në një të ardhme të afërt në struktura me folje që shprehin lëvizje dhe nuk kanë ngjyrosje modale (6). Edhe preteritumi i gjermanishtes mund të përdoret për të shprehur veprime, të cilat mendohen se do të ndodhin në të ardhmen, por këtu bëhet fjalë për teknikë të rrëfimit letrar, duke zhvendosur momentin e ligjërit të rrëfyesit në një të ardhme të largët (7)²⁰⁴. Këtë përdorim të preteritumit të lidhur me veprime në të ardhmen shkencëtarja dhe filozofja Hamburger²⁰⁵ (8) e sheh me kuptim mbarëkohor dhe e quan preteritumi epik²⁰⁶. Përdorime të këtilla nevojiten të shihen dhe të interpretohen në kuadër të kontekstit dhe jo të shkëputura nga ai. Është e vërtetë që si e kryera e thjeshtë edhe preteritumi mund të përdoren për veprime në të ardhmen, porse këto përdorime janë të ndryshme midis tyre.

(6)

*Nazo, ku je? – thirri gjyshja. **Erdha!** – iu përgjigja unë menjëherë.*

Nazo, wo bist du? – rief Großmutter. Ich komme. - antwortete ich sofort.

(7)

*Es war nicht das erste Mal, dass wir Stoteerer über Beethoven hörten. Bald schon **sprach** er wieder über ihn.*

Nuk ishte hera e parë, që dëgjonim Shtorerenin nga Bethoveni. Së shpejti ai do të fliste përsëri për të.

²⁰³ Këtu përputhet mendimi i shprehur në Gramatikën e gjuhës shqipe I (2002:311) me atë të Demirajt (Demiraj, 1970:203) dhe Buholcit e Fidlerit (Buchholz-Fiedler, 1987:128).

²⁰⁴ Walter Flämig, *Grammatik des Deutschen, Einführung in Struktur- und Wirkungszusammenhänge*, Akademie Verlag, 1991, f. 392.

²⁰⁵ Käte Hamburger (1896–1992) publikoi më 1957 tezën "*Logika e poezisë*" (Logik der Dichtung) duke paraqitur anën tjetër të preteritumit, atë të kuptimit të vlerës mbarëkohore.

²⁰⁶ Përdorime të së kryerës së thjeshtë me kuptim mbarëkohor Demiraj (Demiraj, 1970:202) i sheh në shembuj të tipit: *Kush kërkoi, gjeti./Wer suchte, fand*. Si në shqipe *kërkoi, gjeti* edhe në gjermanishte *suchte, fand* duket fare qartë, që kuptimi i fjalës së urtë popullore nuk është i ngërthyer në kohën e shkuar – foljet dalin jashtë funksionit gramatikor të së kryerës së thjeshtë dhe preteritumit, duke e humbur nuancën kohore përkatëse, e në këtë mënyrë ato kapërcejnë murin si kohë të së shkuarës duke marrë kështu vlera mbarëkohore.

(8)

*Aber am Vormittag hatte sie den Baum zu putzen. Morgen war Weihnachten.*²⁰⁷

Por paradite ajo duhej të pastronte pemën. Nesër ishte Krishtlindje.

Në shembullin (6) në shqipe është përdorur e kryera e thjeshtë *erdha*, ndërsa në gjermanishte është e tashmja *komme*. Ligjëruesi, në rastin tonë, Nazo nuk e ka nisur ende veprimin, pra, nuk është nisur ende të shkojë te gjyshja, por autori e paraqit si fakt, pasi Nazo ka ndërmend të shkojë tek gjyshja dhe menjëherë. Nisur nga siguria e përmbylljes së veprimit në një të ardhme shumë të afërt, autori përdor në shqipe të kryerën e thjeshtë, si koha me funksionin gramatikor të paraqitjes së një veprimi të përmbyllur tashmë. Ndryshe qëndron çështja në gjermanishte: siç e vërejmë në kthimin në gjermanishte (6), përkthyesi përdor kohën e tashme *komme*. Kjo përzgjedhje e formës gramatikore të së tashmes dëftore lidhet me tiparin e saj për t'u përdorur për veprime të cilat do të ndodhin në të ardhmen, duke theksuar se kusht për këtë përdorim është siguria e përmbylljes së veprimit, i cili plotësohet në shembullin tonë. Në shembullin (7) në gjermanishte kemi përdorim të preteritumit për një veprim, i cili mendohet se do të ndodhë në të ardhmen. Fjalja shoqërohet me tregusin kohor *bald*, roli i të cilit është vendimtar për të kuptuar, që i referohemi të ardhmes. Kthimi në shqipe realizohet me të ardhmen e së shkuarës *do të fliste*. Shembulli (8) përmban shprehje deiktike, ndajfoljet kohore *Morgen/Nesër*; nga ana gramatikore nuk është e mundur që në një fjali të bëhet kombinimi *kohë e shkuar (folje) + kohë e ardhme (ndajfolje kohore)*, vetëm nëse koha e shkuar i kapërcen vlerat e saj tradicionale të përdorimit. E pra, në shembullin tonë një gjë e tillë është e mundur jo falë formës gramatikore apo treguesit kohor, por falë kontekstit, i cili e shkrin marrëdhënien midis elementeve duke realizuar zhvendosjen e lexuesit në një botë rrëfimesh.

5. Në shqipe folësi parapëlqen të përzgjedhë herë të pakryerën e herë të kryerën e thjeshtë, kur ka për qëllim të zbusë një kërkesë²⁰⁸ – në kësaj rastesh kohët thjeshta të së shkuarës dëftore përdoren me vlerën e kohës së ardhme të afërt apo të asaj të tashme. Gjithashtu ky përdorim i së pakryerës dëftore gjen terren edhe në rastet e pranisë së disa leksemave foljore si *kam* apo *do*, për të drejtuar një pyetje në mënyrë më të sjellshme. Këto përdorime në shqipe janë të ngjyrosura nga ana modale²⁰⁹. Edhe në gjermanishte e gjejmë këtë përdorim, por jo në të

²⁰⁷ Shembull i marrë nga Käte Hamburger, *Die Logik der Dichtung*. Klett, Stuttgart 1957, f. 4.

²⁰⁸ Këtë aftësi të së pakryerës në shqipe e njohin Demiraj (Demiraj, 1970:201), Buholci dhe Fidleri (Buchholz-Fiedler, 1987:127).

²⁰⁹ Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 127-129.

njëjtën masë si në shqipe – kthimi i fjalive me përdorime të tilla në gjermanishte, por jo vetëm, edhe fjalitë e origjinës, shpesh kërkojnë përdorimin e mënyrës lidhore, pikërisht të Konjunktiv II, si mënyra e përligjur në gramatikën gjermane për të shprehur politesën.

(9)

Kisha një fjalë me ty.

Ich hätte etwas mit dir zu besprechen.

(10)

Doja (desha) të të pyesja, nëse ke kohë e dëshirë të shkojmë nesër në kinema.

Ich wollte dich fragen, ob du morgen Zeit und Lust hast ins Kino zu gehen.

Në shembullin (9) folja në shqipe *kisha* është në kohën e pakryer dëftore - ligjëruesi ngërthen formën foljore të së pakryerës për të shprehur kërkesën e tij në mënyrë të tillë, që kjo e fundit të tingëllojë më e kuruar nga ana gjuhësore. Kthimi në gjermanishte realizohet me anë të formave gramatikore të Konjunktiv II *hätte*, i cili transmeton fare mirë kuptimin e fjalisë në gjuhën origjinale. Në shembullin (10) folja në shqipe *Doja* është në kohën e pakryer, por këtu mund të përdoret e kryera e thjeshtë *desha* dhe folja ka po të njëjtin funksion e përdorim si ajo në shembullin (9). Kthimi në gjermanishte bëhet me preteritumin *wollte* – folja *wollen* (dua) mbart ngjyrosje të politesës, e nisur nga ky fakt stilistik, përdorimi i saj në struktura të tilla gramatikore është më se i përshatshëm. Në shembullin (10) kemi puqje të dy gjuhëve – ligjëruesi përdor kohë të thjeshta të shkuara për të shprehur pyetjen e ligjëruesit. Më tej themi që në të dyja shembujt gjejmë përputhje morfologjike, semantike dhe stilistike.

Përpos shembujve të lartpërmendur (9), (10) mund të sjellim në të dyja gjuhët momente nga situata komunikimi situatash nga jeta profesionale apo mes të huajsh me përmbajtje politese (a), (b) – si shembuj të tjerë që kërkojnë këtë përfaqësim të së tashmes përmes së pakryerës apo preteritumit. Ky përdorim realizohet me anë të disa shprehjeve apo formulave gjuhësore të ngrira, në rastet kur nënkuptohen veprimet që do të vijojnë, por në këtë mënyrë folësi orientohet mbi situatën pasuese²¹⁰.

(a)

Si ishte edhe një herë adresa juaj?

Wie war nochmal Ihre Adresse?

(b)

²¹⁰ Gerhard Helbig & Joachim Buscha, *Deutsche Grammatik, ein Handbuch für Ausländerunterricht*, Berlin und München: Langenscheidt, 2001, f. 133.

Si e donit kafenë?

Wie wollten Sie den Kaffee haben?

6. Një moment tjetër gjuhësor i përbashkët midis dy gjuhëve është ai i përzgjedhjes së preteritumit dhe së kryerës së thjeshtë në struktura gramatikore me foljet ndihmëse *kam* (*haben*), *jam* (*sein*)²¹¹ dhe me foljet modale²¹²(11).

(11)

Ta kam thënë dje. → Ta thashë dje.

Ich habe es dir gestern gesagt. → Ich sagte es dir gestern.

Në shembullin (11) në të dyja gjuhët si rregull duhet të përdoren format gramatikore të së kryerës dëftore *kam thënë/habe gesagt*. Por në të dyja gjuhët ligjëruesi zgjedh të përdorë në jetën e përditshme struktura morfologjike të kohëve të shkuara të thjeshta, konkretisht të së kryerës së thjeshtë në shqipe dhe të preteritumit në gjermanishte.

7. Më tej përmendim në shqipe rastet kur e shkuara lidhet me momentin e ligjërimit – këtu e kryera e thjeshtë paraqitet në një përdorim karakteristik të së kryerës (12)²¹³. Në këtë përdorim gjermanishtja distancohet deri diku nga shqipja duke vendosur më shumë për të kryerën dëftore (12).

(12)

Letra e nënës sime! Çudi! Si erdhi nga Shqipëria?

Der Brief von meiner Mutter! Seltsam! Wie ist er aus Albanien hierher gelangt?

Në shembullin (12) në shqipe kemi përdorim të kohës së kryer të thjeshtë *erdhi*, ndërsa kthimi në gjermanishte kërkon formën gramatikore të së kryerës *ist gelangt*. Kuptimi në të dy shembujt është i njëjtë, ndryshimi qëndron në kohën e përzgjedhur. Por ky është vetëm një variant i kthimit në gjermanishte, pasi nuk përjashtohet edhe mundësia e përdorimit të

²¹¹ Sipas Engelit (Engel), zëvendësime të kohës së kryer me anë të preteritumit gjejmë shpesh në fjalitë veprorë (1a) – ky zëvendësim është përgjithësisht i përzgjedhur në fjalitë me folje joveprorë (1b) (1a) *Ich habe dich gestern mehrmals angerufen. → Ich rief dich gestern mehrmals an.* (folje veprorë) (Unë të kam marrë dje disa herë në telefon. → Unë të telefonova disa herë dje.) (1b) *Ich habe nicht von dem Pudding gegessen. → Ich aß nicht von dem Pudding.* (folje joveprorë) (Unë nuk kam ngrënë nga pudingi. → Unë nuk hëngra nga pudingi.) (Ulrich Engel, 2004:216).

²¹² Ulrich Engel, *Deutsche Grammatik*, IUDICIUM Verlag GmbH München, 2004, f. 216.

²¹³ Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 128.

preteritumit në vend të së kryerës – këtu mund të përmendim edhe faktorin dialekt: ligjëruesi nga Jugu i Gjermanisë preferon të përdorë të kryerën, ndërsa ai nga Veriu i Gjermanisë preteritumin²¹⁴.

8. Një variant tjetër përdorimi është ai i të shprehurit të një veprimi të ndodhur në të shkuarën e hershme me anë të së kryerës së thjeshtë në vend të së kryerës së tejshkuar (13)²¹⁵ apo të më se të kryerës²¹⁶.

(13)

*Merrte gotën, e vështronte ..., sikur në të ishte ajo që e **tradhëtoi**.*

Er nahm (immer wieder) das Glas, blickte hinein, als wäre die darin, die ihn betrogen hatte.

Në shembullin (13) shqipja ngërthen forma foljore të së kryerës së thjeshtë *tradhëtoi* për të shprehur një veprim të ndodhur para një veprimi tjetër në të shkuarën. Ndryshe sillet gjermanishtja: ajo është e vendosur në përdorimin e më se të kryerës *betrogen hatte* për të shprehur veprimin e ndodhur më parë në të shkuarën.

9. Në pikën 7-të të çështjes “Koha e pakryer e shqipes përballë preteritumit të gjermanishtes” kemi trajtuar në mënyrë të detajuar të shprehurit e së pakryerës me ngjyime modale dhe kthimet gjegjëse në gjermanishte. Në përdorimet me nuanca modale të së pakryerës dhe të kryerës së thjeshtë gjejmë pika të përbashkëta, kur foljet shprehin pasojën reale të një mendimi hipotetik (14)²¹⁷. Gjermanishtja këtu distancohet nga shqipja – më lart përmendëm, që preteritumi i gjermanishtes nuk e përmban faktorin modal. Një përdorim i preteritumit në situata të ngjashme si në shembullin (14), do të ishte semantikisht i pamundur dhe gjermanishtja me të drejtë orientohet drejt formave foljore të së kryerës (14) *hast ... gehandelt*.

(14)

*Edhe në e bërë vërtet atë punë, **bëre** shumë ligisht.*

²¹⁴ Gerhard Helbig & Joachim Buscha, *Deutsche Grammatik, ein Handbuch für Ausländerunterricht*, Berlin und München: Langenscheidt, 2001, f. 134.

²¹⁵ Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 128.

²¹⁶ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002, f. 314.

²¹⁷ Po aty, f. 129.

*Und wenn du das wirklich gemacht hast, **hast** du sehr schlecht **gehandelt**.*

Në shembullin (1) fjalja nis me një mendim mbi një veprim hipotetik *Edhe në e bërë vërtet atë punë*. Më tej ligjëruesi vazhdon mendimin e tij duke folur për pasojë reale të veprimit – gjë e cila e mundëson edhe përdorimin e mënyrës dëftore në të dyja gjuhët. Në të vërtetë veprimi nuk ka ndodhur dhe shqipja ngërthen folje në të kryerën e thjeshtë *bërë*. Kthimi në gjermanishte nuk realizohet në të njëjtën mënyrë – këtu gjuha nuk mund të përdorë forma foljore të preteritumit, por në të dyja pjesët e fjalisë ajo ngërthen forma foljore të së kryerës. Fjalja në shqipe mund të shprehet edhe *Po e pate bërë vërtet atë punë, **ke bërë** shumë ligisht*. Pikërisht në këtë variant përdorimi, gjejmë përqasje me gjermanishten, por këtu nuk bëhet më fjalë për të kryerën e thjeshtë, andaj dhe ky krahasim nuk përbën interes të mëtijshëm për çështjen në fjalë.

3.1.5. Kohët e thjeshta të shkuara si kohë drejtuese në rrëfim

Kur flasim për artin e rrëfimit duhet të kemi parasysh degëzimet e tij në dy forma të ndryshme: në rrëfimin e shkruar dhe atë të folur. Përzgjedhja e kohës mbart në vetvete marrje vendimesh të një kompleksi faktorësh: gjuhësorë, historikë, gjeografikë dhe stilistikë. Zakonisht si kohë bazë rrëfimesh në shqipen standarde të shkruar vlen binomi *e pakryer:e kryer e thjeshtë*, duke u ndjekur nga *më se e kryera*. Vajnrh (Weinrich) e cilëson *preteritum* si kohën drejtuese në botën e rrëfimit të shkruar në gjermanishte, duke e nënvizuar këtë si funksionin e saj parësor gramatikor. Shkrimtari i mirënjohur gjerman Tomas Man (Thomas Mann), fitues i çmimit Nobel në literaturë më 1929 shprehet: *Der Erzähler als der raunende Beschwörer des Imperfekts. - Rrëfimtari si përshpëritës i betuar i imperfektit*. Engel (Engel) shkruan se preteritumi përdoret rregullisht në ligjëratën e jetuar, të gjallë, në rastet kur tregohet mbi diçka të kaluar – këtu autori merr përsipër thëniet e ligjërimeve apo të mendimeve të personave të tretë²¹⁸. Duke qenë se me format gramatikore të së pakryerës dhe preteritumit zakonisht shprehet ideja e të zgjaturit dhe e të përsëriturit të veprimit a të gjendjes, këto kohë përdoren shpesh në përshkrime, me të cilat niset e përgatitet tregimi i një ndodhie të vërtetë a të zhvilluar (1), si edhe përshkrime të tjera tregimtare²¹⁹. Koha e pakryer

²¹⁸ Ulrich Engel, *Deutsche Grammatik*, IUDICIUM Verlag GmbH, München, 2004, f. 215.

²¹⁹ Shaban Demiraj, *Morfologji e gjuhës së sotme shqipe, II*, Tiranë, 1970, f. 201.

dhe preteritumi gjejnë përdorim më të gjerë në literaturën artistike – këtë ato ia dedikojnë nuancave të larmishme e sidomos tiparit si kohë e papërcaktuar. Preteritumi në gjermanishte si koha drejtuese në botën e rrëfimit të shkruar (1), (2) qëndron përbri së tashmes së dëftores si koha drejtuese në ligjërimin verbal. Më tutje vlen të përmendim edhe dy formulat e ngurta si në shqipe edhe në gjermanishte me të cilat nisin rëndom përrallat *Na ishte njëherë...*, *Es war einmal...*- funksioni i të cilave, së bashku me struktura foljore në të pakryer apo në preteritum, është sa unik dhe i pazëvendësueshëm. Sapo dëgjojmë këto fraza, fantazia fillon të marrë jetë e krahë duke na zhvendosur në kohë të papërcaktuar, dikur dhe diku. Asnjë kohë tjetër nuk mund të matet me këto dy kohë dhe të zëvendësojë formulat e lartpërmendura. Nëse vijojmë me atë çka shpreh e kryera e thjeshtë e shqipe, themi se ajo përdoret rregullisht në rrëfime ngjarjesh a ndodhish të përfunduara tashmë (18). Por e kryera e thjeshtë haset edhe në fabula, përralla apo tregime historike. Në çështjen mbi kohën më se të kryer dëftore do të mund të shqyrtojmë pasazhe të përkthyer nga J. Rëmi (Röhm) dhe R. Shvarci, ku vihet re lehtësisht kundërvënja *kohë më se e kryer në shqipe: preteritum në gjermanishte*. Këtu vlen të përmendim, që në disa përdorime preteritumi i rri më mirë më se të kryerës, se sa të kryerës së thjeshtë. Është e vërtetë që të tria kohët i cilësuam si kohë bazë të rrëfimit të shkruar, por ato gjejnë përdorim edhe në ligjërimin e folur, secila me kufizimet e veta përkatëse. Kështu në gjermanishte koha e kryer nuk parapëlqehet si kohë rrëfimesh në ligjërimin e shkruar, por zë një vend të konsiderueshëm në atë verbal; p.sh. në gjermanishte, në ligjërimin verbal parapëlqehet të përdoret koha e kryer, ndërsa në shqipe e kryera e thjeshtë – një përzgjedhje e tillë vrojtohet e konstatohet lehtësisht në situata të përditshme. Të krahasohen shembujt: *Nuk e kuptova këtë. Ich habe das nicht verstanden*. Në shembullin e shqipe kemi përdorim të së kryerës së thjeshtë *kuptova*, ndërsa në kthimin në gjermanishte, folje në të kryerën *habe . . . verstanden*. Jo rrallë ndodh që tekste rrëfimtare të nisin dhe të mbyllen me një fjali në kohën më se të kryer. Korniza të tilla të fjalive realizojnë lidhjen me kohën e tashme, ndërkohë që pjesa kryesore e tekstit në preteritum vazhdon e tregon për ngjarjen në kohën e shkuar, ngjarje e cila u prezantua në kohën më se të kryer në fillim të rrëfimit. Kjo përzgjedhje e renditjeve të kohëve është shumë e përhapur (në lajme, në njoftimet e agjencive) dhe pjesërisht e konvencionalizuar.

E megjithatë duhet të themi, që shpeshherë përzgjedhja e kohëve në ligjërimin e shkruar lidhet edhe me stilin personal të shkrimtarit. Gjithashtu në të dyja gjuhët kemi edhe përdorime të kohëve të tjera, si më se të kryerën apo të kryerën, por spektri i përdorimit të kohëve të shkuara të thjeshta është absolutisht më i gjerë, duke konkurruar madje edhe të tashmen

historike. Për ta përmbledhur nga vrojtimet e deritanishme të përdorimeve të këtyre tri kohëve arrijmë në përfundimin, se këto kohë qasen me njëra-tjetrën, duke paraqitur një funksion të njëjtë, atë të përdorimit në rrëfime ngjarjesh apo ndodhish.

(1)

Vështroja pejsazhin e ndryshuar brenda natës dhe mendoja se si lumi e urrente urën, xhadeja urrente me siguri lumin, përrenjtë urrenin muret, era urrente malin që i priste furinë e të gjithë këto bashkë urrenin qytetin, i cili shtrihej i lagur, gri dhe mospërfillës, midis kësaj urrejtjeje shkatërrimtare. Unë e doja atë, sepse në këtë luftë ai ishte i vetëm. (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 10/11)

Ich betrachtete die Landschaft, die sich über Nacht so verändert hatte, und dachte, dass wohl genauso, wie der Fluss die Brücke hasste, die Landstraße den Fluss hassen mochte, die Bäche die Mauern, der Wind die Berge, die ihm seine Wucht raubten, und alle zusammen die Stadt, die nass, grau und voll Verachtung inmitten dieses zerstörerischen Hasses lag. Ich mochte sie, denn in diesem Kampf stand sie allein. (Chronik im Stein, Ismail Kadare, Seite 13)

(2)

Shokët e klasës sonë u shpërndanë nga tre e nga katër nëpër skuadra të ndryshme, bashkë me peshkatarë nga Fritzlandi, me fshatarë, punëtorë e zejtarë, me të cilët u miqësua shumë shpejt. Kropin, Mylerin, kemerihun dhe mua na caktuan në skuadrën e nëntë, komandanti i së cilës ishte kapteri Himelshtos. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 28)

Zu dreien und vieren wurde unsere Klasse bei den Korporalschaften verstreut, zusammen mit friesischen Fischern, Bauern, Arbeitern und Handwerkern, mit denen wir uns schnell anfreundeten. Kropp, Müller, Kemmerich und ich kamen zur neunten Korporalschaft, die der Unteroffizier Himmelstoß führte. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 26)

Në shembullin (1) Kadareja mban veshur petkun e rrëfimitarit e kësaj ai përdor format gramatikore të së pakryerës vështroja, mendoja, urrente, urrenin, doja, ishte për të përshkruar momentin e menduar. Këtu na ndërthuren tre plane: ai i rrëfimit, i këndvështimit të autorit dhe epoka ku jeton autori e respektivisht ku zhvillohet ngjarja. Shkrimtari e vendos veten brenda në ngjarje, në tabllonë e përshkruar duke e vështruar ndodhinë nga përbrenda saj. Ai, në rolin e personazhit kryesor të librit, në këtë shembull ka vendosur një raport midis vetes dhe qytetit të tij të lindjes, e mbi këtë raport realizon edhe përshkrimin e detajuar, duke i dhënë jetë emocioneve e lidhjeve të elementeve të pejsazhit të qytetit, dhe lidhjes së tij me qytetin.

Kthimi në gjermanishte është i arrirë - një rrëfim që të mbërthen në ngjarje me të gjitha ngjyrimet e foljeve dhe forca stilistikore e elementeve të tjera të fjalisë të ngrenë peshë. Këtu dy kohët, e pakryera dhe preteritumi marrin vlerën e përshkrimit brenda botës së rrëfimit. Në shembullin (2) shkrimtari E. M. Remark rrëfen, por në këtë rast ndryshe nga ai në shembullin (17) bëhet fjalë për ngjarje të përfunduara, dhe me të drejtë në shqipe përkthyesi ka përdorur format gramatikore të së kryerës së thjeshtë *u shpërndanë, u miqësuan, na caktuan*. Shkrimtari e shikon ngjarjen nga një perspektivë a vendvendosje e jashtme. Në gjermanishten origjinale është mëse e kuptueshme që Remarku zgjedh të përdorë preteritumin *wurde ... verstreut, uns ... anfreundeten, kamen, führte*, qoftë nga foljet, qoftë nga marrëdhënia e krijuar midis elementeve në fjali. Pra, në kuadrin e kontekstit, kuptohet fare qartë, që bëhet fjalë për ngjarje të cilat kanë ndodhur, janë të përmbyllura tashmë.

3.1.6. Koha e kryer

Sipas “Gramatikës së gjuhës shqipe I”²²⁰ kuptimi themelor i së kryerës dëftore është të tregojë një veprim të përfunduar, që nuk i ka shpëputur lidhjet me çastin e ligjërit. Në fjalinë e kohës së kryer ceken paralelisht edhe pasojat që ka veprimi në momentin e ligjërit. Sipas Duden²²¹ (DUDEN) *das Perfekt* apo e kryera përcakton një veprim të përfunduar në të shkuarën, apo gjendje që do të arrihet, ndonjëherë edhe në të ardhmen. Koha e kryer në gjermanishte ndryshe emërtohet edhe si *e tashme e përfunduar*. Pra, kuptimi i kohës së kryer në të dyja gjuhët është i njëjtë. Radke (Radtke) i atribon së kryerës në gjermanishte shtrirjen në të shkuarën, në të tashmen dhe në të ardhmen. Ajo shprehet se në kontekste të caktuara e kryera dëftore e gjermanishtes nuk shfaqet e qartë, por si kombinim i kohës dhe aspektit – ndryshe e kryera do të kishte të njëjtin kuptim me preteritumin²²². I njëjti qëndrin përse i përket aspektit vlen edhe për shqipen, ku dallimet midis kohës së kryer, së pakryerës dhe të

²²⁰ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 312.

²²¹ DUDEN, *Die Grammatik*, Dudenverlag, Mannheim, Leipzig, Wien, Zürich, 2005, f. 513.

²²² Petra Radtke, *Die Kategorien des deutschen Verbs, zur Semantik grammatischer Kategorien*, Gunter Narr Verlag Tübingen, 1998, f. 136.

kryerës të thjeshtë janë për nga ngjyrimet kohore, pra të karakterit aspektor²²³. E kryera ka spektër të gjerë përdorimi në gjuhën e folur duke përjashtuar përdorimin e saj në literatura teorike apo shkencore. Në funksionin e saj karakteristik e kryera dëftore ka të njëjtin përdorim deiktik sikur e tashmja, pra “folësi-tani” (das Sprecher-Jetzt) shërben si pikë orientimi. Kjo do të thotë, që vetë ngjarja, ashtu si edhe në preteritum, ndodh në të shkuarën e folësit²²⁴. Në të dyja gjuhët e kryera dëftore mund të këmbëhet në disa përdorime të saj me një kohë tjetër të shkuar të dëftores – kjo mundësohet falë karakteristikave kuptimore të njëjta apo të përafërta të strukturave kohore, që ekzistojnë midis këtyre kohëve. Fjala këtu është pikërisht për të kryerën e thjeshtë në shqipe dhe për preteritumin në gjermanishte. Hençel dhe Fogel (Hentschel-Vogel) shprehen se marrëdhëniet semantike midis preteritumit dhe së kryerës janë për disa arsye të vështira për t’u konceptuar, gjë e cila ka çuar edhe në mungesën e një mendimi gjuhësor unik. Më tej ata vazhdojnë duke thënë se këto dy kohë janë të këmbyeshme midis tyre, por kjo nuk është tërësisht e vërtetë: çdo preteritum mund të kthehet në kohë të kryer, por jo cdo kohë e kryer mund të kthehet në preteritum²²⁵. Helbig dhe Buscha (Helbig-Buscha) shohin midis këtyre dy kohëve në gjermanishte ndryshime në përdorim të karaktereve të ndryshme, si p.sh.: të atij fonetik, semantik, morfo-sintaksor, stilistik, socio-linguistik apo edhe dialektor²²⁶. Të njëjtat konsiderata mund të shprehim edhe për të kryerën e thjeshtë dhe të kryerën në shqipe.

1. Sipas “Gramatikës së gjuhës shqipe I”²²⁷, Demirajt²²⁸, Buholcit, Fidlerit²²⁹ (Buchholz-Fiedler), Helbig dhe Bushës²³⁰ folja në të kryerën dëftore në shqipe përdoret kryesisht për të shprehur një veprim ose gjendje, që ka marrë fund, por që lidhet çastin e ligjërimit nëpërmjet

²²³ Për këtë shih: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 274.

²²⁴ DUDEN, *Die Grammatik*, Dudenverlag, Mannheim, Leipzig, Wien, Zürich, 2005, f. 513.

²²⁵ Elke Hentschel & Petra M. Vogel, *Handbuch der deutschen Grammatik: 4., vollständig überarbeitete Auflage*, de Gruyter GmbH, Berlin-Boston, 2013, f. 94.

²²⁶ Gerhardt Helbig & Joachim Buscha, *Deutsche Grammatik, ein Handbuch für Ausländerunterricht*, Berlin und München: Langenscheidt, 2001, f. 134.

²²⁷ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 312.

²²⁸ Shaban Demiraj, *Morfologji e gjuhës së sotme shqipe*, II, Tiranë, 1970, f. 203.

²²⁹ Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 130.

²³⁰ Gerhardt Helbig & Joachim Buscha, *Deutsche Grammatik, ein Handbuch für Ausländerunterricht*, Berlin und München: Langenscheidt, 2001, f. 135.

pasojave të tij. Të njëjtin përdorim e gjejmë edhe për të kryerën dëftore në gjermanishte, variant të cilin gjuhëtarët e cilësojnë si përdorimin kryesor të kësaj kohe²³¹.

(1)

*Për ne të gjitha proceset **kanë rifituar** pafajësinë e tyre, sepse kryhen detyrimisht hapur. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 15)*

*Für uns **haben** diese ganzen Vorgänge den Charakter der Unschuld **wiedererhalten** durch ihre zwangsmäßige Öffentlichkeit. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, S. 13)*

(2)

Këtë verë kemi patur të korra të mira.

*Diesen Sommer haben wir gute Ernte **gehabt**.*

(3)

*Ta **kam thënë** njëqind herë se një orë aq e mirë nuk merret në ushtri! (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 20)*

*Ich **habe** es dir ja immer gesagt, dass man eine so gute Uhr nicht mitnimmt. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 18)*

(4)

Shumë e shumë net jam marrë me to, pothuajse ne të gjithë kemi provuar të shkruajmë diçka; porse tani kjo gjë më duket aq e pavërtetë, saqë s'jam në gjendje ta përfytyroj dot. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 25)

*Manchen Abend habe ich darüber **verbracht**, wir haben ja fast alle so etwas Ähnliches gemacht; aber es ist mir so unwirklich geworden, dass ich es mir nicht mehr richtig vorstellen kann. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 18)*

Siç e vërejmë në shembullin (1), folja në të kryerën në shqipe e shfaq kuptimin e saj pa patur nevojën e mbështetjes së elementeve gramatikorë shtesë, atë të treguesve kohorë të ndryshëm. Kthimi në gjermanishte – por jo vetëm në shembullin (1) por edhe shembuj të origjinës – tregojnë për të njëjtin përdorim. Në shembullin (2) prania e treguesit kohor²³² *këtë verë* në të kryerën deiktike përcakton kohën e orientimit për të shenjuar një moment të caktuar, i cili

²³¹ Karl-Ernst Sommerfeldt & Günter Starke, *Einführung in die Grammatik der deutschen Gegenwartssprache*, Max Niemeyer Verlag, Tübingen 1998, f. 69.

²³² Shembuj të treguesve kohorë në gjuhën shqipe sipas „Gramatikës së gjuhës shqipe I“ mund të jenë: *sot, sivjet, këto ditë, këtë javë, këtë muaj, këtë vit etj; që dje, që atëherë, që atë ditë, që atë javë (e gjer sot)*. Apo *kohët e fundit*, 2015. Këto tregues vlejnë edhe për gjuhën gjermane, përkatësisht: *heute, dieses Jahr, diese Tage, diese Woche, diesen Monat usw.; seit gestern, seit damals, seit jenem Tag, seit jener Woche (bis heute)*. Oder *in den letzten Tagen*, 2015.

përfshin dhe momentin e ligjërimit. Të njëjtin përdorim me të njëjtën vlerë e hasim edhe në gjermanishte *diesen Sommer*. Momenti i vëzhgimit dhe ai i veprimit përputhen me njëri-tjetrin. Helbig dhe Buscha (Helbig-Buscha) e shohin këtë përdorim të së kryerës në gjermanishte si variant i cili nuk e përmban faktorin modal, por mund të përmbajë tregues kohorë fakultativë. Edhe në “Gramatikën e gjuhës shqipe I” shfaqet i njëjti këndvështrim për shqipen përse i përket domosdoshmërisë së përdorimit të treguesve kohorë. Shembulli (3) përmban tregues kohor me kuptim kohor të pacaktuar²³³ *njëqind herë* në shqipe dhe respektivisht në gjermanishte *immer* (gjithmonë) është fjala që përkthyesi ka zgjedhur të përdorë. Këtë vlerë përdorimi e dallojmë shkoqur si në shqipe ashtu edhe në gjermanishte. Edhe shembulli (4) e argumenton qartë këtë përdorim, konkretisht të shoqëruar me tregues kohor me kuptim të pacaktuar: *Shumë e shumë net* në shqipe dhe përkthimi *Manchen Abend* në gjermanishte. Nëse varianti i lartpërmenduar (4) përdoret në kuptimin e kohës së shkuar (me faktor modal), atëherë nevojitet patjetër prania e një elementi leksikor shtesë (në shumicën e rasteve një fjalë modale)²³⁴ (5), (6).

(5)

Gjithkush ka lexuar me siguri ca nga poezitë e Dritëroit.

Jeder hat sicher einige von Driterois Poesien gelesen.

(6)

Gjithkush e ka ndjerë të paktën një herë mallin e atdheut.

Jeder hat wenigstens einmal Heimatweh gehabt.

Megjithatë në thëniet e përgjithshme prania e elementeve leksikore shtesë nuk është e domosdoshme (7):

(7)

Çdo fëmi ka ëndërruar të fluturojë.

Jedes Kind hat vom Fliegen geträumt.

2. Një përdorim tjetër i së kryerës dëftore në të dyja gjuhët krahas atij të lartpërmendur është kur veprimi në të shkuarën vazhdon ende në çastin e ligjërimit (8), (9). Kuptimi i së kryerës

²³³ Shembuj të treguesve kohorë për gjuhën shqipe sipas „Gramatikës së gjuhës shqipe I“ mund të jenë: *gjithnjë, kurdoherë, shpesh, dendur, herë pas here, kurrë*; këto tregues kohorë vlejné edhe për gjuhën gjermane, përkatësisht: *immer, oft, meistens, manchmal, niemals, nie*.

²³⁴ Gerhardt Helbig & Joachim Buscha, *Deutsche Grammatik, ein Handbuch für Ausländerunterricht*, Berlin und München: Langenscheidt, 2001, f. 135.

del nga konteksti, ku mund të ketë edhe tregues kohorë, që tregojnë pikënisjen e veprimit ose gjithë kohën që nga fillimi i veprimit e gjer në çastin e ligjërimit²³⁵. Nëse vërejmë me kujdes fjalinë e mëposhtme në shqipe (8) *Aleks ka ardhur para ca orësh.*, në gjermanishte *Alex ist vor einigen Stunden gekommen.*, themi se, koha e shqyrtimit të veprimit që *Aleks ka ardhur* i paravendoset asaj të ligjërimit, pra fillimisht e shqyrtojmë gjendjen dhe më pas shprehim mendimin tonë – si koha e shqyrtimit edhe ajo e ligjërimit shtrihen pas kohës së veprimit, asaj të ardhjes së Aleksit: veprim-shqyrtim-ligjërimit.

(8)

Aleks ka ardhur para ca orësh. (ai është ende aty)

Alex ist vor einigen Stunden gekommen.

(9)

Ne e kemi humbur sensin e lidhjeve të tjera, sepse janë artificiale. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 26)

Wir haben den Sinn für andere Zusammenhänge verloren, weil sie künstlich sind. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 24)

Kur bëhet fjalë për modalitetin e fjalisë së kryer dëftore, Buhholz dhe Fidler (Buchholz-Fiedler) shprehen se kushtëzimi paraqitet vetëm i shoqëruar me krahasim joreal. Kthimi në gjermanishte mund të realizohet shpeshherë duke përdorur më se të kryerën të mënyrës lidhore (10) apo dhe të tashmen dëftore (11).

(10)

Sapo u japin ndonjë gradë apo shpatë, bëhen njerëz, a thua se kanë ngrënë beton.

(Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 45)

So wie sie Tressen oder Säbel haben, werden sie andere Menschen, als ob sie Beton gefressen hätten. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 43)

(11)

Më bëhet sikur kanë kaluar orë të tëra. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 88)

²³⁵ Për shqipen: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 313; për gjermanishten: po aty.

*Ich habe das Gefühl, dass es Stunden **dauert**. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 86)*

3. Demiraj²³⁶, Buholci, Fidler²³⁷ (Buchholz-Fiedler), Helbig dhe Buscha²³⁸ (Helbig-Buscha) i njohin së kryerës dëftore në të dyja gjuhët edhe një variant tjetër përdorimi, pikërisht atë të shprehjes së një veprimi i cili nuk ka nisur ende, por konsiderohet si i realizueshëm në të ardhmen, pra nuk shfaqen apo mendohet se do të paraqiten pengesa të cilat do të çojnë në mosrealizimin e tij (12), (13).

(12)

*Pas disa orësh **kemi mbaruar** punë. – Pas disa orësh **do të kemi mbaruar** punë. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 58)*

*Nach einigen Stunden **sind wir fertig**. – Nach einigen Stunden **werden wir fertig sein**. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 56)*

(13)

*Ndoshta e **ka shkruar** artikullin deri të hënën. - Ndoshta **do ta ketë shkruar** artikullin deri të hënën.*

*Bis Montag **hat** er den Artikel wahrscheinlich geschrieben. – Bis Montag **wird** er den Artikel wahrscheinlich geschrieben haben.*

Në shembullin (12) kohës së veprimit *kemi mbaruar punë* dhe asaj të shqyrtimit, kur shihet se *puna ka mbaruar*, i paravendoset koha e ligjërimit, momenti kur *puna ka mbaruar*; por koha e veprimit i paravendoset asaj të shqyrtimit; kështu kemi: ligjërim-veprim-shqyrtim. Ky variant kuptimor në vetvete nuk përmban faktor modal të supozimit, por mund të shprehë një supozim përmes elementeve leksikore shtesë²³⁹ (13). Në këtë përdorim e kryera zëvendëson Futur II në gjermanishte²⁴⁰ apo të ardhmen e shkuar në shqipe, përdorim të cilin e hasim si në shqipe ashtu edhe në gjermanishte. Shembujt (12), (13) e argumentojnë përdorimin e së

²³⁶ Shaban Demiraj, *Morfologji e gjuhës së sotme shqipe*, II, Tiranë, 1970, f. 204.

²³⁷ Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 130.

²³⁸ Gerhardt Helbig & Joachim Buscha, *Deutsche Grammatik, ein Handbuch für den Ausländerunterricht*, Langenscheidt, Berlin und München, 2001, f. 136.

²³⁹Po aty.

²⁴⁰ Karl-Ernst Sommerfeldt & Günter Starke, *Einführung in die Grammatik der deutschen Gegenwartssprache*, Max Niemeyer Verlag, Tübingen 1998, f. 69.

kryerës dëftore me vlerën e së ardhmes dëftore *sind fertig* dhe *hat geschrieben* në gjermanishte, *kemi mbaruar* dhe *ka shkruar* në shqipe.

3.1.7. Koha më se e kryer, e kryer e tejshkuar në shqipe dhe ajo më se e kryer në gjermanishte

Sipas “Gramatikës së gjuhës shqipe I”²⁴¹ dhe Duden²⁴² (DUDEN) kuptimi themelor i më se të kryerës²⁴³ është të tregojë një veprim të përfunduar para një çasti të caktuar të së shkuarës. Më se e kryera ka dy tipare të detyrueshme: dykohshmërinë dhe kohshmërinë e shkuar. Ajo në shqipe quhet ndryshe edhe e kryera e së shkuarës²⁴⁴. Po sipas “Gramatikës së gjuhës shqipe I” kuptimi themelor i së kryerës së tejshkuar – kohë të cilën e gjejmë në shqipe dhe jo në gjermanishte - është i njëjtë me atë të më se të kryerës, pra këto të dyja janë kohë sinonime. Nga këto dy forma gramatikore sinonime në gjuhën e sotme letrare përdoret më dendur më se e kryera, më fort nëpër të folmet e Shqipërisë Veriore e më rrallë në shqipen letrare²⁴⁵.

Më lart përmendëm që më se e kryera në të dyja gjuhët ka të njëjtin kuptim themelor. Le të trajtojmë përdorimet e kësaj kohe, ku sipas “Gramatikës së gjuhës shqipe I”²⁴⁶, Helbigut dhe Bushës²⁴⁷ (Helbig-Buscha) dallohen në dy variante kryesore:

1. Variant, ku veprimi i përfunduar lidhet me çastin e caktuar të së shkuarës nëpërmjet pasojave ose vijimit gjer në atë çast (1), (2). Ky variant nuk përmban faktor modal, por mund të ketë tregues kohor fakultativ ose të shoqërohet me fjali të varur kohore.

²⁴¹ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Tiranë, 2002, f. 314.

²⁴² DUDEN - *Die Grammatik, Unentbehrlich für richtiges Deutsch 7., völlig neu erarbeitete und erweiterte Auflage*, Duden Band 4, Dudenverlag, Mannheim, 2005, f. 518.

²⁴³ Në gjermanishte e njohur si Plusquamperfekt, por edhe si Präteritumperfekt (Duden, 2005:518), ndërsa në shqipe njihet edhe si plus-kuam-perfekti (Demiraj, 1970:192).

²⁴⁴ Për këtë shih: Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 131.

²⁴⁵ Për këtë shih: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002, f. 315.

²⁴⁶ Po aty, f. 314.

²⁴⁷ Gerhard Helbig & Joachim Buscha, *Deutsche Grammatik, ein Handbuch für Ausländerunterricht*, Berlin und München: Langenscheidt, 2001, f. 136-137.

(1)

*Plaka Haxhe kishte njëzetedy vjet që nuk **kish dalë** nga shtëpia. Plaka Neslihan s'kishte dalë qysh prej tetëmbëdhjetë vjetësh, kur varrosi nipin e fundit. (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 31)*

*Die alte Haxhe hatte seit zweiundzwanzig Jahren das Haus nicht **verlassen**. Die greise Neslihan **war** vor achtzehn Jahren zum letzten Mal **ausgegangen**, als sie den letzten Enkel begrub. (Chronik im Stein, Ismail Kadare, Seite 38)*

(2)

*Kapaku i librit **ishte mykur** dhe fletët qenë ngjitur me njëra-tjetrën, ngaqë ishin lagur. (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 59)*

*Das Buchdeckel **war angeschimmelt**, und die Seiten waren durch die Feuchtigkeit zusammengeklebt. (Chronik im Stein, Ismail Kadare, Seite 70)*

Në shembujt e mësipërm (1), (2) përputhet momenti i ligjërimit me atë të vëzhgimit, të cilët paraprihen nga momenti/koha e veprimit. Kuptimi i më se të kryerës përcaktohet nga konteksti dhe kjo kohë përdoret si një e kryer e së shkuarës. Treguesit kohorë *njëzetedy vjet* dhe *prej tetëmbëdhjetë vjetësh* shërbejnë për të shprehur qartë karakterin përmbledhës të kohës më se të kryer, duke qenë se kemi periudha kohore prej *njëzetedy* dhe *tetëmbëdhjetë vjetësh* në një fjali. Veprimi vijon edhe në çastin e ligjërimit – plaka Hatixhe dhe ajo Nerixhan vazhdojnë të jenë ende të mbyllura në shtëpi. Edhe në shembullin (2) përmes kontekstit arrihet të kuptohet që kapaku i librit ishte mykur, pasi libri kishte kohë që rrinte në lagështirë. Në këtë shembull ndihen pasojat e veprimit në momentin e ligjërimit – nga lagështira fletët janë ngjitur me njëra-tjetrën dhe janë ende të ngjitura.

(3)

*Das Gerücht ist Wahrheit geworden. Himmelstoß ist da. Gestern **ist er erschienen**, wir **haben** seine wohlbekannte Stimme schon **gehört**. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 70)*

*Thashethemet kishin dalë të vërteta: Himelshtosin e kemi këtu. Ai **kishte mbërritur** dje, bile ne ia **kishim dëgjuar** edhe zërin aq të mirënjohur. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 72)*

(4)

*Kropp war sogar so weit **gegangen**, dass er sich vorgenommen hatte, im Frieden das Postfach einzuschlagen, um später, wenn Himmelstoß wieder Briefträger war, sein Vorgesetzter zu werden. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 46)*

*Kropi bile **kishte shkuar** aq larg, sa vendosi t'i futej degës së PTT-së kur të mbaronet lufta dhe të bëhej eprori i Himelshtosit, kur ky të ishte përsëri postier. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 48)*

Në të dy shembujt e mësipërm (3), (4) veprimi, i cili ka nisur dhe ka përfunduar në të kaluarën - si në gjermanishten origjinale, edhe në shqipen e përkthyer - i shprehur në kohën më se të kryer dëftore: *war gegangen/kishte shkuar* - ka ende ndikim në të tashmen, madje ky ndikim shtrihet edhe në të ardhmen.

2. Variant, ku veprimi i përfunduar mund të mos ketë lidhje me çastin e caktuar të së shkuarës (5). Edhe ky variant nuk përmban faktor modal, por mund të përmbajë tregues kohorë ose të shoqërohet me fjali të varur kohore.

(5)

*Kur dolëm nga shtëpia e Dino Çiços, shiu **kishte pushuar**. (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 97)*

*Als wir Dino Çiços Haus verließen, **hatte der Regen aufgehört**. (Chronik im Stein, Ismail Kadare, Seite 112)*

Momenti i veprimit (5) *rënia e shiut* ka ndodhur para atij të vëzhgimit *Kur dolëm nga shtëpia e Dino Çiços* dhe që të dy këto momente i paravendosen atij të ligjërimin – ligjëruesi tregon më vonë mbi ndodhinë. Kuptimi i më se të kryerës përcaktohet nga konteksti dhe kjo kohë ka vlerën e një të kryere të thjeshtë të së shkuarës: veprimi tashmë ka përfunduar në një parakohë. Si në shqipe edhe në gjermanishte më se e kryera shoqërohet me një fjali të varur kohore *Kur dolëm nga shtëpia e Dino Çiços/Als wir Dino Çiços Haus verließen*.

Kur paraqitëm dy variantet kryesore të përdorimeve të më se të kryerës dëftore në të dyja gjuhët, thamë që, përdorimet nuk e përmbanin faktorin modal. Dhe me të drejtë, pasi kjo kohë nuk priret të ketë ngjyrosje modale. Por Buholc dhe Fidler (Buchholz-Fiedler) e shohin një dritare të ngushtë të pranisë të faktorit modal: në një fjali kryesore të një periudhe hipotetike më se e kryera dëftore sinjalizon një kusht joreal në të shkuarën: *Ishte yt atë atje, pa ia **kisha treguar** qejfin!/Es war dein Vater dort, sonst **hätte** er etwas **erlebt***. Më shpesh këto përdorime

hasen në krahasime preteritale joreale: *Dukej pak i emocionuar, sikur i **kish ngjarë** diçka./Er schien etwas bewegt, als ob ihm etwas **zugestoßen wäre***. Duke qenë se që të dyja përdorimet janë në fjali joreale, kthimi në gjermanishte realizohet përmes mënyrës lidhore, Konjunktiv II: *kisha treguar: hätte erlebt, kish ngjarë: zugestoßen wäre*.

Në të dyja gjuhët kemi përdorim të më se të kryerës dëftore kur kthejmë preteritumin apo të kryerën e thjeshtë (aoristin) apo të kryerën nga ligjërata e drejtë në atë të zhdrejtë (6):

(6)

*Xhexhua duke folur për aeroportin **kishte thënë** një ditë se fushat dhe bari do të mbuloheshin me çimento. (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 78)*

*Xhexho **hatte** im Gespräch über den Flugplatz **erwähnt**, man übergieße dort die Felder und das Gras mit Beton. (Chronik im Stein, Ismail Kadare, Seite 90)*

Te të dy romanet e përzgjedhura si korpus letrar, mbizotëron rrëfimi në preteritum (imperfekt) për gjermanishten dhe të pakryerën për shqipen, e kur shkrimtarët dëshirojnë të tregojnë për ngjarje të ndodhura para një momenti të caktuar në të shkuarën, përdorin më se të kryerën. Në disa raste vërejmë që në gjermanishte përdoret preteritumi, ndërsa në kthimin në shqipe apo edhe në tekstin origjinal në shqipe, shkrimtari përdor kohën më se të kryer – kjo lidhet, siç e kemi përmendur edhe më lart, me prirjen e shqipes për ta përdorur këtë kohë për të rrëfyer apo përshkruar personazhe, sjellje apo ngjarje në të shkuarën. Ndërsa në gjermanishte koha e parapëlqyer e rrëfimit është preteritumi (imperfekti) dhe krahasuar me vendin që zë përdorimi i kësaj kohe në gjermanishte me vendin në shqipe, themi që, spektri i përdorimit është dukshëm më i gjerë se ai i kohës më se të kryer dëftore. Më poshtë shqyrtojmë pasazhe të përkthyer nga J. Rëm (Röhm) dhe R. Shvarc, ku vihet re lehtësisht kundërvënja *kohë më se e kryer e shqipe: preteritum i gjermanishtes* (7), (8).

(7)

*Në mesditë, në shtëpinë e Mane Vocos **kish trokitur** një grua e zeshkët. Ajo **kish kërkuar** një gotë ujë. E zonja e shtëpisë i **kish nxjerrë** një gotë ujë dhe e panjohura e **kish pirë** atë përgjysmë. (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 27)*

*Eines Mittags **klopfte** eine dunkelhäutige Frau an Mane Vocos Tür und **bat** um ein Glas Wasser. Die Hausfrau **brachte** ihr eines, und die Fremde **trank** es zur Hälfte aus. (Chronik im Stein, Ismail Kadare, Seite 33)*

(8)

*Aber fast alle Russen haben längst die Sachen abgegeben, die sie **hatten**. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 170)*

*Mirëpo pothuajse të gjithë rusët i kanë këmbyer me kohë gjërat që **kishin patur** me vete. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 169)*

Më lart thamë që në gjermanishte nuk gjendet koha e kryer e tejshkuar dëftore dhe se kjo kohë mbulohet lehtësisht përmes asaj më se të kryer (9), (10).

(9)

*Er **war** nur bewusstlos **gewesen**. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 16)*

***Pati qenë** pa ndjenja për një kohë të gjatë. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 18)*

Në shembullin (9) në gjermanishte foljet *war gewesen* janë në kohën më se të kryer dëftore, ndërsa kthimi në shqipe bëhet me të kryerën e tejshkuar dëftore *pati qenë*. Edhe në shembujt e mëposhtëm (10), (11) të shkëputur nga korpusi letrar "*Kronikë në gur*" të Kadaresë, gjatë kthimit në gjermanishte, foljet në të kryerën e tejshkuar në shqipe *që ngritur, qenë ngjitur* jepen me më se të kryerën në gjermanishte *war aufgestanden, waren zusammengeklebt*. Ky kthim bëhet natyrshëm duke patur parasysh që këto dy kohë rrinë pranë njëra-tjetrës në kuptim dhe përdorim.

(10)

*Bido Sherifi **që ngritur** papritur natën, kish thirrur dy-tri herë si këndes dhe kish fjetur përsëri dhe në mëngjez nuk mbante mend asgjë. (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 27)*

*Bido Sherifi **war** des Nachts plötzlich **aufgestanden**, hatte ein paar Mal gekräht wie ein Hahn, war dann wieder eingeschlafen und hatte am nächsten Morgen an nichts mehr erinnern können. (Chronik im Stein, Ismail Kadare, Seite 33)*

(11)

*Kapaku i librit ishte mykur dhe fletët **qenë ngjitur** me njëra-tjetrën, ngaqë ishin lagur. (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 59)*

*Das Buchdeckel war angeschimmelt, und die Seiten **waren** durch die Feuchtigkeit **zusammengeklebt**. (Chronik im Stein, Ismail Kadare, Seite 70)*

Më poshtë vërejmë të paraqitur në tabelën nr. 4 foljet e vjela nga shembujt 9-11; foljet në shqipe janë në të kryerën e tejshkuar, ndërsa ato në gjermanishte në më se të kryerën.

<i>Shqipe</i>	<i>Gjermanishte</i>
pati qenë	war gewesen
qe ngritur	war aufgestanden
qenë ngjitur	waren zusammengeklebt

Tabela 4

3.1.8. Koha e ardhme

(1)

Ditët, javët, vitet e jetuara këtu, në vijën e parë, do të kthehen sërishmi edhe njëherë tjetër, edhe atëherë shokët tanë të vdekur do të ngrihen e do të marshojnë bashkë me ne; mendjen do ta kemi të kthjellët dhe do të kemi një qëllim – dhe ashtu do të marshojmë, me shokët e vdekur në krah dhe me vitet e frontit prapa . . . Por kundër kujt, kundër kujt? (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 127)

Die Tagen, die Wochen, die Jahre hier vorn werden noch einmal zurückkommen, und unsere toten Kameraden werden dann aufstehen und mit uns marschieren, unsere Köpfe werden klar sein, wir werden ein Ziel haben, und so werden wir marschieren, unsere toten Kameraden neben uns, die Jahre der Front hinter uns:-gegen wen, gegen wen? (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 127)

Në të dyja gjuhët kuptimi themelor kohor i së ardhmes dëftore është i njëjtë: të tregojë një veprim, që pritët të kryhet pas çastit të ligjërimit²⁴⁸. Si në shqipe edhe në gjermanishte kjo kohë është e shenjëzuar minimalisht. Spektri i përdorimit të këtyre dy kohëve shtrihet në ligjërimin verbal dhe të shkruar, kryesisht në tekste letraro-artistike apo gazetareske, si edhe në situata ligjërimore të jetës së përditshme; hasen fare pak në tekste me karakter shkencor apo teorik. Në shqipe kemi dy tipa të së ardhmes: *do të mësoj* dhe *kam për të mësuar*. Në

²⁴⁸ Për shqipen: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 316; për gjermanishten: Karl-Ernst Sommerfeldt & Günter Starke, *Einführung in die Grammatik der deutschen Gegenwartssprache*, Max Niemeyer Verlag, Tübingen 1998, f. 70.

shumicën e përdorimeve në gjermanishte Futur I ose e quajtur edhe Futur Präsens (e ardhmja e tashme) është i lidhur deiktikisht dhe i referohet veprimeve në të ardhmen - koha e ngjarjes përcaktohet më qartë me anë të ndajfoljeve kohore. Gjithashtu këtë përdorim e gjejmë edhe në rastet, kur folësi i referohet një veprimi në të tashmen. Kjo drejtohet nga pritshmëria, që thënia e tij do të të vërtetohet²⁴⁹. Të njëjtat konsiderata mund të shprehim edhe për shqipen.

1. E ardhmja e tipit *do të mësoj* në shqipe përdoret kryesisht për të treguar një veprim që pritet të kryhet pas çastit të ligjërimit²⁵⁰. Kohëzgjatja deri në realizimin e veprimit bën të dallohen këtu dy variante përdorimi:

a) variant, ku veprimi supozohet që do të ndodhë në të tashmen ose në një të ardhme shumë të afërt pas ligjërimit (5), përdorim të cilin e hasim edhe në gjermanishte²⁵¹.

(5)

Me siguri ai do të jetë në zyrë (tani). – Unë mendoj (supozoj), që ai tani është në zyrë, por nuk jam e sigurt.

Er wird wohl (jetzt) im Büro sein. – Ich nehme an, er ist jetzt im Büro.

Duke qenë se veprimi mendohet si i realizueshëm në të tashmen, por nuk shfaqet siguri e plotë, fjalia (5) është domosdoshmërisht e lidhur me faktorin modal të supozimit. Prania e ndajfoljeve *wohl, vermutlich (me siguri, ndoshta)* (5) mbështet të shprehurin e supozimit. Gjithashtu fjalia mund të shoqërohet me tregues kohorë, si p.sh.: *jetzt, gerade, in diesem Moment* (6) (tani, në këtë moment), por jo domosdoshmërisht.

(6)

Ai do të jetë në zyrë (tani).

Er wird (jetzt) im Büro sein.

Format gramatikore në fjalitë e mësipërme janë të së ardhmes dëftore. Në këtë variant përdorimi kemi përputhje të kohës së veprimit, së vëzhgimit dhe asaj të ligjërimit²⁵².

²⁴⁹ DUDEN, *Die Grammatik*, Dudenverlag, Mannheim, Leipzig, Wien, Zürich, 2005, f. 514-515.; Të njëjtin mendim ndajnë edhe Zomerfeld dhe Shtarke (Sommerfeldt- Starke): Karl-Ernst Sommerfeldt & Günter Starke, *Einführung in die Grammatik der deutschen Gegenwartssprache*, Max Niemeyer Verlag, Tübingen 1998, f. 67.

²⁵⁰ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Tiranë, 2002, f. 317.

²⁵¹ Hentschel, Elke & Vogel, Petra M. – *Deutsche Grammatik*, De Gruyter Lexikon, Berlin, New York, ISBN-10:3110185601, 2010, f. 92.

²⁵² Gerhard Helbig & Joachim Buscha, *Deutsche Grammatik, ein Handbuch für Ausländerunterricht*, Berlin und München: Langenscheidt, 2001, f. 137.

Përqindja e sigurisë së vërtetimit të thënies së folësit rritet, nëse nga fjalia e mësipërme largojmë ndajfoljen e supozimit *ndoshta* (*wohl, vielleicht*) (7).

(7)

Ai mund të jetë në zyrë.

Er könnte im Büro sein.

(8)

Vielleicht erfolgt der Angriff vormittags. (*Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 96*)

Ndoshta sulmi **do të fillojë** pasdreke. (*Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 99*)

Më lart kemi përmendur²⁵³, që mënyra dëftore shpreh modalitetin e vërtetësisë: për të ardhmen, si diçka që pritët të vërtetohet. Këto dy fjali (8), si në shqipe edhe në gjermanishte – edhe pse me përdorim të së ardhmes dëftore apo të së tashmes me kuptim për një veprim që do të ndodhë në të ardhmen – karakterizohen nga modaliteti i mundësisë, duke gjetur përputhje me të tashmën e lidhore në shqipe²⁵⁴. Fjalitë mund të jepen edhe me folje që shprehin mundësi në të dyja gjuhët.

b) Variant në të cilin mendohet se veprimi do të ndodhë në të ardhmen; këtu folësi shpreh një parashikim, shpallje apo plan - veprimi nuk paraqet si i realizueshëm, por si i mundshëm. Koha e vëzhgimit përputhet me atë të veprimit dhe të dyja këto shtrihen pas kohës së ligjërit²⁵⁵ (9), (10), (11), (12). Faktori modal i supozimit mund të jetë i pranishëm edhe në këtë variant përdorimi, por jo domosdoshmërisht (9), (10), (12). Prania e treguesve kohorë, si p.sh.: *nesër, së shpejti, vitin tjetër*, respektivisht në gjermanishte: *morgen, bald, nächstes Jahr* është fakultative²⁵⁶.

(9)

²⁵³ Për shtjellime më të detajuara shih nënkapitullin mbi kohën e tashme dëftore.

²⁵⁴ Këtë përdorim e hasim kryesisht tek foljet *kam* dhe *jam*, më fort në vetën e tretë e aty-këtu edhe në vetën e dytë (për këtë shih: Sh. Demiraj, SF 3, 1977, 110-111).

²⁵⁵ Për gjermanishten: Gerhardt Helbig & Joachim Buscha, Deutsche Grammatik, *ein Handbuch für Ausländerunterricht*, Berlin und München: Langescheidt, 2001, f. 138.

²⁵⁶ Po aty.

Ne të gjithë **do ta kemi** të vështirë. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 83)

Es **wird** überhaupt schwer **werden** mit uns allen. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 80)

(10)

Mos u mërzitni, **do të bëjmë** qyfyre me të, - qesh Myleri. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 84)

Wir **werden** an ihm noch viel Spaß **haben**. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 81)

(11)

Pëshpëritet, që **do të ketë** ofensivë. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 90)

Es **wird** von einer Offensive **gemunkelt**. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 90)

(12)

E di: ai **do të rrijë** përpara tryezës së vet gjer më dymbëdhjetë të natës e **do të lidhë** libra e **do të ngjisë** e **do të presë**. Në orën tetë do të hajë një çikëz darkë, ndonjë lëtyrë të katranosur nga ushqimet që u japin me triskë; pastaj do të marrë ndonjë pluhur kundër dhimbjes së kokës dhe **do të vazhdojë punën**. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 173)

Ich weiß: Er **wird** bis zwölf Uhr nachts an seinem Tisch **stehen** und **falzen** und **kleben** und **schneiden**. Um acht Uhr abends wird er etwas **essen** von diesem kraftlosen Zeug, das sie auf Karten beziehen. Hinterher wird er ein Pulver gegen seine Kopfschmerzen **einnehmen** und **weiterarbeiten**. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 175-176)

2. E ardhmja e tipit “kam për të mësuar” (folja kam + forma e pashtjelluar të foljes kryesore) në shqipe (13):

(13)

Këtë s’**kam për t’jua harruar** sa të jem gjallë! (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 91)

Das vergesse ich euch nie. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 89)

Ky tip i së ardhmes përdoret në rastet, kur flasim për një veprim i cili është i sigurt që do të ndodhë në të ardhmen – kjo siguri lidhet me ruajtjen e ngjyrimin të fortë të detyrimit që bart togfjalëshi *kam për të bërë*²⁵⁷, si diçka që duhet të realizohet domosdoshmërisht. Spektri i këtij tipi përdorimi në shqipe është më i ngushtë se ai i tipit *do të mësoj*. Më lart kemi përmenduar, që ndryshimi i së ardhmes dëftore në shqipe me atë në gjermanishte konsiston pikërisht në formimin morfologjik të kësaj kohe. E nisur nga kjo, themi që tipi i së ardhmes *kam për të bërë* nuk njihet në gjermanishte si përdorim për kohën e ardhme. Në gjermanishte hasim strukturën “*folja kam + formë e pashtjelluar të foljes kryesore*”, por ky përdorim lidhet me situata të tilla, si: *Ich habe jetzt keine Zeit für Sie. Ich habe zu tun. (Tani nuk kam kohë për ju. Kam punë për të bërë.)* ose *Ich habe morgen/nächste Woche keine Zeit. Ich habe zu tun. (Nesër/Javës tjetër nuk kam kohë. Kam punë për të bërë)*. Përdorime të kësaj lidhen ngushtë me situatën dhe kontekstin. Në këtë rast përdorimi haset në situatë në të tashmen. Në kthimin e fjalive të tipit *kam për të mësuar* në gjermanishte, nevojitet mbështetja e foljes modale *müssen* (duhet). Për të shprehur sigurinë e domosdoshmërinë e realizimit të veprimit, folësi përdor fjalë mbështetëse, si: *unbedingt, sicher* (patjetër, me siguri) etj. Ky përdorim në gjermanishte e ka burimin në domosdoshmërinë e kryerjes së veprimit në të ardhmen. Nëse shqyrtojmë shembullin e mëposhtëm, pikërisht kthimin në gjermanishte, në gjuhën e folur është e saktë të shprehem: *Ich muss morgen unbedingt für die Prüfung lernen*. Parë nga këndvështrimi gramatikor është korrekte të themi: *Ich werde morgen unbedingt für die Prüfung lernen müssen*. – por një përdorim i tillë i së ardhmes dëftore nuk haset shpesh⁽¹⁴⁾. Ndërtimet me foljen *müssen* (duhet) në gjermanishte janë të domosdoshme - kjo e bën dallimin midis tipit të së ardhmes *kam për të bërë* dhe *do të bëj*.

(14)

Nesër kam për të mësuar për provimin.

Ich muss morgen für die Prüfung lernen. ose Ich werde morgen unbedingt für die Prüfung lernen müssen.

Gjithashtu me anë të së ardhmes dëftore mund të shprehet edhe një premtim (15) apo një qëllim (16), përdorime të cilat i hasim në të dyja gjuhët. Me qëllim përforcimin e asaj që kërkon të shprehë folësi, fjalitë plotësohen me tregues kohorë, me ndajfolje apo togfjalësja të ndryshëm, si p.sh.: *përsëri, patjetër, në orar* (në gjermanishte: *wieder, unbedingt, pünktlich*) etj. (15), (16).

²⁵⁷ Ky tip i së ardhmes është quajtur ndryshe edhe *futurum necessitas* – emërtim nga latinishtja.

(15)

Ich werde wieder kommen. - Ich verspreche es dir.*Do të vij përsëri.* – Ta premtoj.

(16)

*Ich werde die Prüfung unbedingt mit eins **bestehen**.* - Das ist mein Ziel.*Unë do të marr patjetër 10 në provim.* - Ky është qëllimi im.

Në disa raste kthimi në gjermanishte apo edhe anasjelltas realizohet me strukturën gramatikore “*folja modale wollen (dua) + infinitivin e foljes kryesore*” (17), (18). Këtë përdorim e gjejmë shpesh kur folësi do të shprehë një dëshirë (17), qëllim (18) apo plan (19), i cili/e cila mendohet ose pritët të realizohet në të ardhmen.

(17)

Willst du denn die Stiefel mitnehmen, Franz? (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 20)

A do t'i marrësh me vete këto çizme, Franc? (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 22)

(18)

Wollen Sie meinem Befehl Folge leisten oder nicht? (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 76)

Do t'i bindesh urdhrit tim, apo jo? (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 78)

(19)

*Ich will morgen in die Bibliothek (gehen).**Nesër do të shkoj në bibliotekë.*

Hera-herës hasim në shqipe edhe një prirje të së ardhmes për të devijuar nga forma e saj klasike e formimit, për t'u rrudhur duke mos e përdorur pjesëzën formuese të të lidhore²⁵⁸ (20). Megjithatë kuptimi i kësaj kohe ruhet plotësisht në shqipe e për rrjedhojë dhe kthimi në gjermanishte realizohet me sukses.

²⁵⁸ Nëpër të folme popullore, sidomos të Shqipërisë Jugore, ndeshet edhe forma e tipit *do punoj* (pa pjesëzën të të lidhore) (Demiraj, 1976:103).

(20)

*Do gjejmë një vend. (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 144)**Wir werden einen Platz finden, an dem wir sicher sind. (Chronik im Stein, Ismail Kadare, S.169)*

3.1.9. Koha e ardhme e përparme

Në “Gramatikën e gjuhës shqipe I” qëndron se e ardhmja e përparme përdoret për të shprehur një veprim i cili pritët të kryhet në të ardhmen para një veprimi tjetër²⁵⁹. Sipas Cifonun, Hofman dhe Shtreker (Zifonun, Hoffmann, Strecker) e ardhmja e përparme (Futur II) shpreh një veprim të mundshëm të së shkuarës në të tashmen apo në të ardhmen²⁶⁰. Parë përkufizimet e këtyre dy kohëve në shqipe dhe gjermanishte themi se kuptimi themelor i tyre është i njëjtë. Në të dyja gjuhët kjo kohë përmban dy komponentë semantikë: atë kohor dhe modal²⁶¹. Përdorimet më të shpeshta të kësaj kohe karakterizohen nga faktori modal i supozimit²⁶² duke e lënë komponentin kohor në plan të dytë.

Sipas “Gramatikës së gjuhës shqipe I”²⁶³ dhe Demirajt²⁶⁴ e ardhmja e përparme në shqipe ka dy variante përdorimi²⁶⁵ (më poshtë varianti 1 dhe 2). Helbig dhe Buscha²⁶⁶ (Helbig & Buscha) i njohin kësaj kohe në gjermanishte edhe një variant të tretë²⁶⁷, atë në të cilin shprehet një veprim i cili supozohet të ketë ndodhur në të shkuarën dhe ka pasoja në të tashmen. Në

²⁵⁹ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Tiranë, 2002, f. 316.

²⁶⁰ Gisela Zifonun & Ludger Hoffmann & Bruno Strecker, *Grammatik der deutschen Sprache*, Band 1, 2, 3, De Gruyter, 1997

²⁶¹ Për shqipen: Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 146/147; për gjermanishten: Gisella Ferraresi, *Grammatikalisierung, kurze Einführung in die germanistische Linguistik*, Universitätsverlag WINTER Heidelberg, 2015, f. 125.

²⁶² Për shqipen: Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 147.

²⁶³ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Tiranë, 2002, f. 316-317.

²⁶⁴ Shaban Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, II, Tiranë, 1970, f. 207.

²⁶⁵ Në punim varinti i parë dhe i dytë.

²⁶⁶ Gerhard Helbig & Joachim Buscha, *Deutsche Grammatik, ein Handbuch für Ausländerunterricht*, Berlin und München: Langenscheidt, 2001, f. 139-141.

kërkimet tona për këtë punim kemi konstatuar se këtë variant përdorimi e gjejmë edhe në shqipe. Le t'i trajtojmë me rradhë tri variantet e përdorimit të kohës së ardhme të përparme dëftore.

1. Varianti kryesor i përdorimit është ai i përcaktimit të një veprimi të mundshëm në të shkuarën, të lidhur domosdoshmërisht me një faktor modal të supozimit²⁶⁸ (1). Prania e një treguesi kohor shtesë (*dje, para ca ditësh etj./gestern, vor einigen Tagen*) mund të jetë fakultative - megjithatë kjo nuk ndikon në kuptimin kohor apo në faktorin modal të fjalisë. Koha e vëzhgimit dhe ajo e veprimit përputhen dhe që të dyja shtrihen para kohës së ligjërit²⁶⁹. Këtë përdorim të së ardhmes së përparme e hasim në të dyja gjuhët.

(1)

Duhet ta ketë zënë plumbi keq; do të ketë marrë ndonjë nga ato plagët e liga, të cilat nuk janë aq të rënda, saqë të ta dobësojnë trupin shpejt e të shushatin fare, dhe as aq të lehta, saqë t'i durosh dhimbjet me shpresë se do të të kalojnë. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 114)

Er wird einen bösen Schuss haben, eine dieser schlimmen Verletzungen, die nicht so stark sind, dass sie den Körper rasch derart schwächen, dass man halbbetäubt verdämmert, und auch nicht so leicht, dass man die Schmerzen mit der Aussicht ertragen kann, wieder heil zu werden. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, S. 113)

Në fjalinë (1) folja në shqipe *do të ketë marrë* është në të ardhmen e përparme, ndërsa folja me ngjyrim sigurie *duhet* e përdorur në pjesën e parë të fjalisë, shërben për të përforcuar faktorin modal të supozimit. Në fjalinë në gjermanishte kthimi realizohet me strukturën “*werden + infinitivin e foljes haben (kam)*“. Si në shqipe edhe në gjermanishte, elementet e tjerë të fjalisë mbështesin mundësinë e kryerjes së veprimit në të shkuarën.

²⁶⁷ Në punim varianti i tretë.

²⁶⁸ Për shqipen shih: Shaban Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, II, Tiranë, 1970, f. 207; për gjermanishten: Gerhard Helbig & Joachim Buscha, *Deutsche Grammatik, ein Handbuch für Ausländerunterricht*, Berlin und München: Langenscheidt, 2001, f. 139.

²⁶⁹ Gerhard Helbig & Joachim Buscha, *Deutsche Grammatik, ein Handbuch für Ausländerunterricht*, Berlin und München: Langenscheidt, 2001, f. 139.

(2)

*Kam përshtypjen se ai **do t'i ketë shkruar** shpesh - dhe ajo patjetër do të marrë edhe një letër prej tij ndoshta nesër, ose pas një muaji, po të ngatërrohet në ndonjë postë. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 194)*

Er sieht aus, als wenn er ihr oft geschrieben hätte, - sie wird auch noch Post von ihm bekommen – morgen, in einer Woche -, vielleicht einen verirrten Brief noch in einem Monat. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, S. 197)

Është e vërtetë që e ardhmja e përparme shpreh një supozim në të kaluarën dhe në këtë fjali (2) përkthyesi me të drejtë ka përdorur të ardhmen e përparme: folja *do t'i ketë shkruar* është e paraprirë nga togfjalëshi me ngjyrim dyshimi dhe sigurie *kam përshtypjen* dhe mbështetet nga ndajfolja e frekuencës *shpesh* për t'i dhënë një nuancë sigurie supozimit të shprehur nga autori. Në gjermanishte gjejmë përdorim të mënyrës lidhore *geschrieben hätte* - karakteristike kjo për gjermanishten sa herë që bëhet fjalë për supozim - folja *aussehen* dhe ndajfolja *oft* e forcojnë thënien duke e përforcuar nuancën e supozimit. Në këtë variant përdorimi e ardhmja e përparme në të dyja gjuhët mund të zëvendësohet nga e kryera dëftore e shoqëruar me një pjesëz dyshimi, si p.sh.: *ndoshta (ndofta), patjetër, sigurisht, me siguri* etj., e përkatësisht në gjermanishte: *wohl, sicher, gewiss, vielleicht, vermutlich, bestimmt* (3).

(3)

*Er **wird** (wohl) (dieses Jahr) viel Geld **verdient haben**. – Er hat wohl (dieses Jahr) viel Geld verdient.*

Ai do të ketë fituar (me siguri) shumë para (këtë vit). Me siguri ai ka fituar shumë para (këtë vit).

Përpos zëvendësimit me të kryerën dëftore, në shqipe haset edhe zëvendësimi i këtij varianti përdorimi me të kryerën e lidhore paraprirë nga folja gjysmëndihmëse *mund*²⁷⁰. Është e qartë, që në shembullin e mëposhtëm në gjermanishte kemi përdorim të mënyrës lidhore (*sein müssen*) dhe kthimi në shqipe realizohet me të kryerën e lidhore (*të ketë mbetur*) shoqëruar me foljen *mund*. Shembulli i mëposhtëm në shqipe fare mirë mund të zëvendësohet: *Nuk e gjej dhe i them, se do të ketë mbetur në sekretari* (4).

(4)

*Nuk e gjej dhe i them, se ndoshta **mund të ketë mbetur** në sekretari. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 37)*

²⁷⁰ Për këtë shih: Shaban Demiraj, *Morfologjia historike e gjuhës shqipe, II*, Tiranë, 1976. f. 207.

Es ist nicht da. Ich sage, dass es wohl auf der Schreibstube sein müsse, und gehe. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, S. 35)

Te ky variant përdorimi dallohen edhe disa nënpërdorime me faktor modal të supozimit, si p.sh.: në pyetjet dyshuese (5):

(5)

Do të kenë arritur? - Me siguri.

Ob sie angekommen sind? - Sicher.

apo kur vërehet kalimi nga supozim në habitore (6):

(6)

E paske prirje nga natyra! - Siç duket puna do të kem lindur poet!

*Du hast dazu Talent! - Anscheint bin ich wohl als Dichter geboren.*²⁷¹

Në dy fjalitë e mësipërme kthimi në gjermanishte nuk realizohet me anë të së ardhmes së përparme, por me të kryerën dëftore - duke shtuar edhe pjesëzën modale *wohl* në shembullin e dytë - kohë e cila e zëvendëson apo përdoret shpesh në vend të së ardhmes së përparme.

2. Variant për të shprehur një veprim a gjendje, që pritet të vërtetohet para se të ndodhë diçka tjetër në të ardhmen²⁷². Këtë variant përdorimi e gjejmë edhe në gjermanishte, me ndryshimin që gjuhëtarët nuk e lidhin vërtetimin e veprimit në të ardhmen me një veprim tjetër. Duke vëzhguar më thellë shprehemi se këto dy variante në thelb janë të ngjashme. Konkretisht Helbig dhe Buscha (Helbig & Buscha) mjaftohen vetëm me shprehjen e një veprimi, i cili pritet të ndodhë në të ardhmen²⁷³. Si koha e veprimit, ashtu edhe ajo e vëzhgimit shtrihen pas kohës së ligjërit, por koha e veprimit shtrihet para asaj së vëzhgimit, pra midis kohës së ligjërit dhe asaj të vëzhgimit. Ky variant përdorimi mund të përmbajë një faktor modal të supozimit edhe pa praninë e elementeve leksikorë shtesë. Prania e treguesit kohor, si p.sh.: *nesër, pas dy ditësh, së shpejti, deri të hënën, deri të hënën në mbrëmje* etj., (në gjermanishte: *morgen, in zwei Tagen, bald, bis Montag, bis Montagabend*) është e domosdoshme²⁷⁴ (7). Në rastet kur fjalia nuk përmban tregues kohorë, shembujt mund të kenë të njëjtat vlera nëse

²⁷¹ Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 147.

²⁷² Shaban Demiraj, *Morfologjia historike e gjuhës shqipe*, II, Tiranë, 1976. f. 207.

²⁷³ Për këtë shih: Gerhard Helbig & Joachim Buscha, *Deutsche Grammatik, ein Handbuch für Ausländerunterricht*, Berlin und München, Langenscheidt, 2001, f. 140.

²⁷⁴ Po aty.

përmbajnë një veprim në të ardhmen, para të cilit pritet të vërtetohet veprimi i shprehur me anë të së ardhmes së përparme (8).

(7)

*Deri të hënën **do t'i ketë përpiluar** planet.*

*Bis Montag **wird er die Pläne entwickelt haben.***

(8)

*Deri sa të fillojë mbledhja, **do ta ketë shkruar** raportin.*

*Bis zur Sitzung, **wird er den Bericht geschrieben haben.***

Por këto përdorime të shoqëruara me tregues kohorë të së shkuarës, mund të shprehin edhe një veprim, i cili ka ndodhur në të shkuarën – për këtë nevojitet prania e treguesve kohorë të tipit: *gestern, vor einer Woche* etj., respektivisht në shqipe: *dje, para një jave* (9), (10). Edhe në këtë variant fjalia karakterizohet nga ngjyrimet e mundshme dhe jo të sigurta mbi realizimin e veprimit të emërtuar nga folja. Nëse këmbëjmë te shembujt e mësipërm treguesit kohorë të së ardhmes me ato të së shkuarës, kemi:

(9)

*Ai **do t'i ketë përpiluar** dje planet.*

*Er **wird die Pläne** gestern **entwickelt haben.***

(10)

*Ajo **do ta ketë shkruar** artikullin para një jave.*

*Sie **wird den Artikel** vor einer Woche **geschrieben haben.***

3. Variant, ku tregohet një veprim i cili supozohet të ketë ndodhur në të shkuarën dhe ka pasoja në të tashmen. Koha e vëzhgimit shtrihet para asaj të ligjërimit dhe që të dyja këto shtrihen pas kohës së veprimit. Fjalia mund të përmbajë një faktor modal të supozimit, ndërsa prania e treguesit kohor është fakultative²⁷⁵.

(11)

*Peterin **do ta ketë zënë** gjumi para ca orësh. (Peter po fle akoma.)*

*Peter **wird vor einigen Stunden eingeschlafen sein.** (Peter schläft jetzt.)²⁷⁶*

²⁷⁵ Për gjermanishten: po aty.

²⁷⁶ Shembull i marrë po aty.

(12)

*Himmelstoß **scheint** sie **alarmiert zu haben**. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 81)*

*Siç duket Himelstosi **do të ketë bërë** namin. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 83)*

(13)

*Man **hat** mich bei uns wahrscheinlich längst **verlorengegeben**. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, S. 193)*

*Ata të mitë **do të më kenë hequr** qëkur nga defteri. Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 190)*

Në shembullin (11) në të dyja gjuhët kemi përdorim të së ardhmes së përparme. Veprimi ka ndodhur në të shkuarën e ka zënë gjumi dhe vazhdon të ketë pasoja në të tashmen: *Peter është ende në gjumë*. Këtu kemi përdorim modal, ndërsa prania e treguesit kohor është fakultative. Në shembullin (12) në gjermanishte faktori modal i supozimit shprehet përmes foljes *scheint*, e cila njëkohësisht ndihmon dhe në formimin morfologjik të së ardhmes së përparme. Veprimi ka ndodhur në të shkuarën, porse pasojat e tij ndjehen edhe në të tashmen. Për të shprehur faktorin modal të supozimit në shqipe përkthyesi R. Shvarc ka zgjedhur togfjalëshin *Siç duket* (12) dhe me të drejtë, në kthimin në shqipe ka përdorur të ardhmen e përparme. Në shembullin (13) në gjermanishte autori ka zgjedhur të përdorë të kryerën dëftore *hat verlorengegeben*, ndërsa përkthyesi në shqipe ka zgjedhur të ardhmen e përparme dëftore *do të kenë hequr*. Në të dyja gjuhët gjejmë praninë e faktorit modal të supozimit - në gjermanishte ndajfolja *wahrscheinlich* (12), ndërsa në shqipe nuanca e këtij faktori modal të supozimit është e shpërndarë në kontakt. Më tej vlen të përmendet edhe roli i intonacionit si element gramatikor mbështetës i supozimit.

3.1.10. Koha e ardhme e së shkuarës dhe e ardhme e përparme e së shkuarës në shqipe

Për nga ndërtimi morfologjik dy kohët e shkuara të dëftores, e ardhmja e së shkuarës dhe e ardhmja e përparme e së shkuarës janë të njëjta me dy kohët e kushtores, me të tashmen dhe të kryerën. Ndryshimet midis këtyre katër kohëve e kalojnë planin morfologjik duke u hedhur në atë semantik. Nisur nga përdorimet e së ardhmes të së shkuarës dhe së ardhmes së përparme të

së shkuarës nëpër apodosa periudhash hipotetike të mundësisë apo të pamundësisë ato e kanë forcuar më tej kuptimin modal të mundshmërisë²⁷⁷. Kur përdorimet e këtyre kohëve nuk shprehin semantikisht asnjë kusht apo mundësi duke u karakterizuar nga modaliteti i vërtetësisë, atëherë kemi përdorim të tyre me vlerë të mënyrës dëftore; në rastet e përdorimeve, në të cilat kuptimet kohore janë të mpleksura me kuptimin e modalitetit, i cili del në plan të parë dhe përmes tyre synohet të shprehet mundësia (ose pamundësia) e kryerjes së një veprimi pas plotësimit (ose mosplotësimit) të një kushti të caktuar, atëherë kemi përdorim të kushtores²⁷⁸.

3.1.11. Koha e ardhme e së shkuarës në shqipe dhe format gjegjëse në gjermanishte

Siç e kemi përmendur edhe më parë në këtë punim, në shqipe e ardhmja e dëftores përfaqësohet me katër kohë gramatikore, ndërsa në gjermanishte me dy - në gjermanishte nuk gjenden e ardhmja e së shkuarës dhe e ardhmja e përparme e së shkuarës. Sipas “Gramatikës së gjuhës shqipe I” kuptimi themelor i së ardhmes të së shkuarës është të tregojë një veprim, që pritej të kryhej pas një çasti të caktuar të së shkuarës (1)²⁷⁹. Me këtë kuptim ajo përdoret në ligjëratë të zhdrejtë në vend të kohës së ardhme të ligjëratës së drejtë. Zakonisht tipari i pritshmërisë është i lidhur me tiparin e kohës së shkuar²⁸⁰. E ardhmja e së shkuarës gjen gjerësisht përdorim në ligjërimin e shkruar: në tekste letrare apo në median e shkruar; nuk haset në tekste me karakter shkencor. Në ligjërimin e folur zë një qoshe të bukur duke ofruar nuanca të veçanta në ligjërime.

²⁷⁷ Shaban Demiraj, Studime filologjike: *Rreth kategorive gramatikore të mënyrës dhe të kohës në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1977, f. 105. Në veprën e tij "Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe II" botim i vitit 1970 Demiraj pranon 8 kohë për dëftoren, duke mos përfshirë të ardhmen e së shkuarës dhe të ardhmen e përparme të së shkuarës e duke i renditur format gramatikore të këtyre dy kohëve si kohë të kushtores, përkatësisht e pakryer dhe më se e kryer kushtore (Demiraj, 1970:212-214). Në "Gramatikën e gjuhës shqipe I" botim i vitit 2002, këto dy kohë i gjejmë me emërtimet "e tashme e kushtores" dhe "e kryer e kushtores" (faqe 328). Në trajtimin e së ardhmes të së shkuarës dëftore Buholci dhe Fidler (Buchholz-Fiedler) vendosin në kllapa barazvlefshmërinë e kësaj kohe me të tashmen e kushtores (Buchholz&Fiedler, 1987:144).

²⁷⁸ Shaban Demiraj, Studime filologjike: *Rreth kategorive gramatikore të mënyrës dhe të kohës në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1977, f. 107.

²⁷⁹ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 317.

²⁸⁰ Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 144.

(1)

*Vitin që kaloi **do të fillonte** studimet, por u sëmur.* ²⁸¹

Im vergangenen Jahr hatte er das Studium aufnehmen sollen, aber er wurde krank.

(2)

*Në sytë e tyre unë **do të dukesh** një përbindësh dhe si këshillë **do të merrja** vetëm ndonjë aludim të tërthortë për të shkuar në ato vende ku – siç besojnë ata – dashuria mund të blihet. (Me syrin e një kllouni, Heinrich Böll, f. 13)*

..., ich muss ihnen wie ein Monstrum vorkommen, und ihr Rat wird nichts weiter sein als ein versteckter Hinweis auf die Gefilde, in denen, wie sie glauben, die Liebe käuflich ist. (Ansichten eines Clowns, Heinrich Böll, S.14)

Në shembujt (1) dhe (2) në shqipe kemi përdorime të së ardhmes së përparme *do të fillonte* dhe *do të dukesh*. Kthimet në gjermanishte realizohen të dyja me strukturë me folje modale, e para në më se të kryerën (1) *hatte aufnehmen sollen*, dhe e dyta me folje në infinitiv (2) *muss vorkommen*, e ardhme *wird sein*. Të dy shembujt (1) dhe (2) nuk shprehin semantikisht asnjë kusht, por një të vërtetë (1) apo diçka të menduar si të vërtetë (2). Megjithatë ne e shohim të hollë vijën ndarëse midis përdorimeve të karakterizuara nga modaliteti i vërtetësisë (1-3) me ato të karakterizuara nga modaliteti i mundësisë (4).

(3)

*Gjithçka tjetër lihet mënjanë, sepse **do t'i harxhonte** fuqitë kot. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 235)*

Alles andere ist verbannt, weil es unnötig Kraft verzehren würde. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 240)

(4)

*Askush s' **do ta besonte** që në këtë shkretëtirë të handakosur mund të kishte akoma njerëz, ... (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 103)*

Niemand würde glauben, dass in dieser zerwühlten Wüste noch Menschen sein könnten; ... (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 101)

Për të kthyer format gramatikore të së ardhmes së shkuar në gjermanishte apo format gjegjëse të kësaj kohe nga gjermanishtja në shqipe Buholci dhe Fidleri (Buchholz-Fiedler), si përkthyesi Shvarc zgjedhin kryesisht strukturën gramatikore me foljen *werden* (do të) në

²⁸¹ Shembull i marrë nga Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 144.

Konjunktiv II „würden (do të në Konjunktiv II) + folje kryesore në infinitiv” - kjo në rastet e përdorimeve me ngjyime modale. Këtë e vërejmë edhe në shembujt e mësipërm, në shqipe (3), (4): *do t'i harxhonte, do ta besonte*, ndërsa në gjermanishte: *würde verzehren* (3), *würde glauben* (4). Struktura të tjera gramatikore konkurruese në gjermanishte - edhe pse hasen rrallë - janë edhe: "*hätten (kam në Konjunktiv II) + folje kryesore në infinitiv*", "*folje modale në preteritum/në lidhore (Konjunktiv II) + folje kryesore në infinitiv*" (5).

(5)

Vetë perandori s' do të ishte më i fyer. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 79) .(Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 79)

Der Kaiser könnte nicht beleidigter sein. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 76)

Por krahas kësaj forme, që është mbizotëruese, në shqipe haset edhe forma tjetër e cila ndërtohet me anë të së pakryerës së foljes ndihmëse *kam* të ndjekur nga forma e pashtjelluar e tipit *për të larë*, p.sh.: *kisha për të larë*²⁸².

Rrallëherë kjo kohë përdoret për të shprehur veprime rutinë në të shkuarën; paskohshmëria sinjalizohet në fjali: *E kishte zakon, sa herë endte ndonjë punë, do pyeste dhe botën, se shkonte sipas fjalës së urtë. . . Er hatte die Angewohnheit, so oft er irgendwie Sache (neu) betrieb, die Leute zu fragen, denn er verfuhr nach dem Sprichwort. . .*²⁸³

Në të folmet popullore format gramatikore të së ardhmes së shkuar hasen edhe pa pjesëzën *të*.

3.1.12. Koha e ardhme e përparme e së shkuarës në shqipe dhe format gjegjëse në gjermanishte

Format gramatikore të së ardhmes së përparme të së shkuarës janë ndërtuar mbi bazën e së ardhmes të së shkuarës: "*do të mësoja*→*do të kisha mësuar*" për diatezën veprorë dhe "*do të isha mësuar*" për atë pësorë. Kjo kohë përdoret për të shprehur një veprim a gjendje që mund

²⁸² Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 290-291.

²⁸³ Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 144.

të ketë ndodhur para një çasti të caktuar të së shkuarës²⁸⁴ (1)²⁸⁵. Koha e ardhme e përparme e së shkuarës është e lidhur me tre tipare të detyrueshme, të shenjëzuara shumë fort: pritshmërinë, dykohshmërinë dhe të shkuarën relative. Në përdorimet e veçanta këto tipare krijojnë marrëdhënie të ndryshme me njëra-tjetrën²⁸⁶. Këtë kohë e gjejmë në shqipe, si në ligjërimin e folur, edhe në atë të shkruar, por spektri i përdorimit është i ngushtë. Strukturat gramatikore që përdoren në kthimin në gjermanishte janë: "würden (,do të‘ në Konjunktiv II) + folje kryesore në infinitiv“(1), "hätten (,kam‘ në Konjunktiv II) + folje kryesore në infinitiv“.

(1)

Vishej trashë dhe kaq keq i rrinin rrobat në trup, sa menjëherë formoje bindjen se këto rroba dikush do t'ia kishte falur.

Er war immer dick angezogen und die Sachen passten ihm gar nicht, und man merkte sofort, jemand habe ihm die Sachen verschenkt.

(2)

Peter më tha, se gjer të hënën do ta kishte mbaruar raportin.

Peter sagte mir, dass er bis Montag den Bericht fertig haben würde.

Fjala në shembullin (2) është në ligjëratën e zhdrejtë dhe shpreh dykohshmëri: *më tha* është në të shkuarën, *do ta kishte mbaruar* është gjithashtu në të shkuarën duke e theksuar më mirë këtë me praninë e togfjalëshit kohor *gjer të hënën*. Ky është dhe përdorimi kohor më i gjerë i kësaj kohe²⁸⁷. Kthimi në gjermanishte realizohet me strukturë foljore në Konjunktiv II *fertig haben würde*, duke e nxjerrë qartë në pah nuancën e mundësisë që ka realizimi i veprimit në një të shkuar të përcaktuar *bis Montag*. Në të dyja gjuhët është lehtësisht e vërtetueshme shkalla e lartë e sigurisë së realizimit të veprimit të mundshëm.

Sipas Buholcit dhe Fidlerit²⁸⁸ (Buchholz & Fiedler), e ardhmja e përparme e së shkuarës përdoret edhe për të shprehur një supozim. Megjithatë përdorimi më i dendur i kësaj kohe është - ashtu si edhe në të ardhmen e së shkuarës - pikërisht ai i kushtores, duke sinjalizuar

²⁸⁴ Shaban Demiraj, *Morfologjia historike e gjuhës shqipe*, II, Tiranë, 1976. f. 105.

²⁸⁵ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 318.

²⁸⁶ Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 147.

²⁸⁷ Për këtë shih: po aty.

²⁸⁸ Po aty.

kushte irreale përkundrejt kohshmërisë. Shembulli (2) tregon përdorim të së ardhmes së përparme të së shkuarës në tekstin narrativ:

(2)

*Ndryshe **do ta kishte kyçur** gojën, sepse çdokush e sheh që Kemerihu s' del më i gjallë këtej.*
(Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 20)

*Sonst **würde** er den Mund **halten**, denn jeder sieht, dass Kemmerich nicht mehr aus diesem Saal herauskommt. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 18)*

Në të folmet popullore format gramatikore të së ardhmes së përparme të së shkuarës hasen edhe pa pjesëzën *të*.

KREU IV

MËNYRA HABITORE

4.1. Mbi mënyrën habitore në shqipe dhe gjermanishte

Terma *mënyra habitore* në gramatikën e gjuhës shqipe përdoret në kuptimin e termës latine *modus admirativus*²⁸⁹. Për nga tipi strukturor habitorja e shqipes nuk ka shoqe në asnjë gjuhë tjetër indoevropiane. Ky mendim i Demirajt gjen mbështetje edhe nga Hecer (Hetzer) me tezën se në gjuhët e tjera indoevropiane mungon një mënyrë ekuivalente e habitores²⁹⁰. Kjo lidhet me faktin që habitorja nuk është element i trashëguar nga familja e gjuhëve indoevropiane, por një zhvillim i brendshëm i shqipes përmes kontaktit gjuhësor të dyanshëm të saj me gjuhën bullgare dhe atë maqedonase²⁹¹. Format e habitores i gjejmë fillimisht në veprën “Meshari” të Gjon Buzukut (1555), por termi *habitore* për shqipen është përdorur për herë të parë nga August Dozon²⁹² (Auguste Dozon) në veprën e tij “*Manuel de la langue chkiye ou albanaise*” (f. 226) në vitin 1879²⁹³. Haborja e shqipes është një mënyrë jo e zakonshme, e cila ka bërë një rrugëtim të gjatë plot dyshime e pasiguri përsa i përket njohjes së saj si mënyrë gramatikore më vete dhe sukseset e saj në këtë drejtim janë të pjesshme:

²⁸⁹ Shaban Demiraj, *Morfologji e gjuhës së sotme shqipe*, II, Tiranë, 1970, f. 226.

²⁹⁰ Sarah Gretler, *Die Verbale Kategorie Evidenz im Albanischen und Türkischen*, Zürich, 1987, f. 11.

²⁹¹ Blertë Ismajli, *Verbmodi im Deutschen und Albanischen im Vergleich, Alles Mögliche: Sprechen, Denken und Schreiben des (Un)Möglichen*, Verlag Königshausen & Neumann GmbH, Würzburg, 2014, f. 168.

²⁹² Balkanistika, Friedmann, *Balkan Admirativity*, Volume IV, 1980, f. 17.

²⁹³ Funksionet e habitores janë parë si objekt për studime linguistike në gjysmë e dytë të shekullit 20. (Blertë Ismajli, *Verbmodi im Deutschen und Albanischen im Vergleich, Alles Mögliche: Sprechen, Denken und Schreiben des (Un)Möglichen*, Verlag Königshausen & Neumann GmbH, Würzburg, 2014, f. 169.)

Gjuhëtarë shqiptarë dhe të huaj kanë mbajtur qëndrime të kundërta përsa i përket ligjimitetit të saj në sistemin foljor të shqipe – disa e kanë pranuar dhe trajtuar habitoren si mënyrë më vete, ndërsa të tjerë e kanë kategorizuar dhe trajtuar si formë të mënyrës dëftore apo lidhore. Midis gjuhëtarëve shqiptarë që nuk e kanë pranuar habitoren si mënyrë më vete përmendim Sami Frashërin dhe Kostandin Kristoforidhin – ky i fundit i emërton format e habitores me termin “të papritura”²⁹⁴. Ndër gjuhëtarët të cilët e kanë pranuar habitoren si mënyrë më vete përmendim: Camajn, Demirajn, Hecerin (Hetzer), Njumarkun (Newmark), Vaigandin (Weigand), Ferrarin (Ferrari), Boisin (Boissin), “Gramatikën e Gjuhës shqipe I”, Buholcin dhe Fidlerin (Bucholz & Fiedler) etj. Camaj e sheh habitoren si një mënyrë të pazakontë e cila nuk është e integruar lehtësisht në sistemin verbal shqiptar. Midis habitores dhe dëftores vërehen lidhje formale dhe funksionale, si mënyra që paraqesin një realitet, por ndryshe nga dëftorja, habitorja përveç vëzhgimit të një veprimi konkret përmban edhe pjesën e habisë së folësit²⁹⁵ (1). Ndërsa Demiraj²⁹⁶ dallon qartë habitoren nga dëftorja, si nga ndërtimi i formave kohore, ashtu edhe nga kuptimi modal i tyre.

(1)

*Ore, shokë, ky na **qenka** ai më i madhi i të mëdhenjve!* (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 178)

*Tjaden sagt staunend: "Das **ist** nun der Allerbeste, den es gibt".* (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 179)

Në gjermanishte, siç e kemi përmendur edhe më lart në këtë punim, nuk gjenden forma gramatikore të mënyrës habitore. Nisur nga ky fakt gjuhësor ne kemi hulumtuar mjetet morfologjike, sintaksore apo semantike që përdor gjermanishtja për të shprehur habinë e folësit duke i vënë përballë shembujve të mënyrës habitore në shqipe.

²⁹⁴ Shaban Demiraj, Studime filologjike: *Rreth kategorive gramatikore të mënyrës dhe të kohës në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1977, f. 103.

²⁹⁵ Martin Camaj, *Albanian Grammar with Exercises, Chrestomathy and Glossaries*, Verlag Otto Harrassowitz, Wiesbaden, 1984, f. 162.

²⁹⁶ Shaban Demiraj, Studime filologjike: *Rreth kategorive gramatikore të mënyrës dhe të kohës në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1977, f. 103-104.

4.1.1. Mënyra habitore në shqipe

Habitorja është mënyrë e shenjëzuar me anë të së cilës shprehet në përgjithësi modaliteti i së vërtetës. Sipas Vajngandit (Weingand) me anë të habitores në shqipe paraqitet një veprim si i papritur – ngjarja shfaqet si diçka e panjohur apo e paditur më parë duke shkaktuar habi²⁹⁷. Në “Gramatikën e gjuhës shqipe I” na jepet një përkufizim më i plotë për habitoren: Në shqipe me anë të mënyrës habitore shprehet në përgjithësi modaliteti i vërtetësisë, i shoqëruar edhe me ndjenjën e habisë së folësit për një veprim të papritur, që është kryer në të shkuarën ose kryhet në çastin e ligjërit (2). Gjithashtu nëpërmjet mënyrës habitore folësi mund të shprehë edhe dyshimin ose mospajtimin e tij e ndonjëherë edhe ironi lidhur me një veprim, thënie a pohim të një tjetri²⁹⁸. Jo të gjithë studiuesit – vendas apo të huaj – mbajnë të njëjtin qëndrim mbi funksionet e habitores në shqipe, por ata [“Gramatika e Gjuhës shqipe I”, Demiraj, Camaj, Njumarku (Newmark), Heceri (Hetzer), Buholci & Fidleri (Buchholz&Fiedler), Vajngandi (Weingand), Broji (Breu), Greteli, Karapinjalli, Ismajli] janë të një mendimi kur flitet mbi funksionin e saj për të shprehur habinë e folësit apo dyshimin (mospajtimin, ironinë) e tij. Përdorimi i habitores mbulon në thelb situata ligjërimi në të cilat folësi shpreh habinë, ironinë apo dyshimin për një veprim të caktuar të ndodhur në kohën e shkuar apo në të tashmen. Habia (2) apo ironia (dyshimi, mospajtimi) (3) e ligjëruesit vendos raport të drejtpërsëdrejtë me realitetin. Shpesh habia e shprehur shoqërohet me tone të forta gëzimi (4) apo inati e mllëfi (5). Mbi përdorimin e habitores në ndërtime në ligjëratën e zhdrejtë shprehen Buholci dhe Fidleri (Buchholz & Fiedler), Camaj, Gretel, Njumark (Newmark) dhe Ismajli. Por këtë përdorim të habitores nuk e gjejmë të shprehur në “Gramatikën e gjuhës shqipe I” apo te Demiraj. Hecer (Hetzer) i njeh habitores edhe përdorimin e saj në zëvendësimet e ndërtimeve me struktura të dëftores në gjuhën popullore emocionale, funksion i cili është i zhveshur nga ngjyrimet modale²⁹⁹. Gretel pranon për habitoren edhe një funksion tjetër të rëndësishëm, pikërisht atë për të shprehur fakte të fshehura apo të panjohura të së shkuarës, së ardhmes të rindërtuara përmes folësit³⁰⁰. Shpesh të gjitha këto funksione të habitores të përmendura më lart shoqërohen me intonacionin

²⁹⁷ Gustav Weingand, *Albanesische Grammatik*, Leipzig, 1913, f. 120.

²⁹⁸ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 318.

²⁹⁹ Sarah Gretel, *Die verbale Kategorie: Evidenz im Albanischen und Türkischen*, Universität Zürich, Seminar für Allgemeine Sprachwissenschaft, Zürich, 1987, f. 14.

³⁰⁰ Po aty.

karakteristik, por jo vetëm. Një vend të veçantë zënë edhe ndajfoljet, si: *befas*, *papritmas*, *papritur*, *menjëherë*, *në mënyrë të papritur*.

(2)

*Uah, sa **qënke rritur** e **zbukuruar** moj çupë!*

Waw Mädchen, wie groß und schön bist du aber geworden!

(3)

*Nuk **ditkeni** të nderoni?* (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 145)

Können Sie nicht grüßen? (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 146)

(4)

*O Zot, kush **paska ardhur**!*

Mein Gott, wen haben wir denn da?!

(5)

*Ç’**paska qenë** një nëpërkë ajo vajza e Kashajve.* (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 92)

“Welch eine Schlange, diese Kashahutochter. (Chronik im Stein, Ismail Kadare, S.98)

Në shembullin (2) habia e folësit është reagim ndaj një realiteti të ri, të panjohur më parë. Fjalja nis me pasthirrmën habitore *Uah*, e cila pasohet menjëherë nga përemri i pacaktuar *sa* për të vijuar me foljet në mënyrën habitore *qënke rritur e zbukuruar*. Habia e folësit nuk është e përqëndruar vetëm te foljet në mënyrën habitore – ajo është e shpërndarë në të gjithë elementet e fjalisë, ku më shumë e ku më pak dhe funksionon si një mekanizëm i tërësishëm, ku fjalët e fjalisë kanë hyrë në marrëdhënie funksioni dhe kuptimi me të vetmin qëllim: të shprehin habinë e ligjëruesit. Fjalja (2) mund të jetë funksionale nga ana morfologjike dhe semantike edhe nëse i shkëpusim disa elemente duke e lënë *Qënke rritur e zbukuruar moj çupë!*. E dhënë kështu nuk do të kishim kurrësi të njëjtën ngarkesë emocionale si më lart, por do të jepej një fjali në mënyrën habitore pa forcën dhe ngjyrimet emocionale karakteristike të kësaj mënyre. Kthimi në gjermanishte bën të njëjtën hyrje triumfuese përmes pasthirrmës *Waw*, duke vijuar me ndajfoljen *wie* dhe folja e habitores realizohet me kombinimin e së kryerës *bist geworden* me mbiemrat *groß* dhe *schön* (e *rritur* dhe e *bukur*). Mendojmë se gjatë kthimit në gjermanishte nuk humbet ndopak nga fuqia e habisë e shprehur në shqipe – çdo element qoftë semantik, stilistik apo sintaksor ruan domethënien apo potencialin përkatës.

Në shembullin (4) në shqipe habia e folësit e shprehur përmes foljes në habitore *paska ardhur* shoqërohet me tone gëzimi. Terreni i këtij shpërthimi emocionesh pregatitet që në nisje nga

togfjalëshi *O Zot*; fjalia shoqërohet me një intonacion karakteristik dhe ngazëllimin e ligjëruesit. Kthimi në gjermanishte realizohet përmes foljes në dëftore *haben*. Këtu vlejnë të njëjtat konsiderata si në shqipe mbi togfjalëshin *Mein Gott* dhe intonacionin e ligjëruesit duke shtuar edhe vlerat e pjesëzës modale *denn*. Në shembullin në gjermanishte habia e gërshetuar me gëzim është e shpërndarë në të gjithë fjalinë. Në këtë përdorim gjejmë përjasje midis dy gjuhëve. Në shembullin (5) në shqipe habia e folësit përmban tone të theksuara mllëfi. Nënvizojmë roli e intonacionit në përdorime të këtilla. Nëse vëzhgojmë kthimin në gjermanishte, gjejmë puqje me shqipen – përzgjedhja e përkthyesit për të përdorur përemrin *welch* është e gjetur, nëse nisemi nga funksioni kryesor i tij: për të përforcuar thirrje të ndryshme në dëftore.

Mënyra habitore në shqipe gjen përdorim si në ligjërimin letrar, ashtu edhe në atë të përditshëm. Ajo paraqitet mjaft e gjallë në të folmet dhe krijimet popullore dhe përdoret zakonisht nëpër fjali, që nuk janë të varura³⁰¹. Ndërsa format e habitores në lidhore shërbejnë për të ndërtuar periudha hipotetike si letërsinë e re, ashtu edhe në atë të vjetër, atëherë kur lidhja me kushtoren është normale³⁰². Habitorja gjithashtu afron me funksionet tregimtare të së tashmes historike – këtë anë të habitores e hasim gjerësisht në literaturën popullore. E megjithatë duhet të themi që habitorja haset më shpesh në ligjërimin e folur, duke e bërë më të gjallë shprehjen e ndjenjave me ngjyime emocionale - të njëjtën gjë mund të themi edhe për strukturat që shprehin habi në gjermanishte. Bazuar në funksionet e habitores ajo del rrallë në tekste të karakterit studimor apo shkencor, kur autori dëshiron të na vërë përballë realitetin e treguar me atë të prekur³⁰³ – e megjithatë këto përdorime janë të kufizuara.

4.1.2. Koha e tashme

Në “Gramatikën e gjuhës shqipe I” qëndron se kuptimi themelor i foljes në të tashmen e habitores është të shprehë habinë, dyshimin, mospajtimin etj. të folësit për një veprim të

³⁰¹ Shaban Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe (pjesa II)*, Tiranë, 1970, f. 226.

³⁰² Martin Camaj, *Albanian Grammar with Exercises, Chrestomathy and Glossaries*, Verlag Otto Harrassowitz, Wiesbaden, 1984, f. 163.

³⁰³ Sarah Gretler, *Die verbale Kategorie: Evidenz im Albanischen und Türkischen*, Universität Zürich, Seminar für Allgemeine Sprachwissenschaft, Zürich, 1987, f. 38.

caktuar që vazhdon të kryhet në çastin e ligjërit. Në këtë përdorim e tashmja e habitores mund të shoqërohet me pjesëzën *po*³⁰⁴. Buholci dhe Fidleri (Buchholz-Fiedler) i atribuojnë habitores dy tipare të cilat janë të lidhura me njëra-tjetrën: *emocionale*, që lidhet me habinë dhe *modale*, që lidhet me komentin³⁰⁵. Përgjithësisht kuptimi modal mund të shprehet nëse është i lidhur me habinë: riprodhimi i ligjëratës së dikujt tjetër përmes mënyrës habitore, përgjithësisht është i mundur vetëm nëse ekziston një distancë e konsiderueshme e folësit³⁰⁶.

Habitoren pa komente në kohën e tashme e gjejmë të shprehur në fjali të shoqëruara me pasthirrma, si raste klasike të shprehjes spontane ose jo spontane të habisë apo në fjali pyetëse-habitore. Këtu folësi mund të shprehë:

a) *habi* (shpërthyes): *habi* spontane në formë thirrrore të shoqëruar edhe me pasthirrma, si: *ej, ou, hej etj...* (6), apo - si rezultat i të menduarit - *habi* jo spontane mbi një veprim apo gjendje e cila deri tani nuk është vënë re dhe shprehet në formën e një thirrjeje³⁰⁷.

(6)

Ah, qenkeni në Bon, sa mirë! (Me syrin e një kllouni, Heinrich Böll, f. 75)

Ach, Sie sind in Bonn – wie nett – oder ähnlich, aber sie schwieg verlegen, sagte dann schwach: “Ach, nett.”. (Ansichten eines Clowns, Heinrich Böll, S.63)

Në shembullin (6) në shqipe fjalia në habitore nis me një pasthirrme *ah*, e cila shërben për të sinjalizuar habinë që do të vijojë. Folja në të tashmen e habitores *qenkeni* e përmbush më së miri të shprehurin e habisë: për ligjëruesen ishte e papritur që zoti Shnir (Schnier) të ndodhet në Bon. Fjalia në gjermanishte jepet me folje në të tashmen dëftore *sind*. Ndërveprimi i elementeve: pasthirrma *ach*, folja në dëftore dhe konteksti shoqëruar me intonacionin karakteristik të habisë arrijnë të shprehin habinë, që në shqipe realizohet me foljen në të tashmen habitore.

b) *habi* jo thirrrore (jo eksklamative), para së gjithash e hasur në fjali të varura. Këtu, ashtu si edhe në rastet e shprehjes së habisë jospontane, paraqiten pasoja (7).

(7)

³⁰⁴ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Tiranë, 2002, f. 319.

³⁰⁵ Termin "*koment*" duket se e përdorin vetëm Buholci dhe Fidleri (Buchholz & Fiedler) - për qartësi mund të themi "*kuptim modal*".

³⁰⁶ Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 154.

³⁰⁷ Po aty.

*Meqënëse **dashke** ashtu, mos hajde me ne!*

Wenn du nicht mitkommen willst, dann bleibe doch hier!

Në shembullin (7) në shqipe kemi përdorim të formës foljore të habitores *dashke*. E megjithatë krahasuar me përdorimin e habitores në shembullin (6) në shqipe bëhet lehtësisht krahasimi i shkallës së fuqisë së habitës të shprehur – në përdorimin tonë (7) entuziazmi i habitës është më i ulur, disi më i përmbajtur dhe nuk e ka shpërthimin karakterizues të habitores sikur në shembullin (6). Fjalja nis me lidhëzën nënrenditëse *Meqënëse* duke i dhënë një nuancë justifikuese mosrealizimit të pritshmërisë së ligjëruesit e duke e zbutur habinë e tij. Kthimi në gjermanishte realizohet me foljen modale *wollen*, në shqipe: *dua*. Por këtu luan një rol vendimtar intonacioni si faktor sintaksor, i cili transmeton në mënyrë mjeshtërore habinë e ligjëruesit lidhur me mosardhjen e bashkëbiseduesit. Më tej themi, që edhe këtu gjuhët afrohen me njëra-tjetrën në nivelin semantik, stilistik dhe sintaksor, por jo në nivelin morfologjik.

c) njëkohësisht fjali pyetëse dhe habitore, të cilat mund të shprehin ngjyrimë të ndryshme modaliteti, si p.sh.: i habitur në mënyrë të inatosur, i habitur në mënyrë jo të këndshme ³⁰⁸(8).

(8)

*Akoma këtu **qënkeni** ju?*

Ihr seid noch da?

Në shembullin (8) vërtet që folësi drejton një pyetje, por ai shpreh edhe habinë e tij mbi praninë e personave – kjo pasi ai mendonte se personat do të ishin larguar tashmë. Kthimi në gjermanishte realizohet me anë të së tashmes dëftore *seid*. E tërë barra e fuqisë së habitës të folësit i mbetet intonacionit – është pikërisht ky mjet i fuqishëm sintaksor, i cili e realizon të shprehurin e habitës të kombinuar me gjendjen e pakëndshme të folësit.

ç) habia mund të lidhet me kushtoren (9), ku që të dyja, si shkaku edhe arsyeja sinjalizojnë habi³⁰⁹.

(9)

*Kur **ardhkan** të mirat, **ardhkan** menjëherë.*

³⁰⁸ Po aty.

³⁰⁹ Po aty.

Wenn schon das Gute kommt, dann kommt es aber auch auf einmal!

Në shembullin (9) në shqipe kemi një marrëdhënie të pastër midis habitës së ligjëruesit *Kur ardhkan të mirat* me një kusht të plotësuar *ardhkan menjëherë*. Fuqia e habitës në shqipe është e përqëndruar më së shumti në format gramatikore të habitores *ardhkan, ardhkan*. Duket që në kthimin në gjermanishte gjuha tregohet e zhdërvjellët duke futur në valle disa aktorë: ajo ngërthen forma gramatikore të së tashmes dëftore *kommt, kommt*, intonacionin, por përpos këtyre elementeve, angazhon edhe pjesëzat *schon, aber* të cilat luajnë një rol vendimtar në krijimin e atmosferës së habitës dhe për të kthyer në këtë mënyrë shumë mirë fjalinë e shqipes në gjermanishte duke patur kujdes dhe mjeshtërinë në pengimin e rrjedhjeve gramatikore. Si rezultat, midis dy gjuhëve kemi përjasje në nivelin semantik, stilistik dhe atë sintaksor.

Habitoiren me komente në të tashmen e hasim më shpesh në fjali me nuanca ironike (10), në pyetje polemike, në fjali të tipit thashetheme, por jo vetëm, ajo mund të haset përmes një mendimi të shprehur, të përsëritur. Në fjalitë habitore me komente dallohen rastet në ligjëratën e zhdrejtë (10) dhe në atë të drejtë (11). Forma e habitores në ligjëratën e zhdrejtë mund të ruhet ose jo, kur kthehet në ligjëratën e drejtë, sepse folësi i parë në rastin e parë shpreh një element të habitës, ndërsa në të dytin nuk është i habitur folësi i parë, por ai i dytë³¹⁰. Vlera e habitores në përdorime të ligjëratës së zhdrejtë mund të lidhet me habinë apo me dyshimin (10) e ligjëruesit mbi vërtetësinë e asaj që ai po tregon.

(10)

*Mjekët shpresonin që do të shërohej, por ne s'kishim dëgjuar kurrë që kanceri u shëroka*³¹¹.
(*Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 172*)

Die Ärzte hoffen, dass sie gesund wird, aber wir haben noch nie gehört, dass Krebs geheilt worden ist. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 174)

(11)

*Me sa duket, nuk paskeni*³¹² *për të mësuar kurrë!* (*Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 156*)

Sie scheinen es nie zu lernen. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 157)

³¹⁰ Po aty, f. 154-155.

³¹¹ Përkthyesi Robert Shvarc përdor formën *shërokëka*; për arsye saktësimi gramatikor kemi përdorur formën *shëroka*.

³¹² Përkthyesi Robert Shvarc përdor formën *paskërkeni*; për arsye saktësimi gramatikor kemi përdorur formën *paskeni*.

Në shembullin (10) folja në habitore *u shëroka* bart nuancën e habisë, vlera kuptimore e dyshimit dhe ironisë plotësohet duke e ndërtuar kuptimin e foljes në kuadër të kontekstit. Fjalja fillon me një mendim të personave të tretë, të mjekëve *Mjekët shpresonin që do të shërohej* për t'u pasuar nga një pjesë e dytë e cila fillon me lidhëzen kundërshtore *por* - me anë të kësaj lidhëze ligjëruesi kërkon të shprehë habinë dhe ironinë e tij mbi atë çka kanë thënë mjekët. Duhet të pranojmë që shembulli në gjermanishten orgjinale na ofron një tabllë me nuanca të zbehta habie duke mos e përçuar të njëjtën forcë emocionale si në kthimin në shqipe - këtu gjuha ka prirjen të tregojë më shumë diçka të vërtetë, se sa të shprehë dyshimin e ligjëruesit, vetëm nëse intonacioni i tij do të jetë aq pranë dyshimit, sa të përmbushë hendekun gjuhësor të krijuar. Ndryshe qëndron çështja në shembullin (11): në shqipe është e qartë, fjalja në habitore e arrin menjëherë qëllimin e saj, pjesërisht me anë të foljes në habitore *paskeni* e pjesërisht përmes kontekstit. Që në hyrje, autori përdor togfjalëshin *Me sa duket*, i cili në vetvete shpesh bart nuanca ironie, siç është edhe rasti ynë. Ironia e shprehur në fjali organizohet jo e shkëputur, por në kuadrin e kontekstit – është marrëdhënia e fjalëve që na transmeton ironinë e folësit të gërshetuar me mllef, gjë të cilën folja e vetme nuk mund ta realizojë. Fjalja në gjermanishten orgjinale shprehet me folje në mënyrën dëftore, por kjo zgjedhje gramatikore nuk përbën rëndësinë vendimtare për realizimin e ironisë - është pikërisht karakteristika kuptimore e foljes *scheinen* me tiparin e saj mosbesues dhe ironik e cila bart peshën dhe meritën kryesore të shprehjes së ironisë së ligjëruesit.

(12)

Si?! Unë nuk u pyetkam fare?

Wie?! Ich werde gar nicht gefragt?

Në shembullin (12) folja në shqipe *u pyetkam* është në të tashmen habitore në diatezën pësore dhe shpreh habinë e ligjëruesit. Kthimi në gjermanishte realizohet me folje në të tashmen dëftore në diatezën pësore *werde gefragt*, duke na ofruar përjasje kuptimore, porse të pjesshme morfologjike. Ky përdorim na tregon mundësinë e shtrirjes së kuptimit të të shprehurit të habisë në gjermanishte në diatezën pësore.

4.1.3. Koha e pakryer

E pakryera e habitores përdoret zakonisht për të shprehur habinë (13), dyshimin, mospajtimin etj. të folësit për një veprim të caktuar, që vazhdonte ende në një çast të caktuar të së shkuarës³¹³. Midis katër kohëve së habitores në shqipe e pakryera e ka më të ngushtë spektrin e përdorimit. E megjithatë ajo e ka të qartësuar mirë pozicionin e saj dhe sinjalizon të paktën dy nivele kohësh: α) habi në kohën e tashme (në momentin e ligjërit) për një veprim që ka ndodhur në të shkuarën; β) habi e ndodhur në të shkuarën (p.sh. në ligjëratën e zhdrejtë)³¹⁴.

(13)

Në fillim me habi, pastaj me mllëf e së fundmi me mospërfillje vumë re që, me sa dukej, nuk qenkësh vendimtare intelligenca, por furça e këpucëve, nuk u përfillka mendimi, por sistemi, nuk paskësh rëndësi liria, por stërvitja. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 27)

Zuerst erstaunt, dann erbittert und schließlich gleichgültig erkannten wir, dass nicht der Geist ausschlaggebend zu sein schien, sondern die Wichtsbürste, nicht der Gedanke, sondern das System, nicht die Freiheit, sondern der Drill. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 25)

Në shembullin (13) foljet *qenkësh*, *paskësh* në shqipe janë në të pakryerën habitore. Ligjëruesi përshkruan gradualisht habinë e tij në rritje mbi çështje të cilat ai deri më parë i konsideronte ndryshe nga ç'ishin paraqitur tani në këtë realitet lufte. Në tekstin original në gjermanishte fjalia jepet me anë të “*preteritumit dëftore + infinitiv me zu + intonacion*” (*zu sein schien*). Mendojmë se vlerat kuptimore të habitës janë të njëjta me ato në shqipe duke konsideruar edhe rolin e intonacionit të duhur.

³¹³ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Tiranë, 2002, f. 319.

³¹⁴ Për këtë shih: Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 156.

4.1.4. Koha e kryer

E kryera e habitores përdoret për të shprehur habinë, dyshimin, mospajtimin etj. të folësit për një veprim të përfunduar, që nuk i ka shkëputur lidhjet me çastin e ligjërimit³¹⁵ (14). Përsa i përket përdorimeve të habitores në të kryerën ajo paraqitet afërsisht në të njëjtin spektër si në të tashmen e habitores. Pasqyra e shfaqjes së habitores midis rasteve në të tashmen dhe ato në të kryerën kanë një ngjashmëri të habitshme midis tyre³¹⁶.

(14)

Nuk e paskeni gjetur? (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 85)

"Habt ihr ihn nicht gefunden?" (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 82)

(15)

Shnir, - rënkoi ai, - habitem sa shumë paskeni menduar për këtë gjë. (Me syrin e një kllouni, Heinrich Böll, f. 125)

"Schnier", sagte er matt, "ich bin erstaunt, wie viel Sie über die Sache nachgedacht haben." (Ansichten eines Clowns, Heinrich Böll, Seite 101)

Në shembullin (14) në shqipe folja *paskeni gjetur* është në të kryerën habitore. Në këtë përdorim duke marrë në konsideratë kontekstin, shprehemi se folja bart nuancën e dyshimit. Në gjermanishten origjinale kjo fjali shprehet me anë të foljes në të kryerën dëftore *Habt gefunden* të shoqëruar me intonacionin me nuancë dyshimi, i cili luan rolin vendimtar gramatikor për realizimin e habisë. Në shembullin (15) folja në shqipe *paskeni menduar* është në të kryerën habitore dhe shpreh hapur habinë e folësit të gërshetuar me mospajtimin e tij. Në mbështetje të binomit *habi + mospajtim* janë dhe dy elementë shtesë: folja *habitem*, e cila me kuptimin e saj semantik të habisë e përforcon kuptimin e ndërtimit foljor në habitore, dhe folja *rënkoi*, e cila i jep nuancën e mospajtimit. Në gjermanishten origjinale *habia* dhe mospajtimi i ligjëruesit janë të shpërndara në fjali: përqëndrimi i habisë gjendet në togfjalëshin me kuptimin semantik të habisë *ich bin erstaunt (jam i habitur)*. Ndërsa folja korresponduese e habitores në shqipe *paskeni menduar, nachgedacht haben* është në të kryerën dëftore dhe ka rol minimal në shprehjen e habisë. Ngarkesa emocionale që transmetojnë shembujt (14) dhe (15) në shqipe është më e fuqishme se ajo në gjermanishte; realizimi gjuhësor i shprehjes së

³¹⁵ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 320; Shaban Demiraj, *Morfologji e gjuhës së sotme shqipe*, II, Tiranë, 1970, f. 230; M. Celiku, M. Karapinjalli, R. Stringa, *Gramatika praktike e gjuhës shqipe*, Botimet Toena, Tiranë, 2004, f.169.

³¹⁶ Për më shumë shih: Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 155-156.

habisë në këto shembuj në gjermanishte është i ulët.

4.1.5. Koha më se e kryer

Më se e kryera e habitores përdoret për të shprehur habinë, dyshimin, mospajtimin etj. të folësit për një veprim që është përfunduar para një çasti të caktuar të së shkuarës³¹⁷. Habia e shprehur nga folësi paraqitet si e shkuar në momentin e ligjërimit³¹⁸ (16).

(16)

Flitej se atje, në atdhe, e pati tepruar me ca rekrutë të rinj në fushën e stërvitjes; por midis tyre na paskësh qëlluar edhe i biri i një ministri. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 72,73)

Er soll zu Hause ein paar junge Rekruten zu kräftig im Sturzacker gehabt haben. Ohne dass er es wusste, war der Sohn des Regierungspräsidenten dabei. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 70)

Në shembullin (16) folja në shqipe *paskësh qëlluar* është në më se të kryerën habitore dhe mjafton vetëm ky element gramatikor, që të ndjehet habia e folësit mbi praninë e djalit të një ministri në fushën e stërvitjes. Fjalja në gjermanishten origjinale është rezultat i kombinimit të një sërë elementesh: folja modale *sollen* (*duhet*) e cila parapregatit terrenin për të vazhduar me fjalinë e dytë, ku kemi folje në të pakryerën dëftore *war*. Ligjërimi shoqërohet me intonacionin përkatës duke i dhënë fjalisë nuanca të habisë, edhe pse ato janë të zbehta. Në këtë përdorim nuk mendojmë se mund të flitet për përjasje midis dy gjuhëve.

4.1.6. Shprehja e habisë në gjermanishte

Në mungesë të një mënyre habitore të mirëfilltë në gjermanishte për të shprehur habinë apo ironinë e folësit përdoren një kompleks mjtesh gramatikore morfologjike (mënyra dëftore e

³¹⁷ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 320; Shaban Demiraj, *Morfologji e gjuhës së sotme shqipe*, II, Tiranë, 1970, f. 230; M. Celiku, M. Karapinjalli, R. Stringa, *Gramatika praktike e gjuhës shqipe*, Botimet Toena, Tiranë, 2004, f.169.

³¹⁸ Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 157.

ajo lidhore), format epistemike të foljeve modale [*sollen, müssen (duhet), möchten (dëshiroj)*], mjete sintaksore (intonacioni), semantike [ndërtime me foljen *scheinen (duket)*, e cila bart në kuptimin e saj nuancën e habisë, ndërtime me mbiemrin *offenbar (e dukshme)* apo ndajfolje, si: *angeblich/anscheinend, plötzlich, gerade, unvermuteter Weise (me sa duket, papritur, sapo, në mënyrë të papritur)*] apo mjete leksikore [pjesëza modale ose siç quhen në gjermanishte *Abtönungspartikeln*³¹⁹: *ja, eigentlich, schon, aber, doch, wohl, ruhig, plötzlich, gerade, ach so (në të vërtetë, tashmë, por, posi, qetësisht, papritur, madje, ah kështu)*], shenjat e pikësimit (pikëçuditëse)³²⁰.

Më lart kemi folur mbi përdorimet kryesore të habitores në shqipe (të shprehurit e ndjenjës së habisë të folësit, dyshimit, mospajtimit apo ironisë së tij, në ligjëratën e zhdrejtë). Paraqitjen e mjeteve gramatikore që ngërthen gjermanishtja për të shprehur habinë do ta orientojmë pikërisht mbi këto shina përdorimi.

Për të shprehur habinë në gjermanishte kryesisht kemi përdorime me mënyrën dëftore (1, 2, 17, 18, 22, 26, 27 etj.). Gama e përdorimit të dëftores në struktura të habisë në gjermanishte është tejet e gjerë duke fituar dukshëm terren ndaj mjeteve të tjera. Në rast se duam të shprehim habi me nuanca ironie apo dyshimi atëherë gjermanishtja ngërthen përpos ndërtimeve me dëftore (11, 14, 26, 27) edhe struktura gramatikore të lidhore (25, 28). Gjithashtu ironia apo mospajtimi në gjermanishte shprehen edhe me ndërtime me folje modale (24, 28), me foljen *scheinen (duket)* (11) apo ndërtime me ndajfoljet *scheinbar/anscheinend (me sa duket)*, ndërtime me mbiemrin *offenbar (e dukshme)*. Realizimi i shprehjes emocionale të habisë së ligjëruesit arrihet si ndërveprim i disa elementeve: foljeve, intonacionit dhe (jo gjithmonë) prania e pjesëzave modale, të cilat duke hyrë në kombinim me foljen dhe intonacionin e duhur kompletojnë shprehjen e habisë (17).

Shprehja e habisë: Hecer (Hetzer) shprehet se gjermanishtja përdor pjesëzat modale, si p.sh.: *ja, denn, doch (ja, po, posi)* për të shprehur habinë e folësit³²¹. Të njëjtin mendim mbi përdorimin e pjesëzave modale ndan edhe Ismajli, e cila përmend këtu edhe përdorimet e

³¹⁹ Termi *Abtönungspartikeln* ose pjesëzat modale është përdorur për herë të parë nga Weydt (Hentschel und Weydt, 1990:280). Pjesëzat modale nuk sjellin asnjë informacion të ri në fjali. Ky koncept nënkupton që përmes këtyre pjesëzave do të ngjyroset diçka, pra një mendimi do t'i jepet ngjyrim modal. (Karin Schwiiggerr, 2006/07:4) Ato gjejnë përdorim të shpeshtë në gjuhën e folur. Shumica e studiuesve dhe gramatikanëve i pranojnë pjesëzat modale si njësi të pastra të mesfushës të fjalisë, me pozicione relativisht të lira. Në më të shumtën e rasteve ato janë të patheksuara. (Ulrike Hammer, 2005:3/4).

³²⁰ Sarah Gretler, *Die Verbale Kategorie Evidenz im Albanischen und Türkischen*, Zürich, 1987, f. 11. & Edisa Shahini, *Der albanische Admirativ im Vergleich mit den Modi des Deutschen*, Diplomarbeit, University of Vienna. Philologisch-Kulturwissenschaftliche Fakultät, Wien, 2009.

³²¹ Cit. nga Sarah Gretler, *Die Verbale Kategorie Evidenz im Albanischen und Türkischen*, Zürich, 1987, f. 11.

strukturave foljore të dëftores dhe intonacionin³²². Mbështesim mendimet e Hecerit (Hetzer) dhe të Ismajlit, por duke shtuar edhe rolin e foljeve modale, si p.sh.: *können* (mund), rradhën e pjesëzave modale që gjejnë përdorim në shprehjen e habisë së folësit: *eigentlich, schon* (në të vërtetë, tashmë), si dhe të shenjave të pikësimit (pikëçuditëse, pikëpyetje). Ndodh që fuqia shprehëse e pjesëzave modale është aq e madhe, sa që ato mund të përmbushin thujtë të vetme misionin e shprehjes së habisë në gjermanishte (19).

(17)

Das ist dann ja alles für uns! (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 10)

*Pra, **qenkan** të gjitha për ne! (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 12)*

(18)

Manchmal sitze ich mit einem von ihnen in dem kleinen Wirtsgarten und versuche, ihm klar zu machen, dass dies eigentlich schon alles ist: so still zu sitzen. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 151, 152)

*Nganjëherë ndodh që të rri me ndonjërin prej tyre në kopshtin e vogël të restorantit dhe të përpiqem t'ia bëj të qartë se, në fund të fundit, kjo **qenka** e gjitha: të rrish kështu i qetë. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 151)*

(19)

“Ach so”, sagt die Schwester, “dazu braucht er doch nicht seinem Gipsverband aus dem Bett zu klettern” (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 220)

*- Ah, kështu na **qënka** puna! – ia bën murgesha, - për kaq gjë s'është nevoja të kërcejë nga shtrati me këmbën në allçi. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 214)*

(20)

Wie das bisschen verkürztes Bein? (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 247)

*“Qysh? Po e **bëkeni** kaq të madhe, pse e paskeni njëren këmbë pak më të shkurtër?!” (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 241)*

(21)

Nun rückt etwas wieder von draußen näher; - wenn Essen geholt werden soll, kann es ja nicht so schlimm sein, denken die Rekruten. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 97)

³²² Blertë Ismajli, *Verbmodi im Deutschen und Albanischen im Vergleich, Alles Mögliche: Sprechen, Denken und Schreiben des (Un)Möglichen*, Verlag Königshausen & Neumann GmbH, Würzburg, 2014, f. 172.

*Shenjë e mirë kjo – që na sjellin ushqim, kjo do të thotë se punët nuk **qenkan** edhe aq keq.*
(Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 99)

(22)

Hurra, ich habe den ersten Platz gewonnen!

*Urraa, **paskam dalë** i pari në konkurs!*

Në shembullin (17) në shqipe habia e folësit nuk është shpërthyes, por e pranishme dhe e qetë, më tepër konstatuese. Fjalja në gjermanishten origjinale jepet përmes mënyrës dëftore të shoqëruar me pjesëzat modale *eigentlich* dhe *schon*. Ana emocionale e shprehur në shqipe përmes formës foljore të habitores *qenka* arrihet të ndjehet njësoj edhe në gjermanishte. Gjithashtu në shembullin (18) në shqipe habia e shprehur nuk është e mirëfilltë emocionale – ajo çka do të shprehë ligjëruesi ngjason me një konstatim të shoqëruar me një nuancë të zbehtë habie. Të njëjtën ndjesi gjuhësore e gjejmë edhe në gjermanishte – forca e pjesëzës modale e mbulon vendin bosh të foljes duke arritur në realizim gjuhësor. Në shembullin (20) habia është e shpërndarë në kontekstin letrar, e kombinuar me intonacionin e folësit dhe në fund vulolet me pikëpyetje. Mungesa e një foljeje nuk e cënon përcjelljen e anës emocionale të habisë së folësit: këtu kemi përqasje në përdorimet modale në të dyja gjuhët. Në shembullin (21) habia shprehet me strukturën foljore “*folje modale + foljen sein në infinitiv*” duke shtuar edhe rolin e pjesëzës modale *ja*. Duhet të themi që edhe në shembullin në shqipe habitorja nuk është në daljet e saj më të fuqishme – nuancat e saj janë në harmoni me nuancën e realitetit. E megjithatë një zëvendësim me dëftoren në shqipe do të përbënte dëm gjuhësor duke çuar në humbjen e habisë. Logjikën, që përderisa në gjermanishte përdorim dëftoren dhe kemi realizim të habisë, përse nuk mund të veprojmë në të njëjtën mënyrë edhe me shqipen nuk e gjejmë me vend, pasi gjuhë të ndryshme jetojnë e veprojnë në forma e mënyra deri diku edhe të personalizuar. Daljet e habitores si në shembullin (22) në shqipe *paskam dalë* janë goditëse duke na dhënë shpërthime emocionale të habisë së bashku me ato të gëzimit. Vlerat për këtë funksion të habitores nuk i takojnë vetëm foljes, por edhe intonacionit karakteristik euforik dhe pasthirmës *Urraa*. Kthimi në gjermanishte realizohet përmes foljes në të kryerën dëftore *habe gewonnen* dhe arrin të transmetojnë emocionet që ndjehen në shqipe po në të njëjtën mënyrë e shkallë ndërveprimi me intonacionin tipik dhe pasthirmën *Hurra*, si elementi kryesor i shprehjes së habisë së ligjëruesit.

Në fjalitë e mëposhtme mund të vëzhgohet lehtësisht roli i intonacionit³²³ në shprehjen e habisë në gjermanishte duke e bërë të dukshëm dallimin midis një fjalie në mënyrën dëftore, e cila shpreh një konstatim (23a) dhe një fjalie gjithashtu në mënyrën dëftore, por që shpreh habi (23b). Në fjalinë me shprehje habie si shenjë pikësimi vendoset pikëçuditësja (23).

(23)

a) *Mënyra dëftore*: Es regnet. (Bie shi.)

b) *Habi e shprehur*: Es regnet! (Bika shi!)

Të dy shembujt (23a, 23b) në gjermanishte janë fjali në mënyrën dëftore, porse përmbillen me shenja të ndryshme pikësimi dhe karakterizohen nga intonacioni i ndryshëm. Janë pikërisht këto dy elementë shtesë: pikëçuditëse dhe intonacioni i duhur gramatikor, të cilët mundësojnë të shprehurin e habisë në gjermanishte, shembull i cili në shqipe jepet me mënyrën habitore.

Daljet e habisë në ligjëratën e zhdrejtë paraqiten disi më pak të komplikuar në gjermanishte se sa shprehja e habisë së ligjëruesit. E tërë çështja këtu qëndron në dhënien e një informacioni të thënë nga dikush tjetër – mbështesim mendimin e Hecerit (Hetzer) mbi përdorimin e foljes modale *sollen*³²⁴, e cila në fjali mund të shoqërohet me ndajfoljen *angeblich*³²⁵ (24) e gjen përdorim edhe në shembujt kur shprehet dyshim, mospajtim apo ironi e folësit. Gjithashtu jemi dakord edhe me mendimin e Ismajlit, se për daljet e habitores së shqipes në ligjëratën e zhdrejtë në gjermanishte përdoren struktura të dëftores dhe të lidhore, më saktë të Konjunktiv I³²⁶ (25). Në shembujt e përzgjedhur nga Buholz dhe Fidler³²⁷ (Buchholz & Fiedler) del qartë që gjermanishtja përdor dëftoren, lidhoren (Konjunktiv II) dhe foljet modale: *sollen*, *wollen* (duhet, dua). Përdorimi i dëftores bart në vetvete një dozë të besimit mbi atë që po flasim, ndërsa përdorimet me strukturë me folje modale apo me lidhore kanë një hije mosbesimi – edhe pse në të dyja rastet folësi në shqipe

³²³ Intonacioni luan një rol me rëndësi si mjet analitik në rrafshin sintaksor të gjuhës. Dimë se intonacioni i përfunduar është një tipar i domosdoshëm i fjalisë, pa të cilin s'mund të ketë fjali. Ndryshimi i skemës intonacionore shërben shpesh si mjet për shprehjen e modalitetit të fjalisë. Kështu, duke ndërruar intonacionin, një fjali me po atë përbërje leksikore dhe me po atë ndërtim gramatikor mund të shndërrohet nga dëftore në pyetëse: **Dëftore**: *Deti është larg prej këtej*. **Pyetëse**: *Deti është larg prej këtej?* (Memushaj, 2004:227)

³²⁴ *Sollen* (duhet) është një nga 6 foljet modale në gjermanishte. Me anë të kësaj folje shprehet: kërkesë, udhëzim, këshillë apo plan. Gjithashtu edhe diçka që mendohet se mund të ndodhë në të ardhmen apo kur folësi nuk mund të garantojë të vërtetën e një lajmi apo informacioni të dëgjuar nga dikush tjetër (Engel, 2004:147). Kjo folje modale ka një përdorim shumë të gjerë në gjuhën gjermane.

³²⁵ Cit. nga Sarah Gretler, *Die Verbale Kategorie Evidenz im Albanischen und Türkischen*, Zürich, 1987, f. 11.

³²⁶ Blertë Ismajli, *Verbmodi im Deutschen und Albanischen im Vergleich, Alles Mögliche: Sprechen, Denken und Schreiben des (Un)Möglichen*, Verlag Königshausen & Neumann GmbH, Würzburg, 2014, f. 173-4.

³²⁷ Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 158-159.

në momentin që vendos të përdorë format e habitores distancohet dukshëm nga vërtetësia e informacionit që transmeton. Këtu jemi të mendimit, që megjithë “mundimin” e tij, masa e distancimit është individuale, e cila varet drejtpërsëdrejti nga përfshirja/mospërfshirja e ligjëruesit në situatën për të cilën ai po ligjëron.

(24)

Angeblich soll Alex gestern unsere Nachbarn darüber sprechen gehört haben.

*Me sa duket **paska dëgjuar** dje Aleks fqinjët tanë të flasin për këtë.*

(25)

Angeblich habe er nichts davon gewusst.

*Me sa duket ai nuk **paskësh ditur** asgjë.*

Në shembullin (24) në gjermanishte nisja e fjalisë me ndajfoljen *angeblich* e pasuar nga ndërtimi me foljen modale *soll gehört haben* si dhe e shoqëruar me intonacionin karakteristik na transmeton plotësisht emocionet e shembullit në shqipe me folje në mënyrën habitore. Në shembullin (25) në gjermanishte për të shprehur habinë e tij, ligjëruesi ngërthen elemente të ndryshme gjuhësore, duke e nisur me të tashmen lidhore *habe gewusst*, përdorimi i së cilës i volit për të shprehur dyshimin e gërshetuar me habinë e tij. Me shumë peshë në këtë përdorim është roli i ndajfoljes në gjermanishte *angeblich*, e cila mbart kryesisht kuptimin e mosbesimit, dyshimit duke treguar njëkohësisht edhe qëndrimin personal. Kthimi në shqipe nuk ka nevojë për elemente shtesë – përdorimi i formave foljore të habitores e realizon më së miri shprehjen e habisë së ligjëruesit të gërshetuar me ironi.

Sipas Ismajlit shprehja e dyshimit, mospajtimit apo e ironisë në gjermanishte realizohet përmes foljeve në mënyrën lidhore (Konjunktiv II³²⁸) (28), formave epistemike të foljes modale *sollen* (28), me anë të pjesëzave të ndryshme modale³²⁹, si p.sh.: *ja, aber, eigentlich, etwa, schon, doch, wohl, ruhig*, dhe ndajfoljeve: *angeblich, anscheint, offenbar*. Gjithashtu këtu shtojmë edhe përdorimet e mënyrës dëftore (26), (27) – e cila e kombinuar me pjesëza modale apo ndajfolje krijon një tablo të kompletuar të shprehjes së dyshimit apo ironisë së folësit.

(26)

³²⁸ Autorja Blertë Ismajli në punimin e saj (Ismajli, 2014:173) e ka shënuar Konjunktiv I, por jemi të mendimit se këtu bëhet fjalë për një gabim shtypi duke qenë se shembulli të cilit ajo i referohet përmban folje në Konjunktiv II.

³²⁹ Blertë Ismajli, *Verbmodi im Deutschen und Albanischen im Vergleich, Alles Mögliche: Sprechen, Denken und Schreiben des (Un)Möglichen*, Verlag Königshausen & Neumann GmbH, Würzburg, 2014, f. 173.

"Habt ihr ihn nicht gefunden?" (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 82)

Nuk e **paskeni gjetur**? (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 85)

(27)

Ich habe ihm kein Wort davon erzählt. -Wie, du hast ihm kein Wort davon erzählt?!

Unë nuk i kam thënë asnjë fjalë atij. -Si nuk i **paske thënë** asnjë fjalë?!

(28)

Wie bitte? Das wäre nicht die Wahrheit?! / Das soll nicht die Wahrheit sein?!

Çfarë? Kjo nuk na **qënka** e vërteta?!

Midis tri shembujve në gjermanishte [(26), (27), (28)], (27) dhe (28) distancohen dukshëm nga (26) përse i përket shprehjes së dyshimit. Në shembullin (26) në gjermanishte kemi strukturë me folje në mënyrën dëftore *habt gefunden* dhe mund t'i afrohem shprehjes së dyshimit vetëm me intonacionin e duhur – mungesa e këtij të fundit çon në mosrealizim gjuhësor të shembullit të shqipes në gjermanishte. Në shembullin (27) arrihen të transmetohen emocionet e dyshimit si në shembullin në shqipe falë rolit vendimtar të ndajfoljes *wie (si)*. Në shembullin (28) gjermanishtja e ka më të lehtë ta kryejë misionin e saj përmes formës së lidhore (Konjunktiv II) *wäre* duke na dhënë pastër emocionet e habisë të shprehur me dyshime sikurse në shembullin e shqipes.

4.1.7. Shprehja gramatikore e mënyrës habitore në shqipe dhe format gjegjëse në gjermanishte – ilustrime përmes shembujsh

Koha	Shqipe	Gjermanishte
e tashme	Sa i lehtë qenka kostumi civil! Të duket vetja sikur je, vetëm me të mbathura edhe këmishë! (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 147)	Wie leicht so ein Anzug ist, man hat das Gefühl, als wäre man nur in Unterhosen und Hemd. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 147)
	S'po u besoj syve. Edhe Bëtheri na	(Habi e shprehur me anë të kohës së tashme dëftore + ndajfoljen <i>wie</i> + intonacionin karakteristik të habisë) Ich traue meinen Augen kaum.

	qenka këtu, portieri i shkollës sonë. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 156)	Boettcher ist ja auch da, Boettcher, unser Schulportier. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 157) (Habi e shprehur me anë të kohës së tashme dëftore + pjesëzat modale <i>ja</i> dhe <i>auch</i> + intonacionin karakteristik të habisë)
e pakryer	Në fillim me habi, pastaj me mllef e së fundmi me mospërfillje vumë re që, me sa dukej, nuk qenkësh vendimtare intelligenca, por furça e këpucëve, nuk u përfillka mendimi, por sistemi, nuk paskësh rëndësi liria, por stërvitja. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 27) Po sa i vështirë qenkësh emigrimi!	Zuerst erstaunt, dann erbittert und schließlich gleichgültig erkannten wir, dass nicht der Geist ausschlaggebend zu sein schien, sondern die Wichsbürste, nicht der Gedanke, sondern das System, nicht die Freiheit, sondern der Drill. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 25) (Habi e shprehur me anë të kohës së pakryer dëftore + infinitiv me <i>zu</i> + intonacion) Doch wie schwer war (für ihn) die Auswanderung! (Habi e shprehur me anë të kohës së pakryer dëftore + pjesëzën modale <i>doch</i> + intonacionin karakteristik të habisë + pikëçuditëse)
E kryera	Ashtu! Paskeni ardhur nga fronti? (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 148) Pra, paska shpëtuar gjallë, por krahun e mban në një fashë. (Asgjë	So, Sie kommen von der Front? (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 149) (Habi e shprehur me anë të kohës së tashme dëftore + pjesëzën modale <i>so</i> (atëherë) <i>ashtu</i> + intonacionin karakteristik të habisë + pikëpyetje) ..., er ist also davongekommen, sein Arm liegt in der Binde. (Im Westen

	<i>e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 123)</i>	<i>nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 123)</i> (Habi e shprehur me anë të kohës së kryer dëftore + pjesëzën <i>also</i> + intonacionin karakteristik të habisë)
më se e kryer	<i>Flitej se atje, në atdhe, e pati tepruar me ca rekrutë të rinj në fushën e stërvitjes; por midis tyre na paskësh qëlluar edhe i biri i një ministri. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 72,73)</i>	<i>Er soll zu Hause ein paar junge Rekruten zu kräftig im Sturzacker gehabt haben. Ohne dass er es wusste, war der Sohn des Regierungspräsidenten dabei. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 70)</i> Kombinim i një sërë elementesh gramatikore: folja modale <i>duhet</i> , e cila përgatit terrenin për fjalinë e dytë dhe e vesh me petkun e habisë; (Habi e shprehur me anë të kohës së pakryer dëftore + intonacionin karakteristik të habisë)

KREU V

MËNYRA LIDHORE

5.1. Mënyra lidhore në shqipe dhe gjermanishte

Termet *mënyrë lidhore* në shqipe dhe *der Konjunktiv* në gjermanishte u përgjigjen termës latine *modus coniunctivus*³³⁰, që do të thonë i lidhur, i varur. Siç e kemi përmendur edhe më lart në këtë punim gjatë zhvillimit historik gjuhësor gjermanishtja ka pësuar një "rurdhje" të numrit të mënyrave - nga katër mënyra mbetën tri, duke i bashkëngjitur mënyrën lidhore atë dëshirore, ndyshim i cili ka prekur edhe gjuhë të tjera indoevropiane. Ndërsa shqipja shfaqti tendencë në drejtim të kundërt, duke u zgjeruar dhe paraqitur më qartë mënyrat e saj. Evoluimi gjuhësor bëri që, mënyra lidhore në të dyja gjuhët të pësojë ndryshime të thella duke u riorganizuar, si në aspektin e përdorimit ashtu edhe në atë të ndërtimit. Pas dëftores, lidhorja është mënyra më e përdorur, duke ofruar një larmi kuptimesh modale dhe një sistem foljor mjaft të pasur. Dëftorja dhe lidhorja janë kategori përbërëse sintaksore të cilat i shërbejnë sinjalizimit të modalitetit, dëftorja luan formalisht dhe semantikisht rolin e një kategorie të pashenjëzuar. Andaj është më e lehtë të përpunohen veçoritë e lidhore përballë dëftores, sesa të karakterizohen dëftorja dhe lidhorja gjithnjë pozitive për veten³³¹. Karakteristike për format foljore të lidhore është prania paralele si e kuptimit kohor ashtu edhe atij modal, i cili duhet thënë që është mjaft i spikatur. Ndryshe nga dëftorja, lidhorja është mënyrë e shenjëzuar³³².

³³⁰ Për shqipen: Shaban Demiraj, *Morfologji e gjuhës së sotme shqipe*, II, Tiranë, 1970, f. 207.

³³¹ Peter Eisenberg, *Grundriß der deutschen Grammatik, Band 2: Der Satz, 2. Überarbeitete und aktualisierte Auflage*, Verlag J. B. Metzler, Stuttgart – Weimar, 2004, f. 114.

³³² DUDEN, *Die Grammatik, Unentbehrlich für richtiges Deutsch 7*, völlig neu erarbeitete und erweiterte Auflage, Duden Band 4, Dudenverlag, Mannheim, Leipzig, Wien, Zürich, 2005, f. 522.

Sipas “Gramatikës së gjuhës shqipe I” me anë të mënyrës lidhore në shqipe shprehet kryesisht modaliteti i mundësisë³³³. Në shumicën e përdorimeve të saj lidhorja shpreh modalitetin e pavërtetësisë, duke treguar një veprim të pavërtetë, joreal, një veprim të menduar nga folësi, i cili mund të paraqitet si i mundshëm, i domosdoshëm, i hamendshëm, i dëshiruar ose i diktuar nga vullneti i tij³³⁴. Në gjermanishte lidhorja konsiderohet si mënyra e mundësisë - mënyra e ligjëratës së zhdrejtë dhe e kushteve të supozuara apo joreale³³⁵, e përdorur për të shprehur: ligjëratën e zhdrejtë, jorealitetin/mundësinë, një kërkesë apo dëshirë. Kur shkrimtari a folësi zgjedh të përdorë lidhoren ai e vesh përmbajtjen e thënies me një ngjyrosje modale dhe shpreh kështu një "qëndrim subjektiv"³³⁶. Kur flasim për lidhoren e kapërcejmë murin e saj si mënyrë që përdoret në këtë apo atë kohë duke u fokusuar në modalitetet e shumta të saj, në shumëngjyrat dhe faqet që ajo na tregon. Si në shqipe edhe në gjermanishte vërehen jo rrallëherë përdorime sinonimike të mënyrës lidhore, përkatësisht me kuptimin modal të dëshirores apo urdhërores. Këtë shtrirje përdorimi mënyra lidhore - kryesisht e tashmja e lidhore - ia dedikon veshjes të saj me një gamë të tërë kuptimesh modale të afërta dhe të ndërkëmbyeshme midis tyre³³⁷. Megjithatë përdorimet e lidhore në të dyja gjuhët me kuptimin e urdhërores janë zbehur disi me kalimin e kohës dhe nuk mund të konsiderohen më si pjesë të funksioneve kryesore të saj³³⁸. Në shqipen e dokumentuar lidhorja përdoret më shumë në fjali të nënrenditura, por edhe në fjali kryesore, kryesisht në format e së tashmes së lidhore³³⁹. Të njëjtën konstatim shprehim edhe për gjuhën gjermane. Në shqipen standarde lidhorja zëvendëson paskajoren³⁴⁰. Në dialektin jugor të shqipes, si dhe në gjuhën letrare shqipe, ku nuk ka një paskajore në kuptimin e plotë të termit, lidhorja njeh një përdorim të

³³³ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 321.

³³⁴ Fatmir Agalliu, *Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1988, f. 18.

³³⁵ Renate Luscher - Roland Schäpers, *Deutsch 2000, A Grammar of Contemporary*, Max Hueber Verlag, 1998, f. 34.

³³⁶ Vepër e cituar: Hadumod Bußmann, *Lexikon der Sprachwissenschaft 3. Aktualisierte und erweiterte Auflage*, Kröner, Stuttgart, 2002, f. 306.

³³⁷ Për këtë shih: Shaban Demiraj, *"Rreth kategorive gramatikore të mënyrës dhe të kohës në gjuhën shqipe"*, SF 3, 1977, f. 111.

³³⁸ Për gjermanishten: DUDEN, *Die Grammatik, Unentbehrlich für richtiges Deutsch 7., völlig neu erarbeitete und erweiterte Auflage*, Duden Band 4, Dudenverlag, Mannheim, Leipzig, Wien, Zürich, 2005, f. 522.

³³⁹ Shaban Demiraj, *Gramatika historike e gjuhës shqipe*, II, Tiranë, 2002. Vep. e cituar nga M. Xhaferaj, 2012.

³⁴⁰ Emine Teichmann, *Handbuch Grammatik der albanischen Sprache Teil I*, GRIN Verlag, 2015, f. 26.

dendur e të larmishëm³⁴¹. Të shprehurit e lidhore në disa funksione të cilat zëvendësohen me anë të infinitivit (1) e gjejmë edhe në gjermanishte – në shembullin e mëposhtën, folja *sehen* është në infinitiv, ndërsa folja *të shikosh* në shqipen origjinale, duke iu referuar kontekstit, shpreh një udhëzim:

(1)

Të shikosh. (*Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 17*)

Sehen. (*Chronik im Stein, Ismail Kadare, S.21*)

Në gjermanishte lidhorja degëzohet në *Konjunktiv I*³⁴², i emërtuar edhe si "Konjunktiv der indirekten Rede" apo "Konjunktiv der fremden Meinung" (lidhore e ligjëratës së zhdrejtë apo lidhore e mendimit të të tretëve) dhe *Konjunktiv II*³⁴³, i emërtuar edhe si "Konjunktiv irrealis" ose "Konjunktiv der Nichtwirklichkeit"³⁴⁴ (lidhore joreale ose lidhore e së pavërtetës). Ndryshimi midis Konjunktiv I dhe Konjunktiv II në gjermanishte është i madh - secili ka fushën e vet të veçantë të përdorimit dhe dy lidhoret nuk janë të këmbyeshme me njëra-tjetrën, pra ato nuk mund të zëvendësojnë njëra-tjetrën, me përjashtim të disa përdorimeve, që do t'i përmendim në vijim. Që të dyja lidhoret hasen në fjali kryesore dhe të varura. Përsa i përket zonës së funksioneve të Konjunktiv I dhe Konjunktiv II gjejmë një pikë të përbashkët, përdorimin e tyre në ligjëratën e zhdrejtë, secili nga këto ka një kuptim parësor dhe disa nënkuptime të dyta. Kuptimi kryesor i Konjunktiv I, ashtu siç mund të kuptohet edhe nga emërtimet e tij të dyta, është ai i dhënies së ligjëratës së zhdrejtë. Kuptimet e dyta të Konjunktiv I janë: të shprehë një veprim si joreal, në fjalitë krahasuese joreale Konjunktiv I mund të këmbëhet me Konjunktiv II, dhe të sinjalizojë që një veprim duhet të jetë real. Kuptimi kryesor i Konjunktiv II është të shprehë dëshira joreale. Kuptimet e dyta të Konjunktiv II janë tre: të japë ligjëratën e zhdrejtë, kur kjo nuk është e mundur të realizohet përmes Konjunktiv I, të shprehë fjali kushtore joreale dhe të ndërtojë fjali mirësjelljeje³⁴⁵.

Parë nga ndërtimet gramatikore, Konjunktiv II zëvendëson Konjunktiv I atëherë kur forma gramatikore e foljes në të tashmen e Konjunktiv I përputhet me preteritumin dëftore - kjo ndodh me foljet e buta, pasi foljet e forta kanë forma të qarta në të tashmen lidhore. Në

³⁴¹ Fatmir Agalliu, *Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1988, f. 17.

³⁴² Konjunktiv Präsens, në shqipe: e tashme lidhore.

³⁴³ Konjunktiv Präteritum, në shqipe: preteritumi lidhore.

³⁴⁴ Vjosa Morina, *Magisterarbeit "Modus und Tempus im Deutschen und Albanischen"*, Wien, 2009, f. 59.

³⁴⁵ Për këtë shih: Ulrich Engel, *Deutsche Grammatik*, IUDICIUM Verlag GmbH München, 2004, f. 217-221.

gjermanishten e folur Konjunktiv I nuk luan rol të rëndësishëm duke qenë se përdorimet e tij janë të vakta. Gjermanishtfolësit e kanë më të lehtë që në komunikimin e tyre të përditshëm të përdorin format gramatikore të përbëra të Konjunktiv II edhe atëherë, kur vetë gramatika orienton drejt përdorimeve të Konjunktiv I. Jemi të mendimit se kjo prirje e përdorimit të Konjunktiv II me anë të foljes ndihmëse *werden*: "*würde + folje kryesore*" ka karakter praktik. Përjashtim këtu bëjnë foljet ndihmëse: *haben (kam)*, *sein (jam)*, *werden (do të)* si dhe foljet *modale* - këto parapëlqehen të përdoren në Konjunktiv I. Të njëjtin fenomen mënjanimi nga Konjunktiv I, edhe pse jo në të njëjtën masë si në gjuhën e folur, e vërejmë edhe në gjuhën letrare - megjithatë kjo tendencë ka të bëjë me stilin individual të shkrimtarit, gjë e cila nuk kalon pa u vënë re në korpuset letrare të zgjedhur për këtë punim shkencor. Ndryshe qëndron çështja në artikujt e gazetave, ku përjashtohet ngërthimi në masë i formave foljore të Konjunktiv II në vend të Konjunktiv I. Me fjalë të tjera, roli i Konjunktiv I është shumë i kufizuar jashtë ligjëratës së zhdrejtë dhe fjalive krahasuese joreale - ai mund të shërbejë edhe për të shprehur një dëshirë, një lutje ose një urdhër, prandaj ndonjëherë quhet edhe *volitiv* (wollend). Përdorimet e tij në fjali kryesore janë të kufizuara³⁴⁶.

Më lart kemi përmendur pjesëzën *të* si tregues karakteristik të lidhore në shqipe. Disa gjuhëtarë, si: Demiraj, Agalliu, Vaigand (Weigand) dhe Sheperi (Sheper) janë të mendimit se në disa përdorime lidhorja shkëputet prej pjesëzës *të*. Në shqipen e sotme, lidhorja pa pjesëzën *të* paraprihet thajse gjithmonë nga fjalëzat *mos* dhe *se mos*. Në shembullin (2) në gjermanishte folja *dazwischenkäme* është në lidhore (në Konjunktiv II). Gjithashtu edhe folja *ndodhë* në shqipe është në lidhore, por në përdorimin e saj pa pjesëzën *të* - fjalia më vete është e ngjyrosur me modalitetin e mundësisë duke shprehur dyshimin e folësit. Pjesëzat *befas/plötzlich* zgjojnë dukshëm interesin tonë duke e drejtuar atë drejt frikës se diçka jo e mirë mund të ndodhë. Megjithatë gjenden edhe përdorime të lidhore në shqipe të shkëputura nga pjesëza karakteristike *të*, madje edhe pa praninë e fjalëzave *mos* dhe *se mos* (3) - folja *rrojmë* është në lidhore: asaj i është paravendosur për emri lidhor *sa* i cili gramatikisht duhet të pasohet nga një folje në lidhore, dhe që këtu së bashku me kontekstin sinjalizojnë habi të ndërthurur me mundësi. Në kthimin në gjermanishte, i realizuar në kuadër të përshtatjes gjuhësore, përkthyesi Rëmi (Röhm) ka përdorur strukturë morfologjike të dëftores me nuancë habie, të mbështetur nga intonacioni ngjitës si element sintaksor, dhe pikëçuditësja.

(2)

³⁴⁶ DUDEN, *Die Grammatik - unentbehrlich für richtiges Deutsch*, Band 4, Dudenverlag, Mannheim, Leipzig, Wien, Zürich, 2005, f. 543.

Befas më zunë të dridhurat, trembem se mos ndodhë gjë. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 198)

*Nun beginne ich plötzlich zu zittern, dass etwas **dazwischenkäme**. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 201)*

(3)

*Sa **rrojmë** dëgjojmë. (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 188)*

Was es nicht alles gibt! (Chronik im Stein, Ismail Kadare, S.220)

Në të dyja gjuhët lidhorja përdoret në disa tipe fjalish të nënrenditura, por edhe në fjali kryesore. Kur ligjëruesi/shkrimtari përdor mënyrën lidhore, ai shpreh një qëndrim subjektiv dhe ligjërimi/fjalja mbart ngjyrosje³⁴⁷. Larmia e ndërtimeve me lidhore në shqipe i atribuohet edhe kërkesës morfologjike të disa foljeve apo togfjalëshve në shqipe, të cilët duhet domosdoshmërisht të pasohen nga një folje në lidhore. Këtë veçori gjuhësore të shqipes e hasim edhe në gjermanishte, por me ndryshimin, që te kjo e fundit shpesh kërkohet një folje në infinitiv (*Ai duhet të shkojë./Er muss gehen.*).

Me anë të mënyrës lidhore në të dyja gjuhët mund të shprehet: *një urdhër, dëshirë, këshillë, propozim apo domosdoshmëri*. Në përdorime të këtilla lidhorja haset kryesisht në struktura të foljes *jam/sein*, në ndërtime me folje modale: *duhet/sollen, dua/wollen, dëshiroj/möchten, mund/können* etj. apo edhe në ndërtime me folje të plota - këto struktura mund të gjenden në fjali kryesore ose të nënrenditura. Në shqipe përdorime të lidhores për të shprehur një *domosdoshmëri, detyrim, këshillë, propozim, dëshirë, mundësi* apo edhe *një urdhër* realizohen duke i paravendosur strukturës në lidhore foljet modale "*folje modale + strukturë e lidhores*" (unë duhet të shkoj). Këtu dy gjuhët diferencohen nga njëra-tjetra, pasi kthimi në gjermanishte mund të realizohet me ndërtime në dëftore (*ich muss gehen*) ose në lidhore (*ich müsste gehen*) – pra vërtet kemi strukturë me lidhore, porse këto nuk përputhen në të dyja gjuhët: në gjermanishte pas foljes modale vjen një folje në infinitiv. Në gjermanishte gjejmë përdorime të foljeve modale: *mögen, wollen dhe sollen* në vend të ndërtimeve me folje të plota. Struktura gramatikore paraqitet "*folje modale + folje kryesore në infinitiv*" (*ich soll gehen/ich sollte gehen*). Përdorimet mund t'i referohen veprimeve në të shkuarën, në të tashmen ose dhe në të ardhmen. Le t'i shqyrtojmë me rradhë më poshtë përdorimet e mënyrës lidhore në të dyja gjuhët duke i vënë përballë njëra-tjetrës.

³⁴⁷ Emma-Lotta Myllyharju, *Zum Konjunktiv I im Deutschen, Ein Vergleich zwischen der grammatischen Beschreibung und der Sprachwirklichkeit unter besonderer Berücksichtigung der Sprachentwicklung*, Schweden, Juni 2009, f. 7.

1. *Dëshirë e shprehur* - ky përdorim gjen në të dyja gjuhët shtrirje kohore në të tashmen, në të shkuarën dhe në të ardhmen, porse ngjyrimet modale nuk paraqiten të njëjta në kohë të ndryshme. Buholci, Fiedleri (Buchholz-Fiedler)³⁴⁸ dhe Vajnrih (Weinrich) e shohin të shprehurin e dëshirës në kohën e tashme dhe në të ardhme, qoftë kjo në formë urimi apo mallkimi, si përdorim i cili i drejtohet një fuqie ndihmëse për realizimin e saj. Me anë të së tashmes lidhore shprehet një dëshirë e menduar si e realizueshme – kryesisht në kohën e tashme apo të ardhme në gjermanishte, dhe në kohën e tashme në shqipe – ndërsa me kohët e shkuara lidhore (e pakryer, preteritum dhe më se e kryer) shprehet një dëshirë joreale në momentin e ligjëritimit, tashmë e parealizueshme (9). Shprehje të dëshirave apo urdhrave gjenden edhe në tekste të specialitetit matematikë, në udhëzime dhe udhëzues tek recetat mjekësore, në shprehje dhe formula të gatshme gjuhësore³⁴⁹. Përdorime të tilla hasen në fjali kryesore dhe në të varura. Format morfologjike të foljes *mögen*³⁵⁰ në lidhore në gjermanishte janë kthyer në këto përdorime në indikatorët e dëshirave³⁵¹. Në shqipe përdorime të këtilla të foljes përkatëse sikurse *mögen* në gjermanishte nuk i hasim. Ndërtimet me foljen *mögen*, të cilat shprehin një dëshirë në gjermanishte (*Möge er gewinnen!*), gjatë kthimit në shqipe, herë jepen me struktura morfologjike të lidhore (*Uroj të fitojë!*) e herë me ato të dëshirores (*Fitofitë!*). Ndërsa në të pakryerën lidhore në shqipe dhe në preteritumin lidhore në gjermanishte, dëshira e shprehur është joreale nga këndvështrimi i momentit të ligjëritimit³⁵². Shpesh në gjermanishte fjalitë dëshirore në lidhore paraprihen nga lidhëza *wenn* (*sikur*) (5), e cila gjen përdorim duke qenë se me anë të saj shprehet një dëshirë joreale në momentin e ligjëritimit. Në të dyja gjuhët këto fjali mund të shoqërohen edhe me pjesëza karakteristike për fjalitë dëshirore: *doch, nur*,³⁵³ *bloß* (*ah, sikur*), të cilat përmbajnë në vetvete një hamendësim

³⁴⁸ Për këtë shih: Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 134/146.; Harald Weinrich, *Textgrammatik der deutschen Sprache*, Dudenverlag, 1993, f. 265.

³⁴⁹ DUDEN, *Grammatik der deutschen Gegenwartssprache*, Band 4, Dudenverlag, Mannheim, Leipzig, Wien, Zürich, 2001, f. 158.

³⁵⁰ Në shqipe folja “*mögen*” ka disa përgjegjëse, “*pëlqej*” është kuptimi i parë, por që nuk ka të bëjë me vlerën e foljeve gjermane në përdorimet dëshirore.

³⁵¹ Për këtë shih: Harald Weinrich, *Textgrammatik der deutschen Sprache*, Dudenverlag, 1993, f. 265.

³⁵² Për shqipen: Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 138.

³⁵³ Për gjermanishten: Ulrich Engel, *Deutsche Grammatik*, IUDICIUM Verlag GmbH München, 2004, f. 221.

negativ³⁵⁴. Në shembullin (6) realiteti dhe dëshira e shprehur nga folësi nuk përputhen e nuk shtrihen në të njëjtën nivel realizimi, dhe pjesëza *doch* i dërgon këtij realiteti një sinjal shtyes drejt realizimit të dëshirës – por kjo mbetet një përpjekje që nuk e ndryshon dot realitetin: personi të cilin folësi dëshiron të vijë, përsëri nuk vjen.

(4)

Të na trashëgohen!

*Sie sollen ein langes Leben haben!*³⁵⁵

(5)

Ah, sikur ***të vinte!***

Wenn er doch käme!

Përdorime të ngjashme me shembullin (4) i hasim shpesh në formula ose përdorime të gatshme, si p.sh.: në lutje fetare, në urime në momente të rëndësishme të jetës. Foljet në të dyja gjuhët janë përdorime në fjali kryesore dhe shprehin një dëshirë drejtuar një force të huaj, e cila pritët të realizohet në të ardhmen. Folja në fjalinë në shqipe është në lidhore, ndërsa në gjermanishte kemi strukturë më folje modale: *folje modale + folje kryesore në infinitiv*. Në shembullin (5) bëhet fjalë për një dëshirë hipotetike, por jo në të shkuarën, edhe pse kemi përdorim të kohëve të shkuara lidhore, e pakryer në shqipe *të vinte*, preteritum në gjermanishte *käme* – realizimi i saj shtrihet në të ardhmen pikërisht falë modalitetit të së pakryerës dhe preteritumit që na vendos në të ardhmen.

Në gjermanishte fjalitë dëshirore (6) dhe strukturat me folje modale (7) (të dyja struktura në lidhore, në Konjunktiv II) qëndrojnë shumë pranë njëra-tjetrës për nga ana kuptimore. Kjo është edhe arsyeja që mundësohen formulime të njëjës strukturë në tjetrën³⁵⁶. Të njëjtat konsiderata shprehim edhe për shqipen: folja në shembullin (6) *të kishim shkuar* në lidhore shpreh një dëshirë joreale, e cila i referohet një veprimi, i cila nuk ka ndodhur në të shkuarën; gjithashtu folja në shembullin (7) *duhet të kishim shkuar* është në mënyrën lidhore e shoqëruar me folje modale dhe shpreh një dëshirë joreale në momentin e ligjërit, e cila gjithashtu i referohet një veprimi, i cili nuk ka ndodhur në të shkuarën. Siç vërehet nga shembujt (6) dhe (7) strukturat gramatikore në të dyja gjuhët janë lehtësisht të

³⁵⁴ Harald Weinrich, *Textgrammatik der deutschen Sprache*, Dudenverlag, 1993, f. 251.

³⁵⁵ Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 134.

³⁵⁶ Gerhard Helbig & Joachim Buscha, *Deutsche Grammatik, ein Handbuch für Ausländerunterricht*, Berlin und München: Langenscheidt, 2001, f. 185.

ndërkëmbyeshme midis tyre duke ruajtur kuptimet modale. Edhe në shembullin (8) personazhi ynë përmes foljes *do të desha të pija* shpreh një dëshirë joreale në momentin e ligjëritimit – e vërteta është se ai nuk e ka mundësinë të pijë një gotë konjak në momentin kur flet. E njëjta dëshirë joreale shprehet edhe në gjermanishte *möchte trinken*, por jo me strukturë të pastër lidhoreje.

(6)

Wären wir nach Spanien gereist!

Sikur të kishim shkuar në Spanjë!

(7)

Wir wären nach Spanien reisen sollen/müssen.

Ne duhet të kishim shkuar në Spanjë.

(8)

Ndjej ftohtë, do të desha të pija një gotë konjak. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 23)

Mich friert, ich möchte einen Schnaps trinken. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, S. 22)

(9)

Përse nuk shkova? Të kisha shkuar! E pakryer: Të shkoja!

Warum bin ich nicht weggegangen? Wäre ich doch weggegangen!

2. Një urdhër - përdorime të lidhore me modalitetin e urdhërores, konsiderohen në gramatika të të dyja gjuhëve si forma konkurruese të mënyrës urdhërore³⁵⁷ (10), (11), (12). Në shembujt e mëposhtëm vërehet fare qartë afria funksionale e lidhore me urdhëroren. Me anë të lidhore një urdhër mund të shprehet në të tashmen, por edhe në atë të pakryerën dhe në të kryerën, kryesisht në përdorime të ligjëratës së zhdrejtë. Shtrirja kohore e realizimit të veprimit është ajo e së ardhmes, si në përdorime të së tashmes, ashtu edhe të së kryerës. Ndërsa lidhëria në të pakryerën e shqipes dhe në preteritumin e gjermanishtes i referohet së shkuarës. Spektri i përdorimit të së tashmes dhe së pakryerës apo preteritumit lidhore në të dyja gjuhët është i njëjtë, ndërsa përdorimet në të kryerën lidhore janë të rralla. Megjithatë përsa i përket modalitetit zor se ka ndryshim midis së tashmes dhe së kryerës lidhore. Midis së tashmes dhe

³⁵⁷ Për këtë shih në këtë punim çështjen *Format konkurruese të urdhërores.

së pakryerës lidhore qëndrojnë dy ndryshime thelbësore: a) nga ana e modalitetit paraqet e pakryera apo preteritumi përbërës shtesë të jorealitetit apo të paktën elemente hipotetikë, të cilët në disa përdorime çojnë në ndryshim të fortë të kuptimit dhe shfaqen kështu frekuenca të tjera si pasojë; b) nga ana e kuptimit kohor³⁵⁸ shfaqen më shumë tipe të ndryshme³⁵⁹. Urdhri i shprehur në lidhore mund t'i drejtohet një apo shumë personave në vetën e dytë njëjës (10) dhe shumës (11). Gjithashtu ai mund t'i drejtohet edhe vetës së parë njëjës (12) apo shumës, si edhe vetës së tretë njëjës dhe shumës. Përdorime të lidhore-urdhërore me ngjyrimë rekomandimi apo udhëzimi gjejmë edhe në receta gatimi, në fletë-udhëzime në medikamente, katalogë udhëzimi për pajisje etj. (*Të merren dy hape në ditë./Man nehme zwei Tabletten täglich.*).

(10)

Kjo të mbesë midis nesh!

Das bleibe unter uns!

(11)

Të veni me shëndet, - tha gjyshja dhe na puthi të gjithëve me rradhë. (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 146)

Kommt gesund wieder, - sagte Großmutter und küsste alle der Reihe nach. (Chronik im Stein, Ismail Kadare, S.172)

(12)

Të shkoj menjëherë!

Ich gehe sofort weg!

Në shembullin (10) foljet *të mbesë* dhe *bleibe* janë që të dyja në të tashmen e lidhore dhe shprehin një urdhër, i cili i drejtohet një personi të vetëm: bashkëbiseduesit. Në gjermanishte folja *bleibe* është në Konjunktiv I. Edhe në shembullin vijues (11), folja *të veni* nga ana gramatikore është në të tashmen e lidhore, e përdorur me kuptimin kohor të së ardhmes, por semantikisht ajo bart kuptimin e urdhërores. Nëse e kthejmë këtë fjali në urdhërore nuk kemi realizim semantik: *Shkoni me shëndet, - tha gjyshja dhe na puthi të gjithëve me rradhë*. Ndryshe qëndron çështja në gjermanishte: përkthyesi Rëm (Röhm) ka zgjedhur të përdorë mënyrën urdhërore *kommt*, përdorim, i cili i jep mjaft mirë në gjermanishte emocionet e

³⁵⁸ Temporalitetit.

³⁵⁹ Për shqipen shih: Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 134, 138, 141.

shprehura në fjalinë e shqipes. Shembulli (12) përfaqëson rastet e rralla të përdorimeve të lidhore-urdhërore në vetën e parë në shqipe *të shkoj*. Në gjermanishte përdoret e tashmja dëftore *gehe weg* duke iu referuar një veprimi në të ardhmen duke mbartur ngjyrimin e urdhërores. Në të dyja gjuhët del qartë nga konteksti, që veprimi ka përqindje të lartë realizimi. Ndajfoljet *menjëherë/sofort* e mbështesin fjalinë në përmbylljen sa më parë të veprimit të ikjes. Raste të lidhore për të shprehur një urdhër gjejmë edhe në shembujt (13), (14) dhe (15) – në të tri shembujt foljet në shqipe janë në të tashmen e lidhore. Është e vërtetë që përdorime të tilla të lidhore kategorizohen si forma konkurruese të urdhërores, por gjithsesi jemi të mendimit që intonacioni i këtyre përdorimeve është më i butë se ai i në shembujt e pastër gramatikorë të urdhërores. Gjatë kthimeve në gjermanishte apo edhe në shembujt e origjinës në gjermanishte (14) kemi ndërtime me folje në mënyrën urdhërore (14) *sei*, formë konkurruese të urdhërores *Lass uns gehen* (13) apo përdorim të foljes modale *sollen* në të tashmen dëftore (15), e cila vlen gjithashtu si formë konkurruese³⁶⁰ e urdhërores në gjermanishte.

(13)

Të shkojmë!

Lass uns gehen!

(14)

Lëri këto, - ma preu im atë, - të jesh i kënaqur që gëzon përkrahjen e një njeriu specialist e kaq me ndikim. (Me syrin e një kllouni, Heinrich Böll, f. 144)

"Lass das“, sagte mein Vater scharf, "sei froh, dass du einen so einflussreichen und fachmännischen Gönner im Hintergrund hast.“ (Ansichten eines Clowns, Heinrich Böll, S.117)

(15)

Të mos gënjes!

Du sollst nicht lügen!

3. Domosdoshmëri [(16), (17), (18)] gadishmëri, përpjekje (19), dëshirë [(20), (21)], mundësi [(21), (22)], aftësi, lejim, druajtje para një veprimi, frikë (24) – përdorime të tilla i gjejmë në të dyja gjuhët, si në fjali të thjeshta ashtu edhe në të përbëra, shpesh pas foljeve modale apo

³⁶⁰ Për më shumë shih në këtë punim çështjen *Format konkurruese të urdhërorës.

me ngjyrimë modale me veçori semantike³⁶¹, por jo të gjitha ndërtimet me lidhore të shqipes jepen me lidhore në gjermanishte. Foljet në përdorime të këtilla shprehin kryesisht një qëndrim personal ndaj veprimit në fjalë³⁶². Gjithashtu nëse trajtojmë temporalitetin, themi se kemi përjasje në të dyja gjuhët: foljet kanë shtrirje të gjerë përdorimi në të tashmen (21), në të shkuarën (18), (19), (20) dhe në të ardhmen³⁶³ (16), (17), (21), (22), (23).

(16)

*Mendja më punon vetëm në një vend; ai aty duhet ta **marrë vesh**. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 65)*

Ich denke an nichts mehr als an dies: Der dort muss wissen. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, S. 63)

(17)

Duhet të shkosh për ca ditë tek babazoti. (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 41)

Du solltest für ein paar Tage zu Großpapa gehen. (Chronik im Stein, Ismail Kadare, S.49)

(18)

*Çdokush duhej ta **kishte kuptuar** se kjo arratisje ishte vetëm mall për shtëpinë dhe një turbullirë e çastit. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 238)*

*Jeder **hätte** daraus **wissen können**, dass die Flucht nur Heimweh und momentane Verwirrung war. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, S. 244)*

(19)

*Natën e parë të mbërritjes sonë përpiqemi të **orientohemi**. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 92)*

In der ersten Nacht versuchen wir uns zu orientieren. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, S. 90)

(20)

*Edhe unë kam dëshirë të **qaj** nganjëherë, edhe unë kam dëshirë që të më ngushëllojnë nganjëherë; vërtet që s'jam më shumë se një fëmijë, në raft ndodhen akoma pantallonat e mia*

³⁶¹ Për shqipën shih: Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 135-136.

³⁶² Emine Teichmann, *Cikël leksionesh*, 2016.

³⁶³ Siç e kemi përmendur edhe më lart te shtrirja dhe kuptimi kohor i kohëve të lidhore në shqipe, koha e tashme lidhore mbulon veprime në të ardhmen.

të shkurtra – sa pak kohë ka kaluar që atëherë! (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 163)

Warum muss ich immer der Stärkere und der Gefäßtere sein, ich möchte doch auch einmal weinen und getröstet werden, ich bin wirklich nicht viel mehr als ein Kind, im Schrank hängen noch meinen kurze Knabenhosen,-es ist doch erst so wenig Zeit her, warum ist es denn vorbei? (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, S. 164)

(21)

*Duam **të jetojmë** me çdo kusht; prandaj nuk mund **të ngarkohemi**, me barrën e ndjenjave, të cilat në kohë paqeje mund të jenë ndoshta dekorative, por që këtu s'e kanë vendin fare. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 126)*

Wir wollen leben um jeden Preis; da können wir uns nicht mit Gefühlen belasten, die für den Frieden dekorativ sein mögen, hier aber falsch sind. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, S. 125)

(22)

*O tokë, me ledhet dhe gropat dhe hendeqet e tua, ku mund **të hidhesh** e **të tulatesh**! (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 54)*

Erde, mit deinem Bodenfallen und Löchern und Vertiefungen, in die man sich hineinwerfen, hineinkauern kann! (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, S. 52)

(23)

*Befas më zënë të dridhurat, trembem se mos **ndodhë** gjë. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 198)*

*Nun beginne ich plötzlich zu zittern, dass etwas **dazwischenkäme**. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, S. 201)*

Në shembullin (16) në shqipe struktura gramatikore e lidhore duhet ta marrë vesh është me përbërje me folje modale: "folje modale + folje kryesore në kohën e tashme lidhore". Gjithashtu edhe struktura gramatikore në gjermanishte muss wissen është me përbërje me folje modale: "folje modale + folje kryesore në infinitiv", por folja modale nuk pasohet me folje në lidhore. Pra, themi se nga ana morfologjike kemi përjasje midis dy gjuhëve për ndërtime në struktura me folje modale. Me tëj, nëse i referohemi faktit gjuhësor, që në shqipen standarde lidhorja zëvendëson paskajoren, atëherë nënkuptojmë, se edhe pjesa e dytë përbërëse e strukturës gramatikore në fjalë, ka afrim mes shqipes dhe gjermanishtes. Në të dyja rastet, si në gjermanishten origjinale edhe në shqipen e kthyer, edhe pse kemi përdorim të

kohës së tashme, nga konteksti del fare qartë, që folja shpreh një domosdoshmëri e cila i referohet së ardhmes, pra pritët të ndodhë në një të ardhme të afërt. Hyrja e fjalisë *Ich denke an nichts mehr als an dies.../Mendja më punon vetëm në një vend...* e parapregatit situatën duke e orientuar veprimin drejt domosdoshmërisë të realizimit të tij. Në shembullin (17) në shqipen origjinale vërejmë se kemi përdorim të foljes modale *duhet* me nuancën e nevojshmërisë, shoqëruar me intonacion mbështetës të kësaj nuance dhe përkthyesi Rëmi (Röhm) me të drejtë në kthimin në gjermanishte ka përzgjedhur foljen *sollen*. Veprimi i referohet së ardhmes dhe mendohet gjithashtu si i realizueshëm në një të ardhme të afërt. Në shembullin (19) vërejmë një përputhje të një shkalle të lartë në rrafshin morfologjik, semantik dhe sintaksor: ndërtimi morfologjik në gjermanishte *versuchen uns zu orientieren*, "folje + infinitiv me zu" është një strukturë gramatikore gjerësisht e përdorshme dhe i përkon korrektësisht strukturës gramatikore në shqipe *përpiqemi të orientohejmë*, "folje + strukturë në lidhore". Si në gjermanishten origjinale ashtu edhe në shqipen e kthyer që të dy, autori dhe përkthyesi zgjedhin të përdorin të tashmen për të rrëfyer një ngjarje të ndodhur në të shkuarën *Natën e parë të mbërritjes sonë/In der ersten Nacht*. Në shembullin (23) shkrimtari, në rastin tonë personazhi kryesor në libër, shpreh frikë për mosrealizimin e qëllimit të tij, të shpëtojë veten në betejë. Pjesa e parë e fjalisë *Befas më zënë të dridhurat/Nun beginne ich plötzlich zu zittern* e reflekton direkt frikën e tij, të kuptueshme tashmë, duke parë nga konteksti rrethanat e rrezikshme për jetën në të cilat ai gjendet. Edhe ndajfoljet *befas/plötzlich* e mbështesin fort përshkallëzimin e frikës së ushtarit në libër, e cila ndjehet aq pranë edhe nga lexuesi. Në të dyja gjuhët, si në gjermanishten origjinale, ashtu edhe në shqipen e kthyer, autori Remark dhe përkthyesi Shvarc kanë zgjedhur të përdorin mënyrën lidhore - edhe pse frika e personazhit tonë ka potencial e mundësi që të konfirmohet, ajo mbetet gjithsesi në kuadrin e jorealitetit, të druajtjes.

4. Një pendim – përdorim të tillë me lidhore e hasim si në shqipe edhe në gjermanishte. Në fjalitë e mëposhtme (24) në gjermanishten origjinale kemi strukturën gramatikore "*Konjunktiv II + folje kryesore + folje modale*", ndërsa në shqipe e gjejmë të kthyer me strukturën gramatikore "*folje modale + kohë më se e kryer lidhore*". Në të dyja gjuhët kemi elemente "të dukshëm" dhe "të padukshëm" gramatikorë të cilët e mbështesin pendimin e heroit tonë: në shqipe pjesëzën mohuese *nuk*, ndërsa në gjermanishte ndajfoljen mohuese *nie*, si edhe intonacionin, i cili bart nuancën karakteristike të pendimit, një intonacion qortues me shkallë ulëse. Kthimi në shqipe ka përputhje semantike, sintaksore dhe emocionale me gjermanishten,

ndërsa përputhja morfologjike është e pjesshme: në të dyja rastet kemi përdorim të lidhores, veçse ndërtimi i formave morfologjike është i ndryshëm.

(24)

Nuk duhet të kisha ardhur me leje. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 165)

*Ich **hätte** nie auf Urlaub **fahren dürfen**. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, S. 166)*

5. Një këshillë - në shembullin (25) është e vërtetë që në gjermanishte kemi përdorim të foljes modale *müssen*, e cila shpreh diçka si të detyrueshme apo të domosdoshme, por prania e disa elementeve semantikë, siç është pjesëza *nun* në gjermanishte, lidhëza *por* dhe ndjafolja kohore *tani* në shqipe; prania e elementit sintaksor: intonacioni gradualisht ulës e zbutës; elementi semantik: konteksti gjuhësor, të cilët së bashku shprehin qartë përdorimin e foljes modale *duhet* (në gjermanishte: *müssen*) në formën e një këshille. Si përfundim, themi që në këtë përdorim të lidhores në të dyja gjuhët gjejmë përputhje në disa nivele: semantik, emocional, sintaksor dhe stilistik.

(25)

*Por tani duhet të **shkosh** në shtrat, nënë. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 164)*

*Nun **musst** du schlafen gehen, Mutter. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, S. 165)*

6. Në shqipe kemi shpesh përdorim të lidhores pas foljeve që shprehin veprimtari apo të ngjashme me këtë të fundit: *fillon/anfangen, beginnen* (26), (27), *vazhdon/fortfahren, weitermachen* (28), *shkoj/gehen* (29) etj., folje me tiparin e zakonit: *ka zakon/die Angewohnheit haben, ka traditë/die Tradition haben, është mësuar/gewöhnt sein*, dhe së fundmi folje, si: *qëllon, ndodh/passieren* - në përdorime të këtilla mbizotëron komponenti kohor i paskohshmërisë³⁶⁴. Nëse vërejmë shembujt origjinalë apo kthimet në gjermanishte konstatojmë se përdorime të këtilla kërkojnë më shpesh struktura me *infinitiv me zu* (26), (27) por jo vetëm, në shembujt (28) dhe (29) janë ngërthyer edhe struktura me dëftore. Spektri i

³⁶⁴ Për këtë shih: Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 135-136. ; Emine Teichmann, *Cikël leksionesh*, 2016.

shtrirjes së këtyre përdorimeve në të dyja gjuhët është tejet i gjerë dhe koncepti kohor përfshin të tria kohështrirjet: të shkuarën (25), (26), të tashmen (24) dhe të ardhmen. Në shembujt (26), (27), (28), (29) është e vërtetë që të gjitha përdorimet janë me forma gramatikore në mënyrën lidhore, por duhet thënë se këtu ata nuk e bartin modalitetin e mundësisë, por duke qenë se shënojnë veprime reale, të vërteta, orientohen drejt dëftores, dhe lidhorja vesh petkun e modalitetit të dëftores. Ky fenomen gjuhësor ka në shqipen letrare një shtrirje të gjerë. Agalliu shprehet se janë mundur të vihen re rastet e mëposhtme, pa mëtuar që ato të jenë të vetmet: raste me lidhëzën kur ose me ndonjë tjetër lidhëz të tillë; fjalitë e varura kundrinore të drejta, fjalitë e varura të barasvlefshme me një përcaktor kallëzuesor, më shpesh me atë të kundrinës; më rrallë fjalitë rrjedhimore; pas foljes shkaktore (kauzative) *bëj*; në fjali pyetëse, që nisin me fjalë pyetëse³⁶⁵.

(26)

Fillon të rizojë shi. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 70)

Es beginnt zu regnen. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, S. 68)

(27)

Unë fillova përsëri të çfetoj librat. (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 56)

Ich begann von neuem, in den Büchern zu blättern. (Chronik im Stein, Ismail Kadare, S. 66)

(28)

Ne vazhdonim të dridheshim. (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 152)

Wir zitterten noch immer. (Chronik im Stein, Ismail Kadare, S.24)

(29)

Kur shkoi të ankohej, komandanti i kompanisë e talli dhe e këshilloi që, herën tjetër, të kishte mendjen e t'i bënte sytë katër; (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 30)

Als er sich beschweren wollte, lachte ihn der Kompanieführer aus und sagte, er solle doch aufpassen; (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, S. 28)

Shembujt tanë (27), (28), (29) janë shkëputur nga momente të librave që kanë karakter tregues. Nisur nga kjo, vërejmë që kohët e përdorura në të dyja gjuhët janë: e kryera e thjeshtë në shqipe dhe preteritumi në gjermanishte *fillova/begann, të dridheshim/zitterten, shkoi/wollte*.

³⁶⁵ Fatmir Agalliu, *Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1988, f. 22-23.

7. Pas foljeve që shprehin thënie, urdhër apo mendim: *kërkon/auffordern* (30), *fton/einladen*, *thotë/sagen*, *lut/bitten*, *mendon/denken*, *urdhëron/befehlen* (31), *ngul këmbë/bestehen auf*, *bie ndërmend/einfallen*, *harroj/vergessen* (32) etj. – lidhorja shfaqet në shqipe atëherë kur folja sinjalizon: një urdhër, kërkesë, leje etj³⁶⁶. Edhe në këto përdorime (30), (31), (32) lidhorja huazon modalitetin e dëftores, duke qenë se përdorimet e saj janë në fjali që shprehin realitetin, dhe jo hamendësime apo mundësi. Kthimet në gjermanishte realizohen kryesisht me anë të foljeve modale (30) dhe me anë të strukturave *infinitiv me zu* (31), (32). Në përdorime të këtylla midis dy gjuhëve gjejmë përqasje në nivelin semantik, sintaksor dhe stilistik, ndërsa në nivelin morfologjik ajo është e vakët: pjesët përbërëse të fjalisë, që i paravendosen lidhore në shqipe ruhen gjatë kthimit në gjermanishte, ndërsa folja në lidhore nuk ruhet.

(30)

Kur u zhvillua beteja e Zamës? – kërkon të dijë Kropi. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 64)

"Wann war die Schlacht bei Zama?" will Kropp wissen. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, S. 78)

(31)

Pasi kalojnë edhe tetë ditë të tjera, marrim urdhër të tërhiqemi që andej. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 207)

Nach weiteren acht Tagen erhalten wir Befehl, abzurücken. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, S. 211)

(32)

Ai nuk harronte kurrë të përmendte pesë kilogram hekura. (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 177)

Niemals vergaß er, die fünf Kilogramm Eisen zu erwähnen. (Chronik im Stein, Ismail Kadare, S.207)

8. Në fjali që shprehin lejim – lidhorja paraqitet në ato fjali dëshirore, në të cilat folësi konsiderohet si i parëndësishëm për realizimin e dëshirës së tij (33).

(33)

*T'i lemë të tjerat, por të mbetet qyteti pa bukë, nuk shkon.*³⁶⁷

³⁶⁶ Po aty, 137-141; Emine Teichmann, *Cikël leksionesh*, 2016.

Lassen wir das andere, aber, dass die Stadt ohne Brot bleibt, geht nicht.

Në të vërtetë në fjalinë (33) folësi nuk e shpreh qartë dëshirën e tij – ajo është më tepër thirrje për lejim të realizimit të asaj çka ai dëshiron. Është pikërisht ashtu siç e shohin Buholci dhe Fideri (Buchholz-Fiedler): një dëshirë e cila shprehet në kufirin e dëshirës, por që anon më tepër nga lejimi. Edhe folja *lä/lassen* për nga kuptimi i saj semantik e mbështet këtë lejim. Një strukturë e tillë morfologjike njihet në të dyja gjuhët në morfologji si përdorim që kërkon folje në mënyrën lidhore. Në gjermanishte sipas Dudenit (DUDEN) elektronik struktura të tilla mund të kenë përdorime në fjali që në linguistikë njihen si *Heischesatz*³⁶⁸ dhe kanë në fillim të tyre ndërtim me folje në lidhore ose një fjali të varur me *wenn* apo *dass* si hyrje. Në të dyja gjuhët intonacioni si mjet sintaksor luan një rol jo pak të rëndësishëm – është pikërisht nuanca e tij, që e ndan fjalinë lejore nga një urdhërore. Struktura me lidhore e ndihmon folësin të bëjë hyrje të fuqishme në fjali duke përgatitur terrenin për moskundërshtimin e lejitimit që kërkohet. Duke marrë në konsideratë argumentet e mësipërme themi që në të dyja gjuhët këto struktura gramatikore kanë ngjashmëri semantike, morfologjike, emocionale dhe stilistike.

9. Lidhëria në shqipe gjen përdorim të gjerë në *kompleksin e pyetjeve*³⁶⁹ - të gjitha këto përdorime kanë ngjyrosje modale:

a- Në pyetje direkte të thjeshta drejtuar bashkëbiseduesit lidhur me një dëshirë (34), (36) apo mendim të tij (35). Këto fjali në shqipe mund të nisin direkt me folje në lidhore (34) ose me fjalë pyetëse, përemër pyetës (35) ose ndajfolje pyetëse (36). Nëse vërejmë fjalitë e mëposhtme mund të konstatojmë se në gjermanishte në të tre shembujt tanë argumentues kemi struktura gramatikore me foljen modale *sollen*, e cila ka një spektër tejte të gjerë përdorimi. Në këto përdorime nuk kemi ngjashmëri midis dy gjuhëve.

(34)

Ta mbyll dritaren?

Soll ich das Fenster zumachen?

(35)

Cilin të zgjedh?

³⁶⁷ Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 137/140.

³⁶⁸ Në shqipe: fjali që shpreh një dëshirë.

³⁶⁹ Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 137/140, me përjashtim të gërmës *e*.

Wen soll ich nehmen?

(36)

Po sa gjatë ta ziej çajin?

Wie lange soll ich den Tee kochen?

Në të gjithë shembujt argumentues ligjëruesi interesohet për mendimin (35) apo dëshirën (34), (36) e bashkëbiseduesit – këtu kemi të bëjmë me pyetje, përgjigjet e të cilave kthehen në urdhër për ligjëruesit, kemi një përjasje të foljes modale me urdhëroren. Në shqipe është e vërtetë që nuk kemi përdorime me folje modale, por struktura e lidhore ka të njëjtin funksion semantik të ngjashëm me foljen modale *sollen* në gjermanishte.

b- *Në pyetje me elemente dyshimi.* Këto përdorime të lidhore i hasim në të dyja gjuhët pas lidhëzave *sikur/wenn nun* (37).

(37)

A do të kishte plasur lufta sikur të mos donte perandori? (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 178)

*... "ob es Krieg gegeben hätte, wenn der Kaiser nein **gesagt hätte**. " (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, S. 180)*

Në shembullin (37) është e vërtetë që ligjëruesi drejton një pyetje, por ai nuk e fsheh dyshimin e tij duke e ndërthurr pyetjen me habinë personale dhe bashkëbiseduesi orientohet kështu drejt një përgjigjeje të kushtëzuar. Në mbështetje të dyshimit, gjuha vendos disa elemente mbështetës shtesë: elementi i dyshimit prezantohet që me pjesën kryesore të fjalisë, e cila përmban elemente mosbesues *A do të kishte plasur lufta/ob es Krieg gegeben hätte*. Në shqipe kemi përdorim të mënyrës kushtore *do të kishte plasur*, ndërsa në gjermanishte kemi strukturë me lidhoren, më saktë me Konjunktiv II *gegeben hätte*. Shpejtësia me të cilën drejtohen këto pyetje në të dyja gjuhët është në harmoni të plotë me intonacionin e përdorur nga ligjëruesi.

c- *Në pyetje polemike (retorike), të cilat shprehin: inat (38), protestë (39) dhe përmbajnë ngjyrim të fortë modal.* Kthimet në gjermanishte nuk jepen gjithmone më folje në lidhore: ato herë jepen me folje në lidhore (40) e herë me dëftore (38) ose me folje modale (39). Kohështrirja përfshin kryesisht të shkuarën (38), (40) dhe të ardhmen (39). Shembulli (39) në shqipe të mbytemi është në të tashmen, por veprimi ka kohështrirje në të ardhmen. Spektri i përdorimeve të më se të kryerës (40) lidhore në shqipe në pyetje polemike është relativisht i

gjerë, më shumë në gjuhën e shkruar se sa në atë verbale. Në gjuhën e folur parapëlqehet të përdoret e pakryera e lidhore. Në të dyja gjuhët pyetjet shoqërohen me intonacion karakteristik, nuancat e të cilit mbështesin dhe përdoren në varësi të gjendjes shpirtërore të ligjëruesit.

(38)

Pse ta bënte këtë gjë Isai – tha gjyshja me hidhërim. (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 14)

Warum Isa das nur tut - sagte sie bekümmert. (Chronik im Stein, Ismail Kadare, S. 18)

(39)

Ku të mbytemi tani? (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 144)

"Wo sollen wir uns jetzt unterschlumpfen?" (Chronik im Stein, Ismail Kadare, S. 168)

(40)

Po ku ta kishte mësuar ajo e shkreta?!

*Woher hätte es denn die Ärmste erfahren haben können?!*³⁷⁰

Ngjyrimi emocional në këto pyetje polemike është aq i fortë, sa që ligjëruesi njëkohësisht shpreh edhe kundërshtimin apo mospajtimin e tij lidhur me çështjen në fjalë (38), apo protestën (39). Intonacioni si mjet sintaksor e përforcon shprehjen e modalitetit të lidhore. Mungesa e intonacionit të duhur nuk do të përçonte të njëjtin mesazh, madje do të ndikonte edhe në ndryshimin e asaj që folësi dëshiron të shprehë. Nëse vërejmë shembujt e përzgjedhur për argumentimin e inatit apo protestës së folësit, shohim praninë e elementeve gjuhësorë, fjalëve të veshura me ngarkesë emocionale, p.sh.: *me hidhërim/bekümmert; të mbytemi/sollen unterschlumpfen; po/denn; e shkreta/die Ärmste*.

ç- Në pyetje me komponentë të supozimit. Si karakteristikë për këto përdorime Buholz dhe Fidler (Buchholz-Fiedler) shohin njëkohshmërinë (41) – koha e ligjërimit përputhet me atë të veprimit³⁷¹. Jemi të mendimit se ka edhe përdorime me komponentë të supozimit ku njëkohshmëria nuk shfaqet si tipar karakteristik përsa i përket përputhjes së kohës së ligjërimit me atë të veprimit (42). Në shqipe folja në këto përdorime është në të kryerën e lidhore duke shtuar, që është pikërisht kjo kohë, e cila gjen përdorim më të gjerë në pyetje të tilla të supozimit, e ndjekur nga më se e kryera. Shembujt e kthyer në gjermanishte kanë ngjyrimin

³⁷⁰ Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 142.

³⁷¹ Po aty, f. 134.

modal të supozimit, dhe për këtë gramatika gjermane ngërthen struktura gramatikore kryesisht me folje modale (41) apo me mënyrën dëftore (42). Në të dyja gjuhët intonacioni luan një rol të rëndësishëm në shprehjen e hamendjes, duke e theksuar modalitetin e hamendësisë. Pyetje të tilla lidhen me situata jo të përditshme, më tepër me situata të ndodhura disi jashtë normales të zakonshme.

(41)

Kush të jetë kaq vonë?

Wer mag so spät noch sein?

(42)

Kush ta ketë katandisur kështu?

Wer hat ihm das angetan?

Në shembullin (41) vërehet lehtësisht tipari i njëkohshmërisë: ligjëruesi pyet menjëherë sapo dikush ka trokitur në derë ose ndërkohë që dikush është duke trokitur në derë. Ndërsa në shembullin (42) kemi elemente të supozimit, ku koha e ligjërimit përputhet me atë të vëzhgimit, por jo me atë të veprimit, e cila i paravendoset këtyre të dyjave. Në të dyja shembujt në shqipe kemi përdorime të lidhore - në gjermanishte kemi ndërtim me folje modale *mögen* (41) e në shembullin (42) përdorim të pastër të së kryerës dëftore.

d- Në pyetje të zbërdhulura, me kundërshtim të zbehur, përzier me ndjenjën e entuziasmit ose të dëshpërimit³⁷² (43).

(43)

Ah moj nënë, moj nëna ime! Pse mos të të marr tani në krahë e të vdesim të dy bashkë?
(*Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 163*)

Ach Mutter, Mutter! Warum nehme ich dich nicht in meine Arme und wir sterben? (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, S. 164)

Shembulli (43) është i mbushur me ngarkesë të fortë emocionale, ku hyrjen e bën fjalja paraardhëse në të dyja gjuhët: *Ah moj nënë, moj nëna ime!* // *Ach Mutter, Mutter!* Autori, i pushtuar nga ndjenja e dëshpërimit, arrin deri në atë pikë, sa që ai do të ishte gati të mos jetonte më, pasi mjerimi e tejkalon dëshirën për të jetuar. Është e kuptueshme nga konteksti, që ai nuk mendon të bëjë ndonjë marrëzi, por këtu ai ka gjetur valët e duhura për të shprehur

³⁷² Fatmir Agalliu, *Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1988, f. 65.

dëshpërimin e thellë dhe dhimbjen që e ka kapluar. Ai e nis pyetjen me një nuancë keqardhjeje e vajtimi, e cila sa vjen e rritet deri në fund të fjalisë. Në të dyja gjuhët shembulli përçon të njëjtin emocion. Është e vërtetë që në gjermanishten origjinale Remarku (Remark) përdor mënyrën e së vërtetës, atë dëftore, por ai i referohet një veprimi në të ardhmen, dhe dihet që e ardhmja ngërthen në vetvete pasiguri – qasja morfologjike qëndron në kohështirjen e veprimit, por jo në mënyrat e përdorura: në shqipe kemi përdorim të lidhore e në gjermanishte të dëftores. Në përdorime të këtilla midis shqipes dhe gjermanishtes kemi përjasje semantike, stilistike, dhe sintaksore, por jo morfologjike.

10. Përpos rasteve të trajtuara më sipër në gjermanishte mënyra lidhore (Konjunktiv II) gjen përdorim edhe në *fjalitë e thjeshta rrëfyese joreale* (44) apo *irreale Aussagesätze* (45) siç emërtohen në gjermanishte, dhe shërben për të shprehur një mundësi apo jorealitet. Shpesh fjalitë shoqërohen nga ndajfolje, si p.sh.: *fast (gati, pothuajse, thuajse), beinahe (gati-gati, thuajse)* apo me shprehje ndajfoljore *um ein Haar/për një qime* në kuptim të ngjashëm apo të afërt – këto elemente gramatikore nxitin me kuptimet e tyre Konjunktiv II³⁷³. Gjithashtu edhe në shqipe përdorime të tilla kërkojnë struktura gramatikore në mënyrën lidhore (45), por më tepër në atë kushtore (44). Përfundime bëhen kur në gjermanishte kemi fjali rrëfyese e cila përmban strukturën gramatikore: *"Folje modale në Konjunktiv II + pjesoren e shkuar të foljes kryesore + folje ndihmëse werden në infinitiv"* – kthimi në shqipe këtu bëhet me forma foljore të lidhore me përmbajtje foljesh modale: *"Folje modale duhet në të pakryerën + foljen kryesore në kohën e kryer lidhore"* (45).

(44)

*Eine zweite Kandidatur **wäre** ein Bergaufrennen für Lafontaine.*³⁷⁴

Një kandidaturë e dytë do të ishte një maratonë për Lafontenin.

(45)

*Ich **hätte** mehr **gelernt haben müssen**, um die Prüfung überhaupt zu bestehen.*

*Unë duhej të **kisha mësuar** më shumë, për të marrë provimin.*

Në shembullin (45) jorealiteti i shprehur në fjali nuk është i shpërndarë në të gjithë format foljore, por është përqëndruar në *gelernt haben/të kisha mësuar* – edhe pse folja modale si

³⁷³ DUDEN, *Die Grammatik, Unentbehrlich für richtiges Deutsch 7.*, völlig neu erarbeitete und erweiterte Auflage, Duden Band 4, Dudenverlag, Mannheim, Leipzig, Wien, Zürich, 2005, f. 526.

³⁷⁴ Po aty.

rregull bart ngjyrim modal, e parë nga pikëpamja semantike këtu ajo mbetet e privuar nga ky tipar: modalizimi mbetet "real", ndërsa ngjarja e modalizuar është irreale³⁷⁵.

11. Në të dyja gjuhët gjejmë përdorime të lidhore në *fjali krahasore joreale* ose siç quhet në gjermanishte *irrealer Vergleichssatz* apo *Komparativsatz*. Këto përdorime shfaqen në fjali të nënrenditura, të shoqëruara me lidhëzat nënrenditëse: *wenn (sikur)*, *als wenn (po sikur)*, *als (si)*, *als ob (po sikur)*. Në gjermanishte përdoret Konjunktiv II, ndërsa në shqipe folja mund të jetë në lidhore ose në kushtore. Siç vërehet edhe nga emërtimi, kuptimi i këtyre fjalive është krahasimi. Me lidhëzën krahasore-mënyrore *sikur* mund të përdoret edhe dëftorja në shqipe – ndryshimi në këto përdorime nxjerr në shesh dallimin e modalitetit të foljes³⁷⁶. Të njëjtin fenomen gjuhësor e hasim edhe në gjermanishte: lidhëza krahasuese *als* mund të përdoret edhe me dëftoren – përdorime të tilla hasen më tepër në gjuhën e folur se sa në atë të shkruar³⁷⁷. Si në shqipe edhe në gjermanishte në fjalitë krahasore të supozimit apo në fjalitë krahasore joreale, në vend të ndërtimeve me lidhëzën *sikur/wenn*, hasim edhe pse më rrallë, edhe ndërtime me lidhëzën *si (als ob)*. Në këto përdorime dy lidhëzat në shqipe dhe në gjermanishte janë sinonime dhe nisur nga kjo, ato mund të zëvendësojnë fare lehtë njëra-tjetrën. Siç vërehet edhe nga shembujt ilustrues, themi që, në fjalitë krahasuese irreale shfaqet një tendencë për të përdorur të pakryerën në shqipe dhe preteritumin në gjermanishte, kur duam të shprehemi mbi veprime në të tashmen, dhe koha më se e kryer lidhore, kur duam t'i referohemi veprimeve në të shkuarën.

(46)

Të nesërmen, sikur ta kishte dëgjuar bisedën e Xhexhos, Iliri më tha: ... (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 189)

*Als ob er Xhexho **habe reden hören**, schlug Ilir tags darauf vor: ... (Chronik im Stein, Ismail Kadare, S. 221)*

(47)

Do të na ketë shtyrë frika; ndoshta do t'ia kishim mbathur edhe sikur të na kishin fluturuar këmbët – do të ecnim me cungjet tona. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 210)

³⁷⁵ Po aty, f. 527.

³⁷⁶ Për këtë shih: Fatmir Agalliu, *Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1988, f. 46-47.

³⁷⁷ Për këtë shih: DUDEN, *Die Grammatik, Unentbehrlich für richtiges Deutsch 7.*, völlig neu erarbeitete und erweiterte Auflage, Duden Band 4, Dudenverlag, Mannheim, Leipzig, Wien, Zürich, 2005, f. 529.

*Das hat nur die Angst gemacht; wir würden fortgelaufen sein, selbst wenn uns die Füße **weggeschossen wären** – dann eben auf Stümpfen. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, S. 214)*

(48)

*Edhe sikur të tjerët **të ishin** të këqinj, aeroplani im nuk ishte i tillë. (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 110)*

*Auch wenn die anderen schlecht **wären**, mein Flugzeug nicht. (Chronik im Stein, Ismail Kadare, S. 127)*

(49)

*Vërtet që do të futeshim në atë peisazh e do të dashuronim e do të mallëngjeheshim nga pamja e tij – por e tëra kjo do të ishte njëlloj sikur **të kridheshim** në mendime para fotografisë së një shoku të vdekur; (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 112)*

Wir würden in ihr sein und ihr umgehen; wir würden uns erinnern und sie lieben und bewegt sein von ihrem Anblick. Aber es wäre das gleiche, wie wenn wir nachdenklich werden vor der Photographie eines toten Kameraden; (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, S. 110)

(50)

*Bëra një gjumë krejt të turbullt. Më dukej sikur **kisha** ethe. (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 57)*

*Ich schlief sehr unruhig, als ob ich Fieber **hätte**. (Chronik im Stein, Ismail Kadare, S. 67)*

Krahasimi i bërë në fjalitë (46) nuk është real: *sikur ta kishte dëgjuar bisedën e Xhexhos/als ob er xhexho habe reden hören* – me anë të lidhëzave nënrenditëse *sikur/als ob* folësi e transporton krahasimin menjëherë në një gjendje të imagjinuar, e cila në të vërtetë nuk ka ndodhur, por rezultati i përfutur, reagimi i Ilirit, të orienton drejt një hipoteze të tillë. Në shembullin (49) autori e nis butësisht përfshirjen e lexuesit - fillimisht duke përshkruar një tabllo imagjinare të bukur të gjendjes së tyre në një të ardhme, për të kaluar më pas në krahasimin e goditur, i cili është dhe finalizimi i mendimit të autorit. Në kthimin në shqipe përkthyesi Shvarc përdor lidhoren, ndërsa në gjermanishten origjinale, shkrimtari ka vendosur të përdorë dëftoren. Në shembullin (50) forma e lidhore *hätte* nga gjermanishtja në shqipe paraqitet me dëftoren *kisha*. Edhe pse shkrimtari ka zgjedhur të përdorë mënyrën e së vërtetës, fjalia nuk tregon një të vërtetë reale, por bën një krahasim. Përdorimi ka ngjyrosje modale dhe

autori e bën këtë krahasim për të dhënë më të qartë gjendjen e tij shpirtërore të turbullt, aspak të qetë.

12. Në shqipe lidhorja shfaqet në *fjalitë e varura kohore* pa e patur të nevojshme praninë e ndonjë lidhëze të nënrenditur. Lidhëzat nënrenditëse që hasen në fjalitë e varura kohore janë: *kur/wenn* (51), *als*, *si/wenn*, *pasi/nachdem*, *sa/sobald*, *sapo/sobald*, *porsa/sobald*, *para se/bevor* (54), *përpara se/bevor* (53), *sa herë që/jedesmal* etj. Spektri i përdorimeve në të tashmen krahasuar me kohët e shkuara është më i gjerë. Si rregull kthimet e fjalive të varura kohore në gjermanishte apo edhe shembujt në gjermanishten origjinale nuk kërkojnë struktura gramatikore në lidhore – ata orientohen drejt përdorimeve të dëftores. Argumentimin gjuhësor për këtë mund ta gjejmë pjesërisht në faktin që këto fjali rrëfejnë kryesisht një të vërtetë, jo mundësi, duke u karakterizuar kështu nga kuptimi modal i vërtetësisë. Andaj dhe gjermanishtja ngërthen struktura gramatikore të dëftores. Në rastet e një veprimi, i cili nuk ka ndodhur ende, por ligjëruesi/autori flet me shumë siguri për realizimin e tij, ky veprim mbetet brenda kornizës së mundshmërisë dhe mund të gjejë përdorim lidhorja. Me lidhëzën *para se* shkojnë vetëm e tashmja (53) dhe e pakryera e lidhore (52), që shënojnë veprime të pastajme ndaj çastit të tanishëm ose ndaj një çasti të shkuar³⁷⁸. Folja në lidhore që i pasvendoset *para se* mendohet që shpreh një veprim i cili ndodh apo duhet të ndodhte para veprimit që shprehet me folje në dëftore në fjali. Në shembullin e origjinës (52) në gjermanishte apo në atë të kthyer (53) vërejmë se struktura e shqipes “*përpara se + e pakryer lidhore*” i përgjigjet strukturës morfologjike në dëftore “*als + preteritum dëftore*” dhe struktura e shqipes “*para se (përpara se) + e tashme lidhore*” i përgjigjet gjithashtu dëftores “*bevor + e tashme dëftore*”. Shembulli (52) rrëfen mbi një veprim i cili ka ndodhur tashmë, është i përmbyllur – nuk mund të themi, që është diçka në kornizën e probabilitetit, pasi djemtë kanë shkelur në oborrin e kazermës³⁷⁹. Ndryshe qëndron çështja e modalitetit të mundshmërisë në shembullin (53): lidhorja e ruan modalitetin e mundshmërisë pas lidhëzës *para se* - këtu veprimi nuk ka ndodhur ende. Nëse ai do të ndodhë apo jo, kjo nuk jepet në kontekstin gjuhësor - ajo çfarë paraqitet është një veprim i mundshëm në të ardhmen. Edhe në shembullin (54) struktura e lidhore në shqipe “*gjersa + e tashme lidhore*” i përgjigjet strukturës morfologjike në dëftore

³⁷⁸ Fatmir Agalliu, *Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1988, f. 41.

³⁷⁹ Fatmir Agalliu e ka riparë qëndrimin e tij në përdorimet e lidhore së pakryer pas lidhëzës *para se*, *përpara se* - ai tani ka krijuar bindjen që edhe pas këtyre lidhëzave, lidhorja e ruan modalitetin e mundshmërisë (Agalliu, 1988:21).

“bis + e tashme dëftore”. Në shembujt (53), (54) lidhorja e ruan modalitetin e mundshmërisë, më tepër në shembullin (51) në të tashmen, se sa në shembullin (52) në të pakryerën, kur veprimi është real i përmbyllur tashmë. Kuptimi i një veprimi të mundshëm del qartë tek e tashmja e lidhore, kur kjo shkon me të tashmen mbarëkohore të dëftores³⁸⁰: *Njeriu mendohet para se të flasë./Man denkt nach, bevor man redet*. Kohëveprimi i së tashmes lidhore në këtë shembull, në të dyja gjuhët, ndryshon nga ai i shkëputur nga korpusi letrar (51) – këtu e gjejmë me kuptim kohor të pacaktuar. Parë nga ana kohore ngjason tej mase me kuptimin mbarëkohor të së tashmes së dëftores. Fjalja e mësipërme *Njeriu mendohet para se të flasë./Man denkt nach, bevor man redet*. përdoret në një kontekst në formë këshille apo qortimi, duke menduar që bashkëbiseduesi apo një person i tretë ka vepruar në nxitim e sipër duke mos e mirëmenduar atë çka ka shprehur. Në këtë përdorim e shohim si një mundësi veprimi, e cila i këshillohet apo sugjerohet dikujt në mënyrë indirekte, por që nga konteksti gjuhësor kuptohet nëse sinjali i drejtohet bashkëbiseduesit apo dikujt tjetër.

(51)

"Një këmbë druri e kam, por, kur të kthehem tani prapë në front e kur të ma këputin kokën, do të vë në vend të saj një kokë druri e do të bëhem mjek i komisionit ushtarak!". (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, S. 248)

Ein Holzbein habe ich schon; aber wenn ich jetzt hinausgehe und wenn man mir den Kopf abschießt, dann lasse ich mir einen Holzkopf machen und werde Stabarzt. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, S. 248)

(52)

Përpara se të shkelnim në oborrin e kazermës, shkuam bashkarisht tek berberi dhe, shend e verë, i thamë të na rruante – disa prej nesh s'kishin vënën asnjëherë brisk në faqe. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 27)

Als wir zum Bezirkskommando gingen, waren wir noch eine Klasse von zwanzig jungen Menschen, die sich, manche zum ersten Male, übermütig gemeinsam rasieren ließ, bevor sie den Kasernenhof betrat. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, S. 25)

(53)

Është mirë të marrësh bekimin e nënës, para se të largohesh.

Es ist gut den Segen deiner Mutter zu haben, bevor du fortgehst.

(54)

³⁸⁰ Po aty, f. 21.

Por kemi akoma kohë, gjerësa të vijnë kamionët. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 58)

Aber wir haben noch Zeit, bis die Lastwagen kommen. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, S. 257)

13. Përdorime të lidhore në të dyja gjuhët gjenden edhe në fjali të nënrenditura lejore joreale të ndërtuar me lidhëzat: *sado, sado që, sido, sido që, edhe sikur* etj. apo *irrealer Konzenssatz* siç emërtohet në gjermanishte, të drejtuar nga lidhëzat nënrenditëse: *obwohl, obgleich* dhe *trotzdem* në gjermanishte. Këto struktura gramatikore të lidhore në fjali lejore bartin ngjyrimë modale dhe kuptimi i tyre është kufizimi i shprehur. Në shqipe është e padiskutueshme, që pas lokucioneve lidhëzore *edhe pse, edhe sikur*, me të cilat ndërtohen fjali lejore – kushtore, vjen patjetër lidhorja³⁸¹. Parë nga ana formale fjalitë lejore me përdorime të lidhore me kuptim modal nuk janë asgjë tjetër veçse fjali kushtore të shoqëruara nga pjesëza shtyese detyruese *auch* në fjalinë e nënrenditur dhe nga korrelati fakultativ *so* në fjalinë kryesore³⁸². Shtrirja kohore e këtyre fjalive në të dyja gjuhët është e shkuar, e tashme dhe e ardhme.

(55)

Edhe sikur të kisha mjaftueshëm para, nuk do ta bleja aspak këtë makinë.

Auch wenn ich Geld genug hätte, würde ich dieses Auto doch nicht kaufen.

Në shembullin (55) folësi shpreh një mendim joreal, hipotetik në formën e një kushti *Edhe sikur të kisha mjaftueshëm para/Auch wenn ich Geld genug hätte* – madje edhe përmbushja e tij do ta pengonte folësin të bënte veprimin pasues të blente mjetin në fjalë, duke folur për një lejim të penguar nga vetë folësi. Lidhëza nënrenditëse *edhe sikur* në shqipe dhe *wenn* në gjermanishte e paraprirë nga pjesëza *auch*, e cila e realizon kthesën gramatikore, thithin tërë vëmëndjen e dëgjuesit në pjesën e parë. Intonacioni në të të dyja gjuhët është i njëjtë dhe në pjesën e parë të fjalisë kemi theksim tek *Edhe sikur/Auch wenn*, ndërsa në pjesën e dytë theksohen pjesëzat mohuese dhe përforcuese *nuk... aspak/doch nicht*. Të tërë këto elemente gjuhësorë janë të lidhur harmonishëm me njëri-tjetrin. Në këto përdorime të lidhore në fjalitë lejore në të dyja gjuhët kemi përputhje në të gjitha nivelet: gramatikor, semantik, sintaksor

³⁸¹ Fatmir Agalliu, *Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1988, f. 50.

³⁸² Gerhard Helbig & Joachim Buscha, *Deutsche Grammatik, ein Handbuch für Ausländerunterricht*, Berlin und München: Langenscheidt, 2001, f. 183.

dhe stilistik. Përveç përdorimeve të së pakryerës apo preteritumit në lidhore dhe më se të kryerës, fjalia e nënrenditur lejore shfaqet edhe në fjali me karakter pyetës dhe urdhërues – me kuptimin modal të mungesës së rëndësisë – në të tashmen e lidhore (56)³⁸³.

(56)

Çfarëdo të thotë babai, unë do të shkoj.

Was Vater auch sage, ich gehe hin.

Në shembujt (57) folësi e konsideron si të parëndësishme atë se çfarë mund të thotë babai – edhe pse duhet përmendur që gjendemi në territorin e mundësisë, hamendësisë lidhur me reagimin e prindit, orientuar drejt një qëndrimi kritik kundrejt veprimit të fëmisë. Hyrjen triumfale të mungesës së rëndësisë e jep menjëherë lidhëza *Çfarëdo* në shqipe dhe *Was* në gjermanishte. Referimi kohor si në shqipe edhe në gjermanishte (56) është ai i së ardhmes.

14. Në të dyja gjuhët haset lidhëza në fjali të nënrenditur kushtore apo *Konditionalsatz* siç emërtohet në gjermanishte. Spektri i përdorimeve në gjermanishte është shumë më i gjerë se sa ai në shqipe – kjo për arsyen, që në shqipe gjendet edhe mënyra kushtore, me anë të së cilës mund të shprehen fjalitë kushtore. Në të dyja gjuhët këto fjali kanë ngjyrim modal - veprimi i shprehur me këto ndërtime është hipotetik, joreal dhe kuptimi i fjalisë është ai i një kushti të shprehur. Në gjermanishte foljet si në pjesën kryesore, edhe në atë të nënrenditur janë në lidhore (57) *Wären ... heimgekommen/hätten... entfesselt*. Ndryshe qëndrojnë kohët në shqipe: folja në pjesën kryesore është në kushtore (57) *do të kishim ditur*, ndërsa në pjesën e nënrenditur në lidhore (57) *të ishim kthyer*. Në shqipe lidhëzat kushtore që shkojnë me lidhoren janë: *po* dhe *sikur*. Në përgjithësi mund të themi se format kohore të lidhore pas këtyre dy lidhëzave, që janë pothuaj të barasvlefshme dhe mund të zëvendësojnë njëra-tjetrën, tregojnë një veprim të supozuar³⁸⁴. Lidhëza që përdoret në struktura të tilla në gjermanishte është: *wenn (sukur)*. Helbig dhe Buscha (Helbig-Buscha) dallojnë në gjuhën gjermane tri tipe fjalish kushtore: *fjali kushtore me potencial realizimi, hipotetike dhe atë joreale*. Ndër këto, e para haset në përdorime me dëftoren, ndërkohë dy të dytat në përdorime me lidhoren. Ndryshimi qëndron në faktin, që përdorimet me dëftore e shprehin situatën jo si hipotetike apo joreale, por si të pasur me potencial për realizimin e veprimit, duke lënë mundësi të hapur: *Po të kem kohë nesër, shkojmë në kinema./Wenn ich morgen Zeit habe, gehen wir ins*

³⁸³ Për gjermanishten shih: Po aty.

³⁸⁴ Fatmir Agalliu, *Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1988, f. 39.

Kino. Fjalja kushtore hipotetike realizohet me preteritumin e lidhore (Konjunktiv Vergangenheit) ose "würde (do të) + infinitiv" dhe i referohet veprimeve në të tashmen apo në të ardhmen, ndërkohë që fjalja kushtore joreale ndërtohet me më se të kryerën e lidhore dhe i referohet të shkuarës³⁸⁵.

(57)

Po të ishim kthyer në shtëpi më 1916, do të kishim ditur të shpërthenim një stuhi të fortë nga gjithë ato dhembje e ato përjetime të fuqishme. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 251)

Wären wir 1916 heimgekommen, wir hätten aus dem Schmerz und der Stärke unserer Erlebnisse einen Sturm entfesselt. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, S. 257)

Në shembullin (57) autori shpreh një mendim joreal duke përdorur më se të kryerën e lidhore *Po të ishim kthyer në shtëpi më 1916/Wären wir 1916 heimgekommen* – e kaluara ka ndodhur tashmë dhe nuk mund të ndryshohet më. Duke qenë se nuk përmbushet pjesa e parë e fjalisë, automatikisht themi që edhe pjesa e dytë, pasoja, nuk është e realizueshme. Lidhëza e parme *po* mund të zëvendësohet lehtësisht me atë *sikur*, gjë e cila nuk çon në ndryshimin semantik të fjalisë – kuptimi mbetet i njëjtë. Përdorimet më të shpeshta të lidhore me fjali kushtore hasen në kohën më se të kryer. Nuk është tipike që koha e kryer të shfaqet në përdorime të fjalive kushtore me lidhoren³⁸⁶.

Në shqipe ka edhe raste, kur në fjalitë kushtore me përdorime të lidhore bie lidhëza nënrenditëse, megjithatë kuptimi i fjalisë ruhet fare mirë. Jemi të mendimit që lënia mënjane e lidhëzës nga ligjëruesi/shkrimtari bëhet e qëllimshme – kjo "mungesë" i jep ligjëritimit një nuancë elegance gjuhësore, duke e mundësuar kalimin tejet butësisht: *Mrekullohesh (po) të shohësh çfarë arrin njeriu përmes fuqisë së besimit në Perëndi*. Nëse folësi do të përdorte lidhëzën *po*, ajo do të tërhiqte vëmendjen e dëgjuesit dhe do t'ja rrëmbente skenën pjesës së nënrenditur të fjalisë, duke ia venitur shkëlqimin. Një gjë e tillë nuk mund të realizohet në gjermanishte – fjalja nuk do të ishte e saktë nga ana gramatikore.

15. Në fjali të varur rrjedhimore joreale³⁸⁷ pas lidhëzave *që, aq sa* në shqipe dhe *als dass, dass* në gjermanishte gjejmë përdorime të lidhore. Ndër dy lidhëzat e shqipes, e para ka

³⁸⁵ Gerhard Helbig & Joachim Buscha, *Deutsche Grammatik, ein Handbuch für Ausländerunterricht*, Berlin und München: Langenscheidt, 2001, f. 181.

³⁸⁶ Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 141.

³⁸⁷ Në gjermanishte: irrealer Konsekutivsatz.

përdorim më të gjerë. E përbashkëta në të dyja gjuhët është që këto fjali janë me ngjyrim modal dhe përdoren në fjali me struktura gramatikore të lidhore. Kuptimi i këtyre fjalive është ai i pasojës, i një pasoje të mundshme të rrjedhur nga një veprim tjetër i mundshëm. Në fjalitë rrjedhimore joreale lidhëzat kanë një domethënie të madhe - modaliteti i fjalisë shprehet me anë të këtyre lidhëzave nënrenditëse dhe jo përmes formave gramatikore të lidhore, siç ndodh në fjalitë e varura joreale kushtore³⁸⁸. Karakteristike për fjalitë e nënrenditura rrjedhimore janë fjalët mbështetëse në pjesën e parë të fjalisë, dhe konkretisht në shqipe gjejmë: *aq, kaq* etj, ndërsa në gjermanishte: *so, zu*³⁸⁹. Në shqipe fjalia e varur rrjedhimore dhe ajo e varur krahasore kanë të përbashkët lidhëzat, por ato dallohen qartë nga njëra-tjetra edhe pse të dyja kërkojnë përdorime me lidhore. Në gjermanishte nuk e gjejmë një përjasje të tillë, por hasim ndryshim midis fjalisë së nënrenditur rrjedhimore dhe asaj të nënrenditur kushtore pikërisht në faktin, që në parën vetëm folja në pjesën e nënrenditur ndodhet në mënyrën lidhore, ndërsa në të dytën, që të dyja pjesët janë në lidhore. Gjithashtu referimi kohor, e shkuar apo e tashme, në fjalinë kushtore realizohet përmes kontekstit, ndërsa në fjalinë rrjedhimore referimi kohor jepet në pjesën kryesore³⁹⁰.

(58)

Moti është shumë i ftohtë dhe i lagësht, aq sa nuk mund të bëhej/bëhet asnjë pik-nik.

*Das Wetter ist zu kalt und feucht, als dass man kein Picknik **machen könnte/kann**.*

(59)

Moti ishte shumë i ftohtë dhe i lagësht, aq sa nuk mund të kishim bërë/nuk mund të bëhej asnjë pik-nik.

*Das Wetter war zu kalt und feucht, als dass man kein Picknik **hätte machen können**/man kein Picknick machen konnte.*

Është pikërisht pjesa e parë e fjalisë (58) *Moti është shumë i ftohtë dhe i lagësht*/*Das Wetter ist zu kalt und feucht*, e cila jep sinjalin për pasimin e një veprimi joreal, i cili nuk do të vijojë. Rol të rëndësishëm më pas kanë lidhëzat *sa që* dhe *als dass*: me ngjyrosjen modale të tyre ato e orientojnë lexuesin/bashkëbiseduesin drejt rrjedhojës *aq sa nuk mund të bëhej/bëhet asnjë*

³⁸⁸ Për me tepër mbi gjermanishten shih: Gerhard Helbig-Joachim Buscha, *Deutsche Grammatik, ein Handbuch für Ausländerunterricht*, Berlin und München: Langenscheidt, 2001, f. 183.

³⁸⁹ Për gjermanishten: DUDEN, *Grammatik der deutschen Gegenwartssprache*, Band 4, Dudenverlag, Mannheim, Leipzig, Wien, Zürich, 2005, f. 163.

³⁹⁰ Për gjermanishten shih: Gerhard Helbig & Joachim Buscha, *Deutsche Grammatik, ein Handbuch für Ausländerunterricht*, Berlin und München: Langenscheidt, 2001, f. 183.

pik-nik/als dass man kein Picknik machen könnte/kann. Përfundimisht themi që, përdorimet kuptimore të fjalisë rrjedhimore joreale në të dyja gjuhët janë të njëjta. Madje kemi përqasje edhe përsa i përket elementeve gramatikore që paraqiten në pjesët kryesore të fjalive në të dyja gjuhët: *shumë* dhe *zu*.

16. *Fjali të nënrenditura vendore*, të ndërtuara me lidhëzat: *ku/wo* (60), *kudo që/wohin* (61), *ngado që/wohin auch immer*, *nga/woher*. Si për shqipen, edhe për gjermanishten këto fjali janë të ngjyrosura nga ana modale. Folja në lidhore e paraqet veprimin si mundësi, si diçka që mund të vërtetohet në të ardhmen apo që mund të vërtetohet në të shkuarën³⁹¹.

(60)

Le të shkojë, ku të dojë!

*Möge sie gehen, wohin sie **wolle**!*

(61)

Ta paguaj studimin, kudo që të duash. (Me syrin e një kllouni, Heinrich Böll, f. 147)

Ich zahl' dir das Studium, egal, wo du hingehen willst. (Ansichten eines Clowns, Heinrich Böll, S.119)

Në shembullin (60) vërejmë ekuivalencë të plotë midis përdorimeve në shqipe dhe në gjermanishte, si në rendin morfologjik, semantik, sintaksor dhe atë stilistik. Pjesa kryesore e fjalisë *Le të shkojë/Möge sie gehen* përgatit terrenin për hyrjen e pjesës së nënrenditur *ku të dojë/wo sie wolle*. Theksi i fjalisë bie në pjesën e nënrenditur, pak më fort në lidhëzën *ku/wo*. Në formën e një lejimi të papërcaktuar ligjëruesi shpreh indiferentizmin e tij ndaj një personi i cili është tema e bisedës në fjalë. Intonacioni luan një rol të veçantë, pikant, duke i dhuruar situatës një nuancë teatrale. Nuk mund të themi të njëjtat konsiderata për përdorimin në shembullin (61): folja në shqipe *të duash* është në të tashmen e lidhore, ndërsa në gjermanishten origjinale *hingehen willst* kemi ndërtim me folje modale në të tashmen dëftore "*folje modale wollen (dua) + folje kryesore në infinitiv*". Në shembullin (61) nuk kemi përputhje të rendit morfologjik, por të rendit emocional, stilistik dhe semantik.

17. *Përdorime të lidhore* hasim edhe pas përemrave lidhorë të pacaktuar: *kush, ç', cili etj..* Këtu lidhorja sinjalizon lejim apo mundësi të pacaktuar³⁹². Këto ndërtime të lidhore të shqipe

³⁹¹ Për shqipen: Fatmir Agalliu, *Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1988, f. 49.

³⁹² Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 135.

në gjermanishte jepen me ndihmën e foljes modale *mögen* dhe e shfaqin fare të pastër ngjyrosjen modale. Sipas Agalliut³⁹³ folja e fjalisë drejtuese duhet të ketë kuptimin kohor të së ardhmes, përndryshe folja e së varurës do të jetë në dëftore. Lidhur me këtë konstatim të tij në veprën "*Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe*", shohim përjashtim në përdorimin e mëposhtëm: në shembullin (64) folja në fjalinë drejtuese *le të vinte* është me kuptimin kohor të së shkuarës e megjithatë pas përemrit lidhor të pacaktuar *kush* vijon lidhorja. Le të vijë kush të dojë (63)/Le të vinte kush të donte (64).

(61)

Le të flasë kush të dojë.

Jeder der mag, soll sprechen. (... kann sprechen.)

(62)

Nuk e dija çfarë t'i thoja.

Ich wusste nicht, was ich sagen sollte.

(63)

Le të vijë kush të dojë!

Jeder der mag, soll kommen! (... kann kommen!)

(64)

Le të vinte kush të donte!

Jeder der wollte, sollte kommen!

18. Përdorimet e lidhore në *ffjali të nënrenditur qëllimore* pas lidhëzave: *që* (65), (66), *me qëllim që*, *në mënyrë që* nuk janë të shpeshta. Lidhëzat nënrenditëse që përdoren në gjermanishte në *Finalsatz* janë: *damit*, *um...* *zu* (*për të*, *me qëllim që*). Në gjermanishte në fjalitë qëllimore përpos Konjunktiv I përdoret edhe Konjunktiv II, por mënyra normale për të shprehur fjalitë qëllimore është dëftorja. Ndërsa në shqipe mënyra e vetme që përdoret në fjalitë qëllimore, pas lidhëzave *që*, *me qëllim që*, dhe *në mënyrë që* është lidhorja. Në disa përdorime në shqipe - më tepër në gjuhën e folur se sa në atë të shkruar - kur nga ana gramatikore lidhorja mund të zëvendësohet nga paskajorja, dhe nga ana kuptimore e stilistike folësi ka për qëllim të japë udhëzime apo këshilla, ai e lë jashtë lidhëzën e nënrenditur *që*. Megjithatë kuptimi i fjalisë nuk cënohet aspak. Kjo lidhet me faktin, që ngjyrimin modal në

³⁹³ Fatmir Agalliu, *Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1988, f. 50.

këto fjali e bart folja në lidhore dhe jo lidhëza e nënrenditur. Siç vërehet edhe në shembujt e kthyer, në gjermanishte nuk mund të formohet fjali e saktë nga ana gramatikore pa praninë e lidhëzave *damit*, *um...zu*. Pësia gramatikore dhe ngjyrimi modal i këtyre lidhëzave është tejet i madh dhe mungesa e tyre çon në një fjali të gjymtuar nga ana gramatikore dhe kuptimore: *Puno më shumë, (që) të kesh sukses! (Puno më shumë për të patur sukses!)/Arbeite harter, damit du erfolgreich bist!* dhe *Duhet të mundohesh më shumë, (që) të dalësh i pari! (Duhet të mundohesh më shumë për të dalë i pari!)/Du sollst dich mehr anstrengen, um den ersten Platz zu bekommen!*

(65)

Ai që ka akoma çizme në këmbë, i mbështjell me thasë (të vegjël³⁹⁴) rëre, të cilëve ua lidh grykën lart, që të mos u futet uji kollaj brenda. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 246)

Wer noch Stiefel trägt, bindet sie oben mit Sandsäcken zu, damit das Lehmwasser nicht so rasch hineinläuft. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, S. 252)

(66)

Unë kërkoj ndonjë copë, që t'i bëjmë një bandazh provizor. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 69)

Ich suche nach Stoff, um ihn lose darüber zu wickeln. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, S. 67)

Në shembullin (65) fjalia tregon një veprim të synuar - autori fillon të tregojë duke bërë një përshkrim të kujdesshëm plot detaje në të dyja gjuhët: *Ai që ka akoma çizme në këmbë... i mbështjell me thasë të vegjël rëre... të cilëve ua lidh grykën lart/Wer noch Stiefel trägt... bindet sie oben... mit Sandsäcken zu*. Në pjesën e nënrenditur ai shpreh qartë dhe direkt qëllimin për t'u realizuar në lidhje me tërë ato veprime të kryera në pjesën kryesore të fjalisë: *që të mos u futet uji kollaj brenda/damit das Lehmwasser nicht so rasch hineinläuft*. Është e vërtetë që fjalia në gjermanishte ka përdorim të dëftores, por nga konteksti vërehet qartë ngjyrimi modal i mundësisë, dhe jo i vërtetësisë: nuk është e sigurt, nëse uji do të hyjë në çizme apo jo, kjo gjë mbetet të vërtetohej në të ardhmen si e vetmja e vërtetë e mundshme.

19. Përdorime të lidhore në shqipe gjejmë edhe në ndërtime me strukturën "është + mbiemër/ndajfolje/emër": *është mirë/es ist gut* (66), *është gabim/es ist falsch*, *është e*

³⁹⁴ Plotësim përkthimi nga autorja e disertacionit.

domosdoshme/es ist notwendig, është e nevojshme/es ist nötig, është e rëndësishme/es ist wichtig, është e trishtueshme/es ist zum Verzweifeln, është e dobishme/es ist nützlich, do të ishte më mirë/es wäre besser (67)³⁹⁵. Të gjitha këto përdorime ngërthejnë në vetvete ngjyrimet modale.

(66)

Është mirë të bësh sport çdo ditë.

Es ist gut, jeden Tag Sport zu machen.

(67)

Do të ishte më mirë të bëje sport çdo ditë.

Es wäre besser, jeden Tag Sport zu machen.

(68)

Shtëpitë e ngurta, në lëvizje e sipër po i afroheshin kërcënueshëm njëra-tjetrës, ishte rrezik të përplaseshin, të shkatërroheshin. (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 163)

Die in Bewegung geratenen Häuser kamen einander bedrohlich nahe, liefen Gefahr, aufeinanderzuprallen und einzustürzen. (Chronik im Stein, Ismail Kadare, S. 190)

Në disa shembuj në gjermanishte lidhorja shfaqet te struktura: "është + mbiemër/ndajfolje/emër". Kjo gjë nuk ndodh në shqipe, ku lidhorja i pasvendoset këtyre strukturave. Duke qenë se në të tilla përdorime ndërtimet e lidhore në gjermanishte janë në gjendje të ngurtësuar, pra ndërtime të foljes në infinitiv me *zu*, koha dhe mënyra e fjalisë përcaktohet nga folja *jam/sein* në strukturën "është + mbiemër/ndajfolje/emër". Të krahasohen shembujt (66), (67), (68). Përdorime të tilla hasen më gjerë në gjuhën e folur, se sa në atë të shkruar letrare (68). Kjo për faktin se kontekste në të cilat ato mund të përdoren kanë më tepër karakter këshillues e udhëzues dhe gjejnë vend më mirë në dialogje të jetës së përditshme.

20. Gjithashtu përdorime të lidhore në shqipe gjejmë edhe pas shprehjeve me foljen "*jam + mbiemër*": *jam i lumtur/glücklich sein* (69), *jam i kënaqur/zufrieden sein*, *jam krenar/stolz sein*, *jam i detyruar/gezwungen sein* (70) etj.³⁹⁶ apo pas ndërtimeve me foljen "*kam + mbiemër*": *e kam të lehtë/es ist leicht für mich*, *e kam të vështirë/es ist schwierig für mich* (*es fällt mir schwer*). Ngjyrimin modal në këto struktura e mbart mbiemri i cili krijon marrëdhënie

³⁹⁵ Emine Teichmann, *Cikël leksionesh*, 2016.

³⁹⁶ Po aty.

me foljen në lidhore dhe e tërë vëmendja e theksi i fjalisë bie mbi mbiemrin. Kthimi në gjermanishte realizohet me ndihmën e strukturës "*folje në infinitiv me zu*". Forma konkurruese në shqipe është përdorimi "*lidhëza që + folje e pazgjedhuar*". Të krahasohen: *Jam i lumtur të jem këtu sot mes jush.* dhe *Jam i lumtur që jam këtu sot mes jush.* Ndryshim tjetër midis këtyre dy formulave gjuhësore në shqipe është i karakterit etik: *struktura me lidhore* është më formale e letrare se sa ajo *me lidhëzën që*. Struktura të tilla në të dyja gjuhët e orientojnë interesin e dëgjuesit/lexuesit në strukturën hyrëse - vëmendja e dëgjuesit/lexuesit nuk shkon aspak te struktura gramatikore me lidhore në shqipe apo tek ajo në infinitiv me zu në gjermanishte. E rëndësishme është se si ndjehet ligjëruesi: në shembullin (69) ai ndjehet i lumtur, ndërsa në (70) i detyruar. Gjendja emocionale e ligjëruesit e rrëmben skenën duke e lënë tërësisht në hije faktin se ku ndodhet folësi në shembullin (69) dhe ku duhet të shkojë ai në shembullin (70).

(69)

Jam i lumtur të jem këtu sot mes jush.

Ich bin glücklich, heute hier bei euch zu sein.

(70)

Unë jam i gatshëm të të financoj. (Me syrin e një kllouni, Heinrich Böll, f. 145)

Und ich bin bereit, dir das zu finanzieren. (Ansichten eines Clowns, Heinrich Böll, S.118)

(71)

E kam zor të të besoj. (Me syrin e një kllouni, Heinrich Böll, f. 149)

Es fällt mir schwer, dir zu glauben. (Ansichten eines Clowns, Heinrich Böll, S.120)

5.2. Marrëdhënia "ligjëratë e zhdrejtë:Konjunktiv" në gjermanishte përballë kthimit në ligjëratë të zhdrejtë në shqipe

Sipas Dudenit (DUDEN) funksioni gramatikor më i rëndësishëm i Konjunktiv-it³⁹⁷, lidhores në gjermanishte është ai në ligjëratën e zhdrejtë. Si rregull bazë në gjuhën e sotme gjermane vlen: mënyra normale e ligjëratës së zhdrejtë është lidhja³⁹⁸. Ndryshe qëndron çështja me shqipen: kthimi i ligjëratës së drejtë në të zhdrejtë, si rregull do të thotë ndryshim i kohëve gramatikore dhe jo i mënyrës. Përjasje të dy gjuhëve kemi në organizimin e përgjithshëm të procesit të kthimit të ligjëratës së drejtë në të zhdrejtë. Siç e thotë edhe teoria - në më të shumtën e rasteve në të dyja gjuhët fjalitë e ligjëratës së drejtë përmbajnë folje të të shprehurit dhe të të menduarit apo *Verba Dicendi et Sentiendi*, siç quhen në latinisht: *them/sagen, mendoj/denken, supozoj/behaupten, hamendësoj/vermuten, preferon/bevorzugen*, etj. Këtu vlen të përmendet shpeshtësia e ridhënies së ligjëratës së të menduarit në të dy korpuset tanë të përzgjedhur artistikë. Gjatë kthimit të një fjalie nga ligjërata e drejtë në të zhdrejtë hyjnë në lojë elemente "të dukshëm" dhe "të padukshëm" gramatikore. Fillimisht nevojitet të përmendin në vija të përgjithshme shndërrimin klasik që ndodh me fjalitë e ligjëratës së drejtë në të dyja gjuhët: fjalitë e kryesore kthehen në fjali të nënrenditura, zakonisht me anë të lidhëzës *dass* në gjermanishte apo *që* dhe *se* në shqipe (72), duke krijuar në këtë mënyrë fjali të nënrenditur – në këtë hap gramatikor kemi përputhje të të dyja gjuhëve. Në disa raste si në shqipe edhe në gjermanishte lidhëza nënrenditëse bie, por kuptimi i fjalisë mbetet i njëjtë. Për të trajtuar më konkretisht kthimin e ligjëratës së drejtë në të zhdrejtë në të dyja gjuhët, mendojmë të ndalemi në dy hallka kryesore të këtij procesi: në shndërrimin e kohës dhe atë të mënyrës. Së fundmi do të japim edhe disa shembuj konkretë lidhur me format konkurruese të lidhores në ligjëratën e zhdrejtë në gjermanishte përballë atyre në shqipe.

(71)

Als er sich beschweren wollte, lachte ihn der Kompanieführer aus und sagte, er solle doch aufpassen; (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, S. 28)

³⁹⁷ Midis Konjunktiv I dhe Konjunktiv II në gjermanishte, ligjëruesi/shkrimtari bën si zgjedhje të parë Konjunktiv I, ndërsa Konjunktiv II vlen si zgjedhje e dytë, kur format e lidhores nuk dallojnë nga ato të dëftores. (Duden, 2003:165)

³⁹⁸ DUDEN, *Grammatik der deutschen Gegenwartssprache*, Duden Band 4, Mannheim, Leipzig, Wien, Zürich, 2003, f. 168-169.

Kur shkoi të ankohej, komandanti i kompanisë e talli dhe e këshilloi, që, herë tjetër, të kishte mendjen e t'i bënte sytë katër; (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 30)

Ndryshimi i mënyrës dhe i kohës gjatë kthimit në ligjëratën e zhdrejtë: më lart përmendëm rregullin bazë, që vlen në gramatikën e sotme gjermane, në të cilin përcaktohet lidhja si mënyra e ligjëratës së zhdrejtë, por duhet të themi, që kjo nuk është e vetmja mundësi gramatikore për të realizuar këtë kthim në gjermanishte. Në disa përdorime ruhet gjatë kthimit në ligjëratë të zhdrejtë mënyra dëftore e ligjëratës së drejtë – në këtë proces koha e mënyrës dëftore e përdorur në ligjëratën e drejtë, zakonisht mbetet e pandryshuar. Nëse mënyra dëftore nuk ruhet gjatë kthimit në ligjëratë të zhdrejtë, atëherë koha e dëftores në ligjëratën e drejtë do të shndërrohet në kohën përkatëse në lidhore³⁹⁹. Gjatë kthimit të ligjëratës së drejtë në të zhdrejtë në gjermanishte e tashmja dhe e ardhmja mbeten të pandryshueshme. Tri kohët e së shkuarës: preteritumi, e kryera dhe më se e kryera kthehen në të kryer. Ndryshe qëndron çështja në shqipe: të gjitha kohët shndërrohen: e tashmja → në të pakryer; e pakryera dhe e kryera e thjeshtë apo Aorist I → në të kryer; e kryera → më se të kryer; e ardhmja → në ardhmen e së shkuarës e kështu me rradhë⁴⁰⁰. Gjuha gjermane dhe ajo shqipe përqasen në përdorimin e lidhore, kur kthejmë fjalitë e mënyrës urdhërore (72) në ligjëratë të zhdrejtë dhe kur kemi përdorime të foljeve të të shprehurit dhe të të menduarit (73). Në të dyja rastet e përmendura kemi përdorime me ngjyrim modal. Edhe fjalitë e mënyrës dëshirore në shqipe kthehen në ligjëratën e zhdrejtë përmes lidhore - këtu kemi përqasje të pjeshme me gjermanishten, pasi flasim për përdorim të lidhore. Në shqipe mund të përdoret mënyra habitore kur ligjëruesi apo shkrimtari duan të distancohen nga ajo çka thuhet⁴⁰¹ (76d).

(72)

Ligjëratë e drejtë:

Geh jetzt nach Hause! – sagte der Vater zu Peter.

Shko tani në shtëpi! – i tha babai Peterit.

Ligjëratë e zhdrejtë:

*Der Vater sagte zu Peter, er **solle** jetzt nach Hause **gehen**.*

*Babai i tha Peterit **të shkonte** në shtëpi.*

³⁹⁹ Për këtë shih: DUDEN, *Grammatik der deutschen Gegenwartssprache*, Duden Band 4, Mannheim, Leipzig, Wien, Zürich, 2003, f. 165.

⁴⁰⁰ Vjosa Morina, *Magisterarbeit "Modus und Tempus im Deutschen und Albanischen"*, Wien, 2009, f. 75.

⁴⁰¹ Po aty.

(73)

Ligjëratë e zhdrejtë:

*Peter behauptet, er **habe** das Buch gestern hier **gesehen**.**Peteri pretendon, ta **ketë parë** librin dje këtu.*

Koncepti apo rregulli i kthimit të ligjëratës së drejtë në të zhdrejtë është ndryshimi i ligjëritimit në formë, por jo në përmbajtje. Megjithatë, ligjëruesi, si transmetues potencial dhe i vetëm i së vërtetës së dëgjuar apo së lexuar luan rol jo pak të rëndësishëm - shpesh në gjuhën e folur është e pashmangshme, që ai vetë të mos i japë një ngjyrosje modale asaj që thuhet, të mbajë një qëndrim personal, duke ia obliguar këtë edhe dëgjuesit. Këtë ndikim ai e luan që në pikënisje të ligjëritimit, me për zgjedhjen e foljes të të shprehurit (75d), (75e), të ndjafoljeve (75a) apo togfjalëshave (75b), (75c). Shpesh në gjermanishte për të dhënë ligjëratën e zhdrejtë paraqiten disa forma konkurruese të mënyrës lidhore ose siç quhen ndryshe forma konkurruese të ligjëratës së zhdrejtë⁴⁰². Nga kthimet në shqipe (75), konstatojmë që këto vlerësime mbi format konkurruese të ligjëratës së zhdrejtë vlejné edhe për gjuhë shqipe.

(74)

Ligjëratë e drejtë:

*Ich habe gestern das Buch hier gesehen. – sagte Peter.**Unë e kam parë librin dje këtu – tha Peter.*

Ligjëratë e zhdrejtë – kthimi klasik:

*Peter hat gesagt, dass er das Buch gestern hier gesehen hat. ose Peter hat gesagt, er **habe** das Buch hier gestern **gesehen**.**Peteri tha, që e ka parë dje librin këtu. ose Peteri tha, ta **ketë parë** librin dje këtu.*

(75)

Ligjëratë e zhdrejtë – format konkurruese:

a) *Angeblich **hat** Peter das Buch gestern hier **gesehen**.**Me sa duket Peteri e **ka parë** këtu dje librin.*a) *Nach seinen Worten **hat** Peter das Buch hier gestern **gesehen**.**Sipas fjalëve të tij, Peter-i e **ka parë** dje këtu librin.*b) *Wie Peter sagt, **hat** er das Buch hier gestern **gesehen**.*

⁴⁰² Për këtë shih: Gerhard Helbig & Joachim Buscha, *Deutsche Grammatik, ein Handbuch für Ausländerunterricht*, Berlin und München: Langenscheidt, 2001, f. 180.

Siç thotë Peteri, ai e ka parë këtu librin dje.

- c) *Peter will gestern das Buch hier gesehen haben.*

Peteri e paska parë këtu dje librin.

- d) *Peter behauptet, das Buch gestern hier gesehen zu haben.*

Peteri pretendon, të ketë parë librin dje këtu.

Dy elemente shoqëruese të tjerë gjatë kthimit në ligjëratë të zhdrejtë janë *perspektiva e ligjëruesit* dhe *ruajtja e informacionit të dhënë në ligjëratën e drejtë*. Kur ligjëruesi i origjinës thotë diçka si të vërtetë (74), është e pashmangshme, që autori i ligjëratës së zhdrejtë të mos mbajë një qëndrim ndaj asaj që ai do të transmetojë – ndodh që ai ta "deformojë lehtësisht" këtë të vërtetë në mënyrë të qëllimshme apo jo, jo duke ndryshuar thënien e autorit origjinal, por në vendimmarrjen e tij se cilët elemente gramatikorë do të përzgjedhë (75) për të referuar në ligjëratën e zhdrejtë. Përpos kësaj, ndodh, jo domosdoshmërisht, që një element apo një pjesë e elementeve të fjalisë të ligjëratës së drejtë, të lihen jashtë gjatë kthimit në ligjëratë të zhdrejtë. Kuptohet që këto nuk bëjnë pjesë në grupin e elementeve të domosdoshëm për realizimin e kthimit në ligjëratë të zhdrejtë. Shpesh në komunikimin tonë të përditshëm ndodh që pasi na është thënë diçka në ligjëratë të zhdrejtë, na krijohet përshtypja e të qënurit jo pranë së vërtetës së ligjëruar dhe përgjigjemi me pyetjen: cilat ishin fjalët konkrete të tij/saj? Kjo mbështet atë çka trajtuam më sipër. Gjithashtu nuk mund të lihet pa u përmendur roli i intonacionit që përdor ligjëruesi, si element që ndikon në ngjyrimin modal të ligjërimit. Fakti gramatikor që gjermanishtja zgjedh lidhoren për të kthyer ligjëratën e drejtë, e cila është mënyra e mundësisë, e joreales, e vesh ligjëratën e zhdrejtë deri diku me petkun e jo të vërtetës. Nëse ne, njerëzit si përdorues potenciale të gjuhës, do të flisnim për vërtetësinë e ligjëratës së zhdrejtë, me siguri që do të kishim rezervimet tona.

5.3. Konjunktiv II në gjermanishte – shprehje e mirësjelljes

Gjuha gjermane ka zhvilluar e kuruar një anë saj për të shprehur mirësjelljen – këtu bëhet fjalë pikërisht për Konjunktiv II si strukturë gramatikore për të drejtuar një pyetje (76), një lutje (77), (80), një kërkesë (78), (79) apo qoftë edhe për të shprehur një mendim ndryshe nga parafolësi (81), (82). Këto përdorime të Konjunktiv II janë shumë të favorshme për të dyja palët e përfshira në ligjërim, si për ligjëruesin edhe për bashkëbiseduesin: bashkëbiseduesit i

krijohet ambjent i rehatshëm komunikues duke i lënë hapësirë veprimi, dhe duke mos e kushtëzuar apo vënë në siklet në veprimet e tij, ndërsa ligjëruesi përmes gjuhës së kuruar të përdorur "fiton" në më të shumtën e rasteve një përgjigje pozitive ndaj kërkesës apo lutjes së tij. Është me të vërtetë e habitshme se sa e madhe është forca bindëse e fjalëve të përzgjedhura me kujdes: duke qenë se bashkëbiseduesi ndjehet shumë mirë në kërkesën apo lutjen drejtuar atij me mirësjellje dhe respekt, atij i mbetet shumë pak hapësirë që të thotë jo – dhe në të vërtetë, po për arsye mirësjelljeje, ky i fundit nuk e bën këtë gjë⁴⁰³. Spektri i përdorimit të Konjunktiv II në lutje apo kërkesa të tilla është tejet i gjerë. Populli gjerman si përdorues aktiv i gjermanishtes ndjehet mirë në përdorimet e Konjunktiv II, si në gjuhën e folur ashtu edhe në atë të shkruar. Shpesh kjo lidhore vlen si mjet gjuhësor i favorshëm, nëse ligjëruesi mendon të shprehë një mendim ndryshe nga parafolësi (81), duke mënjanuar kështu keqkuptimet midis bashkëbiseduesve.

(76)

Hätten Sie einen Augenblick Zeit für mich?

Keni një moment kohë për mua? Më rrallë: A do të kishit një moment kohë për mua?

(77)

Würden Sie bitte Platz **nehmen**?

Uluni, Ju lutem!!/Zini vend, Ju lutem!

(78)

Würden Sie bitte mir **helfen**?

A më ndihmoni, ju lutem?

(79)

Dürfte ich Sie um einen Gefallen **bitten**?

Do të më bënit një nder? (a) Por edhe: Mund t'ju **lutem** për një nder? (b)

(80)

Wären Sie so nett und **würden** mir **helfen**?

Jeni aq i sjellshëm **të** më **ndihmoni**?

(81)

Ich **wäre** damit nicht ganz **einverstanden**.

Unë nuk jam plotësisht dakord.

⁴⁰³ Për këtë shih: Harald Weinrich, *Textgrammatik der deutschen Sprache*, Dudenverlag, 1993, f. 257.

(82)

*Ich hätte da meine Zweifel.**Për këtë kam dyshimet e mia.*

Gjuha shqipe nuk e ka kaq të kuruar sikur gjermanishtja këtë moment gjuhësor. Nëse shohim kthimet në shqipe, mund të themi të bindur, që shqipja është më direkte në përdorime të tilla duke përdorur dëftoren (76), (78a), (81), (82), lidhoren (79b) apo urdhëroren (77). Shpesh hasen edhe përdorime me folje modale (79b). Në shembullin (76) vihet lehtësisht re, që në gjermanishte ligjëruesi i drejtohet bashkëbiseduesit me formen e respektit, me Konjunktiv II, ndërsa ligjëruesi në shqipe përdor format e mënyrës urdhërore me ngjyrimin modal të lutjes, të shoqëruar me intonacionin karakteristik, por gjithsesi gjuha shqipe vendos për urdhëroren. Në shqipe theksi vihet më shumë në intonacionin e përdorur në këto pyetje-lutje-kërkesa, ai është "arma" e respektit për të arritur në sukses. Alternativa gjuhësore për përdorime të lidhore në struktura politese e respekti në gjermanishte do të ishte dëftorja apo urdhërorja, por rezultati i përfutur, nuk do të ishte kurrësi i njëjti, për të dyja palët do të kishte pakënaqësi. Përdorimi i dëftores jo vetëm që nuk e mundëson veshjen e një pyetjeje me petkun e lutjes, të zbutjes së kërkesës etj., por kurrësi nuk transmeton elegancën dhe respektin që arrihet vetëm me përdorimin e Konjunktiv II. Të krahasohen: *Haben Sie einen Augenblick Zeit für mich? Helfen Sie mir bitte!* me ***Hätten Sie einen Augenblick Zeit für mich? Würden Sie mir bitte helfen?***

KREU VI

MËNYRA KUSHTORE

6.1. Mbi mënyrën kushtore në shqipe dhe gjermanishte

Terma *mënyrë kushtore* i përgjigjet termës latine *modus conditionalis*⁴⁰⁴. Me anë të kësaj mënyre në shqipe shprehet modaliteti i mundësisë duke u afruar kështu me lidhoren. Ajo është shpesh e barasvlershme me të pakryerën, përkatësisht me më se të kryerën e lidhore, të prirë nga folja modale *mund*⁴⁰⁵. Në sistemin foljor të gjermanishtes së sotme nuk gjenden forma foljore të mënyrës kushtore. Përballë mënyrës lidhore dhe kushtore së shqipes qëndron ajo lidhore në gjermanishte. Në gjuhën e sotme gjermane flitet për *Konditionalsatz* – fjalinë kushtore, por jo për një mënyrë kushtore më vete. Nëse ndalemi pak në historinë gjuhësore, themi që edhe kushtorja e shqipes ka patur momentet e saj pak të "favorshme", përse i përket njohjes apo pranimi si mënyrë më vete në sistemin foljor të shqipe standarde, qoftë nga gjuhëtarë shqiptarë apo të huaj – këtu mund të përmendim qëndrimet unike të S. Frashërit apo F. Agalliut, të cilët i trajtonin format e kushtores si forma të së ardhmes të së shkuarës të mënyrës dëftore. Kur diskutojmë për ndërtimet gramatikore të formave kohore të kushtores së shqipes dhe origjinën e tyre, përgjigja është e thjeshtë: këto forma kohore duhet të listohen tek dëftorja, por është pikërisht kuptimi modal i mundshmërisë i shprehur përmes këtyre formave kohore në përdorimet e tyre nëpër apodosa periudhash hipotetike të mundësisë dhe të

⁴⁰⁴ Shaban Demiraj, *Morfologji e gjuhës së sotme shqipe*, II, Tiranë, 1970, f. 212.

⁴⁰⁵ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 328.

pamundësisë, i cili i bën ata të distancohen nga kuptimi modal i vërtetësisë që shprehin format kohore të dëftores⁴⁰⁶. Folja e përdorur në mënyrën kushtore, tregon një veprim që mund të kryhej, po të vërtetohej një kusht i caktuar (1). Ai mund të jetë i realizueshëm në të ardhmen ose i parealizueshëm, se s'është realizuar ose është i parealizueshëm kushti. Kushti zakonisht shprehet me anë të një fjalie të varur kushtore, kallëzuesi i së cilës është një folje në të pakryerën e lidhore ose në më se të kryerën e saj⁴⁰⁷. Si në lidhore ashtu edhe në kushtore modaliteti i shprehur nga folja fiton dukshëm terren përballë kuptimit kohor të saj. Ndryshimi midis përdorimeve të së tashmes dhe të kryerës në kushtore dhe së ardhmes të së shkuarës dhe të ardhmes së përparme të së shkuarës në dëftore qëndron në modalitetin që i karakterizon ato: kohët e dëftores karakterizohen nga tipari modal i vërtetësisë, ndërsa te kohët e kushtores kuptimet kohore janë të mpleksura me kuptimin e modalitetit, i cili del në plan të parë⁴⁰⁸.

Krahasur me lidhoren, në shqipe kushtorja ka një spektër më të ngushtë përdorimi. Duket sikur kjo mënyrë mbush ato boshllëqe dhe shkon deri aty, ku nuk mund të hyjë lidhorja. Kushtoren e hasim si në gjuhën letrare ashtu edhe në atë të folur, duke realizuar struktura gjuhësore me ngjyrim të veçanta në bashkëudhëtim të ngushtë me intonacionin tipik që e shoqëron fjalinë. Kushtorja nuk gjen përdorim në tekste me natyrë shkencore – përjashtim këtu bëjnë rastet kur autori ka për qëllim të ngrejë hipoteza.

(1)

Po të isha në vendin tënd, do të përpiqesha të bëhesha toger. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 77)

An deiner Stelle, würde ich sehen, dass ich Leutnant würde. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 74)

Në shqipe kushtorja ka dy kohë: *të tashmen* dhe *të kryerën*. E tashmja kushtore tregon një veprim, që mund të kryhet para ose pas çastit të ligjërit, në rast se vërtetohet një kusht i caktuar⁴⁰⁹: *Po të ishin peshkaqenët njerëz, do të bënin edhe luftëra me njëri- tjetrin./Wenn die Haifische Menschen wären, würden sie auch untereinander Kriege führen*. E kryera kushtore

⁴⁰⁶ Për këtë shih: Shaban Demiraj, "Rreth kategorive gramatikore të mënyrës dhe të kohës në gjuhën shqipe", SF 3, 1977, f. 103/105.

⁴⁰⁷ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 327.

⁴⁰⁸ Për këtë shih: Shaban Demiraj, "Rreth kategorive gramatikore të mënyrës dhe të kohës në gjuhën shqipe", SF 3, 1977, f. 106.

⁴⁰⁹ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 328.

tregon një veprim, i cili mund të ishte realizuar në të shkuarën, në rast se do të ishte plotësuar një kusht i caktuar. Në momentin e ligjëritit veprimi shprehet si i perealizueshëm, duke qenë se kushti nuk është plotësuar: *Po të kishte qenë kohë e mirë, do të kisha bërë një shëtitje me biçikletë.*/Wenn das Wetter gut gewesen wäre, hätte ich eine Fahrradtour gemacht⁴¹⁰. Duke qenë se në gjermanishte nuk gjenden paradigma foljore të mënyrës kushtore është e pamundur të flitet për krahasim mbi nivelin morfologjik midis dy gjuhëve. Krahasimi ynë do të vijojë në rrafshin semantik dhe funksional duke përvijuar mjetet gramatikore që ka në dispozicion gjermanishtja për të mbuluar a shprehur fjalitë e mënyrës kushtore të shqipes.

6.2. Përdorime të mënyrës kushtore në shqipe dhe format gjegjëse në gjermanishte

Fjalitë e mënyrës kushtore në shqipe paraqesin interes studimi nëse i trajtojmë të kategorizuara në tipet e fjalive që ato shfaqen, më tepër se sa po të trajtohen të ndara sipas kohëve të përdorimeve. Nisur nga kjo më poshtë do të shqyrtojmë tipet e fjalive në mënyrën kushtore në shqipe duke dhënë respektivisht gjegjësen e tyre në gjermanishte. Fjalitë që përdoren me kushtore janë të thjeshta edhe të nënrenditura; lidhëzat nënrenditëse të këtyre fjalive në shqipe janë: *sikur, nëse, po, në qoftë se, po qe se/që* etj. Përballë këtyre lidhëzave në gjermanishte qëndrojnë lidhëzat nënrenditëse *wenn, als ob, als wenn* etj.

Fjalitë e mënyrës kushtore në shqipe shfaqet në:

1. Në fjalitë joreale *pohuese* (2), *pyetëse* (3), pra në fjali kryesore, *kuptimi i të cilave nuk është real, por thjesht i supozuar*. Këto përdorime janë në fjali të thjeshta dhe hasen kryesisht në dialogje, si në gjuhën e folur ashtu edhe në atë shkruar letrare, duke i dhënë ligjëritit një ngjyrosje karakteristike modale⁴¹¹.

(2)

Ai do të kishte patur sukses.

Er wäre erfolgreich gewesen.

(3)

⁴¹⁰ Emine Teichmann, *Cikël leksionesh*, 2016.

⁴¹¹ Po aty.

A do t'i flisje ti kështu babait?

Würdest du so mit Vater sprechen?

Në shembullin (2) folja në shqipe *do të kishte patur* është në të kryerën kushtore. Vërtet kemi përdorim me fjali pohuese, por ligjëruesi bën një supozim duke folur për diçka joreale, dhe nëse kemi realizim apo jo, është e pamundur të vërtetohet. Në shembullin (3) folja në shqipe *do t'i flisje* është në të tashmen kushtore - me anë të fjalisë pyetëse ngrihet një supozim: nëse përgjigja për këtë është pozitive apo negative nuk jepet në fjali dhe gjithashtu nuk përbën rëndësi. Në të dy shembujt kthimi në gjermanishte realizohet përmes mënyrës lidhore, herë me strukturë në kohën e shkuar (2) (Konjunktiv II Vergangenheit) *Er wäre ... gewesen* e herë me strukturë në kohën e tashme (3) (Konjunktiv II Gegenwart) *Würdest du ... sprechen* duke ndihmuar të shprehurin e një situatë joreale, të supozuar. Intonacioni shoqërues në të dy shembujt luan një rol të rëndësishëm – ai është karakteristik dhe paraqitet me nuanca të ndryshme: në fjalinë pohuese (2) ky intonacion është konstant, ndërsa në atë pyetëse (3) ai është ngjithës, me ngjyrim modal, dhe në shembullin tonë përpos hakisë së shprehur në formën e pyetjes, ai ka ton qortues. Në të dy shembujt (2) dhe (3) kemi përjasje midis shqipes dhe gjermanishtes në rrafshin semantik, sintaksor, stilistik dhe atë emocional.

2. Në fjali kushtore joreale: Nga të gjitha përdorimet e mënyrës kushtore në shqipe spektrin më të gjerë e zënë pikërisht fjalitë kushtore joreale⁴¹², të cilat mendojmë se gjejnë dukshëm përdorim në literaturën artistike, por edhe në gjuhën e folur, kryesisht në situata të përditshme.

(4)

Po të ishim kthyer në shtëpi më 1916, do të kishim ditur të shpërthenim një stuhi nga gjithë ato shembje e ato përjetime të fuqishme. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 251)

Wären wir 1916 heimgekommen, wir hätten aus dem Schmerz und der Stärke unserer Erlebnisse einen Sturm entfesselt. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 257)

(5)

Po të isha në vendin tënd do të përpiqesha të bëhesha toger. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 77)

⁴¹² Po aty.

An deiner Stelle würde ich sehen, dass ich Leutnant würde. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 74)

Në të dy shembujt (4) dhe (5) kushtet shprehen me mënyren lidhore si në shqipe edhe në gjermanishte: *Po të ishim kthyer në shtëpi* (4) është në të kryerën lidhore, *Wären wir heimgekommen* në të tashmen lidhore (Konjunktiv II Gegenwart); *Po të isha në vendin tënd* (5) është në të pakryerën lidhore, *An deiner Stelle würde ich sehen* në të tashmen lidhore (Konjunktiv II Gegenwart). Veprimet në shembujt (4) dhe (5) në shqipe të cilat shprehen me mënyrën kushtore **do të kishim ditur** të shpërthenim një stuhi nga gjithë ato shembje e ato përjetime të fuqishme (4) në të kryerën e kushtores, **do të përpiqesha** të bëhesha toger (5) në të tashmen e kushtores, paraqiten si të mundshme, me potencial realizimi, nëse do të vërtetohej kushti i shprehur. Duke qenë se bëhet fjalë për veprime të mundshme në të dy shembujt në gjermanishten origjinale autori ka përdorur ndërtime në të shkuarën e lidhore (Konjunktiv II Vergangenheit): *hätten ... entfesselt* (4), ndërsa *würde sehen* (5) në të tashmen e lidhore (Konjunktiv II Gegenwart). Nëse kemi realizim të veprimit apo jo, kjo mbetet çështje e hapur – as konteksti nuk na ndihmon për të kuptuar më tej. Gjithsesi jemi të mendimit se struktura të tilla të kushtores nuk kanë për qëllim të japin një informacion nëse kemi realizim apo jo - përdorimet e saj lidhen më shumë me përcjelljen e një mesazhi të mundshëm, nëse realiteti do të ishte ndryshe, nëse një kusht i dhënë do të plotësohej.

(6)

Po të ndodhte kjo gjë, do të hapeshin përnjëherësh me dhjetëra dritare, gratë dhe plakat **do të shkullnin** faqet e *do të mallkonin dhe më në fund dikush do t'i hidhte* ujë guximtarit. (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 43)

Und wäre es dennoch geschehen, hätten sich schlagartig Dutzende von Fenstern geöffnet, Frauen und Greisinnen hätten sich die Haare gerauft und Verwünschungen ausgestoßen, und schließlich hätte jemand Wasser auf den Vorwitzungen herabgeschüttet. (Chronik im Stein, Ismail Kadare, Seite 51)

Në shembullin (6) përdorimet e së tashmes kushtore janë veprime të kushtëzuara potencialisht dhe joreale, në të cilat si kushti *Po të ndodhte kjo gjë* dhe pasoja *do të hapeshin, do të shkullnin, do t'i hidhte* ndodhin njëkohësisht në të shkuarën. Kthimi në gjermanishte është realizuar me strukturë në lidhore, pikërisht me *Konjunktiv II në të shkuarën* (*hätten sich geöffnet, hätten sich gerauft, hätte herabgeschüttet*).

3. Në fjalitë lejore joreale: Përdorime të tilla si në shqipe edhe në gjermanishte kërkojnë që lidhëzat nënrenditëse të shoqërohen me elemente gjuhësorë shtesë, si p.sh.: *edhe sikur, edhe* (7), *edhe po*⁴¹³ në shqipe dhe *selbst wenn, auch wenn, selbst wenn* në gjermanishte. Ndërsa në pjesën kryesore fjalia përmban pjesëza të mohimit *s'* apo *nuk* në shqipe dhe *nicht* në gjermanishte. Në këto përdorime të dyja gjuhët afrohen me njëra-tjerën e këtu shtojmë që shembujt e fjalive lejore joreale përmbajnë zakonisht nuancë negative: edhe nëse do të plotësohej kushti i përmendur me folje në mënyrën lidhore (7) në të dyja gjuhët në pjesën e nënrenditur *Edhe babai të të vinte bashkë me ata përtej/Käme dein Vater mit denen drüben*, kuptohet që realizimi i veprimit në pjesën kryesore pengohet, nuk lejohet të realizohet *ti s'do të ngurroje t'ia vërvitje granatën gjoksit/du würdest nicht zaudern, ihm die Granate gegen die Brust zu werfen*. Ndërtimi foljor me mënyrën kushtore në shqipe *ti s'do të ngurroje t'ia vërvitje granatën gjoksit* në gjermanishte jepet me strukturë në të tashmen e lidhore (Konjunktiv II Gegenwart) *du würdest nicht zaudern, ihm die Granate gegen die Brust zu werfen*.

(7)

Edhe babai të të vinte bashkë me ata përtej, ti s'do të ngurroje t'ia vërvitje granatën gjoksit!
(Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 105)

Käme dein Vater mit denen drüben, du würdest nicht zaudern, ihm die Granate gegen die Brust zu werfen! (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 103)

4. Në fjalitë krahasuese joreale⁴¹⁴: Lidhëzat nënrenditëse që mund të përdoren në këto tipe fjalish janë të njëjta: në shqipe lidhëza *sikur*, ndërsa në gjermanishte *als ob/als wenn*. Duke vijuar themi që, tipike për këto ndërtime është fuqia që bart domethënia e fjalisë së nënrenditur krahasuese joreale, e cila karakterizohet nga ngjyrimet modale të theksuara duke gjetur përdorim si në letërsinë artistike, ashtu edhe në ligjërimin e folur. Këto fjali janë të veshura me emocione të forta të cilat përcillen te dëgjuesi/lexuesi duke e përfshirë nëpër imagjinatë krahasuese joreale (8), (9), (10).

(8)

Ajo ulëriti aq fort, sikur do t'i shkullnin zemrën nga kraharrori.

Sie schrie so laut, als ob man ihr das Herz aus der Brust rausnehmen würde.

⁴¹³ Po aty.

⁴¹⁴ Po aty.

(9)

*Dukej sikur sytë **do t'i dilnin** vendit nga inati.**Es schien, als ob seine Augen vom Zorn rausspringen würden.*

(10)

*Dukej sikur **do të sillte** pranverën me zërin e saj të magjishëm.**Es war, als ob sie den Frühling mit ihrer bezauberten Stimme bringen würde.*

Në shembullin (8) në të dyja gjuhët pjesa kryesore *Ajo ulëriti aq fort/Sie schrie so laut* shpreh një të vërtetë, një realitet, prandaj edhe foljet janë në mënyrën dëftore; pjesa e nënrenditur shpreh një krahasim i cili nuk është real, por i supozuar, e nisur nga kjo në shqipe përdoren forma foljore të kushtores *sikur **do t'i shkulnin** zemrën nga kraharori*, ndërsa në gjermanishte kemi ndërtim me folje në të tashmen e lidhore (Konjunktiv II Gegenwart) *als ob man ihr das Herz aus der Brust rausnehmen würde..*

Në shembullin (9) në pjesën kryesore foljet *Dukej/Es schien* në të dyja gjuhët janë në mënyrën dëftore, ndërsa krahasimi që vijon në pjesën e nënrenditur është joreal – në gjuhën shqipe kemi ndërtim me strukturë në të tashmen kushtore *sikur sytë do t'i dilnin vendit nga inati*, ndërsa në gjermanishte ndërtim me folje në të tashmen lidhore (Konjunktiv II Gegenwart) *als ob seine Augen vom Zorn rausspringen würden*. Gjuha e përdorur është e fuqishme – fjalia hyrëse shërben për të tërhequr vëmendjen e dëgjuesit, për ta përfshirë atë më tej në botën joreale të krahasimit. Pushimi që ekziston midis *dukej/es schien* dhe pjesës tjetër të fjalisë ka një funksion domethënës, pikërisht atë të rritjes së tensionit emocional të dëgjuesit/lexuesit për atë çfarë vjen më pas, dhe e tërë vëmendja e tij përqëndrohet në atë çka vijon.

Shënim: Duke qenë se në lidhja e gjermanishtes qëndron përballë lidhore dhe kushtores së shqipe, kemi menduar që përfundimet për kapitullin e lidhore dhe kushtores t'i përmbledhim në një të vetme.

KREU VII

MËNYRA DËSHIRORE

7.1. Mbi mënyrën dëshirore në shqipe dhe gjermanishte

Terma *mënyra dëshirore* i përgjigjet termës latine *modus optativus*⁴¹⁵ – me anë të kësaj mënyre shprehet modaliteti i dëshirës, dëshirë e folësit në formë urimi (1) apo mallkimi⁴¹⁶ (2).

(1)

Pra, mbetsh me shëndet! (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 150)

Alles Gute! (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 151)

(2)

Plaç të preftë, - i bërtiti një plakë... (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 97)

“Geh zum Teufel!” schrie ihm eine Alte an. (Chronik im Stein, Ismail Kadare, S. 112)

Dëshirorja e shqipes në formatin e saj të posaçëm paraqitet shumë e vështirë për t’u sqaruar historikisht. Në shumë gjuhë indoevropiane ka ndodhur përzjerja e lidhore me dëshiroren, ndërkohë në sistemin foljor të shqipes është vërtetuar një prirje e kundërt, ajo për t’i dalluar sa

⁴¹⁵ Shaban Demiraj, *Morfologji e gjuhës së sotme shqipe*, II, Tiranë, 1970, f. 216.

⁴¹⁶ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Tiranë, 2002, f. 329.

më qartë formalisht kuptimet modale⁴¹⁷. Në shqipe dëshirorja dallohet shkoqur si për nga format foljore, edhe për nga kuptimet modale përkatëse, pra themi që është një mënyrë e përvijuar. Parë në këndvështrimin e asaj që shpreh dëshirorja, intensiteti i përdorimeve të kësaj mënyre ka një shtrirje relativisht të ngushtë, si në ligjërimin verbal, kryesisht në atë popullor, por jo vetëm, ashtu edhe në atë të shkruar, duke u fokusuar në literaturën artistike e nuk është e pranishme në tekste a literatura me karakter shkencor.

Ndryshe qëndron çështja në gjuhën e sotme gjermane, ku nuk gjenden paradigma foljore të mënyrës dëshirore. Fillimisht në këtë gjuhë gjendeshin katër mënyra: midis tri mënyrave të pranuara tashmë (dëftore, lidhore dhe urdhërore) edhe një mënyrë e katërt e ashtuquajtur “forma e dëshirës“, “*Optativi*“, e cila me kalimin e kohës iu bashkëngjiti lidhore. Andaj lidhoreja në gjermanishte ka aq shumë nuanca kuptimore dhe nuk është gjithmonë lehtësisht e dallueshme⁴¹⁸. Më lart përmendëm, që sot gjuhëtarët nuk e pranojnë apo njohin mënyrën dëshirore si mënyrë më vete në gjermanishte. Por ky qëndrim nuk ka qenë gjithmonë kështu ose të paktën jo kaq i prerë. Historia e gramatikës së gjuhës gjermane na tregon se hasim përdorime të termit *der Optativ* (mënyrë dëshirore). Ajo çka gjuhëtarët ngrenë si çështje dhe diskutojnë është pikërisht shfaqja e pastër ose jo e kësaj mënyre, por nuk e vënë në diskutim që ajo ekziston. Midis tri mënyrave tashmë në gjuhën e sotme gjermane, disa autorë kanë pranuar dëshiroren dhe eksklamativin (habitoren), edhe pse me rezerva e duke i vendosur shpeshherë në pikëpyetje. Openrajderi (Oppenrieder) klasifikon dëftoren, lidhoren dhe urdhëroren në klasa të mëdha ose qëndrore, ndërkohë që dëshiroren dhe habitoren (eksklamativin) i klasifikon në klasa të vogla ose periferike⁴¹⁹. Dëshiroren që nuk përmban asnjë përbërës të lidhore Karnapi (Carnap) e quan “dëshirore të pastër“⁴²⁰. Disa gjuhëtarë njohin dhe përmendin fjalinë dëshirore nën termin “*Desiderativsatz*“ në vend të “*Optativsatz*“ (Meibauer, Steinbach, Altmann, 2013:3)⁴²¹.

⁴¹⁷ Shaban Demiraj, *Morfologjia historike e gjuhës shqipe (pjesa II)*, Tiranë, 1976, f. 22.

⁴¹⁸ Emma-Lotta Myllyharju, *Zum Konjunktiv I im Deutschen Ein Vergleich zwischen der grammatischen Beschreibung und der Sprachwirklichkeit unter besonderer Berücksichtigung der Sprachentwicklung*, Pro Gradu Arbeit, Institut für moderne und klassische Sprachen, Deutsche Sprache und Kultur, Universität Jyväskylä, 2009, f. 4.

⁴¹⁹ Stefan Rabanus, *Intonatorische Verfahren zwischen dem deutschen und Italienische: Gesprächsanalyse und autosegmentale Phonologie*, Linguistische Arbeiten 439, Tübingen Verlag, Niemeyer, 2001, f. 71.

⁴²⁰ A. Siegetsleitner, *Ethic und Moral im Wiener Kreis: Zur Geschichte eines engagierten Humanismus*, Böhlau Verlag G.m.b.H.-CO.KG, Wien Köln Weimar, Wien, 2014, f. 155.

⁴²¹ *Kontroversen in der Forschung zu Satztypen und Satzmodus*, <http://www.linguistik.uni-mainz.de/mitarbeiter/meibauer/publikationen/pub-aufsaezte/Paper>.

7.1.1. Mënyra dëshirore në shqipe

Sipas “Gramatikës së gjuhës shqipe I”, Demirajt, Karapinjallit dhe Stringës, Buholcit dhe Fidlerit (Buchholz-Fiedler) me anë të kësaj mënyre shprehet modaliteti i dëshirës në formë urimi apo mallkimi⁴²². Dëshirorja është mënyrë e joreales, duke qenë se ajo i referohet ndodhive, realizimin e të cilave e dëshiron ligjëruesi, por që nga ana tjetër ato nuk janë domosdoshmërisht të realizueshme⁴²³. Në fjalinë dëshirore është ligjëruesi, i cili përcakton ligjshmërinë e saj – këtu bëhet qartë dallimi me fjalinë e mënyrës urdhërore, ku rolet midis ligjëruesit dhe bashkëbiseduesit apo atij të cilit i drejtohet urdhri, janë të mirëpërcaktuara dhe të shpërndara: në fjalinë e mënyrës urdhërore nevojitet bashkëpunimi i bashkëbiseduesit për të përmbushur urdhrin; në fjalitë dëshirore e tërë vëmendja si e folësit ashtu edhe e bashkëbiseduesit apo dëgjuesit fokusohet pikërisht tek ligjëruesi, e nuk përbën rëndësi nëse dëshira apo mallkimi realizohet. Për më tepër, që fjalia shpeshherë i drejtohet një fuqie të tretë dhe realizimi i tyre varet pikërisht nga kjo fuqi mbinatyrore (3), (4)⁴²⁴.

(3)

*Zoti të **ruajtë**!*

Möge Gott dich beschützen!

(4)

*Pika **të rëntë**, -i tha gruaja. (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 89)*

“Der Schlag soll dich rühren! – fuhr ihn seine Frau an. (Chronik im Stein, Ismail Kadare, S. 103)

Mënyra dëshirore në shqipe ka dy kohë: të tashmen dhe të kryerën. Nisur nga funksionet e tyre në fjali e tashmja është koha, e cila përdoret më dendur.

Është e vërtetë që në shqipe ka një mënyrë të posaçme për të shprehur dëshirën e ligjëruesit, por lëmi i përdorimeve gjuhësore na vërteton me shembuj argumentues që shqipja ka zhvilluar në dispozicion të gjuhëpërdoruesve edhe mjete të tjera gramatikore, si p.sh. mënyra

⁴²² Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 329; Shaban Demiraj, *Morfologji e gjuhës së sotme shqipe*, II, Tiranë, 1970, f. 220; Mehmet Çeliku & Mustafa Karapinjalli & Artur Stringa: *Gramatika praktike e gjuhës shqipe*, Toena, Tiranë, 1998, f. 177; Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 150.

⁴²³ Wolfram Euler & Konrad Badenheuer: *Sprache und Herkunft der Germanen. Abriss des [Proto germanischen vor der Ersten Lautverschiebung](#)*, Verlag Inspiration, Hamburg 2009.

⁴²⁴ Harald Wehrich, *Textgrammatik der deutschen Sprache*, Dudenverlag, 1993, f. 265.

të tjera gramatikore apo elemente gramatikorë shtesë për të shprehur një dëshirë a një mallkim. Këtu gjejmë përqasje midis shqipes dhe gjermanishtes.

7.1.2. Koha e tashme

Kuptimi themelor i kohës së tashme dëshirore në shqipe është të shprehë dëshirën e folësit në formë urimi ose mallkimi, për kryerjen e në veprimi në çastin e ligjërit ose pas tij⁴²⁵.

Kjo kohë përdoret:

a) për të treguar një veprim a gjendje për të cilën folësi shpreh dëshirën (në formë urimi apo mallkimi) që të vërtetohet në një të ardhme të afërt ose të largët⁴²⁶ (5). Ky përdorim përbën edhe spektrin më të gjerë të përdorimeve të së tashmes dëshirore.

(5)

*T'u **thaf**të goja! (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 80)*

Die Zunge soll dir verdorren! (Chronik im Stein, Ismail Kadare, S. 85)

(6)

*Pika të **rë**ntë – tha nëna ... (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 112)*

"Hol dich der Kuckuck!" sagte Mutter. (Chronik im Stein, Ismail Kadare, S. 121)

Në shembullin (5) folja në shqipe *thaf*të është në të tashmen dëshirore dhe shpreh një mallkim. Kthimi në gjermanishte realizohet me anë të foljes modale *sollen* (duhet) në të tashmen dëftore duke i shtuar intonacion karakteristik dhe pikëçuditëse. Edhe në shembullin (6) në shqipe folja *rë*ntë është në të tashmen dëshirore dhe shpreh gjithashtu një mallkim. Kthimi në gjermanishte realizohet me mënyrën urdhërore *hol* të shoqëruar me intonacion karakteristik dhe pikëçuditëse. Edhe pse në të dy shembujt e kthyer në gjermanishte (5, 6) kemi praninë e kuptimit dëshiror, ruajtja e elementeve emocionalë të shprehur në shembujt në shqipe (5, 6) gjatë kthimit në gjermanishte është e vakët.

b) për të shprehur edhe veprime të mundshme në kohën e ardhme, duke u afruar me mënyrën lidhore, pa shprehur dëshirën e folësit në formë urimi apo mallkimi (7), (8), (9). Përdorime të

⁴²⁵ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Tiranë, 2002, f. 329.

⁴²⁶ Shaban Demiraj, *Morfologji e gjuhës së sotme shqipe*, II, Tiranë, 1970, f. 220.

tilla ndeshen në fjali të varura kushtore dhe lejore dhe paraprihen nga lidhëza nënrenditëse në⁴²⁷.

(7)

Në u vonofsha, mos më prit, por bjer e fli gjumë.

Falls ich spät werde, warte nicht auf mich! Geh ins Bett!

(8)

Në të gënjejsha për këtë gjë, mos më fol më me gojë!

Falls ich dich darüber anlüge, rede nie ein Wort mit mir!

(9)

Edhe në e humbsha luftën, nga hiri do të ngrihem dhe mbanë do t'ja dal!

Auch wenn ich den Krieg verliere, aus der Asche werde ich wieder gebären und es schaffen!

Në shembujt në shqipe (7, 8, 9) foljet *u vonofsha*, *gënjejsha*, *humbsha* janë në të tashmen dëshirore. E megjithatë ato e kanë humbur vlerën e tyre të përdorimit parësor për të shprehur një urim apo mallkim duke treguar një veprim të mundshëm në të ardhmen. Kthimi në gjermanishte realizohet me folje në të tashmen dëftore *spät werde*, *anlüge*, *verliere*. Duke krahasuar shembujt shprehemi se kemi realizim të plotë emocional e stilistik, por jo të rendit morfologjik.

7.1.3. Koha e kryer

E kryera dëshirore në shqipe dallon dy përdorime kryesore:

a) për të shprehur dëshirën e folësit (në formë urimi apo mallkimi) për veprime të cilat i referohen së kaluarës⁴²⁸ (10). Ky përdorim zë një spektër të ngushtë.

(10)

Të pastë marrë të ligat!

Er sollte dein Böses wegnehmen!

⁴²⁷Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 329.

⁴²⁸ Po aty, f. 330-331.

Në shembullin (10) në shqipe folja *pastë marrë* është në të kryerën dëshirore dhe shpreh një dëshirë të shtrirë në të kaluarën. Kthimi në gjermanishte realizohet me anë të foljes modale *sollen (duhet)* në preteritum + folje në infinitiv, të shoqëruar me intonacionin karakteristik dhe pikëçuditëse. Në shembullin e kthyer nuk kemi realizim të asnjë rendi, qoftë emocional apo stilistik dhe as morfologjik.

b) në fjali të varura kushtore të ndërtuara me lidhëzën *në*, kur kushti i referohet kohës së shkuar⁴²⁹ (11) - ky variant përdorimi është më i rrallë.

(11)

Në pastë mbaruar punë, thuaji të vijë këtu.

Sollte er mit der Arbeit fertig sein, sag ihm, er soll herkommen.

Në shembullin (11) folja *pastë mbaruar* është në të kryerën dëshirore - fjalia nuk shpreh ndonjë dëshirë në formë urimi a mallkimi, por një kusht të lidhur me të shkuarën. Kthimi në gjermanishte është realizuar me ndërtim me foljen modale *sollen (duhet)* në preteritum dhe foljen ndihmëse *sein (jam)* në infinitiv. Megjithëse nuk mund të flasim për përqasje në nivelin morfologjik, midis shqipes dhe gjermanishtes gjejmë përqasje në nivelin semantik e stilistik.

Shpeshherë dëshirorja e shqipes haset në formula të gatshme ngjyime të forta emocionale (12), (13), (14) dhe me përdorim të gjerë në jetën e shqipfolësve. Kur i kthejmë këto fjali në gjermanishte nuk gjejmë formula të gatshme, si në shqipe (12), (13), (14). Përkthimi në gjermanishte është i papërdorshëm - ai na jep një ide të zbehtë, por nuk paraqet apo ofron asnjë atmosferë përdorimi. Këto kthime mund të jenë konform rregullave standarde morfologjike, por ata nuk përbëjnë kuptim, nuk kanë aspak ngjyrim emocional - paraqitja emocionale që transmetohet në gjermanishte është neutrale dhe si të tilla nuk gjejnë përdorim. Dallimet midis fjalive në mënyrën dëshirore në shqipe dhe prodhimeve të tyre në fjali dëshirore në gjermanishte janë të të gjitha niveleve: kur këto urime kthehen në gjermanishte nuk e bartin vlerën e urimit; përse i përket ekuivalencës morfologjike ajo është zero, ndërsa ajo kuptimore mund të themi, që është e vakët. Megjithatë edhe në gjermanishte gjejmë formula të gatshme, të cilat shprehin një urim a mallkim: *Alles Gute! (Gjithë të mirat!)*, *Viel Erfolg! (Suksese!)*, *Viel Spaß! (Bëfshi qejf!)*, *Gute Besserung! (Shërim të shpejtë!)*, *Zum Teufel mit dir! (Vafsh në djall!)*.

(12)

⁴²⁹ Po aty, f. 330.; Shaban Demiraj, *Morfologji e gjuhës së sotme shqipe*, II, Tiranë, 1970, f. 220.

Të bëftë mirë!

Möge es dir gut tun! (Guten Appetit!)

(13)

U bëfsh 100 vjeç!

Du sollst 100 Jahre alt werden! Mögest du 100 Jahre alt werden! (Herzlichen Glückwunsch!)

(14)

U trashëgofshi!

Ihr sollt Nachwuchs haben! (Wir wünschen euch viele Kinder!/Herzlichen Glückwunsch!)

Duke marrë në konsideratë sa më sipër themi që, kur i kthejmë fjalitë e mënyrës dëshirore nga shqipja origjinale në gjermanishte nuk realizohet ekuivalencë e plotë, edhe pse ekziston kuptimi dëshiror i foljes dhe i fjalisë dëshirore. Midis tyre ka dallime, shpesh të qenësishme; ato mund të jenë të rendit semantik ose ngjyrim semantik, të rendit stilistik dhe atij emocional. E megjithatë, i qëndrojmë mendimit, që kthimi i fjalive të mënyrës dëshirore në gjermanishte realizohet në kornizën e përshtatjes gjuhësore duke qenë se, qoftë foljet modale, qoftë strukturat me lidhore nuk mund të njëjtësohen me dëshiroren e kështu themi që në mënyrë kategorike nuk bëhet fjalë për përkthim të pastër gjuhësor, dhe një kthim ekzakt haset tejet rrallë.

7.1.4. Vështrimi semantiko-pragmatik i mënyrës dëshirore në gjuhën shqipe

Dëshiroja e shqipes është e shenjëzuar minimalisht dhe spektri i përdorimit të kësaj forme është relativisht i ngushtë. Kjo mënyrë shërben kryesisht për të shprehur një dëshirë në formë urimi apo mallkimi (15)⁴³⁰. Ndodh që fjalitë në mënyrën dëshirore të shoqërohen edhe me pasthirrma, si: *ah, aj, uh*, duke i dhënë ngjyime emocionale urimit apo mallkimit të shprehur. Përdorimi i dëshirores lidhet kryesisht me ngjarje shenjuese të jetës së njeriut me ngarkesë të veçantë emocionale (15).

(15)

⁴³⁰ Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987, f. 150.

*Hë, mos **vdeksh** kurrë, o xha Spiro, dhe ti, o djalë, u **bëfsh** . . . njeri i madh, të **nderofshin** të gjithë!*

He, du sollst niemals sterben, Onkel Spiro, und du, mein Junge, sollst ein großer Mann werden, und alle sollen dich ehren. (Buchholz-Fiedler, 1987:150)

Gjuha shqipe është shumë e pasur me fjali të mënyrës dëshirore të shprehura në formën e urimit dhe të mallkimit. Këto shprehje janë pjesë e jetës së përditshme, më tepër të asaj popullore, por jo vetëm - në gjuhën popullore gjenden përdorimet më të spikatura të urimeve e mallkimeve. Më poshtë po sjellim disa shembuj për ilustrim dhe siç mund të shihet, jo të gjitha përdorimet ngërthejnë forma gramatikore të mënyrës dëshirore, por pa diskutim, ato që të gjitha shprehin një urim apo mallkim.

Urime	Mallkime
• Paç fat! • Gjithë të mirat! • U bëfsh 100 vjeç! • Dalsh faqebardhë! • Me fitore! • T'u bëftë dita një mijë! • Zoti të ndihmoftë! • Perëndia qoftë me ty! • Mos pafsh kurrë keq në jetën tënde! • Mos vdeksh kurrë • Të marrshin të ligat! • Mbetsh me shëndet! • Ta dëgjofsha zërin për mirë! • Ju pastë lënë uratën!	• Plaç të preftë! • Plaç në vend! • Pika të rëntë! • Të preftë rrufeja! • Të zëntë kolera! • Të marrrtë djalli! • Mos pafsh një ditë të bardhë!

Dëshira apo mallkimi mund t'i drejtohet një (16) apo disa personave (17). Por ka raste përdorimi, edhe pse të rralla, që ligjëruesi i drejtohet vetes. Kjo për të veshur me petk emocional e për të shprehur forcën e urimit apo mallkimit në kuadrin e situatës së gjendur. Në shembullin (18) ligjëruesi, në rastin tonë plaka Xhexho, kërkon të na transmetojë çudinë e saj në një shkallë të lartë, deri në atë pikë sa ajo mallkon veten, për të transmetuar tek lexuesi atë çka ajo ndjeu në ato momente.

(16)

*Pika të **rëntë**, -i tha gjyshja, ç'ke me djalin. (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 75)*

“Nun mach aber einen Punkt!” sagte Großmutter. ... (Chronik im Stein, Ismail Kadare, S. 87)

(17)

*Pika ju **rëntë**, -tha ajo më në fund, -thashë se ç'kishte bërë vaki. (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 75)*

“Du liebe Güte!” sagte sie schließlich. (Chronik im Stein, Ismail Kadare, S. 88)

(18)

*Mos **qofsha**, thashë me vete. (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 13)*

Um Himmels Willen! Dachte ich. (Chronik im Stein, Ismail Kadare, S. 17)

7.1.5. Shprehja e dëshirës në gjermanishte

Në gjermanishte si fjali dëshirore përcaktohet një tip fjalie, që shërben për të shprehur një dëshirë. Në gjermanishten e sotme letrare nuk gjenden paradigma morfologjike të mënyrës dëshirore. Diskutimi ngrihet në nivelin se cila mënyrë apo cilat mjete të tjera gramatikore shërbejnë për të shprehur dëshirën e folësit, në formë urimi apo mallkimi. Më poshtë paraqesim disa shprehje në formën e urimeve apo mallkimeve:

<i>Urime</i>	<i>Mallkime</i>
Mach's gut! (Kalofsh mirë!)	Geh zum Teufel!
Alles Gute! (Gjithë të mirat!)	(Vafsh / Shkofsh në djall/dreq!)
Möge Gott dich schützen/dir helfen!	Zum Teufel mit dir!
(Zoti të mbroftë / ndihmoftë !)	(Shkofsh / Vafsh në djall/dreq!)
Ich drück' dir die Daumen! (Të uroj fat!)	
Viel Erfolg! (Suksese!)	
Viel Glück! (Fat të mbarë!)	

Nga ana formale fjalia dëshirore s'është gjë tjetër veçse një fjali kushtore e paraprirë nga lidhëza *wenn* (*sikur*) e shoqëruar me intonacion karakteristik, si dhe me pjesëza të ndryshme modale (Abtönungspartikeln): *Wärst du doch gekommen! Wenn du doch gekommen wärst!* (Të kishe ardhur! Ah, sikur të kishe ardhur!). Nëse krahasojmë përdorimet e fjalisë dëshirore në gjermanishte me fjalitë e mënyrës dëshirore në shqipe nuk gjendemi në të njëjtën platformë – më e udhës do të ishte të vinim përballë njëra-tjetrës fjalinë dëshirore „*Wunschsatz*“ në

gjermanishte me dëshirën e shprehur me anë të lidhore në shqipe. Në të dyja rastet kemi përjasje morfologjike dhe semantike: *Hätte ich doch nichts gesagt!* – *Ah, sikur të mos kisha thënë gjë!*. Nisur nga ato çka thamë më sipër, krahasimi ynë vijon në kornizën e përkthimeve. Duke qenë se në gjuhën e sotme gjermane nuk gjendet një mënyre dëshirore e mirëfilltë, për të shprehur urimin apo mallkimin e folësit ajo përdor një kompleks elementesh morfologjike, sintaksore dhe semantike: mënyrën dëftore (19), lidhore (20) dhe (21), mënyrën urdhërore të shoqëruar me pjesëza modale ose siç quhen në gjermanishte *Abtönungspartikeln*⁴³¹: *bloß*, *doch* (22), *nur*, foljen modale *mögen* (23), foljen modale *sollen* (*duhet*) (24), gjithmonë të shoqëruar me intonacionin karakteristik.

(19)

*Hoffentlich gewinnst du!****Dalsh*** me fitore!

(20)

*Wenn doch unser Team gewonnen hätte!**Sikur* të kishte fituar skuadra jonë!

(21)

*Wenn du doch alle hättest helfen können!**Sikur* të kishe mundur t'i ndihmoje të tërë!

(22)

*Geh doch zum Teufel!****Vafsh*** në djall!

(23)

*Möge Gott dir helfen!**Zoti të **ndihmohtë**!*

(24)

*Der Teufel soll dich holen!**Të **marrtë** djalli!*

⁴³¹ Termi *Abtönungspartikeln* ose pjesëzat modale është përdorur për herë të parë nga Weydt (Hentschel & Weydt, 1990: 280). Pjesëzat modale nuk sjellin asnjë informacion të ri në fjali. Ky koncept nënkupton që përmes këtyre pjesëzave do të ngjyroset diçka, pra një mendimi do t'i jepet ngjyrim modal. (Schwiegerr, 2006/07:4). Ato gjejnë përdorim të shpeshtë në gjuhën e folur. Shumica e studiuesve dhe gramatikanëve i pranojnë pjesëzat modale si njësi të pastra të mesfushës të fjalisë, me pozicione relativisht të lira. Në më të shumtën e rasteve ato janë të patheksuara (Hammer, 2005:3-4).

Përzgjedhja e mënyrës apo foljeve modale nga ana e ligjëruesit nuk është krejt e rastësishme – ajo mbështetet në dy kriterë gjuhësorë: e para në llojin e asaj çka do të shprehë ligjëruesi urim apo mallkim dhe e dyta në perceptimin e ligjëruesit se sa e realizueshme është dëshira e shprehur prej tij. Kështu, nëse dëshira që shpreh folësi mendohet si e realizueshme, ai përdor të tashmen dëftore (19). Kthimi në shqipe realizohet me të tashmen dëshirore „*dalsh*“. Në gjermanishte kjo dëshirë mbështetet nga ndajfolja *hoffentlich* dhe shtrihet në të ardhmen. Vërtet që mendohet se dëshira mund të ketë mundësi të mira realizimi, por kjo gjë mbetet e pasigurt; në të dyja gjuhët fjalia shoqërohet me pikëçuditëse. Në këtë shembull (19) kemi përputhje semantike dhe stilistike, por jo morfologjike. Në rastet kur dëshira e shprehur nga folësi nuk është realizuar, gjejmë përdorime me mënyrën lidhore, duke përdorur më se të kryerën (20) ose ndërtim me Konjunktiv II në të shkuarën: *folje modale + folje kryesore* (21). Në këto shembuj (20, 21) vëmë re që, realiteti është ndryshe nga ai që ligjëruesit dëshirojnë, por kjo gjë nuk mund të ndryshohet më: skuadra nuk ka fituar dhe bashkëbiseduesi nuk ka arritur të ndihmojë të gjithë – lidhëzat *wenn/sikur* i përshtaten dëshirës së shprehur. Në përdorimet (20) dhe (21) midis shqipes dhe gjermanishtes kemi përjasje të të gjitha niveleve: morfologjike, semantike dhe stilistike. Ndodh që dëshira të shprehet edhe me folje në mënyrën urdhërore (22). Në gjermanishte në shembullin (22) kemi përdorim të foljes në mënyrën urdhërore - kthimi në shqipe realizohet me folje në dëshirore duke shprehur kështu një dëshirë në formë mallkimi. Këtu midis dy gjuhëve gjejmë përjasje semantike dhe stilistike, por jo morfologjike. Urimet shprehen me anë të foljes modale *mögen* (23), ndërsa mallkimet me anë të foljes modale *sollen* (24). Në të dy shembujt (23) dhe (24) qoftë urimi, qoftë mallkimi nuk varen as nga ligjëruesi e as nga bashkëbiseduesi – ata i drejtohen një fuqie të tretë, një fuqie të mbinatyrshme (23). Në këto raste përdorimi (23) dhe (24) midis dy gjuhëve kemi përputhje semantike dhe stilistike, por jo morfologjike.

KREU VIII

MËNYRA URDHËRORE

8.1. Mënyra urdhërore në shqipe dhe gjermanishte

Në shumicën e gramatikave urdhërorja zë një vend relativisht të kufizuar - ajo përmendet një herë në kapitullin e mënyrave, në paraqitjen e zgjedhimeve të foljeve dhe një herë në klasifikimin e tipave të fjalisë, pikërisht në ato urdhërore⁴³². Në shqipe urdhërorja nuk ka ngjallur dyshime për vendin e saj midis mënyrave të tjera. Ndryshe qëndron çështja në gjermanishte: nisur nga kufizimet e saj gramatikore për mungesë të paradigmave foljore kohore apo edhe të kongruencës me kryefjalën, urdhërorja është parë e trajtuar jo me bindje të plotë si pjesë e familjes së mënyrave në gramatikën gjermane⁴³³. Cifonun (Zifonun), Hofman (Hoffmann) dhe Shtreker (Strecker) e shikojnë defiçitin që krijon urdhërorja në gramatikën gjermane të prekë përpos vetën, kohën edhe genus verbin, duke e argumentur këtë mungesë nga këndvështrimi semantik⁴³⁴. Krahësuar me mënyrat e tjera, të cilat janë të qarta me nënndarjet e tyre foljore sipas formave kohore – urdhërorja në të dyja gjuhët nuk e ka këtë

⁴³² Eva Klimova, Sbornik Praci Filozoficke Fakulty Brinske Univerzity Studia Minora Facultatis Philosophicae Universitatis Brunensis L 25 - “*L’imperativo italiano tra morfologia e pragmatica*”, 2004, f. 1.

⁴³³ Ajzenberg (Eisenberg) nuk e liston dhe nuk e trajton urdhëroren si mënyrë më vete duke e shënuar në kllapa në tabelën e mënyrave në gramatikën gjermane. Ai trajton vetëm dëftoren dhe dy lidhoret: Konjunktiv I dhe Konjunktiv II. Nga disa gramatikanë urdhërorja konsiderohet thjesht si një formë e kërkesës, por ajo pranohet në DUDEN. Mbështetje për t’u klasifikuar e trajtuar si mënyrë më vete urdhërorja ka gjetur edhe nga gjuhëtarët Cifonun (Zifonun) Helbig, Buscha (Helbig-Buscha) dhe Engel.

⁴³⁴ Gisela Zifonun, Ludger Hoffmann, Bruno Strecker, *Grammatik der deutschen Sprache*, Band 1, 2, 3, De Gruyter, 1997, f. 1728.

tipar gramatikor. Vështuar nga dimensionet apo kategoritë kohë dhe vetë urdhërorja nuk është mënyrë e shenjëzuar⁴³⁵. Parë nga këndvështrimi morfologjik, në shqipe ajo nuk është gjithmonë e dallueshme nga mënyrat e tjera, por ajo mund të dallohet qartë nisur nga roli dhe funksioni i saj në fjali, pra nga tiparet sintaksore (p.sh.: *ti ha*→*ha*, *ti rri*→*rri*). Këtu përmendim fillimisht intonacionin, si element sintaksor, duke vijuar me shpejtësinë dhe ritmin karakteristik për urdhëroren në përgjithësi. Përpos aspekteve morfo-sintaksore, me rëndësi të veçantë studiuese janë edhe aspektet semantike e pragmatike të urdhërores. Edhe pse në pamje të parë mund të themi që, kjo mënyrë paraqitet ngjashëm në të dyja gjuhët, si në formë apo mjete gramatikore, ashtu dhe në vlerat e saj të përdorimit, ka momente ku shqipja dhe gjermanishtja largohen nga njëra-tjetra. Terma *mënyra urdhërore* i përgjigjet termës latine *modus imperativus*⁴³⁶. Sipas “Gramatikës së gjuhës shqipe I”⁴³⁷, Demirajt⁴³⁸ dhe Karapinjallit⁴³⁹ në shqipe me anë të kësaj mënyre shprehet modaliteti i dëshirës në formë urdhri, kërkesë, këshillë, porosie, lutjeje, grishjeje, lejimi etj. Sipas Duden në gjermanishte mënyra urdhërore shpreh një kërkesë (urdhër, ndalim, lutje, udhëzim, këshillë, sugjerim, paralajmërim, nxitje)⁴⁴⁰. Për nga vetë natyra e asaj që shpreh dhe e karakterizon, urdhërorja në të dyja gjuhët konsiderohet si fenomen i diskursit⁴⁴¹ duke iu drejtuar një apo disa personave prej të cilëve në vijim pritet përmbushja e urdhrit, kërkesës apo dhe dëshirës së shprehur. Helbig dhe Buscha (Helbig-Buscha) e përcaktojnë urdhëroren si formën bazë për me anë të së cilës folësi shpreh kërkesën e tij drejtuar bashkëbiseduesit⁴⁴². Në më të shumtën e rasteve urdhërorja lidhet me situata konkrete, por ajo mund të shfaqet edhe në momente në të cilat ligjëruesi shpreh një urdhër apo ndalim të përgjithshëm, dhe kjo vlen për të gjitha situatat e

⁴³⁵ Po aty, f. 1724.

⁴³⁶ Shaban Demiraj, *Morfologji e gjuhës së sotme shqipe*, II. Tiranë. 1970, f. 221.

⁴³⁷ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 330.

⁴³⁸ Shaban Demiraj, *Morfologji e gjuhës së sotme shqipe*, II. Tiranë. 1970, f. 225.

⁴³⁹ M. Çeliku, M. Karapinjalli, R. Stringa, *Gramatika praktike e gjuhës shqipe*, Toena, Tiranë, 1998, f. 181.

⁴⁴⁰ DUDEN, *Der Imperativ*, Mannheim, 2001, f. 36.

⁴⁴¹ Për gjermanishten: Gisela Zifonun, Ludger Hoffmann, Bruno Strecker, *Grammatik der deutschen Sprache*, Band 1,2, 3, De Gruyter, 1997, f. 1724.

⁴⁴² Gerhardt Helbig & Joachim Buscha, *Deutsche Grammatik, ein Handbuch für Ausländerunterricht*, Langescheidt, Berlin und München, 2001, f. 185.

mendueshme. Me këtë kuptim urdhërorja në të dyja gjuhët haset shpesh në fjalë të urta (1), këshilla, apele politike (2)⁴⁴³.

(1)

Mos i shih gunën, por punën.

Schaue nicht auf den Mantel, schaue auf die Arbeit!

(2)

Proletarë të të gjitha vendeve, bashkohuni!

*Proletarier aller Länder, vereinigt euch! (Karl Max, Kommunistisches Manifest)*⁴⁴⁴

Urdhërorja është e vetmja mënyrë në shqipe dhe gjermanishte e cila nuk ka ndarje kohore sikur mënyrat e tjera. Kuptimi kohor i saj në të dyja gjuhët është i tanishëm ose i ardhshëm⁴⁴⁵ - në të dyja gjuhët mënyra urdhërore ka vetëm disa forma foljore të kohës së tashme. Nisur nga lloji i kuptimeve modale që shpreh urdhërorja është e qartë kjo rrudhje në kohë. Ky deficiet kohor gjen shpjegim në semantikë, pasi realisht është e pamundur të jepet një urdhër në të shkuarën dhe të pritët përbushja e tij. Ndërsa përse i përket formave kohore të së ardhmes, të dyja gjuhët kanë treguar se evoluimi gjuhësor nuk e ka parë të udhës të krijojë forma të posaçme gramatikore, duke qenë se të dyja gjuhët mundësojnë përdorimin e formave gramatikore të së tashmes për veprime në të ardhmen duke i shoqëruar këto fjali me ndjafolje kohore (3). Më tej shprehësimi se vetë gjuha ka krijuar disa forma konkurruese të urdhërores të cilat e përmbushin më së miri funksionin gramatikore të së ardhmes. Megjithatë praninë e formave gramatikore jo aq të larmishme siç ndodh me mënyrat e tjera, urdhërorja nuk paraqet asnjë deficiet gjuhësor, madje mund të konsiderohet dhe studiohet si një mënyrë me një gamë të gjerë funksionesh. Përse i përket spektrit të përdorimit të urdhërores në të dyja gjuhët si edhe llojit e ligjërit ku ajo është e pranishme, themi që urdhërorja zë një vend të rëndësishëm në ligjërimin verbal, sidomos në situata të përditshme komunikimi, por jo vetëm – atë e hasim gjerë edhe në ligjërimin e shkruar, kryesisht në literaturën artistike, por nuk gjendet në atë me karakter gazetaresk, teorik apo shkencor.

⁴⁴³ Për më shumë për gjermanishten shih: Harald Weinrich, *Textgrammatik der deutschen Sprache*, Dudenverlag, 1993, f. 273.

⁴⁴⁴ Po aty.

⁴⁴⁵ Buholz dhe Fidler (Buchholz-Fidler) i njohin asaj në shqipe edhe përdorim në të shkuarën, sidomos në të folmet e popullit, të ngjashëm me të tashmen historike, në situata të ngarkuara emocionale. Kthimet në gjermanishte realizohen përmes dëftores (Buchholz & Fidler, 1987:150). Qëndrim të ngjashëm gjejmë edhe në gramatikën e Dudenit (DUDEN-Grammatik), e cila i njeh urdhërores në gjermanishte përdorime në të shkuarën (Radtke, 1998:197). Megjithatë përcaktimet e tilla nuk klasifikohen në përdorimet kryesore të urdhërores.

(3)

Ejani** pas një jave dhe sillni të gjitha dokumentet me vete ju lutem!*Kommen Sie** in einer Woche und bringen Sie bitte alle Unterlagen mit!*

Në të dyja gjuhët mënyra urdhërore haset në fjali kryesore duke u afruar kështu me dëshiroren dhe habitoren e shqipes. Kështu urdhërorja qëndron përballë dëftores dhe lidhores, të cilat gjejnë përdorim si në fjali kryesore apo pjesë kryesore të një fjalie të nënrenditur, ashtu edhe në pjesë të nënrenditura. Në shqipe ashtu si dhe në gjermanishte me anë të mënyrës urdhërore shprehim një urdhër apo kërkesë. Në gjuhësinë shqiptare urdhërores i njihet edhe përdorimi për të shprehur një dëshirë në formë urdhri⁴⁴⁶, çka do të thotë se ajo shënohet si mënyrë që karakterizohet nga modaliteti i dëshirës. Në Duden urdhërorja përcaktohet si mënyra që shërben për të shprehur një kërkesë drejtuar një personi apo shumë personave⁴⁴⁷. Bazuar në përkufizimet e urdhërores në shqipe dhe gjermanishte, si dhe në kërkimet e bëra shprehemi se, kuptimet e urdhërores në të dyja gjuhët janë të njëjta. Më poshtë vijojmë me përdorimet e urdhërores në shqipe dhe në gjermanishte.

a) Urdhërorja përdorimin e saj kryesor e ka të shprehë dëshirën e folësit në formë urdhri (3).

(3)

*Tjaden, të urdhëroj si epror: **çohu** në këmbë! (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 79)*

*Tjaden, ich befehle Ihnen dienstlich: **Stehen Sie auf!** (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 76)*

Në shembullin (3) urdhri i shprehur është fare i qartë: që në nisje, personazhi, të cilit i drejtohet urdhri thërritet në emër, për të vijuar me përmendjen e pozicionit epror, për t'u përmbyllur me foljen në urdhërore *çohu*. Këtu urdhri është sa i shpërndarë në kontekstin gjuhësor, aq edhe i përqëndruar në foljen në urdhërore – është pikërisht konteksti ai i cili përgatit terrenin për urdhrin që pason. Gjithashtu nevojitet të marrim në konsideratë intonacionin ngjithës dhe agresiv, shpejtësinë dhe ritmin karakteristik të fjalive të kësaj tipologjie. Po kaq bukur mund të vrojtohet shpërndarja e elementeve të porsapërmendur në shqipe edhe në gjermanishten origjinale, duke theksuar përjasjen midis dy gjuhëve deri në detajet më të vogla.

⁴⁴⁶ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 330.; Shaban Demiraj, *Morfologji e gjuhës së sotme shqipe*, II, Tiranë, 1970, f. 221.

⁴⁴⁷ DUDEN – *Grammatik der deutschen Gegenwartssprache*, Duden Band 4, Mannheim, Leipzig, Wien, Zürich, 2003. f. 304.

b) Shpeshherë kjo mënyrë përdoret për të shprehur një kërkesë a nxitje (4).

(4)

Fillo. Fillo shpejt, - tha ajo. (*Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 167*)

“Fang an, rasch”, sagte sie. (*Chronik im Stein, Ismail Kadare, Seite 196*)

Në shembullin (4) konteksti gjuhësor, intonacioni dhe kërshëria për të dëgjuar ligjëruesin, ngjitin shkallën e padurueshmërisë së dëgjueses - personazh në libër - e cila e nxit ligjëruesin të tregojë duke shprehur kërkesën e saj përmes foljeve të njëpasnjëshme në urdhërore *fillo, fillo*. Ndajfolja *shpejt* shërben si mbështetëse e mirë e kornizës të situatës. Për të përçar te lexuesi ngjitjen e dëshirës së personazhit për të marrë vesh të rejtat e fundit, autori përdor urdhërore të njëpasnjëshme. Në kthimin në gjermanishte ky tension në rritje shpërndahe në foljen e ndashme në urdhërore *fang an* dhe në ndajfoljen *rasch* - këto në harmoni me njëra-tjetrën e realizojnë më së miri qëllimin e autorit Kadare.

c) Jo rrallëherë ndodh që ligjëruesi apo shkrimtari të ngërthejë format gramatikore të urdhërores për të shprehur një urdhër të gërshetuar njëkohësisht me lutje - nuanca e urdhrit të shprehur zbehet duke i veshur një petk lutjeje (5). Kjo gjë mund të realizohet ose përmes intonacionit karakteristik me ngjyrosje lutëse ose me anë të morfemave *të lutem, Ju lutem/bitte*.

(5)

Lëshomëni! ... Lëshomëni të dal! Dua të iki që këtej!... (*Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 101*)

Lasst mich los, lasst mich raus, ich will hier raus! (*Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 99*)

Në shembullin (5) i rekrutuari i ri u drejton ushtarëve të togës së tij një urdhër në formë lutjeje *lëshomëni* - konteksti gjuhësor shërben për të qartësuar qëllimin e tij në një moment të vështirë sulmi, ku ai e ka humbur toruan. Është e vërtetë që në të dyja gjuhët janë përdorur forma gramatikore të urdhërores në shqipe dhe një formë konkurruese e urdhërores në gjermanishte, duke marrë në konsideratë kontekstin, intonacionin e përdorur në fjali dhe ritmin jo të shpjegtë, por disi të zvarritur të të folurit, mund të themi shkoqur që këtu urdhërorja na tregon një faqe tjetër të funksioneve të saj të shumta, pikërisht atë të lutjes.

ç) Vendosja e vlefshmërisë së urdhërores ka lidhje të ngushtë me personin/personat të cilit/cilëve i/u drejtohet urdhri. Kjo vlefshmëri është e orientuar tërësisht në marrëdhënien midis ligjëruesit dhe dëgjuesit duke i atribuar dëgjuesit rolin bazë të urdhërores⁴⁴⁸. Nëse vështrojmë hapësirën morfologjike që zënë format foljore të urdhërores në shqipe dhe gjermanishte dalim me një inventar të ulët. Megjithatë themi që ato në të dyja gjuhët janë të mirëpërcaktuara tashmë, si nga pikëpamja morfologjike, ashtu edhe nga ajo funksionale⁴⁴⁹. Përpos këtij përcaktimi dihet që gjuhët janë në lëvizje në mënyrë të pandërprerë dhe kjo mund të çojë edhe në çeljen e dritareve të reja mbi numrin e funksioneve të urdhërores. Në këtë kuadër themi që, urdhri nuk mund të lidhet vetëm me dëshirën a vullnetin e folësit. Situata të komunikimit sjellin shembuj, ku urdhri është domosdoshmëri, që rrjedh nga faktorë jashtëpersonalë dhe këtu, nuk bëhet fjalë për modalitetin e dëshirës, por për këshillë e gërshetuar me paralajmërim (6).

(6)

Shko të flesh, nënë, se këtu do të ftohesh. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 162)

Geh schlafen, Mutter, du erkältest dich hier. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 164)

Në shembullin (6) personazhi ynë vërtet e nis ligjërimin e tij me folje në urdhërore *shko*, por nuanca e këtij përdorimi është në formë të një këshille, për të vazhduar me paralajmërim se çfarë mund të ndodhë, nëse nëna e tij nuk e ndjek këtë këshillë të karakterizuar nga një ton i zbutur dhe ritëm i ngadaltë, elemente të cilët qartësohen përmes kontekstit. Me gjermanishten origjinale vërejmë përqasje në të gjitha nivelet, në atë morfologjik, semantik, sintaksor, stilistik dhe funksional.

d) Në shembujt (7) dhe (8) shohim një faqe tjetër të urdhërores – atë të propozimit. Kuptimi i propozimit të shprehur nga gjyshja realizohet nga konteksti gjuhësor. Fjalja paraardhëse *Je dobësuar, - më tha gjyshja*. përgatit terrenin për propozimin që vijon: *Shko ca kohë mysafir tek babazoti*. Kthimin në gjermanishte përkthyesi Rëm (Röhm) e ka realizuar duke përdorur strukturë me folje modale “*sollen*⁴⁵⁰ (*duhet*) + folje kryesore në infinitiv” – gjë e cila

⁴⁴⁸ Për këtë shih: Harald Weinrich, *Textgrammatik der deutschen Sprache*, Dudenverlag, 1993, f. 267.

⁴⁴⁹ Ndoshta ka edhe funksione të tjera të pazbuluara të urdhërores.

⁴⁵⁰ Folja modale *sollen* (*duhet*) gjen përdorim të gjerë në ndërtime që shprehin propozime apo këshilla.

përmbush kornizën e propozimit të ndërthurur me këshillën. Kuptimi i fjalisë në gjermanishte do të ishte i njëjtë, nëse përdorim formën urdhërore të foljes kryesore: **Besuch** Großvater für eine Weile.

(7)

*Je dobësuar, - më tha gjyshja. - **Shko** ca kohë mysafir tek babazoti. (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 164)*

“Du bist dünn geworden”, sagte Großmutter. “Du solltest Großpapa besuchen.” (Chronik in Stein, Ismail Kadare, S.192)

(8)

*Mos u **largo** shumë. Mund të dale Vasiliqia (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 136)*

***Bleib** in der Nähe. Vielleicht kommt Vasilika heraus. (Chronik in Stein, Ismail Kadare, S.158)*

Në shembullin (8) në shqipe urdhërorja *Mos u largo shumë*. përdoret për të paralajmëruar një të keqe që duhet të shmanget *Mund të dale Vasiliqia*. Edhe në përdorime të këtij lloji vlen të përmendet roli i kontekstit. Kthimi në gjermanishte gjithashtu realizohet me folje në urdhërore *Bleib*, e ndjekur nga fjalia me kuptimin modal të supozimit *Vielleicht kommt Vasilika heraus*.

dh) Një tjetër funksion i urdhërores është edhe ajo e përdorimit të saj me nuancën e një oferte (9). Pranimi i kësaj oferte varet plotësisht nga personi të cilit ajo i drejtohet. Intonacioni është zbutës i shoqëruar me një ritëm normal të të shprehurit. Përdorime të këtilla në të dyja gjuhët janë të njëjta si nga niveli morfologjik, ashtu edhe nga ai semantik, stilistik apo sintaksor.

(9)

***Merre** edhe një copë tjetër torte!*

***Nimm** noch ein anderes Stück Torte!*

Përmes strukturave të fjalive (5-9) në gjermanishte ndërtohen shpesh struktura kushtore apo lejore. Të krahasohen: *Besitze Geld und du hast Macht! Nëse ke para, ke pushtet*. Kuptimi i kushtit jepet edhe në shqipe, por ndryshe nga gjermanishtja: në gjermanishte folja është në urdhërore, ndërsa në shqipe në dëftore. Vlera e përdorimeve të këtilla mund të jenë të përgjithshme, jo domosdoshmërisht me një adresat konkret.

Format gramatikore të urdhërores kryesisht shfaqen të zhveshura nga elemente të tjerë shtesë në fjali (10). Ajo çka duam të themi është që këto trajta foljore i kryesojnë fjalitë urdhërore. Këtu nuk përjashtohen edhe struktura ku format foljore të urdhërores e lëshojnë pozicionin e

parë në fjali (11), megjithatë këto raste nuk janë të shpeshta dhe për më tepër nuk ndikojnë në përcimin e urdhrit apo të mesazhit të menduar nga ligjëruesi.

(10)

Dëgjo, -thashë. (*Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 138*)

“**Hör mal**”, -sagte ich. (*Chronik im Stein, Ismail Kadare, Seite 160*)

(11)

Kompania e dytë, **mblidhu** këtu! (*Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 124*)

Zweite Kompanie – ohne Tritt **marsch!** (*Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 123*)

Përpos rasteve klasike të të shprehurit të mënyrës urdhërore në gjermanishte shumë gjuhëtarë njohin edhe përdorimin e vetës së parë shumës si formë të saj. Në lëmin e tyre Engel - me shumë gjasa nisur nga kategorizimi i këtij veprimi si i mundshëm dhe jo si real – e cilëson këtë formë gramatikore si identike me atë të tashmes lidhore⁴⁵¹ (në gjermanishte KI)⁴⁵². Të njëtin përdorim të vetës së parë shumës si urdhërore e hasim edhe në shqipe, madje themi në një gamë më të gjerë qoftë në ligjërimin verbal edhe në atë të shkruar – por në shqipe kjo njihet si përdorimi i vetës së parë të së tashmes dëftore në fjali që shprehin një nxitje apo grishje (12).

(12)

Gehen wir!

Shkojmë!

Në gjermanishte një përdorim i tillë bazohet në ndryshimin e rendit të fjalëve “*kryefjalë:kallëzues→kallëzues:kryefjalë*” dhe në intonacionin përkatës, ndërsa në shqipe nuk kemi tregues të jashtëm formalë për realizimin e një vlere të tillë, por janë intonacioni dhe ritmi, të cilët i japin ngjyrimet e duhura. Në ligjërimin e shkruar kjo vlerë në shqipe përcaktohet nga konteksti gjuhësor.

Sipas Buholcit dhe Fidlerit (Buchholz-Fiedler) në shqipe, ndryshe nga mënyrat e tjera, në atë urdhërore mund të qëndrojnë të lidhura dy forma qëllimore-pasuese pa lidhëza nënrenditëse

⁴⁵¹ Për këtë shih: Ulrich Engel, *Deutsche Grammatik*, IUDICIUM Verlag GmbH München, 2004, f. 221.

⁴⁵² Ne distancohemi nga ky qëndrim i Engelit (Engel) dhe i shohim këto forma gramatikore si identike me format gramatikore të së tashmes dëftore.

apo presje⁴⁵³ (13). Një përdorim të tillë e gjejmë edhe në gjermanishte, por në ndryshim nga shqipja, këtu kërkohet vendosja e presjes midis dy formave të urdhërores.

(13)

“Shko fute në arkë!”

Geh, füll es in die Kiste.

8.2. Format konkurruese të urdhërores

Për të shprehur një urdhër apo kërkesë shqipja dhe gjermanishtja përpos urdhërores kanë zhvilluar edhe forma të tjera gramatikore. Përdorime të këtilla nuk kanë asnjë lidhje me kategorinë morfologjike të urdhërores, por janë krijim i burimeve gjuhësore semantike e sintaksore. Më tej themi, që kjo duket shkoqur në mundësitë linguistike që aderojnë të dyja gjuhët për të realizuar funksionin e urdhrit.

a) Në të dyja gjuhët e tashmja dëftore mund të përdoret me vlerën e urdhërores (14). Spektri i përdorimit në të dyja gjuhët varion, më i gjerë në gjermanishte e më i ngushtë në shqipe. Përdorime të tilla kanë vlerë situative dhe qartësohen nga konteksti gjuhësor i gërshetuar me intonacionin karakteristik.

(14)

*Ti **prit** këtu.*

*Du **wartest** hier.*⁴⁵⁴

(15)

***Flini ju**, unë do të lexoj. (Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 56)*

*“**Schlaft ihr** nur. Ich lese noch ein bisschen. (Chronik im Stein, Ismail Kadare, Seite 67)*

⁴⁵³ Oda Buchholz & Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Leipzig, Verlag Enzyklopädie, 1987, f. 149.

⁴⁵⁴ Ulrich Engel, *Deutsche Grammatik*, IUDICIUM Verlag GmbH, München, 2004, f. 215.; Shaban Demiraj, *Morfologji e gjuhës së sotme shqipe*, II. Tiranë. 1970, f. 221.

b) Në shqipe nganjëherë më kategorike se mënyra urdhërore është koha e ardhme e mënyrës dëftore⁴⁵⁵ (16), (17). Kjo lidhet me pritshmërinë e mënyrës urdhërore për një veprim që të realizohet në të ardhmen. Intonacioni në këto fjali është ngjitës dhe dallohet për ngjyra të forta urdhri. Këtu vlen të përmendim përdorimet më të shpeshta kryesisht në ligjërimin e folur e më pak në atë të shkruar, veçanërisht në letërsi, duke u përqëndruar më tepër në situata familjare apo rrethi shoqëror. Gjenden edhe raste të përdorimit të vetës së parë shumës (18), por këto janë më të rralla.

(16)

Ti do të shkosh që ç'ke me të!

Du wirst unbedingt hingehen!/-

(17)

Ju do të shkonit se s'bën!

Ihr werdet unbedingt hingehen!

(18)

Do të shkojmë dhe do ta fitojmë garën.

Wir werden hingehen und das Wettbewerb gewinnen.

c) Një urdhër në gjermanishte mund të shprehet edhe me anë të pjesores së shkuar (19). Këtu shqipja distancohet nga gjermanishtja, duke qenë se nuk e ka të zhvilluar këtë moment gjuhësor. Siç vërehet edhe nga kthimi në shqipe ajo përdor folje në urdhërore apo ndërtime me emra për të plotësuar urdhrin e dhënë në gjermanishte.

(19)

Aufgepasst!

Kujdes! ose Bëni kujdes!

ç) Për të shprehur një urdhër apo kërkesë në të dyja gjuhët përdoren edhe forma konkurruese të urdhërores, të cilat realizohen me foljet modale *duhet/sollen* (20), *dua* (veta I)/*wollen* dhe *lë* (veta I)/*lassen*⁴⁵⁶ (21): në shembujt (20), (21a, b, c) kemi përputhje të përdorimeve në shqipe dhe gjermanishte E përbashkëta e këtyre formave konkurruese është që ato përmbajnë

⁴⁵⁵ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë. 2002, f. 316.

⁴⁵⁶ Ulrich Engel, *Deutsche Grammatik*, IUDICIUM Verlag GmbH, München, 2004, f. 223.

nuancë këshille dhe parashtrohen më tepër në formën e një kërkesë se sa të një urdhri. Intonacioni i ligjëruetit është i gërshetuar dhe fortësia e fjalisë gjithmonë varet nga konteksti - kërkesa herë shprehet më e orientuar drejt urdhrit herë drejt propozimit. Theksi bie mbi foljet në urdhërore - e megjithatë një gjë e tillë nuk ia rrëmben skenën foljes kryesore.

(20)

Duhet të shkosh ca ditë te babazoti. (*Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 41*)

Du solltest für ein paar Tage zu Großpapa gehen. (*Chronik im Stein, Ismail Kadare, Seite 49*)

(21a)

Lasst uns gehen!

Le të shkojmë!

(21b)

Lass mich gehen!

Lërmë të shkoj!

(21c)

Lass mich dir helfen!

Lërmë të të ndihmoj!

d) Parë nga këndvështrimi morfologjik i Engelit (Engel) për përdorimin e mënyrës lidhore me vlerën e urdhërores⁴⁵⁷ mund të themi fare mirë që të njëjtën sjellje gjuhësore e hasim edhe në shqipe: lidhorja përdoret me vlerën e urdhërores në vetën e parë shumës (22a) dhe në vetën e tretë njëjës (22b) a shumës (22c), por edhe në vetën e dytë⁴⁵⁸. Në shembullin (22a) *të shkoni* nga konteksti del qartë nuanca e urdhërores për të transmetuar një ndalim në shqipe. Kthimi në gjermanishte realizohet me folje në dëftore *geht ihr*.

(22a)

Kurrë të mos shkoni më në kasaphanë, - tha Mane Vocua me zë të zbutur. (*Kronikë në gur, Ismail Kadare, f. 21*)

“Nie mehr geht ihr mir zum Schlachthof, hört ihr!” sagte Mane Voco sanft. (*Chronik im Stein, Ismail Kadare, Seite 27*)

⁴⁵⁷ Ulrich Engel, *Deutsche Grammatik*, IUDICIUM Verlag GmbH München, 2004, Seite 2018.

⁴⁵⁸ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002, f. 323.

(22b)

*Le të rrijë, po të dojë!**Er kann bleiben, wenn er will!;*

(22c)

*Le të rrinë, po të duan!**Sie können bleiben, wenn sie wollen!*

dh) Në gjermanishte hasim edhe përdorime të infinitivit për të shprehur një urdhër (23), përdorim të cilin nuk e gjejmë në shqipen standarde. Në rastin tonë kthimi në shqipe realizohet me ndërtime në urdhërore; në gjermanishte kuptimi del shumë i qartë vetëm me foljen *weetersagen*, ndërsa në shqipe fjalja vetëm me foljen *Thuaja* do të ishte e pakuptimtë pa praninë e një kundrinori, në këtë rast e shprehur me emrin *shokëve*.

(23)

Weetersagen!** (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 63)*Thuaja shokëve!** (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 65)*

e) Jo të rralla në gjermanishte janë edhe përdorimet e fjalive pa kryefjalë në diatezën pësore (24)⁴⁵⁹. Në shembullin në gjermanishte folja është në të tashmen dëftore, në diatezën pësore. Kthimi në shqipe realizohet përmes diatezën pësore, por me kohën e ardhme dëftore. Përdorimi i pësore në të dyja gjuhët flet për një përjasje të pjesshme midis tyre. Krahas kësaj kemi përjasje semantike, sintaksore e stilistike: mesazhi i urdhrit transmetohet pastër, njësoj në të dyja gjuhët, me të njëjtën fuqi emocionale dhe shprehet me të njëjtin intonacion. Përdorime të tilla hasen më shpesh në gjermanishte se sa në shqipe dhe më konkretisht në ligjërimin e folur se sa në atë të shkruar.

(24)

*Jetzt **wird** aber **gearbeitet**!****Tani do të punohet!***

⁴⁵⁹ DUDEN, *Grammatik der deutschen Sprache*, Duden Band 4, Dudenverlag, Mannheim, Leipzig, Wien, Zürich, 2003, f. 172.

f) Duke e përmbyllur përmendim edhe disa përdorime të urdhërores të fshehura në fjali në përbërje të të cilave janë folje me nuancë urdhri⁴⁶⁰ (25). Foljet e mëposhtme bartin ngjyrosje të lartë kërkesë dhe në përdorimet e tyre në funksionin e urdhërores e tërë vëmëndja e bashkëbiseduesit përqëndrohjet pikërisht te këto folje – elementet e tjerë në fjali luajnë rol dytësor, plotësues të mendimit të ligjëruesit/shkrimtarit. Edhe në këto forma konkurruese të urdhërores kemi përjasje në të dyja gjuhët. Shkalla e ngjashmërisë është tejet e lartë duke përfshirë të gjitha nivelet, atë morfologjik, semantik, sintaksor dhe stilistik. Përdorime të tilla hasen më së shumti në ligjërimin e folur se në atë të shkruar.

(25)

Ich wünsche/verlange/fordere, dass das gemacht wird!

Unë dëshiroj/pretendoj/kërkoj, që kjo të bëhet.

Përpos veçorive formale të përdorimit të formave të urdhërores dhe atyre konkurruese, duhet të përmendim edhe disa kufizime të kushtëzuara nga komunikimi⁴⁶¹:

- Në të dyja gjuhët ka folje të cilat nisur nga kuptimi që ato mbartin, nuk mund të përdoren në forma të urdhërores, si p.sh. *të gjitha foljet modale*⁴⁶², *foljet jovevatore* dhe folje si: *vlen (gelten)*, *rishoh një person (jemanden wiedersehen)*, *njoh (kennen)*, *marr (bekommen)*, *banoj (wohnen)*⁴⁶³ etj. Përrjashtim të foljeve modale *duhet/sollen* apo *duhet/müssen* e gjejmë në raste të tilla, si: *Unë nuk dua të shkoj. Ti duhet!/Ich möchte nicht hin. Du musst!* Në këtë përdorim duket qartë nga konteksti që folja modale shpreh një urdhër, por ai nuk ka kuptim i shkëputur nga konteksti.
- Një sërë foljesh dalin në urdhërore në shumicën e rasteve me formë mohore (26)⁴⁶⁴, por nuk përjashtohen edhe rastet kur dalin me forma pohore.

(26)

Mos gënje! / Lüge nicht!

⁴⁶⁰ Po aty.

⁴⁶¹ Për gjermanishten kryesisht nga: Gerhard Helbig & Joachim Buscha, *Deutsche Grammatik, ein Handbuch für Ausländerunterricht*, Langenscheidt, Berlin und München, 2001, f. 185.

⁴⁶² Këtu saktësojmë që përjashtohen përdorime në urdhërore të foljeve modale, por jo në ndërtime me folje modale, gjë të cilën e kemi trajtuar edhe tek format konkurruese të urdhërores.

⁴⁶³ DUDEN – *Grammatik der deutschen Gegenwartssprache*, Duden Band 4, Mannheim, Leipzig, Wien, Zürich, 2003, f. 171.

⁴⁶⁴ Gerhard Helbig & Joachim Buscha, *Deutsche Grammatik, ein Handbuch für Ausländerunterricht*, Langenscheidt, Berlin und München, 2001, f. 185.

- Shpesh fjalitë e urdhërores në të dyja gjuhët shoqërohen edhe me pjesëza⁴⁶⁵ (27), roli i të cilave dihet që është thjesht përforcues apo zbutës, gjithsesi i shërben ligjëruesit për të orientuar më mirë atë çka ai do të shprehë: ***Pa thuaj!** / **Sag mal!**; **Hajde pra!** / **Komm doch!***:

(27)

***Pa shikoji** një herë këta gishtërinj. (Asgjë e re nga fronti i perëndimit, Erik Maria Remark, f. 33)*

***Sieh dir das mal an**, diese Finger. (Im Westen nichts Neues, Erich Maria Remarque, Seite 30)*

⁴⁶⁵ Për gjermanishten: Po aty, f. 186.

PËRFUNDIME

Kategoritë gramatikore të mënyrës dhe kohës i gjejmë në sistemin foljor të shqipes dhe në atë të gjermanishtes; lidhja që ekziston midis këtyre dy koncepteve gramatikore takohet si në paradigmat foljore, ashtu edhe në funksionet e përdorimit të tyre. Sistemi foljor i shqipes është më i larmishëm se ai i gjermanishtes, ndërsa përta i përket kuptimeve gramatikore, që të dyja gjuhët paraqiten tepër të pasura. Përjashtje gjejmë edhe në lidhjen midis veprimit të emërtuar nga folja dhe realitetit objektiv apo subjektiv. Për të dyja gjuhët kategoria gramatikore e mënyrës është mjeti kryesor, por jo i vetëm, për të shprehur modalitetin.

Në shqipen standarde, sipas kuptimeve modale që shprehin dhe paradigmave foljore përkatëse, dallohen gjashtë mënyra: *dëftorja*, *habitorja*, *lidhorja*, *kushtorja*, *dëshirorja* dhe *urdhërorja*. Ndërsa në gjuhën e sotme gjermane pranohen tri mënyra: *dëftorja*, *lidhorja* dhe *urdhërorja*. Evolucion i gjuhësor i ka prekur të dyja gjuhët duke lënë gjurmë domethënëse në sistemin foljor përkatës, porse drejtimet e zhvillimeve gjuhësore kanë qenë në kahe të ndryshme. Ndërkohë që gjermanishtja është treguar "kursimtare" me numrin e mënyrave duke u "rrudhur" nga katër mënyra në tri, shqipja ka patur prirjen të përvijojë e qartësojë mënyrat ekzistuese. Edhe pse numri i mënyrave në të dyja gjuhët është i ndryshëm, gjermanishtja afrohet me shqipen përta i përket numrit të grupeve të mënyrave dhe modalitetit që ato shprehin. Duke krahasuar sistemet foljore ai në shqipe është shumë i komplikuar dhe më i pasur me forma foljore sintetike, analitike dhe të bashkëngjitura se sa ai në gjermanishte.

Midis mënyrave nuk ekzistojnë kufij të mirëpërcaktuar e kjo e bën të vështirë studimin e tyre. Shpesh vërehen kombinime të mënyrave. Territorët në të cilat operon *dëftorja* në të dyja gjuhët janë të shumta e nga njëra gjuhë tek tjetra, ajo shtrihet edhe në përdorime të mënyrave të tjera. Spektri i përdorimit të lidhore - e cila ka pak funksione të sajat dhe një pjesë të mirë e ka falë kombinimeve me mënyrat e tjera - si në shqipe edhe në gjermanishte është tepër i gjerë dhe me shumë nuanca; *urdhërorja* që në nisje paraqitet me një defiçit në forma gramatikore: e krahasuar me *dëftoren* dhe *lidhoren* përdorimet e saj në të dyja gjuhët janë më të pakta. Ndikim në spektrin e përdorimit të *urdhërores* kanë edhe format konkurruese të saj, të cilat e detyrojnë të humbasë terren përdorimi. Në të dyja gjuhët kategoritë e mënyrës dhe kohës nuk ndërveprojnë vetëm në nivelin morfologjik, por edhe në atë semantic.

Marrëdhënia *modalitet:mënyrë* luan të njëjtin rol morfo-sintaksor në të dyja gjuhët - edhe pse përta i përket numrit të mënyrave që gjenden në të dyja gjuhët nuk shohim përjashtje midis

shqipes dhe gjermanishtes, mund të dallojmë fare qartë afrimin e larmisë së kuptimeve modale që ato shprehin dhe tipologjitë e grupimit të mënyrave.

Gjatë evolucionit historik gjuha shqipe dhe ajo gjermane kanë krijuar një sistem kohor koherent dhe mjaft të larmishëm formash gramatikore, të mbështetura jo vetëm në kundërvënien me karakter kohor, por edhe në atë me nuancë aspektore. Porse kjo e fundit shihet e trajtohet si fenomen gjuhësor, i cili, kjo vlen më shumë për gjermanishten, nuk ka një pozicion të qartë e të mirëfiksuar. Në shqipe aspektin e hasim në kundërvënien *veprim i kryer:veprim i pakryer (perfektiv:imperfektiv)*, të mbështetur kryesisht në kundërvënien e kohës së tashme ndaj së shkuarës dhe së ardhmes, ndërsa në gjermanishte shihet pjesorja e shkuar si bartëse gramatikore e aspektit duke e klasifikuar të kryerën dëftore si formë të aspektit. Si në shqipe edhe në gjermanishte nëpërmjet kategorisë së kohës shprehet lidhja midis kohës kur kryhet veprimi i emërtuar nga folja dhe një çasti të caktuar, që merret si bazë për marrëdhëniet kohore. Të dyja gjuhët i kanë të tria kohët themelore të foljes: *të tashmen, të shkuarën dhe të ardhmen*, por shpërndarja e tyre nuk është e njëjtë. Në shqipe kategorinë gramatikore të kohës e kanë mënyra dëftore, habitore, lidhore, kushtore dhe dëshirore, që nga pikëpamja gramatikore i kundërvihen njëra-tjetrës, ndërsa në gjermanishte ajo dëftore dhe lidhore. Te asnjëra gjuhë nuk mund të flasim për kategori gramatikore të kohës për mënyrën urdhërore – këtu kemi mungesë të kundërvënieve kohore, gjë e cila e gjen shpjegimin tek vetë modaliteti i kësaj mënyre.

Midis kategorisë së kohës dhe asaj të modalitetit ekziston një lidhje e ngushtë; është pikërisht tipi i modalitetit të kësaj apo të asaj mënyre ai që kushtëzon numrin e formave kohore. Si në shqipe edhe në gjermanishte dëftorja shtrihet në të tria hapësirat kohore, por numri i kohëve në secilën gjuhë është i ndryshëm: shqipja del me dhjetë kohë – duke u konsideruar si mënyra më e pasur në kohë në sistemin foljor të shqipes - ndërsa gjermanishtja me gjashtë. Kohët e dëftores në shqipe janë: *e tashmja, e pakryera, e kryera e thjeshtë, e kryera, më se e kryera, e kryera e tejshkuar, e ardhmja, e ardhmja e së shkuarës, e ardhmja e përparme, e ardhmja e përparme e së shkuarës*; kohët e dëftores në gjermanishte janë: *e tashmja, preteritumi, e kryera, më se e kryera, e ardhmja, e ardhmja e së shkuarës*, pra katër më pak se shqipja. Në grupin e mënyrave që shprehin modalitetin e së vërtetës, në shqipe gjendet edhe habitorja, - të cilën nuk e hasim në gjermanishte - e paraqitur me katër kohë: *të tashmen, të pakryerën, të kryerën dhe më se të kryerën*. Lidhorja në shqipe shtrihet në dy kohë: *në të tashmen dhe në të shkuarën*, ku e shkuara ka tri ndarje kohore: *të pakryerën, të kryerën, më se të kryerën*; ndërsa në gjermanishte lidhorja shtrihet në të tria kohët: *në të shkuarën, të tashmen dhe në të*

ardhmen, me këto ndarje kohore: *të tashmen*, *preteritumin*, *të kryerën*, *më se të kryerën*, *të ardhmen*, *të ardhmen e së shkuarës*. Krahësuar me gjermanishten, lidhëria e shqipes del me katër kohë, pra me dy më pak. Mënyra e dytë në shqipe që shpreh modalitetin e mundësisë, të cilën nuk e gjejmë në gjermanishte, ajo kushtore, ka dy forma kohore: *të tashmen* dhe *të kryerën*. Mënyra dëshirore, të cilën e hasim vetëm në shqipe del me dy forma kohore: *të tashmen* dhe *të kryerën*. Në të dyja gjuhët urdhërorja nuk përmban forma kohore, por vetëm forma gramatikore të së tashmes.

Në të dyja gjuhët folja përbën bërthamën e fjalisë dhe kuptimi i termit zgjedhim është i njëjtë. Si në gjuhën shqipe edhe në atë gjermane, zgjedhimi i foljeve është dy llojesh: *vepror* dhe *jovepror*. Midis dy zgjedhimeve, ai *vepror* vlen si formë e pashenjësuar morfologjikisht dhe semantikisht. Të gjitha foljet në shqipe dhe në gjermanishte formojnë paradigma foljore në diatezën *veprore*, por veç një pjesë e foljeve paraqiten me paradigma foljore në diatezën *joveprore*.

Si në shqipe edhe në gjermanishte format e ndryshme kohore që merr folja gjatë zgjedhimit të saj janë *sintetike* dhe *analitike*. Dy gjuhët afrohen shumë përsa i përket mjeteve të ndryshme gramatikore që përdorin në ndërtimin e formave sintetike të foljes: me anë të mbaresave vetore, njëherazi me anë mbaresash vetore dhe ndërrimesh fonetike, me anë prapashtesash trajtëformuese, të plotësuar ndonjëherë dhe me mbaresa vetore dhe me anë të supletivizimit, të plotësuar edhe me mbaresa vetore ose me prapashtesa trajtëformuese. Ndërsa te mjetet gramatikore për ndërtimin e formave analitike gjejmë vetëm një pikë të përbashkët midis dy gjuhëve: përdorimin e ndihmësive *kam* dhe *jam* - pjesëzat formante që përdor shqipja për ndërtimin e formave analitike nuk i gjejmë në gjermanishte.

Strukturat foljore analitike në gjuhën shqipe karakterizohen nga tipari morfologjik i domosdoshmërisë për të qëndruar bashkë në fjali, qoftë në ligjërimin e folur, qoftë në atë të shkruar. Ndryshe qëndron çështja në gjermanishte, ku kohët analitike apo të përbëra siç emërtohen edhe në gramatikën gjermane, formojnë të ashtuquajturën në gjermanishte kllapë foljore duke u shpërndarë nëpër fjali.

Kohështrirja e mënyrës dëftore në të dyja gjuhët është e shkuar, e tashme dhe e ardhme, duke u paraqitur me dhjetë kohë (*të tashmen*, *të pakryerën*, *të kryerën e thjeshtë*, *të kryerën*, *më se të kryerën*, *të kryerën e tejshkuar*, *të ardhmen*, *të ardhmen e së shkuarës*, *të ardhmen e përparme*, *të ardhmen e përparme të së shkuarës*), e në gjermanishte me gjashtë kohë (*të tashmen*, *preteritumin*, *të kryerën*, *më se të kryerën*, *të ardhmen*, *të ardhmen e së shkuarës*).

Procesi i ndërtimit të së tashmes dëftore në diatezën veprorë si në shqipe edhe në gjermanishte është parimisht i njëjtë: në të dyja gjuhët format vetore të së tashmes dëftore ndërtohen duke i pasvendosur rrënjës së foljes mbaresat vetore përkatëse; në gjermanishte mbaresat vetore vlejné pothuajse për të gjitha foljet, ndërsa në shqipe thuajse çdo klasë zgjedhimi kërkon mbaresa vetore të veçanta. Gjithashtu përjasje kemi kur disa folje të forta në gjermanishte ndryshojné zanoren e rrënjës së foljes, tipar që e gjejmë edhe në shqipe. Ndryshimi këtu midis dy gjuhëve qëndron në faktin, që në gjermanishte ndiqet një rregull: zanorja e rrënjës pëson ndryshim vetëm në vetën e dytë dhe të tretë njëjës, ndërsa në shqipe ky ndryshim është i variueshëm: në disa folje gjen zbatim vetëm në vetën e dytë shumës, në disa të tjera në vetën e dytë dhe të tretë njëjës edhe në vetën e dytë në shumës. Ndërtimi i së tashmes dëftore në diatezën joveprorë në të dyja gjuhët është morfologjikisht i ndryshëm dhe nuk gjejmë asnjë pikë takimi: në shqipe ky formim realizohet përmes mbaresave të caktuara foljore, ndërsa në gjermanishte ka me dy elemente përbërës: foljen ndihmëse dhe pjesoren e shkuar të foljes kryesore.

Në gramatikën e shqipes standarde gjenden dy kohë të shkuara të thjeshta në mënyrën dëftore: *e pakryera* dhe *e kryera e thjeshtë*. Në gramatikën e gjermanishtes së sotme gjendet vetëm një kohë e thjeshtë e shkuar në mënyrën dëftore: *preteritumi*. Përballë preteritumit të gjermanishtes, në shqipe qëndron binomi: *e pakryer* dhe *e kryer e thjeshtë*. Procesi gjuhësor i formimit të kohëve të shkuara të thjeshta dëftore në diatezën veprorë si në shqipe edhe në gjermanishte gjen në vija të përgjithshme pika të përbashkëta: për të formuar kohët e thjeshta të shkuara dëftore të dyja gjuhët i referohen së tashmes dëftore duke i shtuar mbaresat vetore përkatëse dhe në të dyja gjuhët foljet e forta apo të parregullta siç quhen ndryshe, ndryshojné zanoren e rrënjës. Ndërsa përsa i përket ndërtimit të këtyre kohëve në diatezën joveprorë, ai është i ndryshëm: në kohën e pakryer dëftore në diatezën pësore në shqipe foljes i prapavendosim mbaresat vetore: *-esha/-hesha*, *-eshe/-heshe*, *-ej(-esh)/-hej(-hesh)*, *-eshim/-heshim*, *-eshit/-heshit*, *-eshin/-heshin*. Për të formuar format vetore foljore të së kryerës së thjeshtë dëftore në diatezën joveprorë u paravendoset formave vetore të foljes pjesëza *u*. Ndërsa format foljore të preteritumit dëftore në diatezën pësore në gjermanishte ndërtohen me ndihmësen *werden* në preteritum dhe pjesoren e shkuar të foljes kryesore.

Ndërtimi i së kryerës dëftore në diatezën veprorë në të dyja gjuhët është deri diku i njëjtë: të dyja gjuhët përdorin ndihmësen *kam* dhe pjesoren e shkuar të foljes kryesore – ndryshimi qëndron, që shqipja ndihmësen *kam* e përdor për të formuar format foljore të diatezës veprorë, ndërsa në gjermanishte ajo përdoret për të formuar kohën e kryer për foljet kalimtare dhe

ndihmësja *jam* për të formuar kohën e kryer për foljet jokalimtare. E përbashkëta midis shqipes dhe gjermanishtes në formimin e formave foljore të kohës së kryer dëftore në diatezën pësore qëndron në këto pika: në rolin dhe kohën e ndihmësës *jam*, si dhe në formën gramatikore të foljes kryesore – në të dyja gjuhët ajo është pjesore e shkuar; ndryshimi qëndron në rolin e ndihmësës *werden* në gjermanishte, si element shtesë dhe tipik për të ndërtuar format foljore në diatezën joveprorë.

Ndërtimi i më se të kryerës në diatezën veprorë në të dyja gjuhët është deri diku i njëjtë: pjesorja e shkuar është pjesë përbërëse e strukturës foljore të kësaj kohe; ndryshimi qëndron, që në shqipe përdoret ndihmësja *kam*, ndërsa në gjermanishte kjo folje përdoret për të formuar më se të kryerën për foljet kalimtare e ndihmësja *jam* për foljet jokalimtare. Ndërtimi i më se të kryerës në diatezën joveprorë midis dy gjuhëve është deri diku i ngjashëm: të dyja gjuhët përdorin ndihmësen *jam* – shqipja në të pakryerën dëftore, e gjermanishtja në preteritum dëftore – dhe pjesoren e shkuar të foljes kryesore; struktura foljore në gjermanishte kërkon edhe ndihmësen *werden* në pjesoren e shkuar pa pjesën *ge*.

Duke qenë se në gjermanishte nuk gjenden format foljore të së kryerës së tejshkuar nuk mund të bëhet krahasim në nivelin morfologjik midis dy gjuhëve.

Ndërtimi i së ardhmes dëftore në diatezën veprorë në shqipe dhe në gjermanishte është i ndryshëm: në shqipe zgjedhim i foljes në kohën e ardhme dëftore do të thotë zgjedhim i formave të foljes në të tashmen e lidhore dhe pjesa *do* rri e ngurtësuar; ndërsa në gjermanishte me zgjedhim të foljes në kohën e ardhme dëftore kuptojmë zgjedhim të ndihmësës *werden*, e folja kryesore rri në infinitiv e pandryshuar. Gjithashtu edhe tipi i dytë i së ardhmes dëftore në shqipe nuk ka asnjë pikë të përbashkët me ndërtimin e së ardhmes dëftore në gjermanishte. Ndërtimi morfologjik i së ardhmes dëftore në diatezën joveprorë paraqitet i ndryshëm në të dyja gjuhët: në shqipe realizohet duke i prapavendosur pjesëzës së ngurtësuar *do* foljen kryesore në të tashmen e lidhore, ndërsa në gjermanishte kjo kohë ndërtohet me ndihmësen *werden* në të tashmen dëftore, pjesoren e shkuar të foljes kryesore dhe pjesoren e tashme të ndihmësës *werden*.

Ndërtimi morfologjik i së ardhmes së përparme në të dyja gjuhët është i ndryshëm – si element i përbashkët mund të konsiderohet roli i pjesshëm i kohës së kryer: te shqipja bëhet fjalë për të kryerën e lidhore, ndërsa në gjermanishte për të kryerën në infinitiv. Ndërtimi i formave foljore të kësaj kohe në diatezën joveprorë në të dyja gjuhët, edhe pse në përgjithësi është i ndryshëm, takohet në përdorimin e pjesores së shkuar të foljes kryesore.

Në gramatikën gjermane nuk gjenden paradigma foljore të së ardhmes të së shkuarës e kësisoj nuk mund të flitet për krahasim në nivelin morfologjik midis dy gjuhëve.

Kohët e mënyrës habitore në shqipe janë dy: *e tashme* dhe *e shkuar*, ku e shkuara paraqitet me tri kohë: *të pakryerën*, *të kryerën* dhe *më se të kryerën*. Në gjuhën gjermane nuk gjenden paradigma foljore të mënyrës habitore e për rrjedhojë nuk mund të flasim për krahasim në nivelin morfologjik midis dy gjuhëve.

Shtrirja kohore e mënyrës lidhore në shqipe është *e tashme* dhe *e shkuar*, ndërsa në gjermanishte *e shkuar*, *e tashme* dhe *e ardhme*. Lidhorja në shqipe ka katër kohë: *të tashmen*, *të pakryerën*, *të kryerën* dhe *më se të kryerën*; ndërsa lidhorja në gjermanishte ka gjashtë kohë: *të tashmen*, *preteritumin*, *të kryerën*, *më se të kryerën*, *të ardhmen* dhe *të ardhmen e së shkuarës*. Krahasuar me shqipen, lidhorja e gjermanishtes është më e pasur në kohë – ajo përmban edhe forma gramatikore të kohës së ardhme, ndërsa përse i përket kohëve të shkuara, secila gjuhë ka tri. Lidhoret e të dyja gjuhëve janë të organizuara në mënyra të ndryshme: për nga forma në gjuhën gjermane dallohen Konjunktiv I, i cili formohet nga rrënja e kohës së tashme dëftore, dhe Konjunktiv II, i cili formohet nga rrënja e preteritumit. Kohët analitike e sintetike që ndërtohen me anë të Konjunktiv I janë: *e tashmja*, *e kryera*, *e ardhmja* dhe *e ardhmja e përparme*; ato që ndërtohen me anë të Konjunktiv II janë: *preteritumi* dhe *më se e kryera*.

Procesi i formimit të së tashmes lidhore në diatezën veprorë në të dyja gjuhët është kryesisht i ndryshëm – e përbashkëta qëndron, që këto dy kohë bazohen në të tashmen e dëftores: ndërtimi i paradigmave foljore të së tashmes lidhore në diatezën veprorë në shqipe dhe gjermanishte, dhe i atyre në diatezën joveprorë në gjermanishte. Kur format e Konjunktiv I përputhen me ato të së tashmes dëftore, atëherë lidhorja ndërtohet me "*ndihmësen werden në Konjunktiv II `würden` + foljen kryesore në infinitiv`*".

Si ndërtimi i së pakryerës lidhore në diatezën veprorë në shqipe ashtu dhe ai i preteritumit lidhore në diatezën veprorë bazohen në mënyrën dëftore. Ky proces në shqipe paraqitet më i thjeshtëzuar se në gjermanishte: të gjitha foljet në të pakryerën e lidhores dalin me të njëjtat mbaresa vetore si në të pakryerën e dëftores në formën veprorë duke i shtuar pjesëzën formante *të*, ndërsa gjermanishtja orientohet drejt preteritumit të dëftores duke i shtuar mbaresat vetore përkatëse (*-e*, *-est*, *-e*, *-en*, *-et*, *-en*). Procesi i ndërtimit të këtyre kohëve në diatezën joveprorë është krejt i ndryshëm: shqipja orientohet nga e pakryera dëftore në diatezën joveprorë, ndërsa gjermanishtja nga lidhorja.

Midis dy gjuhëve kemi përjasje në ndërtimin e së kryerës lidhore në diatezën veprorë: si shqipja edhe gjermanishtja e formojnë këtë kohë më të njëjtën formulë gramatikore "*ndihmësja kam në lidhore + pjesoren e shkuar të foljes kryesore*". Ndryshimi qëndron që në gjermanishte foljet që tregojnë lëvizje apo ndryshim gjendjeje e formojnë këtë kohë me ndihmësen *jam*. Ndërtimet e këtyre kohëve në diatezën joveprorë janë të ngjashme në dy pika: të dyja gjuhët i paravendosin pjesores së shkuar të foljes kryesore ndihmësen *jam* në të tashmen lidhore; përpos kësaj në strukturën e saj gjermanishtja ka edhe pjesoren e shkuar të ndihmëses *werden*.

Ndërtimi i më se të kryerës lidhore në diatezën veprorë në të dyja gjuhët paraqitet thuajse i njëjtë: ato orientohen drejt mënyrës lidhore duke i paravendosur pjesores së shkuar ndihmësen *kam* për të dyja gjuhët dhe *jam* për gjermanishten në kohën e thjeshtë të shkuar lidhore. Ndryshe qëndron çështja në formimin e paradigmave foljore të kësaj kohe në diatezën pësorë: shqipja i paravendos pjesores së shkuar të foljes kryesore ndihmësen *jam* në të pakryerën e lidhore, ndërsa gjermanishtja i paravendos pjesores së shkuar të foljes kryesore dhe ndihmëses *werden* foljen ndihmëse *jam* në preteritumin e lidhore.

Duke qenë se koha e ardhme dhe ajo e ardhme e përparme lidhore gjenden vetëm në gjermanishte, nuk është e mundur të flasim për krahasim në nivelin morfologjik midis dy gjuhëve.

Mënyra kushtore në shqipe ka dy kohë: *të tashmen* dhe *të kryerën*. Duke qenë se në gjermanishte nuk gjenden paradigma foljore të mënyrës kushtore, është e pamundur të flitet për krahasim në nivelin morfologjik midis dy gjuhëve.

Mënyra dëshirore në gjuhën shqipe ka dy kohë: *të tashmen* dhe *të kryerën*. Duke qenë se në gjermanishte nuk gjenden forma foljore të mënyrës dëshirore, është e pamundur të flitet për krahasim në nivelin morfologjik midis dy gjuhëve.

Urdhërorja është e vetmja mënyrë në shqipe dhe gjermanishte e cila nuk ka ndarje kohore sikur mënyrat e tjera. Paraqitja e kësaj mënyre në të dyja gjuhët përmbledhet me dhënien e paradigmave foljore në vetën e dytë njëjës e shumës, duke shtuar për gjermanishten edhe vetën e përdorimit zyrtar apo të politesës, e cila gramatikisht shprehet ndryshe te njëra gjuhë e ndryshe te tjera, por përdorimi, kuptimi e funksioni janë të ngjashëm: në shqipe përdoret veta e dytë shumës për të shprehur formën e politesës, ndërsa në gjermanishte forma me *Sie*. Në të dyja gjuhët forma e politesës mund t'i drejtohet një, dy apo disa personave. Procesi i ndërtimit të paradigmave foljore të mënyrës urdhërore në të dyja paraqitet i njëjtë: baza për formimin e tyre është koha e tashme e mënyrës dëftore. Për të formuar vetën e dytë njëjës urdhërore në

shqipe dhe gjermanishte bie për emri vetor (në shqipe kemi edhe ndonjë përjashtim, ku për emri vetor vendoset: *Shko ti, jo Ana! / Flisni ju, jo fëmijët!*) dhe mbaresat vetore të foljes në të tashmen dëftore; ndërsa për të formuar vetën e dytë shumës urdhërore paradigmave të vetës së dytë shumës të të tashmes dëftore – të cilat janë homografe dhe homofone me urdhëroren – i bie për emri vetor. Në shqipe forma e politesës e mënyrës urdhërore ndjek formimin e mënyrës urdhërore të vetës së dytë të numrit shumës, koha e tashme, mënyra dëftore; ndërsa në gjermanishte kjo formë përputhet plotësisht me atë të politesës në të tashmen e dëftores, me ndryshimin e vetëm, që në urdhërore, folja dhe për emri *Sie* këmbejnë pozicionet e tyre në fjali. Përjashtje vërehet edhe në momentin, që në të dyja gjuhët morfologjikisht nuk arrihet të kuptohet nëse po i drejtohem një apo shumë personave - këtë informacion ne mund ta nxjerrim nga konteksti gjuhësor. Në shqipe urdhërorja shfaqet edhe në diatezën joveprore, ndërsa qëndrimi i gjuhëtarëve gjermanë mbi shprehjen e mënyrës urdhërore në diatezën pësore në gjermanishte nuk është i njëjtë - pak e pranojnë e të tjerë e përjashtojnë atë.

Në shqipe dhe gjermanishte me anë të mënyrës dëftore shprehet kryesisht modaliteti i vërtetësisë. Ajo nuk duhet të kuptohet si mënyra e së vërtetës, me anë të së cilës mund të shprehen vetëm thënie të vërteta – e rëndësishme është që këto thënie të jepen si reale ose të paktën, të paraqiten si mundësisht reale. Kjo mënyrë karakterizohet negativisht nga ana e modalitetit e duke qenë se i referohet realitetit, pra operon në një zonë, e cila në sensin epistemik vlen si e verifikueshme ajo nuk trajtohet normalisht si operatore e modalitetit. Edhe nga ana formale, për sa i takon modalitetit, kjo mënyrë karakterizohet negativisht. Në lëmin gjuhësor në të dyja gjuhët gjenden mjete të ndryshme gramatikore me anë të të cilave fjalitë në dëftore mund të ngjyrosen nga ana modale. Ndër këto përmendim: *ndajfoljet modale, disa grupe fjalësh modale, foljet modale, forma kohore modalisht të ngjyrosura, theksim të veçantë dhe folje të caktuara në fjalinë kryesore*. Duke përdorur mjete të tilla gramatikore ligjëruesi merr një qëndrim të caktuar ndaj veprimit në fjalë.

Kuptimi kohor i mënyrës dëftore në të dyja gjuhët është i tanishëm, i shkuar dhe i ardhshëm. Në shqipe dëftorja është e vetmja mënyrë me një shtrirje kaq të madhe në kohë dhe ky numër është më i madh se sa ai i mënyrës dëftore në gjermanishte. Ndryshime vërehen në kohën e shkuar, me diferencën dy kohë dhe në të ardhmen, gjithashtu me dy kohë. Në gjermanishte preteritumi qëndron përballë së pakryerës dhe së kryerës së thjeshtë të shqipes; gjithashtu në gjermanishte nuk gjejmë të kryerën e tejshkuar. Në të ardhmen shqipja ka katër kohë, ndërsa gjermanishtja dy; në gjermanishte nuk gjenden: e ardhmja e përparme dhe e ardhmja e përparme e së shkuarës.

Kuptimi themelor i foljes në të tashmen dëftore në të dyja gjuhët është të tregojë kryerjen e një veprimi në një kohë që përfshin edhe çastin e ligjërit. Veprimet e shprehura me këtë kohë bartin modalitetin e vërtetësisë, qofshin këto pohime, mohime apo dyshime. Shtrirja kohore e së tashmes është e papërcaktuar dhe varet nga ajo çka dëshiron të shprehë folësi – kohëpërdorimi mund të nënkuptojë momentin kur flasim, të jetë i përcaktuar në kontekst apo edhe të zgjasë deri në pafundësi, pra të ketë vlerë mbarëkohore. Përdorimi i pjesëzës *po* në gjuhën shqipe për të dalluar një veprim të caktuar, të individualizuar në momentin e ligjërit është një fenomen gramatikor i zhvilluar kryesisht në të tashmen dëftore. I njëjti kuptim në gjermanishte mund të shprehet përmes ndajfoljeve kohore *gerade, jetzt (në këtë moment, tani)* ose nëpërmjet togfjalëshit *im Moment (në këtë moment)*, pa ndihmë lesikore shtesë. Një numër i kufizuar foljesh në shqipe të cilat shprehin gjendje fizike apo emocionale, që e karakterizojnë kryefjalën për një kohë të pacaktuar si p.sh: *gjendem, jam, kam, dashuroj, urrej, di* etj., nuk shoqërohen me pjesëzën *po*. E tashmja dëftore shfaqet në të dyja gjuhët në përdorime apo kuptime me vlerën e kohëve të tjera, asaj të ardhme apo të shkuar. Spektri i këtyre përdorimeve në shqipe krahasuar me atë në gjermanishte është më i vogël. Në të dyja gjuhët e tashmja historike mund të përfaqësojë të gjitha kohët e shkuara, përdorim, i cili është i përvijuar stilistikisht dhe vlen për theksimin e ngjyrave të veprimit: e shkuara kapërcen në të tashmen, veprimi i ndodhur në të shkuarën na paraqitet aktual, sikur po ndodh tani në këto momente. Në të dyja gjuhët gjejmë përputhje në përdorimin e së tashmes dëftore për të shprehur veprimtari rutine pa patur nevojën e elementeve gramatikore shtesë. Gjithashtu në të dyja gjuhët e tashmja dëftore përdoret për të shprehur një urdhër – këtu dëftorja vesh petkun e urdhërores. Kur i kthejmë fjalitë e së tashmes dëftore shqipe në gjermanishte apo edhe anasjelltas realizohet ekuivalencë e plotë e të gjitha strukturave: gramatikore, semantike, emocionale, stilistike - përputhshmëria e ruatjes së të gjithë elementeve gjatë përkthimit është në shkallë tejet të lartë.

Në gramatikën e shqipes standarde gjenden dy kohë të shkuara të thjeshta në mënyrën dëftore: *e pakryera* dhe *e kryera e thjeshtë*. Në gramatikën e gjermanishtes së sotme gjendet vetëm një kohë e thjeshtë e shkuar në mënyrën dëftore: *preteritumi*. Përballë preteritumit të gjermanishtes në shqipe qëndron binomi: *e pakryer* dhe *e kryer e thjeshtë*. Që të tria kohët shprehin veprime në të shkuarën – dallimi midis dy kohëve në shqipe ka më fort karakter aspektor: e pakryera ka karakter imperfektiv dhe vështrohet brenda veprimit, ndërsa e kryera e thjeshtë ka karakter perfektiv dhe vështrohet veprimin nga jashtë, ndërsa preteritumi i gjermanishtes nuk e ka të zhvilluar karakterin aspektor. Kohët e thjeshta të shkuara dëftore

kanë shumë pika të përbashkëta, ashtu sikurse edhe të veçanta: me anë të tyre shprehet një veprim, gjendje apo gjendje emocionale në të shkuarën. Kuptimi i preteritumit karakterizohet me tiparin semantik të vazhdimësisë dhe të përmbylljes; e kryera e thjeshtë e shqipes dhe preteritumi i gjermanishtes shprehin një veprim të përfunduar tashmë; e pakryera e shqipes dhe preteritumi i gjermanishtes shprehin një veprim në zhvillim e sipër. E pakryera dhe e kryera e thjeshtë përmbajnë në disa përdorime edhe ngjyime modale, ndërsa në preteritumin e gjermanishtes përjashtohen përdorime të këtilla duke u karakterizuar vetëm nga tipari kohor. E pakryera e shqipes shërben për të shprehur nuanca të ndryshme të ngjyimeve modale në përdorime në lëmin e kushtores, kryesisht në të folmet popullore, por edhe në botën letrare. Në përdorime të tilla vërehet një prirje apo aftësi e së pakryerës dëftore për t'u përdorur në fjali, të cilat fare mirë mund të shprehen me mënyrën lidhore apo fjali lidhore me përdorime të kushtores. Struktura të tilla nuk hasen vetëm në të folmet popullore, por ato janë pjesë edhe të ligjëtimeve të përditshme: duke qenë se në lëmin e përdorimeve të preteritumit nuk hasim përdorime me ngjyime modale, përjashtohen kthimet e këtyre përdorimeve nga shqipja në gjermanishte me anë të preteritumit duke u realizuar me Konjunktiv II. Përdorime me nuanca modale gjejmë edhe te e kryera e thjeshtë, e cila afrohet me të pakryerën, në ndërtime, kur foljet shprehin pasojën reale të një mendimi hipotetik.

Studiuar në lëmin e përkthimeve dhe përdorimeve midis këtyre tri kohëve gjejmë përqasje të shumta në nivelin morfologjik, semantik dhe stilistik. Afrim të dy gjuhëve kemi në përdorim të së pakryerës dhe preteritumit, kur duam të tregojmë një veprim të pacaktuar, që është përsëritur herë pas here në të shkuarën, kur i referohemi dy veprimeve të njëkohshme të së shkuarës, për të treguar një veprim të pacaktuar, që ka zgjatur për një kohë pak a shumë të gjatë në të shkuarën. Përqasje kemi gjithashtu te rëndësia dhe roli i kontekstit, kur i referohemi një veprimi të caktuar në të shkuarën, shoqërimi i fjalive në të kryerën e thjeshtë apo në preteritum me tregues kohorë të caktuar apo të pacaktuar. Me të pakryerën dëftore mund të shprehet edhe një veprim i ndodhur në kohë të shkuar para një veprimi fillestar bazë - këtu gjermanishtja distancohet nga shqipja, duke ngërthyer forma foljore të më se të kryerës.

Sikur në të tashmen dëftore edhe në të pakryerën dëftore, folja shoqërohet me pjesëzën *po* kur përdoret me kuptimin e saj themelor. Këto përdorime në të pakryerën janë më të kufizuara se ato në të tashmen – kjo lidhet drejtpërsëdrejti me faktin gramatikor, që e pakryera si kohë e shkuar është më e qartë në fokusimin kohor se sa e tashmja e dëftores (Po me këtë kuptim mund të përdoret edhe forma perifrastike e ndërtuar me anë të së pakryerës së foljes ndihmëse *jam* dhe *përcjellores së foljes*). Ky fenomen gjuhësor është tipik për gjuhën shqipe e në

gjermanishte kjo strukturë gjuhësore njihet si Verlaufsform. Kthimi i shembujve të shqipes në gjermanishte realizohet me anë të preteritumit, duke mos e patur nevojën e elementeve gramatikorë mbështetës shtesë ose bazuar në shembuj të tjerë përdorimi me ndihmën e treguesve kohorë *në atë moment, tani, menjëherë*, respektivisht në gjermanishte: *in diesem Moment, jetzt, gleich, sofort*. E pakryera e dëftores mund të përdoret pa pjesëzën *po* edhe për të treguar veprime të cilat ndodhin në të tashmen - në përdorime të këtilla fjalia në të pakryerën e dëftores mund të shoqërohet me tregues kohorë. Përdorim me të njëjtën vlerë e hasim edhe në preteritumin e gjermanishtes.

Në disa raste e pakryera dëftore përdoret në vend të së kryerës së thjeshtë – këtu bëhet fjalë për foljet *kam* dhe *jam*, format e pakryera të të cilave nga ana funksionale nuk janë të ndara qartazi nga ato të së kryerës së thjeshtë. Shpjegimin kjo dukuri e gjen të mbështetur në faktin që këto dy folje tregojnë një gjendje, e cila e karakterizon kryefjalën për një kohë të gjatë. E meqë e kryera e thjeshtë, si rregull, vë në dukje vetëm përfundimin e një veprimi, por jo zgjatjen e tij, te këto dy folje ajo priret të zëvendësohet nga e pakryera. Në kthimet në gjermanishte përdoret preteritumi. Në disa raste në shqipe e pakryera përdoret me vlerën e së kryerës së thjeshtë: tipari aspektual i së pakryerës është paraqitja e një momenti orientimi, një prapavije veprimi.

E kryera e thjeshtë ka tiparet e detyrueshme të së shkuarës dhe aspektit. Kur përdorimet e kësaj kohe nuk tregojnë tiparin e së shkuarës ato kanë ngjyrosje stilistike (të varura nga konteksti) apo modale. Përfundimi i një veprimi në fjalitë me folje në të kryerën e thjeshtë në shqipe shprehet nga vetë karakteristikat semantike të foljes, ndërsa në ndërtimet në preteritum kjo arrihet të kuptohet apo nxirret më rrallë nga tiparet semantike të foljes e më shpesh nga konteksti. E kryera e thjeshtë dhe preteritumi mund të tregojnë një veprim të përfunduar në një çast të caktuar të së shkuarës. Shpeshherë fjalitë me forma foljore në të kryerën e thjeshtë apo në preteritum shoqërohen edhe me tregues kohorë të caktuar apo të pacaktuar (*dje, pardje, vjet, atëherë*, respektivisht në gjermanishte: *gestern, vorgestern, letztes Jahr, damals*).

E kryera e thjeshtë e dëftores kombinohet me të pakryerën në rastet kur shfaqet një veprim i ri dhe veprimi, që në proces kalon në vëmendje dytësore duke u shprehur me të pakryerën, ndërsa veprimi i ri shprehet me të kryerën e thjeshtë - këtë përdorim e gjejmë edhe në gjermanishte, porse këtu kemi ndërtim të dyfishtë në preteritum. Kur shprehen dy veprime të njëpasnjëshme të varura me njëra-tjetrën apo që kanë lidhje shkakore midis tyre në shqipe kemi përdorim të dy formave gramatikore të së kryerës së thjeshtë në shqipe e të preteritumit në gjermanishte. Në përdorimet me nuanca modale të së pakryerës dhe të kryerës së thjeshtë

gjejmë pika të përbashkëta, kur foljet shprehin pasojën reale të një mendimi hipotetik. Gjermanishtja këtu distancohet nga shqipja, duke qenë se preteritumi nuk e përmban faktorin modal.

Marrëdhëniet morfologjike të vendosura mes kohëve qoftë në shqipe apo në gjermanishte janë të qarta, janë pikërisht marrëdhëniet semantike ato që shkaktojnë pikëpyetje e paqartësi në vendosjen e kufijve të kësaj apo asaj kohe. Më shumë e kryera e thjeshtë dhe preteritumi, e më pak e pakryera përdoren edhe me vlerën e kohëve të tjera të dëftores, qofshin këto të shkuara, të tashme apo të ardhme, si edhe për përcaktime të përgjithshme. E kryera e thjeshtë dhe preteritumi përdoren me kuptim mbarëkohor, porse spektri i përdorimeve të tilla është shumë i ngushtë duke gjetur terren përdorimi në lëmin e botës letrare, kryesisht në atë poetike e në fjalë të urta popullore. Si e kryera e thjeshtë ashtu edhe preteritumi mund të përdoren edhe në situata të lidhura me të ardhmen – ndryshimi këtu qëndron në tipologjitë e përdorimeve: në shqipe përdorime të këtilla aplikohen kur shprehet një veprim i sigurt në një të ardhme të afërt në struktura me folje që shprehin lëvizje dhe nuk përmbajnë ngjyrosje modale, ndërsa në gjermanishte në situata, që shprehin veprime, të cilat mendohen se do të ndodhin në të ardhmen, por këtu bëhet fjalë për teknikë të rrëfimit letrar, duke zhvendosur momentin e ligjërimit të rrëfyesit në një të ardhme të afërt apo të largët. Të dyja gjuhët përzgjedhin respektivisht preteritumin dhe të kryerën e thjeshtë në struktura gramatikore me foljet ndihmëse *kam/haben*, *jam/sein* dhe *foljet modale*. E kryera e thjeshtë dhe preteritumi përdoren edhe me vlerën e së kryerës. Në të dyja gjuhët, kur ligjëruesi ka për qëllim të shprehë një kërkesë në mënyrë më estetike, ngërthen herë forma foljore të së pakryerës e herë të së kryerës së thjeshtë në shqipe, e preteritumin në gjermanishte – shpesh në përdorime të këtilla gjermanishtja orientohet edhe drejt Konjunktiv II.

Në të dyja gjuhët rrëfimi degëzohet në atë të shkruar dhe të folur. Përzgjedhja e kohës që ngërthen njëra gjuhë apo tjetra konsiderohet si ndërveprim i një kompleksi faktorësh: gjuhësorë, historikë, gjeografikë dhe stilistikë. Në ligjërimin e shkruar si kohë bazë rrëfimesh vlejnë: e pakryera, e kryera e thjeshtë për shqipen dhe preteritumi për gjermanishten. E pakryera dhe preteritumi gjejnë përdorim më të gjerë në literaturën artistike – këtë ato ia dedikojnë nuancave të larmishme e sidomos tiparit si kohë e papërcaktuar. E kryera e thjeshtë përdoret rregullisht në rrëfime ngjarjesh a ndodhish të përfunduara tashmë. Preteritumi në gjermanishte, si koha drejtuese në botën e rrëfimit të shkruar, qëndron përbri së tashmes së dëftores si koha drejtuese e ligjërimit verbal. Në ligjërimin e folur si kohë bazë në të dyja gjuhët vlejnë e tashmja, e kryera dhe e ardhmja, por duke nënvizuar këtu spektrin e gjerë të

kësaj të fundit në shqipe, gjë e cila dallon dukshëm nga ai në gjermanishte. Në ligjërimin verbal në shqipe e kryera e gjermanishtes zakonisht qëndron përballë së kryerës së thjeshtë në shqipe.

Në të dyja gjuhët kuptimi dhe përdorimi i së kryerës dëftore është i njëjtë: me anë të saj shprehet një veprim i përfunduar në të shkuarën, por që ka lidhje me të tashmen. Kuptimi themelor i së kryerës dëftore përdoret kur veprimi i përfunduar lidhet me çastin e ligjërimin nëpërmjet pasojave të tij - këtu fjalia mund të jetë e shoqëruar me tregues kohorë të përcaktuar, të pacaktuar, por ka edhe përdorime në të cilat kuptimi shfaqet pa praninë e tyre. Përdorim tjetër të së kryerës dëftore në të dyja gjuhët është kur veprimi në të shkuarën vazhdon ende në çastin e ligjërimin - kuptimi i së kryerës nxirret nga konteksti, i cili mund të përmbajë edhe tregues kohorë, që tregojnë pikënisjen e veprimit ose gjithë kohën që nga fillimi i veprimit e gjer në çastin e ligjërimin.

Në të dyja gjuhët e kryera dëftore mund të këmbëhet me të kryerën e thjeshtë në shqipe dhe me preteritumin në gjermanishte, këmbim i cili mundësohet falë karakteristikave të njëjta kuptimore të strukturave kohore. Midis këtyre dy kohëve në gjermanishte ka ndryshime në përdorim të karaktereve të ndryshme: fonetike, semantike, morfo-sintaksore, stilistike, socio-linguistike apo edhe dialektore. Të njëjtat konsiderata mund të shprehim edhe për të kryerën e thjeshtë dhe të kryerën në shqipe. Me kuptimin e së kryerës së thjeshtë, d.m.th. për të treguar vetëm përfundimin e një veprimi, pa vënë në dukje çastin e ligjërimin, e kryera haset kryesisht në gjuhën e folur, por aty-këtu edhe në atë të shkruar. Në të dyja gjuhët, kur veprimi për të cilin ligjërohet, mendohet si i realizueshëm në të ardhmen, e kryera përdoret edhe me vlerën e së ardhme dëftore. Megjithatë, jo të gjitha rastet e përdorimit të së kryerës me vlerën e së ardhmes në shqipe e ruajnë kuptimin e kohës së ardhme kur kthehen në gjermanishte, duke e lidhur këtë kryesisht me prirjen e sistemit foljor të gjermanishtes për të përdorur të tashmen dëftore në vlerën e së ardhmes dëftore. Kur i kthejmë fjalitë e së kryerës dëftore nga shqipja në gjermanishte apo edhe anasjelltas realizohet ekuivalencë e plotë e të gjitha strukturave: morfologjike, semantike, kuptimore dhe stilistike. Midis tyre shfaqen aty-këtu dallime, por që nuk janë të qenësishme. Përkthimi në gjermanishte dhe anasjelltas e përçon shumë pastër dhe deri në fund atë çka duam të themi në shqipe.

Në të dyja gjuhët kuptimi themelor i më se të kryerës dëftore është i njëjtë: të tregojë një veprim të përfunduar para një çasti të caktuar të së shkuarës. Kjo kohë ka dy tipare të detyrueshme: dykohshmërinë dhe kohën e shkuar. Më se e kryera nuk e përmban faktorin modal, por mund të përmbajë tregues kohorë ose të shoqërohet me fjali të varur kohore.

Përdorime me faktor modal hasen vetëm në fjali me përdorim hipotetik, joreal – kthimi i këtyre ndërtimeve në gjermanishte realizohet me anë të mënyrës lidhore, me anë të Konjunktiv II. Përdorimet e më se të kryerës dëftore si në shqipe dhe në gjermanishte janë thuajse të njëjta dhe shtrihen kryesisht në dy variante: kur veprimi i përfunduar lidhet me çastin e caktuar të së shkuarës nëpërmjet pasojave ose vijimit gjer në atë çast, dhe kur veprimi i përfunduar mund të mos ketë lidhje me çastin e caktuar të së shkuarës, pra të ketë përfunduar në një parakohë. Në të dyja gjuhët gjejmë përdorim të më se të kryerës dëftore kur kthejmë preteritumin, të kryerën e thjeshtë apo të kryerën nga ligjërata e drejtë në atë të zhdrejtë. Në disa raste vërejmë që në gjermanishte përdoret preteritumi dhe në kthimin në shqipe apo edhe në tekstin origjinal në shqipe më se e kryera dëftore.

Në gjermanishte nuk gjendet e kryera e tejshkuar dëftore. Kjo kohë mbulohet nga më se e kryera, përfaqësim i cili realizohet natyrshëm duke patur parasysh që edhe në shqipe këto dy kohë rrinë pranë njëra-tjetrës në kuptim dhe në përdorim, duke u quajtur kohë sinonime. Nga këto dy forma gramatikore sinonime – por jo gjithmonë - në gjuhën e sotme letrare më dendur përdoret më se e kryera, më fort nëpër të folmet e Shqipërisë Veriore e më rrallë në shqipen letrare.

Në të dyja gjuhët kuptimi themelor kohor i së ardhmes dëftore është i njëjtë: të tregojë një veprim i cili do të ndodhë në të ardhmen. Si në shqipe edhe në gjermanishte kjo kohë është e shenjëzuar minimalisht. Për të shprehur të ardhmen dëftore në diatezën veprare në shqipe përdoren dy tipe: *do të mësoj* dhe *kam për të mësuar*. Tipi i së ardhmes *kam për të mësuar* përdoret kur veprimi ka siguri, që do të ndodhë në të ardhmen. Spektri i këtij tipi përdorimi në shqipe është më i ngushtë se ai i tipit *do të mësoj*. Në gjermanishte gjendet vetëm një tip për të ndërtuar të ardhmen e dëftores në diatezën veprare: *ich werde fragen* (unë do të pyes). Përdorimet e së ardhmes dëftore në të dyja gjuhët janë të njëjta - ajo shërben për të shprehur: *një supozim, një parashikim, shpallje, plan, qëllim, premtim, kërcënim, kërkesë* apo *urdhër*. Në rastet kur shprehet një supozim, fjalia mund të shoqërohet me tregues kohorë (*tani, në këtë moment*, respektivisht në gjermanishte: *jetzt, gerade, in diesem Moment*). Kur shprehim një parashikim apo plan, faktori modal i supozimit mund të jetë i pranishëm, por jo domosdoshmërisht dhe prania e treguesve kohorë (*nesër, së shpejti, vitin tjetër*, respektivisht në gjermanishte: *morgen, bald, nächstes Jahr*) është fakultative. Kur duam të shprehim një premtim apo një qëllim, për të forcuar atë që kërkon të shprehë folësi, fjalitë plotësohen me tregues kohorë, ndajfolje apo togfjalësja të ndryshëm (*përsëri, patjetër, në orar* etj., respektivisht në gjermanishte: *wieder, unbedingt, pünktlich*). Hera-herës haset edhe një prirje

e së ardhmes për të devijuar nga forma e saj klasike e formimit, prirje për t'u rrudhur duke mos e përdorur pjesëzën formuese të të lidhore. Megjithatë kuptimi i së ardhmes ruhet plotësisht në shqipe e për rrjedhojë dhe kthimi në gjermanishte realizohet me sukses. Në ato fjali, ku veprimi në të ardhmen ka siguri realizimi, në gjermanishte në vend të së ardhmes dëftore përdoret e tashmja dëftore. Këtë përdorim e hasim edhe në shqipe, porse spektri i përdorimit në gjermanishte është shumë më i gjerë, duke e vendosur në hije të ardhmen dëftore. Në të dyja gjuhët, kur folësi ka për qëllim të japë një udhëzim, urdhër apo porosi përdoret e ardhmja dëftore dhe me vlerën e urdhërores, përdorim i cili bart vlerën e një forme konkurruese të urdhërores. Intonacioni në këto fjali është ngjites dhe dallohet për ngjyra të forta urdhri. Shembuj të tillë hasen më së shumti në ligjërimin e folur e më pak në atë të shkruar, veçanërisht në letërsi, duke u përqëndruar më tepër në situata familjare apo rrethi shoqëror. Përdorimi prek vetën e dytë njëjës dhe shumës, por ka edhe raste të përdorimit të vetës së parë shumës, të cilat janë të rralla.

Në të dyja gjuhët kuptimi themelor kohor i së ardhmes së përparme është i njëjtë: të shprehë një veprim të mundshëm të së shkuarës në të tashmen apo në të ardhmen. Praninë e komponentëve semantikë modal dhe kohor e gjejmë si në shqipe edhe në gjermanishte. Midis këtyre komponentëve, ai kohor i lë vendin atij modal duke qëndruar vetë në hije. Përdorimi i kësaj kohe është thujse gjithnjë i shoqëruar me faktorin modal të supozimit. Në disa përdorime prania e një treguesi kohor shtesë mund të jetë fakultative, në disa të tjera e domosdoshme. Në të dyja gjuhët gjenden raste përdorimi kur e ardhmja e përparme mund të zëvendësohet nga e kryera dëftore e shoqëruar me një pjesëz dyshimi (*ndoshta, ndofta, patjetër, sigurisht, me siguri* etj., respektivisht në gjermanishte: *wohl, sicher, gewiss, vielleicht, vermutlich, bestimmt*). Në shqipe haset edhe zëvendësimi me anë të së kryerës lidhore paraprirë nga folja gjysmëndihmëse *mund*, ndërsa kthimi në gjermanishte më shpesh realizohet me të kryerën dëftore apo me mënyrën lidhore. Përdorimet e së ardhmes së përparme në diatezën pësore si në shqipe edhe në gjermanishte janë të rralla dhe i hasim kryesisht në artikujt e shtypit. Kur fjalitë e së ardhmes së përparme dëftore kthehen nga shqipja origjinale në gjermanishte apo edhe anasjelltas, kemi përputhje në nivelin semantik, sintaksor, stilistik dhe modal, por jo gjithmonë përputhje në nivelin morfologjik.

Në shqipe e ardhmja e dëftores përfaqësohet me katër kohë gramatikore, ndërsa në gjermanishte me dy kohë. Krahasuar me shqipen, në gjermanishte nuk gjejmë kohën e ardhme të së shkuarës dhe të ardhmen e përparme të së shkuarës. Kuptimi themelor i së ardhmes të së shkuarës është të tregojë një veprim, i cili pritej të kryhej pas një çasti të caktuar të së

shkuarës. Për nga ndërtimi morfologjik, format gramatikore të së ardhmes së shkuar përputhen me ato të së tashmes së kushtores. Pikërisht me vlerën modale të kushtores është dhe përdorimi më i gjerë i së ardhmes së shkuar dëftore në shqipe – kur këto forma gramatikore përdoren me vlerën e së ardhmes të së shkuarës dëftore, karakterizohen nga modaliteti i vërtetësisë. Për të kthyer format gramatikore të së ardhmes së shkuar në gjermanishte apo format gjegjëse të kësaj kohe nga gjermanishtja në shqipe përdoret struktura gramatikore "*würden* (*,do të‘ në Konjunktiv II*) + *folje kryesore në infinitiv*" – kjo vlen për rastet e përdorimeve me ngjyrimë modale. Struktura të tjera gramatikore konkurruese në gjermanishte, që hasen rrallë janë edhe: "*hätten* (*,haben‘ në Konjunktiv II*) + *folje kryesore në infinitiv*", "*folje modale në preteritum/në Konjunktiv II* + *folje kryesore në infinitiv*". E ardhmja e së shkuarës gjen përdorim në ligjërimin e shkruar, pikërisht në tekste letrare apo në median e shkruar, nuk haset në tekste me karakter shkencor. Edhe në gjuhën e folur ajo zë një "qoshe të bukur" duke i mundësuar shqipfolësve nuanca të veçanta në ligjërimet e tyre. Në të folmet popullore format gramatikore të së ardhmes së shkuar hasen edhe pa pjesëzën *të*.

E ardhmja e përparme e së shkuarës përdoret me vlerën e së kryerës së kushtores ose për të shprehur një veprim a gjendje që mund të ketë ndodhur para një çasti të caktuar të së shkuarës. Ajo vlen si forma e ardhme e së kryerës dëftore. E ardhmja e përparme e së shkuarës është e lidhur me tre tipare të detyrueshme, të shenjëzuara shumë fort: pritshmëria, dykohshmëria dhe e shkuara relative. Këtë kohë e gjejmë në shqipe si në ligjërimin e folur, edhe në atë të shkruar, porse spektri i përdorimit është i rrallë. Përdorimi i kësaj forme mund të haset në kthimin e fjalive në të kryerën dëftore të ligjëratës së drejtë në ligjëratën e zhdrejtë. Në kthimin në gjermanishte strukturat gramatikore që përdoren janë "*würden* (*,do të‘ në Konjunktiv II*) + *folje kryesore në infinitiv*", "*hätten* (*,kam‘ në Konjunktiv II*) + *folje kryesore në infinitiv*". E ardhmja e përparme e së shkuarës përdoret edhe me kuptim modal të supozimit apo të kushtores. Gjatë kthimit të fjalive në të ardhmen e përparme të së shkuarës nga shqipja në gjermanishte kemi realizim të plotë semantik, stilistike dhe modal – ndryshimi qëndron në planin morfologjik. Në të folmet popullore format gramatikore të së ardhmes së përparme të së shkuarës hasen edhe pa pjesëzën *të*.

Gjuhëtarë shqiptarë dhe të huaj kanë mbajtur qëndrime të ndryshme përse i përket njohjes së mënyrës habitore në shqipe – një palë e kanë trajtuar si mënyrë më vete, një palë tjetër e kanë parë si pjesë të mënyrës dëftore. Habitorja është një zhvillim i brendshëm i shqipes dhe për nga tipi strukturor nuk ka shoqe në asnjë gjuhë indoevropiane. Në gjermanishte nuk gjenden

forma gramatikore të mënyrës habitore, gjë e cila nuk e mundëson studimin tonë në nivelin morfologjik.

Habitorja është mënyrë e shenjëzuar me anë të së cilës shprehet në përgjithësi modaliteti i vërtetësisë. Daljet e saj përmbajnë më së shumti ngjyime modale. Mënyra habitore ka dy veçori të cilat janë të lidhura me njëra-tjetrën: emocionale, e lidhur me habinë dhe modale, e lidhur me komentin. Ndër funksionet kryesore të saj përmendim: shprehjen e habisë së folësit, dyshimin (mospajtimin, ironinë) e tij lidhur me një veprim, thënie a pohim të një tjetri, përdorime në rithënie informacionesh të të tjerëve. Një faqe interesante e habitores është edhe ajo e shprehjes së habisë e shoqëruar me ndjenja të forta gëzimi apo mllëfi. Shpesh të gjitha këto funksione të habitores shpalosen krejt natyrshëm edhe nga gërshetimi i paradigmave foljore në habitore me intonacionin karakteristik apo edhe me ndajfolje (*befas, papritmas, papritur, menjëherë, në mënyrë të papritur*).

Mënyra habitore në shqipe gjen përdorim në ligjërimin e përditshëm dhe në atë letrar, duke u paraqitur mjaft e gjallë në të folmet dhe krijimet popullore. Ajo gjithashtu afron me funksionet tregimtare të së tashmes historike, anë të së cilës i hasim gjerësisht në literaturën popullore. Habitorja në ligjërimin verbal e bën më të gjallë shprehjen e ndjenjave, ngjyimeve emocionale. Përdorimet e habitores në tekste me karakter studimor apo shkencor konsiderohen nga studiues të huaj si tejet të rralla.

Habitorja e shqipes shprehet në *të tashmen, të pakryerën, të kryerën* dhe *më se të kryerën* – ku, kuptimi kohor i së tashmes është i tanishëm ose i ardhshëm – me përdorime në të dyja diatezat. Edhe në gjermanishte kuptimi i shprehjes së habisë shtrihet në të shkuarën, të tashmen dhe në të ardhmen, në të dyja diatezat.

Në mungesë të një mënyre habitore të mirëfilltë në gjermanishte për të shprehur habinë apo ironinë e folësit përdoren një kompleks elementesh gramatikore, morfologjike, sintaksore, semantike apo stilistike. Shpesh gjatë kthimeve të fjalive me ndërtime të habitores në gjermanishte nuk kemi realizim gjuhësor adekuat dhe na ofrohet një tablo me ngjyime të zbehta habie. Ky defīçit gjuhësor rezulton më i madh në përdorimet e habitores me ngjyime dyshimi e ironie.

Për të shprehur habinë e folësit në gjermanishte përdoret kryesisht mënyra dëftore e shoqëruar shpesh me pjesëza modale [*ja, denn, doch, aber, wohl, eigentlich, schon, plötzlich, gerade* etj. (*ja, po, posi, por, në të vërtetë, tashmë, papritur, papritmas, tani*)], të cilat së bashku me intonacionin karakteristik mbajnë një peshë të veçantë në të gjitha shprehjet e habisë në

gjermanishte, qofshin këto edhe ironike, dyshimi, gëzimi, mllefi apo në ndërtime në ligjëratën e zhdrejtë.

Strukturat e habitores së shqipes në ligjëratën e zhdrejtë në gjermanishte jepen kryesisht me format epistemike të foljes modale *sollen* (duhet) në mënyrën dëftore, me ndërtime në mënyrën lidhore (Konjunktiv I, Konjunktiv II) të shoqëruara shpesh me ndajfolje të ndryshme [*angeblich (me sa duket)*] apo me pjesëza modale.

Për të shprehur habinë me nuanca ironie, mospajtimi apo dyshimi gjermanishtja përdor herë ndërtime me mënyrën dëftore e herë me atë lidhore (Konjunktiv I, Konjunktiv II), ndërtime me foljen *scheinen* (duket) apo ndajfolje [*scheinbar, anscheinend, angeblich (me sa duket, gjoja)*], me mbiemrin *offenbar* (e dukshme/i dukshëm), me pjesëza modale [*ja, aber, eigentlich, etwa, schon, doch, wohl, ruhig (ja, por, në të vërtetë, tashmë, posi)*].

Midis të dyja gjuhëve nuk kemi përputhje formale apo morfologjike, por kemi përjasje të dukshme, edhe pse jo të plotë, modale dhe funksionale.

Në të dyja gjuhët mënyra lidhore shpreh kryesisht modalitetin e mundësisë - por në disa përdorime të saj mund të shprehet edhe modaliteti i dëshirës ose i urdhërit. Në sistemin foljor të shqipes standarde përveç mënyrës lidhore, për të shprehur modalitetin e mundësisë është zhvilluar edhe një mënyrë e dytë, ajo kushtore. Në sistemin foljor të gjermanishtes së sotme nuk gjenden forma gramatikore të mënyrës kushtore. Përballë mënyrës lidhore dhe kushtore të shqipes qëndron ajo lidhore e gjermanishtes. Pas dëftores, lidhorja është mënyra më e përdorur, duke ofruar një larmi kuptimesh modale dhe një sistem foljor mjaft të pasur. Karakteristike për format foljore të lidhores është prania paralele si e kuptimit kohor ashtu edhe atij modal, i cili është mjaft i spikatur. Ndryshe nga dëftorja, lidhorja është mënyrë e shenjëzuar. Në gjermanishte lidhorja degëzohet në *Konjunktiv I* dhe *Konjunktiv II*, ku i pari trajtohet si mënyra për të dhënë ligjëratën e zhdrejtë, dhe i dyti si mënyra e jorealitetit dhe e dëshirave.

Shtrirja kohore e përdorimeve me lidhore në të dyja gjuhët u referohet veprimeve në të shkuarën, në të tashmen apo edhe në të ardhmen. Lidhorja si në shqipe edhe në gjermanishte është e pasur në kohë – më tepër kohë gjenden në lidhoren e gjermanishtes, duke krijuar diferencën me dy kohë: të ardhmen dhe të ardhmen e përparme. Në lidhoren e shqipes nuk gjenden forma foljore të së ardhmes, por këto përdorime mbulohen me anë të së tashmes lidhore, përdoren në disa tipe fjalish të nënrenditura, por edhe në fjali kryesore. Kur ligjëruesi përdor mënyrën lidhore, ai shpreh një qëndrim subjektiv dhe ligjërimi mbart ngjyrosje emocionale-subjektive. Larmia e ndërtimeve me lidhore në shqipe i atribuohet edhe

domosdoshmërisë morfologjike të disa foljeve apo togfjalëve, të cilët duhet domosdoshmërisht të pasohen nga një folje në lidhore. Këtë veçori gjuhësore të shqipes e hasim edhe në gjermanishte, por me ndryshimin, që te kjo e fundit shpesh kërkohet një folje në infinitiv.

Lidhorja e shqipes dhe Konjunktiv-i i gjermanishtes janë thuajse të ndryshme - pikat e takimit midis tyre janë të pakta. Përjasje të lidhoreve midis dy gjuhëve gjejmë kur shprehim një dëshirë, përdorim i cili gjen shtrirje kohore në të tashmen, të shkuarën dhe të ardhmen, porse ngjyrimet modale nuk paraqiten të njëjta në kohë të ndryshme. Me anë të së tashmes lidhore shprehet një dëshirë e menduar si e realizueshme – kryesisht në të tashmen apo të ardhmen në gjermanishte, dhe në të tashmen në shqipe – ndërsa me kohët e shkuara lidhore, të pakryerën, preteritumin dhe më se të kryerën, shprehet një dëshirë joreale në momentin e ligjëritimit, tashmë e parealizueshme. Format morfologjike të foljes *mögen* në lidhore në gjermanishte janë kthyer në këto përdorime në indikatorët e dëshirave. Në shqipe nuk hasim përdorime të këtilla të foljes përkatëse sikurse *mögen* në gjermanishte. Ndërtimet me foljen *mögen*, të cilat shprehin një dëshirë në gjermanishte, gjatë kthimit në shqipe, herë jepen me struktura morfologjike të lidhore e herë ato të dëshirores. Në të pakryerën lidhore në shqipe dhe në preteritumin lidhore në gjermanishte, dëshira e shprehur është joreale nga këndvështrimi i momentit të ligjëritimit.

Përdorime të lidhore me modalitetin e urdhërores konsiderohen në gramatika të të dyja gjuhëve si forma konkurruese të mënyrës urdhërore. Me anë të lidhoreve një urdhër mund të shprehet në të tashmen, por edhe në atë të pakryerën dhe në të kryerën, kryesisht në përdorime të ligjëratës së zhdrejtë.

Gjithashtu kemi përjasje në rastet kur, me anë të tyre shprehim *domosdoshmëri, gatishmëri, përpjekje, dëshirë, mundësi, aftësi, lejim, druajtje para një veprimi, frikë* apo *pendim* – përdorime të cilat i gjejmë në të dyja gjuhët, si në fjali të thjeshta ashtu edhe në të përbëra, shpesh pas foljeve modale apo me ngjyime modale me veçori semantike, por jo të gjitha ndërtimet me lidhore të shqipes jepen me lidhore në gjermanishte. Dy lidhoret afrohen edhe në pyetje me elemente dyshimi pas lidhëzave *sikur/wenn nun*, në fjali krahasuese joreale të shoqëruara me lidhëzat *sikur/wenn, po sikur/als wenn, si/als, po sikur/als ob* – te këto të fundit në gjermanishte përdoret Konjunktiv II, ndërsa në shqipe folja mund të jetë në lidhore ose në kushtore. Përafrim në përdorime gjejmë edhe në *fjalitë e nënrenditura vendore*, të ndërtuara me lidhëzat: *ku/wo, kudo që/wohin, wo auch immer, ngado që/wohin auch immer, nga/woher* - fjali të ngjyrosura nga ana modale, të cilat shprehin modalitetin e mundësisë duke

e paraqitur veprimin si mundësi, si diçka që mund të vërtetohet në të ardhmen apo që mund të vërtetohet në të shkuarën.

Përdorime të lidhore në të dyja gjuhët gjenden edhe në *fjali të nënrenditura lejore joreale* të ndërtuara me lidhëzat: *sado, sado që, sido, sido që, edhe sikur* etj., apo irrealer Konzessivsatz të drejtuar nga lidhëzat nënrenditëse: *obwohl (edhe pse), obgleich (edhe pse)* dhe *trotzdem (megjithatë)* në gjermanishte. Këto struktura gramatikore të lidhore në fjali lejore bartin ngjyrimet modale dhe kuptimi i tyre është kufizimi i shprehur.

Fjalitë e varura rrjedhimore joreale pas lidhëzave *që, aq sa* në shqipe dhe *als dass, dass* në gjermanishte janë me ngjyrim modal dhe përdoren në fjali me struktura gramatikore të lidhore. Kuptimi i tyre është ai i një pasojë të mundshme të rrjedhur nga një veprim tjetër i mundshëm. Në fjalitë rrjedhimore joreale lidhëzat kanë një domethënie të madhe - modaliteti i fjalisë shprehet me anë të këtyre lidhëzave nënrenditëse dhe jo përmes formave gramatikore të lidhore, siç ndodh në fjalitë e varura joreale kushtore.

Në struktura me folje modale, lidhorja e shqipes përdoret gjithashtu për të shprehur *një këshillë* - kthimi në gjermanishte realizohet gjithashtu me anë të foljeve modale të pasuara nga folje në infinitiv, duke ofruar përjasje në nivelin semantik, emocional, sintaksor e stilistik, por jo në atë morfologjik.

Format gjegjëse e një pjesë të konsiderueshme të ndërtimeve me lidhore të shqipes jepen në gjermanishte me dëftore, me ndërtime me *infinitiv* me *zu* apo me folje modale. Në shqipe kemi shpesh përdorim të lidhore pas foljeve që shprehin veprimtari apo të ngjashme me këtë të fundit: *fillon, vazhdon, shkoj* etj., folje me tiparin e zakonit: *ka zakon, ka traditë, është mësuar*; dhe folje, si: *qëllon, ndodh*. Në përdorime të këtilla mbizotëron komponenti kohor i paskohshmërisë dhe shembujt origjinalë apo kthimet në gjermanishte kërkojnë shpesh struktura me *infinitiv* me *zu* apo me dëftore. Pas foljeve që shprehin thënie, urdhër apo mendim: *kërkon, fton, thotë, lut, mendon* etj. lidhorja shfaqet në shqipe atëherë kur folja sinjalizon: një urdhër, kërkesë, leje etj. Kthimet në gjermanishte realizohen kryesisht me anë të foljeve modale apo me anë të strukturave *infinitiv* me *zu*. Në përdorime të këtilla midis dy gjuhëve gjejmë përputhje në nivelin semantik, sintaksor dhe stilistik, ndërsa ajo në nivelin morfologjik është e vakët: pjesët përbërëse të fjalisë, që i paravendosen lidhore në shqipe ruhen gjatë kthimit në gjermanishte, ndërsa foljet në lidhore nuk ruhen.

Përdorimet e lidhore në shqipe në *kompleksin e pyetjeve* janë të gjera dhe kanë ngjyrosje modale: *në pyetje direkte të thjeshta drejtuar bashkëbiseduesit lidhur me një dëshirë* apo *mendim të tij; në pyetje polemike (retorike), të cilat shprehin: inat, protestë* dhe përmbajnë

ngjyrim të fortë modal; në pyetje me komponentë të supozimit; në pyetje të zbërdhulura, me kundërshtim të zbehur, përzier me ndjenjën e entuziasmit ose të dëshpërimit. Gjegjëset në gjermanishte herë jepen me folje në lidhore e herë me dëftore ose me folje modale.

Në shqipe lidhorja shfaqet në *fjalitë e varura kohore* të shoqëruara me lidhëzat nënrenditëse: *kur, si, pasi, sapo, para se* etj. Spektri i përdorimeve në të tashmen krahasuar me kohët e shkuara është më i gjerë. Kthimet e fjalive të varura kohore në gjermanishte apo edhe shembujt në gjermanishten origjinale nuk kërkojnë struktura gramatikore në lidhore – ata orientohen drejt përdorimeve të dëftores. Argumentimi gjuhësor për këtë mund të gjendet pjesërisht në faktin, që këto fjali rrëfejnë kryesisht një të vërtetë, jo mundësi, ata karakterizohen nga vërtetësia, andaj dhe gjermanishtja ngërthen struktura gramatikore të dëftores.

Përdorime të lidhore në shqipe hasim edhe pas *përemrave lidhorë të pacaktuar*: *kush, ç', cili etj.*, ku lidhorja sinjalizon lejim apo mundësi të pacaktuar. Këto ndërtime të lidhore së shqipe në gjermanishte jepen me ndihmën e foljes modale: *mögen* duke e shfaqur pastër ngjyrosjen modale.

Përdorime të lidhore në shqipe pas ndërtimeve me strukturat "*është + mbiemër/ndajfolje/emër*": *është mirë, është gabim, është e domosdoshme* etj. kanë në vetvete ngjyime modale. Duke qenë se në të tilla përdorime strukturat e lidhore në gjermanishte janë në gjendje të ngurtësuar, me ndërtime të *foljes në infinitiv me zu*, koha e mënyra e fjalisë përcaktohet nga koha e foljes *jam/sein* në strukturën "*është + mbiemër/ndajfolje/emër*".

Në gjermanishte mënyra lidhore, Konjunktiv II gjen përdorim edhe në *fjalitë e thjeshta rrëfyese joreale*, dhe shërben për të shprehur një mundësi apo jorealitet. Shpesh fjalitë shoqërohen nga ndajfolje, si p.sh.: *fast (gati, pothuajse, thuajse), beinahe (gati-gati, thuajse)* apo me shprehje ndajfoljore *um ein Haar (për një qime)* në kuptim të ngjashëm apo të afërt. Kthimet në shqipe kërkojnë struktura gramatikore në mënyrën lidhore, por më tepër në atë kushtore. Përjashtime bëhen kur në gjermanishte kemi fjali rrëfyese e cila përmban strukturën gramatikore "*folje modale në Konjunktiv II + pjesoren e shkuar të foljes kryesore + folje ndihmëse werden në infinitiv*" – kthimi në shqipe këtu bëhet me forma foljore të lidhore me përmbajtje foljesh modale "*folje modale duhet në të pakryerën + foljen kryesore në kohën e kryer lidhore*".

Një ndryshim thelbësor midis vendit që zë lidhorja në shqipe dhe në gjermanishte është funksioni i saj në kthimin në ligjëratë të zhdrejtë. Këtu dy gjuhët sa shtyhen dhe afrohen njëra me tjetrën: shtyhen përsa i përket mënyrës që përdoret kryesisht në kthimin e ligjëratës së

zhdrejtë dhe afrohen në organizimin e procesit të kthimit në ligjëratë të zhdrejtë. Në gjermanishte ligjërata e zhdrejtë jepet përmes lidhore, më saktë përmes Konjunktiv I, ndërsa në shqipe përmes ndryshimit të kohëve, por jo të mënyrës. Përjasje kemi gjithashtu në praninë e foljeve të të shprehurit dhe të të menduarit si elemente të fjalisë në ligjëratën e zhdrejtë. Dy gjuhët afrohen njëra me tjetrën edhe në përdorimin e lidhore, kur kthejmë fjalitë e mënyrës urdhërore në ligjëratë të zhdrejtë. Përjasje kemi vetëm në përdorimet e shqipes me lidhëzën nënrenditëse *që*. Në shqipe mund të përdoret mënyra habitore, kur ligjëruesi apo shkrimtari duan të distancohen nga ajo çka thuhet. Parë nga këndvështrimi kuptimor, si në shqipe ashtu edhe në gjermanishte kemi përjasje të formave gjuhësore konkurruese që përdoren në dhënien e ligjëratës së zhdrejtë. Në të dyja gjuhët perspektiva e riprodhuesit dhe masa e informacionit të transmetuar bartin një peshë të konsiderueshme në realizimin e fjalisë në ligjëratën e zhdrejtë.

Në evolucionin e saj, gjuha gjermane ka kuruar një anë të veçantë në kuadrin e mirësjelljes, Konjunktiv II si strukturë gramatikore për të drejtuar një pyetje, lutje, kërkesë apo qoftë edhe për të shprehur një mendim ndryshe nga parafolësi. Këtë zhvillim gjuhësor të gjermanishtes nuk e gjejmë në shqipe. Nga kthimet e këtyre strukturave nga gjermanishtja në shqipe konstatojmë që shqipja është më direkte në situata të tilla duke përdorur dëftoren, lidhoren apo urdhëroren apo struktura me folje modale. Në shqipe peshën kryesore në këto pyetje-lutje-kërkesa e mban intonacioni si "arma" e respektit për të arritur me sukses në përmbushjen e kërkesës apo lutjes së parashtruar.

Në shqipe mënyra kushtore ashtu si edhe ajo lidhore ka modalitetin e mundësisë. Kushtorja ka dy kohë: të tashmen dhe të kryerën, format morfologjike të të cilave përputhen me ato të së ardhmes së shkuarës dhe së ardhmes përparme të së shkuarës dëftore. Duke qenë se në gjuhën e sotme gjermane nuk gjenden paradigma foljore të mënyrës kushtore, por vetëm fjalia kushtore joreale, është e pamundur të flitet për krahasim mbi formimin morfologjik të mënyrave midis dy gjuhëve.

Fjalitë e kushtores në shqipe janë të thjeshta dhe të nënrenditura. Lidhëzat nënrenditëse që përdoren në shqipe janë: *sikur, nëse, po qe se* etj. Në gjermanishte përballë këtyre lidhëzave qëndrojnë lidhëzat nënrenditëse: *wenn, als, als ob* etj. Si fjalitë e kushtores në shqipen origjinale edhe kthimet në gjermanishte gjejnë përdorim në ligjërimin e shkruar dhe në atë të folur duke u karakterizuar nga ngjyrimet modale. Mënyra kushtore gjen përdorim në fjali *pohuese, pyetëse, lejore, kushtore* dhe *krahasuese joreale*. Nga të gjitha përdorimet e kushtores spektrin më të gjerë e zënë pikërisht fjalitë kushtore joreale. Kur kthejmë fjalitë e

mënyrës kushtore nga shqipja në gjermanishte, kjo e fundit përdor forma foljore në të tashmen ose të shkuarën e lidhore (Konjunktiv II Gegenwart, Konjunktiv II Vergangenheit). Ndërtimet me mënyrës kushtore në shqipe dhe format gjegjëse në gjermanishte apo edhe anasjelltas kanë disa pika të përbashkëta në rrafshin semantik, sintaksor, stilistik, emocional dhe funksional.

Mënyra dëshirore me paradigmat e saj foljore bën pjesë në gjashtë mënyrat e shqipes standarde - me anë të saj ligjëruesi shpreh një dëshirë në formë urimi apo mallkimi. Në gjermanishten e sotme nuk gjenden paradigma foljore të mënyrës dëshirore, por haset fjalia dëshirore - si e tillë përcaktohet një tip fjalie që shërben për të shprehur një dëshirë. Në fjalitë dëshirore e tërë vëmendja si e folësit ashtu edhe e bashkëbiseduesit fokusohet te folësi, dhe nuk paraqit rëndësi studimore nëse dëshira apo mallkimi e/i shprehur realizohet apo ajo.

Mënyra dëshirore në shqipe ka dy kohë: të tashmen dhe të kryerën – format gramatikore të tyre dallohen shkoqur si në diatezën veprorë ashtu edhe në atë pësore. Midis këtyre dy kohëve e tashmja përdoret më dendur se e kryera. Duke qenë se në gjermanishte nuk gjenden format foljore të mënyrës dëshirore, është e pamundur të flasim për krahasim mbi formimin morfologjik midis dy gjuhëve.

Dëshiroja e shqipes është e shenjzuar minimalisht. Bazuar në funksionet e saj, ajo dhe format gjegjëse të saj në gjermanishte kanë një shtrirje relativisht të ngushtë, si në ligjërimin e folur, kryesisht në atë popullor, por jo vetëm, ashtu edhe në atë të shkruar, duke u fokusuar në literaturën artistike dhe nuk janë të pranishme në tekste e literatura me karakter shkencor. Në disa situata përdorimi i fjalitë e dëshirores në shqipe shoqërohen edhe me pasthirrma, si: *ah, aj, uh*, mjete gramatikore të cilat i japin ngjyrimë emocionale urimit apo mallkimit të shprehur. Në të dyja gjuhët fjalitë karakterizohen nga intonacioni ngjitës. Përdorimi i dëshirores lidhet kryesisht me ngjarje shenjuese të jetës së njeriut, me ngarkesë të veçantë emocionale.

Lëmi i madh i përdorimeve gjuhësore në shqipe na vërteton, që ajo ka evoluar duke vënë në dispozicion të gjuhëpërdoruesve edhe mjete të tjera gramatikore, si p.sh. mënyra të tjera gramatikore apo elemente gramatikorë shtesë për të shprehur një dëshirë a një mallkim. Këtu kemi përjasje midis shqipes dhe gjermanishtes, duke qenë se gjermanishtja ngërthen një kompleks elementesh morfologjike, sintaksore dhe semantike: *mënyrën dëftore, lidhore, urdhërore, foljet modale sollen (duhet) dhe mögen, pjesëzat modale* ose siç quhen në gjermanishte *Abtönungspartikeln*: *bloß, doch, nur (posi)*, si dhe *intonacionin karakteristik*. Përzgjedhja e mënyrës apo foljeve modale nga ana e ligjëruesit në gjermanishte mbështetet në

dy kriterë gjuhësorë: nëse ligjëruesi do të shprehë urim apo mallkim, dhe se sa e realizueshme është në perceptimin e tij dëshira e shprehur.

Dallimet midis fjalive në mënyrën dëshirore në shqipe dhe gjegjëseve në gjermanishte cekin disa nivele. Kur urimet ose mallkimet kthehen në gjermanishte nuk e bartin plotësisht vlerën e urimit apo mallkimit. Edhe pse ekziston kuptimi dëshiror i foljes dhe i fjalisë dëshirore, ekuivalenca midis këtyre strukturave nuk është e plotë - midis tyre ka dallime, shpesh të qenësishme. Këto dallime mund të jenë të rendit semantik ose ngjyrim semantik, të rendit stilistik dhe atij emocional. Përsa i përket ekuivalencës morfologjike ajo është zero. Kthimi i fjalive të mënyrës dëshirore në gjermanishte realizohet në kornizën e përshtatjes gjuhësore, duke qenë se qoftë foljet modale, qoftë strukturat me dëftore apo lidhore nuk mund të njehsohen me dëshiroren e kështu themi që, në mënyrë kategorike nuk bëhet fjalë për përkthim të pastër gjuhësor, dhe një kthim ekzakt haset tejet rrallë.

Vendi që zë urdhërorja në të dyja gramatikat është relativisht i kufizuar duke e bërë atë të paraqitet me një deficit krahasuar me mënyrat e tjera, porse ajo paraqitet me një larmi funksionesh. Urdhërorja nuk e ka kategorinë e kohës dhe të vetës, madje në gjermanishte ajo nuk e ka as kategorinë e genus verbi, gjë e cila e distancon nga shqipja. Kuptimi kohor i saj është i njëjtë si në shqipe edhe në gjermanishte: i tanishëm dhe i ardhshëm. Në të dyja gjuhët ajo ka vetëm format gramatikore të kohës së tashme dhe bazën për formimin e saj e gjen te koha e tashme e mënyrës dëftore. Parë nga këndvështrimi morfologjik, në shqipe urdhërorja nuk është gjithmonë e dallueshme nga mënyrat e tjera, por ajo dallohet qartë nisur nga rolet dhe funksionet e saj në fjali, nga tiparet sintaksore: intonacioni, shpejtësia dhe ritmi karakteristik. Ndërsa në gjermanishte format foljore të urdhërores janë gjithmonë të dallueshme.

Si në shqipe edhe në gjermanishte urdhërorja përdoret me të njëjtin funksion, për të shprehur një urdhër, kërkesë, propozim, ofertë, lutje apo këshillë. Përqasje kemi edhe në pikën që të dyja gjuhët mundësojnë përdorimin e formave gramatikore të së tashmes për veprime në të ardhmen duke i shoqëruar këto fjali me ndjafolje kohore. Më tej shprehemi se vetë gjuha ka krijuar disa forma konkurruese të urdhërores të cilat e përmbushin më së miri funksionin gramatikore të së ardhmes.

Vlera e urdhërores është e orientuar tërësisht në marrëdhënien midis ligjëruesit dhe dëgjuesit duke i atribuar dëgjuesit rolin bazë të urdhërores. Format e urdhërores në të dyja gjuhët janë të mirëpërcaktuara tashmë, qoftë nga pikëpamja morfologjike, edhe nga ajo funksionale. Urdhërorja zë një vend të rëndësishëm në ligjërimin verbal, sidomos në situata të përditshme

komunkimi, por edhe në ligjërimin e shkruar, kryesisht në literaturën artistike; nuk njihet përdorimi i saj në literatura me karakter shkencor. Në të dyja gjuhët mënyra urdhërore ka përjasje në nivelin formal, modal, semantik dhe funksional.

Te të dyja gjuhët përdoren edhe forma të tjera gramatikore të cilat trajtohen si konkurruese të urdhërores: të tashmen dhe të ardhmen e dëftores, mënyrën lidhore, foljet modale *duhet* (*sollen*), *dua* (*wollen*) dhe *lë* (*lassen*), *fjali në përbërje të të cilave janë folje me nuancë urdhri* (kërkoj, urdhëroj etj). Në gjermanishte gjejmë edhe forma të tjera konkurruese të urdhërores, të cilat nuk i hasim në shqipe: infinitivin dhe pjesoren e shkruar.

Në të dyja gjuhët gjenden një numër i caktuar foljesh të privuara nga formimi i urdhërores, si p.sh.: *disa folje modale*, foljet vetvetore, folje si: *vlen* (*gelten*), *rishoh një person* (*jemanden wiedersehen*), *njoh* (*kennen*), *marr* (*bekommen*), *banoj* (*wohnen*) etj.. Një sërë foljesh përdorimin e tyre normal në urdhërore e kanë në formën mohore, por nuk përjashtohen edhe rastet kur dalin me forma pohore.

Pasqyrë mbi mënyrat dhe kohët përkatëse në diatezën veprorë dhe pësorë në shqipe dhe gjermanishte

<i>Koha ...</i>	<i>Mënyra dëftore diateza veprorë</i>		<i>Mënyra dëftore diateza pësorë</i>	
	<i>shqipe</i>	<i>gjermanishte</i>	<i>shqipe</i>	<i>gjermanishte</i>
e tashme	unë pyes	ich frage	unë pyetem	ich werde gefragt
e pakryer / preteritum	unë pyesja	ich fragte	unë pyetesha	ich wurde gefragt
e kryer e thjeshtë	unë pyeta		unë u pyeta	
e kryer	unë kam pyetur unë jam lindur	ich habe gefragt ich bin gekommen	unë jam pyetur	ich bin gefragt worden
më se e kryer	unë kisha pyetur	ich hatte gefragt	unë isha pyetur	ich war gefragt worden
e kryer e tejshkuar	unë pata pyetur	-	unë qeshë pyetur	-
e ardhme / Futur I	unë do të pyes	ich werde fragen	unë do të pyetem	ich werde gefragt werden
e ardhme e përparme / Futur II	unë do të kem pyetur	ich werde gefragt haben	unë do të jem pyetur	ich werde gefragt worden sein
e ardhme e së shkuarës	unë do të pyesja	-	unë do të pyetesha	-
e ardhme e përparme e së shkuarës	unë do të kisha pyetur	-	unë do të isha pyetur	-

<i>Koha ...</i>	<i>Mënyra habitore diateza veprorë</i>		<i>Mënyra habitore diateza pësorë</i>	
	<i>shqipe</i>	<i>gjermanishte</i>	<i>shqipe</i>	<i>gjermanishte</i>
e tashme	unë pyetkam	-	unë u pyetkam	-
e pakryer	unë pyetkësja	-	unë u pyetkësja	-
e kryer	unë paskam pyetur	-	unë qenkam pyetur	-
më se e kryer	unë paskësja pyetur	-	unë qenkës pyetur	-

Koha ...	Mënyra lidhore diateza veprare		Mënyra lidhore diateza pësore	
	shqipe	gjermanishte⁴⁶⁶	shqipe	gjermanishte
e tashme	unë të pyes	ich frage (KI) ich komme (KI) ich würde fragen (KII) ich würde kommen (KII)	unë të pyetem	ich werde gefragt (KI) ⁴⁶⁷ ; ich sei gefragt (KI) ⁴⁶⁸
e pakryer / preteritumi	unë të pyesja	ich fragte (KII)	unë të pyetesha	ich würde gefragt (KII)
e kryer	unë të kem pyetur	ich habe gefragt ⁴⁶⁹ (KI)	unë të jem pyetur	ich sei gefragt worden (KI)
më se e kryer	unë të kisha pyetur	ich hätte gefragt (KII) ich wäre gekommen (KII)	unë të isha pyetur	ich wäre gefragt worden (KII)
e ardhme / Futur I	-	ich werde fragen (KI)	-	ich werde gefragt (werden) ⁴⁷⁰ (KI)
e ardhme e së shkuarës / Futur II⁴⁷¹	-	ich werde gefragt haben (KI)	-	ich werde gefragt worden sein (KI)

⁴⁶⁶ Duke qenë se në mënyrën lidhore në gjermanishte foljet e rregullta dhe ato të çrregullta sillen ndryshe, kemi vendosur të bëjmë një paraqitje tabelore me përfaqësuese nga të dyja grupet në mënyrë që të kemi një tablo më të qartë të fomimit të këtyre kohëve. Për grupin e foljeve të rregullta vijojmë me foljen *fragen* (pyes), ndërsa për grupin e foljeve të çrregullta kemi përzgjedhur foljen *kommen* (vij).

⁴⁶⁷ Në mënyrën lidhore diateza pësore në gjermanishte nuk gjenden forma foljore të KII.

⁴⁶⁸ Diatiza pësore me foljen ndihmëse „sein“ (jam).

⁴⁶⁹ Nëse format foljore të kohës më se të kryer lidhore përrputhen me format gramatikore të kohës më se të kryer dëftore, atëherë këto mund të zëvendësohen me format foljore të kohës më se të kryer lidhore (www.wissen.de).

⁴⁷⁰ Parë nga ana gramatikore forma „werde werden“ nuk tingëllon bukur fonetiki dhe nisur nga kjo shpesh lihet jashtë paskajorja e foljes *werden*. Kështu përkon forma e së ardhmes lidhore në pësore me atë të së tashmes lidhore në pësore (www.deutschegrammatik20.de).

⁴⁷¹ Këto forma gramatikore nuk janë të zakonshme në gjermanishte.

--	--	--	--	--

Koha ...	Mënyra kushtore diateza veprorë		Mënyra kushtore diateza pësore	
	shqipe	gjermanishte	shqipe	gjermanishte
e tashme	unë do të pyesja	-	unë do të pyetesha	-
e kryer	unë do të kisha pyetur	-	unë do të isha pyetur	-

Koha ...	Mënyra dëshirore diateza veprorë		Mënyra dëshirore diateza pësore	
	shqipe	Gjermanishte	shqipe	gjermanishte
e tashme	unë pyetsha	-	unë u pyetsha	-
e kryer	unë paça pyetur	-	unë qofsha pyetur	-

Koha ...	Mënyra urdhërore diateza veprorë		Mënyra urdhërore diateza pësore	
	shqipe	gjermanishte	shqipe	gjermanishte
-	Pyet!	Frag!	Çohu! ⁴⁷²	-

⁴⁷² Duke qenë se kthimi i foljes „pyes“ në urdhërore, në diatezën pësore nuk përbën kuptim në shqipe, kemi marrë si shembull ilustrimi foljen vetevetore „lahem“.

BIBLIOGRAFIA

- Abdiu, Xhemile - *Admirative In Turkish, Albanian And Romanian Languages*, Mediterranean Journal of Social Sciences, MCSER Publishing, Rome-Italy, Vol 5 No 19, August 2014
- Agalliu, Fatmir - *Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1988
- Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë – *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002
- Babel, Reinhard & Feeßler, Nadine & Fluhrer, Sandra & Huber, Sebastian & Thede, Sebastian - *Alles Mögliche: Sprechen, Denken und Schreiben des (Un)Möglichen*, Verlag Königshausen & Neumann GmbH, Würzburg, 2014
- Brünjes, Lena - *Das Paradigma deutscher Modalpartikeln. Dialoggrammatische Funktion und paradigmneninterne Oppositionen*, E-Book, 2014
- Buchholz, Oda & Fiedler, Wilfried - *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopädie Leipzig, 1987
- Buscha, Anne & Szita, Szilvia - *Begegnungen, Deutsch als Fremdsprache*, Schubert-Verlag, 2013
- Bußmann, Hadumod - *Lexikon der Sprachwissenschaft*, 3. Aktualisierte und erweiterte Auflage, Kröner, Stuttgart, 2002
- Безугла Л. Р., Бублик І. Ф., Відюкова Н. І., Криворучко С. І., Мірошніченко М. Ю., Потапова Ж. Є., Скачкова В. В., Сотникова С. , Login 2, *Deutsch für Germanistikstudenten*, NK Verlag, 2016
- Camaj, Martin - *Albanian Grammar with Exercises, Chrestomathy and Glossaries*, Otto Harrassowitz, Wiesbaden, 1984
- Çeliku, Mehmet & Karapinjalli, Mustafa & Stringa, Rudian - *Gramatika praktike e gjuhes shqipe*, Toena, Tiranë, 1998
- Demiraj, Shaban - *Studime filologjike, Rreth kategorive gramatikore të mënyrës dhe të kohës në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1977
- Demiraj, Shaban - *Morfologji e gjuhës së sotme shqipe*, II, Tiranë, 1970
- Demiraj, Shaban - *Morfologjia historike e gjuhës shqipe*, II, Tiranë, 1976
- Drügh, Heinz & Komfort-Hein, Susanne & Kraß, Andreas & Meier, Cécile & Rohowski, Gabriele & Seidel, Robert & Weiss, Helmut - *Germanistik: Sprachwissenschaft – Literaturwissenschaft – Schlüsselkompetenzen*, Springer Verlag, Deutschland, 2012

- DUZEN - Der kleine Duden, Deutsche Grammatik, Dudenverlag, Mannheim • Leipzig • Wien • Zürich, 2004
- DUZEN - Die Grammatik, Unentbehrlich für richtiges Deutsch 7., völlig neu erarbeitete und erweiterte Auflage*, Duden Band 4, Dudenverlag, Mannheim, 2005
- DUZEN – *Grammatik der deutschen Gegenwartssprache*, Duden Band 4, Mannheim, Leipzig, Wien, Zürich, 2003
- Dürich, Kristiane - *The Acquisition of the English Tense and Aspect System by German Adult Learners*, Magisterarbeit, Chemnitz, 2005
- DUZEN - Schülerduden Grammatik, Die Schulgrammatik zum Nachschlagen, Lernen und Üben, Dudenverlag Mannheim, Zürich, 2010
- Eisenberg, Peter - *Grundriss der deutschen Grammatik, Band 2: Der Satz, 2. Überarbeitete und aktualisierte Auflage*, Verlag J. B. Metzler, Stuttgart – Weimar, 2004
- Engel, Ulrich – *Deutsche Grammatik*, IUDICIUM Verlag GmbH München, 2004
- Engel, U. & Tertel, R. - *Kommunikative Grammatik Deutsch als Fremdsprache*, Iudicium, München, 1993
- Eppert, Franz - *Grammatik lernen und verstehen*, Klett Edition Deutsch, München, 1998
- Euler, Wolfram & Badenheuer, Konrad - *Sprache und Herkunft der Germanen. Abriss des Protogermanischen vor der Ersten Lautverschiebung*. Verlag Inspiration, Hamburg 2009
- Ferraresi, Gisella - *Grammatikalisierung, kurze Einführung in die germanistische Linguistik*, Universitätsverlag WINTER Heidelberg, 2015
- Fiedler, Wilfried – *Einführung in die Albanologie*, Meißen, 2006
- Friedman, Victor - *MACEDONIAN STUDIES 2*, Skopje, 2015
- Friedman, Victor - *The Study of Balkan Admirativity: Its history and development*, Balkanistica VI, 1980
- Gallmann, Peter - *Elementare Tempus/Modus-Kategorien*, Jena, 2012
- Graefen, Gabriele & Liedke, Martina – *Germanistische Sprachwissenschaft: Deutsch als Erst-Zweit- oder Fremdsprache*, Verlag Utb; Francke, 2008
- Gretel, Sarah - *Die verbale Kategorie: Evidenz im Albanischen und Türkischen*, Universität Zürich, Seminar für allgemeine Sprachwissenschaft, Zürich, 1987
- Hahn, Johann Georg - *Albanesische Studien*, Jena, Verlag von Dietrich Mauke, 1854

- Kirchhoff, Annette & Kirchhoff, Isabel & Levermann, Kirsten & Schlupp, Beatrix – Grammatik der deutschen Sprache, Schöningh Verlag, Paderborn, 2003
- Helbig, Gerhardt & Buscha, Joachim - *Deutsche Grammatik, ein Handbuch für den Ausländerunterricht*, Langenscheidt, Berlin und München, 2001
- Helbig, Gerhardt - *Zum Verhältnis von Grammatik und Fremdsprachenunterricht*. In: Deutsch als Fremdsprache 9, 1982
- Hentschel, Elke & Vogel, Petra M. – *Deutsche Grammatik*, De Gruyter Lexikon, Berlin, New York, ISBN-10: 3110185601, 2010
- Hentschel, Elke & Vogel, Petra M. – *Deutsche Morphologie*, De Gruyter Lexikon, Berlin, New York, 2009
- Hentschel, Elke & Vogel, Petra M. – *Handbuch der deutschen Grammatik: 4., vollständig überarbeitete Auflage*, de Gruyter GmbH, Berlin/Boston, 2013
- Heringer, Hans Jürgen - *Neues von der Verbszene*, Pädagogischer Verlag Schwann-Bagel GmbH Düsseldorf, 1984
- Heyse, J. C. A. Dr. - *Leitfaden zum gründlichen Unterricht in der deutschen Sprache für höhere und niedere Schulen, nach den größeren Lehrbüchern der deutschen Sprache*, Hannover, Hahnsche Hof-Buchhandlung, 1856
- Heinold, Simone - *Tempus, Modus und Aspekt im Deutschen: Ein Studienbuch*, Narr Francke Attempto Verlag, 2015
- Horn, Friedrich J. - *Grammatik der neuhochdeutschen Sprache auf historischer und logischer Grundlage*, Königsberg, 1837 (Botimi i ri: 2012)
- Igla, Birgit - *Das Romani von Ajia Varvara: Deskriptive und historisch-vergleichende Darstellung eines Zigeunerndialekts* (Balkanologische Veröffentlichungen an der Freien Universität Berlin, Band 29), Harrassowitz Verlag, 1996
- Imo, Wolfgang - *Grammatik, eine Einführung*, Metzler Verlag, Stuttgart, 2016
- Ismajli, Blertë - *Verbmodi im Deutschen und Albanischen im Vergleich, Der Fall Admirativ - Alles Mögliche: Sprechen, Denken und Schreiben des (Un)Möglichen*, Verlag Königshausen & Neumann GmbH, Würzburg, 2014
- Kabashi, Besim - *Automatische Verarbeitung der Morphologie des Albanischen*, Erlangen FAU University Press, University of Tirana, 2015
- Kahl, Thede & Metzeltin, Michael & Schaller, Helmut - *Balkanismen heute – Balkanism today*, LIT Verlag, Berlin, 2012

- Kleineidam, H. - *Fremdsprachengrammatik*, Gunter Narr Verlag, Tübingen, 1996.
- Langenscheidts Großwörterbuch, Berlin - München, 1998
- Krünitz, Floerken, Flörke - *Ökonomische-technologische Enzyklopädie, oder allgemeines System der Staats- Stadt- Haus- und Landwirtschaft*, Berlin, 1834
- Latour, Bernd - *Deutsche Grammatik in Stichwörtern*, Klett Edition Deutsch, Stuttgart, 1997
- Luscher, Renate & Schäpers, Roland - *Deutsch 2000, A Grammar of Contemporary*, Max Hueber Verlag, 1998
- Malo, Adi - *Vlerat stilistikore të kohëve të mënyrës dëftore në gjuhën italiane, në përqasje me shqipen*, Universiteti i Tiranës, 2012
- Jörg Meibauer, Markus Steinbach, Hans Altmann - *Satztypen des Deutschen*, 2013
- Morina, Vjosa – *Magisterarbeit "Modus und Tempus im Deutschen und Albanischen"*, Wien, 2009
- Myllyharju, Emma-Lotta - *Zum Konjunktiv I im Deutschen, Ein Vergleich zwischen der grammatischen Beschreibung und der Sprachwirklichkeit unter besonderer Berücksichtigung der Sprachentwicklung*, Pro Gradu Arbeit, Institut für moderne und klassische Sprachen, Deutsche Sprache und Kultur, Universität Jyväskylä, 2009
- Pani, Pandeli – *Die Diathesen im Albanischen und ihre indogermanischen Grundlagen*, Otto Harrassowitz Verlag, 1997
- Park, Myung-Sook - *Das Stellungsproblem des Verbalkomplexes im Deutschen und des Verbalsyntagmas im Koreanischen: Konfrontative Untersuchung über die lineare Struktur des Prädikatsausdrucks*, Berlin, 2011
- Pellengahr, Carsten - *DUDEN, Grammatiktabellen Deutsch*, Dudenverlag Berlin, 2016
- Radtke, Petra – *Die Kategorien des deutschen Verbs, zur Semantik grammatischer Kategorien*, Gunter Narr Verlag Tübingen, 1998
- Rexhepi, Sadije - *Kontrastive Analyse semantischer Merkmale von Vergangenheitstempora im Deutschen und Albanischen*, GERMANICA WRATISLAVIENSIA 135, Acta Universitatis Wratislaviensis No 3406, Wrocaw Prishtina, 2012
- Roelke, Thorsten – *Geschichte der deutschen Sprache*, Verlag, C. H. Beck, München, 2009
- Rothstein, Björn & Thieroff, Rolf - *Mood in the Languages of Europe*, John Benjamin Publishing Company, Amsterdam, Philadelphia, 2010
- Schlüsselkompetenzen*, Springer Verlag, Deutschland, 2012

- Schmidt, Wilhelm – *"Geschichte der deutschen Sprache"* Ein Lehrbuch für das germanistische Studium, S. Hirzel Verlag Stuttgart, 2013
- Schweikle, Günther - *Germanisch-deutsche Sprachgeschichte im Überblick*, Metzler Verlag, 1996
- Sommerfeldt, Karl-Ernst & Starke, Günter - *Einführung in die Grammatik der deutschen Gegenwartssprache*, Max Niemeyer Verlag, Tübingen, 1998
- Rabanus, Stefan - *Intonatorische Verfahren zwischen dem deutschen und Italienische: Gesprächsanalyse und autosegmentale Phonologie*, Linguistische Arbeiten 439, Tübingen Verlag, Niemeyer, 2001
- Tanaka, Shein - *Deixis und Anaphorik – Referenzenstrategien in Text, Satz und Wort, Linguistik – Impulse & Tendenzen*, De Gruyter, 2011
- Teichmann, Emine – *Handbuch Grammatik der albanischen Sprache Teil I*, GRIN Verlag, 2015
- Teichmann, Emine et al. – *Grammatisches Wörterbuch für Albanisch. Eine grammatisch-lexikographische Zusammenstellung*, GRIN Verlag, 2015
- Teichmann, Emine - *Cikël leksionesh*, 2016
- Vërçani, Brunilda – *Funksionet sintaksore të formave të pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme gjermane dhe në shqipen standarde*, Tiranë, 2016
- Volodina, Anna - *Einführung in die Sprachwissenschaft, Morphologie II: Nominale und verbale Flexion, Wortarten*, Universität Frankfurt, 2010
- Weinrich, Harald – *Textgrammatik der deutschen Sprache*, Dudenverlag, 1993
- W. Fortson, Benjamin - *Indo-European Language and Culture: An Introduction*, 2nd Edition, Wiley-Blackwell, 2009
- Xhafaj, Mirela - *Paralelizma në strukturën gramatikore të shqipes dhe të greqishtes*, Universiteti i Tiranës, 2012
- Xhelili, Avni - *Modaliteti i habisë si problem përkthimor*, Volume 7/2, 2014 37, LCPJ Publishing, 2014
- Gisela Zifonun, Ludger Hoffmann, Bruno Strecker - *Grammatik der deutschen Sprache*, Band 1,2, 3, De Gruyter, 1997

Websites:

<http://home.uni-leipzig.de/jtrommer/papers/MC1.PDF>

www.deutschegrammatik20.de

www.sprache-kompakt.de

www.deutschakademie.de

www.katharineum.de

www.inivie.ac.at

www.uni-marburg.de

www.mein-deutschbuch.de

www.deutschplus.net

www.canno.net

<http://www.literatur-hausarbeiten.com/literarische-gattungen/epik/Episches-Praeteritum.php>

<http://home.uni-leipzig.de/krueger/lehrews/geslaw/kentum-satem>

https://de.wikipedia.org/wiki/Episches_Praeteritum

LITERATURA ARTISTIKE

Asgjë e re nga fronti i perëndimit - Erik Maria Remark, shtëpia botuese “HORIZONT”, përkthyer nga Robert Shvarc, viti i botimit 1999

Im Westen nichts Neues - Erich Maria Remarque, shtëpia botuese „KIEPERNHEUER & WITSCH”, viti i botimit 1998

Kronikë në gur - Ismail Kadare, shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, viti i botimit 1971

Chronik in Stein - Ismail Kadare, përkthyer nga Joachim Röhm, shtëpia botuese “Residenz”, viti i botimit 1988

Me syrin e një kllouni – përkthyer nga Ardian Klosi, shtëpia botuese “DUDAJ”, viti i botimit 2016

Ansichten eines Clowns (& Billiard um halb zehn) – Heinrich Böll, shtëpia botuese “Lingen”, viti i botimit 1980